

DISERTACION
ANALIZA E MODELEVE TË RRITJES SË EFIÇIENCËS
NË SEKTORIN E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE: RASTI
I SHQIPËRISË

EVIS GJEBREA

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, me profil Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm, për
marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Arben Malaj

Numri i fjalëve: 82, 970

Tiranë, Qershor 2015

© **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Unë deklaroj me përgjegjësi dhe dijeni të pasojave ligjore që ka një deklaram i rremë se i gjithë dokumentacioni akademik është vepër/krijimtari e imja dhe nuk është as pjesërisht dhe as plotësisht plagjiaturë ose kopje e ndonjë autori tjetër. Deklaroj se procesi i mbledhjes, regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave si parësore dhe dytësore është pronësi e imja.

ABSTRAKTI

Tema e këtij punimi lidhet me analizën e tre modeleve të efijencës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri duke u thelluar me analizën e faktorëve që ndikojnë në rritjen e saj dhe trajton rajonalizimin e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve si një mënyrë për rritjen e efijencës. Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore, por nga kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm aktualisht shfrytëzohet vetëm 43% e burimeve ujore, çka tregon për një keqmenaxhim të burimeve ujore. Në Shqipëri aktualisht operojnë 58 shoqëri të ujësjellës dhe/ose kanalizimeve dhe indikatorët e performancës tregojnë një situatë jo të shëndetshme financiare. Përgjithësisht shoqëritë përballen pak a shumë me të njëjtat probleme, pavarësisht se shkalla e tyre varion nga një rajon në tjetrin.

Pyetjet kërkimore që ngre lidhen me gjetjen e faktorëve që ndikojnë në koston operative të shoqërisë, karakteristikat e modelit të rajonalizimit që i përshtatet rastit të Shqipërisë dhe gjetja e formës më të përshtatshme të Partneritetit Publik Privat në rastin e rajonalizimit të shoqërive.

Argumenti kryesor është se efijencia e shoqërive të sektorit të ujësjellës kanalizimeve arrihet kur sigurohen ekonomitë e shkallës dhe një ndër faktorët ndikues është numri i popullsisë së shërbyer. Konkretisht, synohet të analizohen modelet e rritjes së efijencës së shoqërive duke përdorur edhe partneritetin publik-privat ndërmjet pushtetit lokal dhe sektorit privat si instrument zbatimi. Identifikimi i opsionit më të mirë nga tërësia e opsioneve teorike është një prej sfidave të këtij punimi.

Baza teorike e punimit përfshin literaturën që lidhet me teoritë e menaxhimit të ujit, partneritetin publik privat dhe rishikimin e studimeve mbi rajonalizimin në vende të ndryshme. Kërkimi sasior përdor modelin ekonometrik për efijencën e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve dhe konkretisht modelin e Katrorëve të Vegjël dhe modelin Stokastik. Kërkimi cilësor merr në konsideratë intervistat gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve kryesore të përfshira në sektor dhe eksperiencën ndërkombëtare për rajonalizimin.

ABSTRACT

The aim of this paper is to analyze three efficiency models for water supply and sewerage sector in Albania by focusing on analysis of the factors affecting its efficiency and it analyzes the regionalization of water and sewerage utilities as a way to increase efficiency. Albania is a country rich in water resources, but out of the annual average capacity of all resources used for the production of drinkable water only 43 % of water resources is currently used, which shows mismanagement of water resources. In Albania currently operate 58 water and/or sewerage companies and performance indicators show an unhealthy financial situation. Companies generally face more or less same problems, regardless of their severity, which varies from one region to another.

The research questions that I raise are related to finding the factors that affect the company's operating costs, features of the regionalization model that fits the case of Albania and finding of the most appropriate form of Public Private Partnership in the case of regionalization of companies. The main argument is that the efficiency of water supply and sewerage companies is achieved when reaching economies of scale and one of the most impacting factors is the number of population served. Specifically, the aim is to analyze models of increasing efficiency of water and sewerage companies using the public-private partnership between local government and the private sector as an instrument of implementation. Identifying the best option from all theoretical options is one of the challenges of this work.

The theoretical ground of the research includes literature related to water management, public private partnership and review of studies on regionalization in different countries. The quantitative research uses econometric model for efficiency of the water and sewerage companies and concretely Ordinary Least Square model and Stochastic model. The qualitative research takes into account the semi-structured interviews with representatives of key institutions involved in the sector and international experience for regionalization.

DEDIKIMI

Dëshiroj që këtë punim t'ja dedikoj familjes sime të dashur, prindërve të mi Violeta dhe Shpëtim si dhe motrës sime Elona, të cilët përherë më kanë qëndruar pranë dhe më kanë mbështetur në ambiciet e mia profesionale dhe akademike.

FALENDERIME

Një falenderim i veçantë shkon për udhëheqësin shkencor Prof. Asoc. Dr. Arben Malaj, i cili më ka ndihmuar maksimalisht për realizimin e këtij punimi shkencor. E falenderoj udhëheqësin tim jo vetëm për mendimet e vyera dhe sugjerimet e vlefshme, por mbi të gjitha për inkurajimin dhe motivimin e nevojshëm për të kryer me sukses këtë studim. Një falenderim i veçantë i shkon Prof. Asoc. Dr. Arben Bakllamaja me ndihmën si ekspert në fushën e ujit, dhe përfaqësuesve të Entit Rregullator të Ujit për gadishmërinë që treguan në dhënien e informacionit të nevojshëm. Gjithashtu dëshiroj të falenderoj miken time Zj. Ada Shameti, e cila ka kontribuar në dhënien e sugjerimeve dhe redaktimit të këtij punimi, PhD Arjan Kadareja dhe PhD Juna Miluka për mbështetjen dhe sugjerimet për modelin ekonometrik.

Falenderoj prindërit e mi të dashur për mbështetjen, ndihmën e pakursyer dhe nxitjen e tyre për të arritur deri këtu. Ju keni qënë në çdo moment frymëzim dhe forcë për të vazhduar më tej dhe për të përfunduar me sukses këtë mision ambicioz dhe të vështirë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I - HYRJE	7
I.1 Përcaktimi i problemit dhe nën-problemeve	11
I.2 Njësitë e analizës dhe pyetjet kërkimore	17
I.3 Objektivat e kërkimit	18
KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS PËR PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT DHE PËRFSHIRJA NË SEKTORIN E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE	20
2.1 Hyrje	20
2.2 Koncepti teorik i PPP-ve	22
2.2.1 Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm	29
2.3 Teoria e menaxhimit të ri publik	30
2.4 Modele të tjera të reformimit publik	34
2.5 Argumentat pro dhe kundër PPP-ve	40
2.6 Llojet e kontratave të PPP-ve	44
KAPITULLI III: RAJONALIZIMI DHE EKSPERIENCA NDËRKOMBËTARE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE	59
3.1 Hyrje	59
3.2 Përkufizimi i rajonalizimit	60
3.3 Faktorët nxitës të rajonalizimit: përfitimet dhe kufizimet	62
3.3.1 Ekonomitë e shkallës	62
3.3.2 Rritja e mundësive për burime financiare	67
3.3.3 Ndarja e kostove	68
3.3.4 Kuadri ligjor	69
3.3.5 Faktori administrativ	70
3.4 Modelet e rajonalizimit	70
3.4.1 Harmonizimi i tarifave	75
3.5 Eksperienca ndërkombëtare: raste studimore të rajonalizimit	76

3.5.1	Franca.....	76
3.5.2	Hollanda.....	77
3.5.3	Italia	78
3.5.4	Brazili.....	80
3.5.5	Kosova	81
3.5.6	Rumania	82
3.6	Mësimet e nxjerra nga rastet studimore	83
KAPITULLI IV: KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL DHE PERFORMANCA E SEKTORIT TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN 2006-2012		86
4.1	Hartimi i politikave dhe strategjive.....	86
4.2	Administrimi i shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve	88
4.3	Kuadri rregullator i sektorit	94
4.4	Politika tarifore	97
4.5	Politika e subvencionimit.....	106
4.6	Kuadri rregullator për marrëdhëniet Operator-Bashki/Komunë-Klientë.....	115
4.7	Përmbledhje e kuadrit ligjor ekzistues nga perspektiva e rajonalizimit.....	118
4.8	Një vështrim i përgjithshëm i sektorit të ujësjellës kanalizimeve	121
4.9	Monitorimi i të dhënave të sektorit UK	125
4.10	Tendenca e performancës së sektorit për periudhën 2006-2012.....	133
4.11	Eksperienca pozitive të performancës së SHUK-ve në Shqipëri	141
4.12	Përse rajonalizim të shoqërive të UK si zgjidhje për eficiencën e sektorit dhe nxitjen e partneritetit publik privat në Shqipëri?	148
4.13	Tendenca e performancës së shoqërive rajonale: Durrës dhe Tiranë.....	152
4.14	Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e UK	160
KAPITULLI V: MODELI EKONOMETRIK PËR EFIÇIENCËN E SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE: KUADRI TEORIK		173
5.1	Metodologjia e kërkimit.....	173
5.2	Modeli cilësor	175

5.2.1	Intervistat gjysmë të strukturuar.....	177
5.2.2	Metodat deduktive dhe induktive.....	179
5.2.3	Vlerësimi i literaturës.....	179
5.3	Modeli sasior.....	180
5.4	Kampioni i përzgjedhur	182
5.5	Mundësitë dhe kufizimet	183
5.6	Rëndësia e studimit.....	185
5.7	Kuptimi teorik i maksimizimit të fitimit të shoqërisë U&K	185
5.8	Përshkrimi matematikor i funksionit të kostos	188
5.9	Të dhënat.....	189
5.10	Karakteristikat e funksionit të kostos.....	189
KAPITULLI VI: REZULTATET PËR EFIÇIENCËN E SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE		195
6.1	Rezultatet e modelit bazë OLS	195
6.2	Renditja e shoqërive sipas efiçencës.....	207
6.3	Krahasimi i renditjes së performancës së shoqërive me renditjen e ERRU.....	210
6.4	Mësimet e nxjerra në drejtim të modelit të propozuar për rastin e Shqipërisë	212
KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....		223
RËNDËSIA DHE RISITË		233
BIBLIOGRAFIA		234
SHTOJCAT		249

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Tabela 2.1: Modelet e reformimit publik.....	36
Tabela 2.2 Llojet e kontratave PPP.....	50
Figura 3.1 Ekonomitë e shkallës	63
Figura 3.2 Aksesit në financim.....	68
Tabela 3.1 Funksionet tipike të një kompanie tregëtare.....	71
Tabela 3.2 Format e rajonalizimit.....	72
Tabela 4.1 Funksionet dhe shërbimet e pushtetit vendor.....	89
Figura 4.1 Struktura institucionale e shoqërisë së ujësjellës kanalizimeve.....	92
Figura 4.2 Proçedura e aplikimit për tarifatat.....	98
Tabela 4.2 Strukturimi i tarifave.....	101
Tabela 4.3 Situata financiare e shoqërisë UK Durrës për periudhën 2008-2012.....	154
Tabela 4.4 Situata financiare e shoqërisë UK Tiranë për periudhën 2008-2012.....	157
Tabela 4.5 Situata e treguesve kryesore të performancës-konçesioni Elbasan.....	167
Tabela 4.6 Treguesit e projektit të Kavajës	169
Tabela 6.1 Përmbledhje e statistikave për modelet bazë OLS.....	195
Tabela 6.2 Modelet bazë OLS për periudhën 2006-2012.....	197
Tabela 6.3 Përmbledhje statistikash për modelet përfundimtare bazë OLS.....	200
Tabela 6.4 Modelet OLS për periudhën 2006-2012 vetëm për variablën mjedisore vëllimi i ujit të matur	202
Tabela 6.5 Modelet Stokastike të funksionit të kostos për periudhën 2006-2012.....	207
Tabela 6.6 Renditja finale e shoqërive UK sipas..... modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2012	208

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 4.1 Ecuria e tarifave të ujit të pijshëm për periudhën 2006-2012.....	104
Grafiku 4.2 Ecuria e tarifave të kanalizimeve për periudhën 2006-2012.....	106
Grafiku 4.3 Ecuria e subvencioneve në raport me.....	108
koston totale operative 2006-2012	
Grafiku 4.4 Prodhimi, shitja dhe uji pa të ardhura (në milionë m ³)	134
Grafiku 4.5 Raporti i mbulimit me shërbimet e ujësjellës dhe kanalizimeve.....	135
Grafiku 4.6 Niveli i matjes së konsumimit të ujit.....	135
Grafiku 4.7 Kosto Direkte Operative dhe çmimi mesatar (lek/m ³).....	136
Grafiku 4.8 Mbulimi i KTO me të ardhura, arkëtime.....	137
dhe subvencione (përqindje %)	
Grafiku 4.9 KTO për m ³ prodhuar, shitur dhe çmimi mesatar	137
Grafiku 4.10 Cilësia e shërbimit.....	138
Grafiku 4.11 Stafi për 1000/lidhje.....	141
Grafiku 4.12 Niveli i matjeve dhe uji pa të ardhura.....	142
Grafiku 4.13 Mbulimi KDO me të ardhura/arkëtime/subvencione.....	143
Grafiku 4.14 Kohëzgjatja e furnizimit orë/ditë.....	143
Grafiku 4.15 Stafi për 1000/lidhje	144
Grafiku 4.16 Niveli i matjeve dhe uji pa të ardhura.....	145
Grafiku 4.17 Mbulimi KDO me të ardhura/arkëtime	145
Grafiku 4.18 Mbulimi KTO me të ardhura/arkëtime	146
Grafiku 4.19 Kohëzgjatja e furnizimit orë/ditë.....	147
Grafiku 4.20 Numri i shoqërive sipas popullsisë së shërbyer/mesatare.....	149
e ponderuar sipas grupimit të shoqërive	
Grafiku 4.21 Stafi për 1000 lidhje/mesatare e ponderuar	150
sipas grupimit të shoqërive	
Grafiku 4.22 Kosto Totale Operative për m ³ ujë të shitur	151
dhe prodhuar/ mesatare e ponderuar sipas grupimit të shoqërive	
Grafiku 4.23 Mbulimi i koston direkte operative me të ardhurat.....	151
dhe arkëtimet/ mesatare e ponderuar sipas grupimit të shoqërive	
Grafiku 4.24 Totali i financimeve të angazhuara dhe disbursuara.....	161
donatorë bilateralë si për qindje 2000-2012	

Grafiku 4.25 Totali i financimeve të angazhuara dhe disbursuara.....	162
donatorë bilateralë në vlerë absolute /2000-2012	
Grafiku 4.26 Totali i financimeve sipas donatorëve multilateralë si përqindje.....	164
2000-2012	
Grafiku 4.27 Totali i financimeve sipas donatorëve multilateralë.....	165
në ‘000 Euro	

SHTOJCA

- Shtojca 1** Lista e 29 shoqërive dhe numrit të popullsisë me akses te ujësjellës kanalizimet
- Shtojca 2** Intervista me Z.Avni Dervishi, Kryetar i Entit Rregullator të Ujit
- Shtojca 3** Intervista me Z. Altin Uka, ish Komisioner pranë ERRU
- Shtojca 4** Intervista me Z. Arjan Jovani, ish Komisioner pranë Entit Rregullator të Ujit
- Shtojca 5** Intervista me Zj. Ana Metohu, Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe të Monitorimit pranë Entit Rregullator të Ujit
- Shtojca 6** Intervista me Zj.Vilma Bibolli/ Drejtor, Njësia e Monitorimit të të dhënave & Benchmarking
- Shtojca 7** Intervista me Zj. Ljutvilda Gugushka Drejtor, Drejtoria e Rajonalizimit dhe Politikave, MPPT
- Shtojca 8** Intervista me Zj. Afrida Saraçi, Shefe e Sektorit të Monitorimit të Buxhetit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Buxhetit në Ministrinë e Brendshme
- Shtojca 9** Intervistë me Zj. Gelardina Prodani, Drejtor, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, Ministria e Financave
- Shtojca 10** Intervistë me Z. Dokllead Ademi, Drejtor i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe ish Kryetar i Shoqatës së Bashkisë
- Shtojca 11** Intervista me Z. Taulant Zeneli, Drejtor-Bashkia Tiranë
- Shtojca 12** Intervista me Z. Bledar Dollaku, Kordinator projektsh pranë KfW
- Shtojca 13** Intervistë me Z. Arben Bakllamaja-ekspert në sektorin e ujësjellës kanalizimeve
- Shtojca 14** Intervistë me Z. Philip D. Giantris, President i Valu Add Management.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE PËRKUFIZIMEVE

AMK	Agjencia e Mirëbesimit të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BWI	Berlinwasser International
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve
EEA	European Environment Agency
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
KDO	Kosto Direkte Operative
KTO	Kosto Totale Operative
KfW	Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim
MeF	Ministria e Financave
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MRP	Menaxhimi i Ri Publik
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
PPP	Partneriteti Publik-Privat
PBA	Programi Buxhetor Afat-Mesëm
SHUK	Shoqëri Ujësjiellës Kanalizime
UK	Ujësjiellës Kanalizime
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave

FJALOR I TERMAVE

Bashki: Njësi administrative urbane me një popullsi mbi 4,000 banorë dhe që ka një zhvillim industrial.

Cilësi shërbimi: Kjo ka të bëjë me “orët e furnizimit me ujë” dhe “presionin e ujit”.

Komunë: Një njësi vendore, rurale, territoriale dhe administrative që drejtohet nga një shef, i cili zgjidhet për një mandat 4-vjeçar nga banorët e kësaj njësie administrative.

Metër Kub: Njësia matëse e volumit që është e barabartë me 1,000 litra.

Rajon: Një njësi vendore, territoriale dhe administrative, e cila përbëhet nga më shumë se një bashki dhe disa komuna.

KAPITULLI I - HYRJE

Ky studim në mbrojtje të titullit “Doktor i Shkencave” ka dy qëllime kryesore: *së pari*, të analizojë rritjen e eficiencës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve (UK) në Shqipëri duke u thelluar në analizën e faktorëve që ndikojnë në rritjen e saj dhe *së dyti*, të analizojë rajonalizimin e shoqërive UK si një mënyrë për rritjen e eficiencës. Konkretisht, në këtë studim synohet të analizohen modelet e rritjes së eficiencës së shoqërive UK duke përdorur edhe partneritetin publik-privat (PPP) ndërmjet pushtetit lokal dhe sektorit privat. Identifikimi i opsionit më të mirë nga tërësia e opsioneve teorike është një prej sfidave të këtij studimi.

Dobishmëria kryesore e këtij studimi synon të jetë një kontribut i ri në fushën e politikave publike, në rastin konkret në cilësinë dhe koston e furnizimit me ujë, si një prej sfidave konkrete me të cilat përballlet një pjesë e konsiderueshme e popullatës së vendit tonë. Po kështu problematika e furnizimit me ujë në shumë zona të vendit, por kryesisht në zonat potenciale për zhvillim të intensifikuar siç është bregdeti i vendit tonë, përbën një nga pengesat për një zhvillim më të plotë të këtyre zonave me ndikime pozitive në ekonominë e vendit në tërësi. Studimi synon të analizojë dhe evidentojë faktorët që duhet të merren në konsideratë për uljen e kostos operative dhe bashkimin e shoqërive, si një alternativë për rritjen e eficiencës së shoqërive duke përdorur PPP si një instrument të rëndësishëm zbatimi.

PPP është mjaft i përhapur dhe ka rezultuar të jetë një nga instrumentat më përfituese si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim nisur nga kontributi që sjellin në zhvillimin ekonomik.

PPP-të morën popullaritet në fillim të viteve 1980 kur ineficiencat e ndeshura nga institucionet publike çuan në krijimin e të ashtuquajturës MRP në Mbretërinë e Bashkuar (në kohën e Margaret Thatcher) dhe në vende të tjera Anglo-Saksone. Shumë qeveri në vende të ndryshme i kanë parë PPP-të si mënyra alternative për menaxhimin e

shërbimeve publike dhe financimin e tyre nëpërmjet projekteve komplekse infrastrukturore (Pollit & Bouckaert, 2011: 6).

Në nivel botëror uji konsiderohet një burim që sa vjen dhe po rrallohet dhe janë disa faktorë që shkaktojnë këtë fenomen të tilla si ngrohja globale, rritja e popullsisë që ushtron presion për më shumë ujë dhe ndryshimet demografike nga zhvendosja e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane. Debati për ujin është bërë një çështje e rëndësishme jo vetëm në rang kombëtar, por edhe atë ndërkombëtar, fakt ky që tregohet nga përfshirja e çështjes së ujit në Axhendën 21 të Kombeve të Bashkuara në vitin 1992 në kuadër të Objektivave të Sfidës së Mijëvjeçarit¹. Uji nga një mall i lirë apo social është kthyer në një mall konsumi dhe mjaft kushte globale që kanë ndodhur dhe po ndodhin kanë çuar në rrallësinë e këtij malli². Si rrjedhim ndër sfidat e shekullit të XXI është menaxhimi me efektivitet dhe efikasitet të ujit. Madje dhe teoria e menaxhimit të ujit ka ndryshuar duke futur konceptin e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe lidhjen e tij me sektorë të tjerë si shëndetësia, mjedisi, bujqësia dhe industria.

Spektori publik megjithëse mund të ofrojë shërbime me çmime të ulta, e dëmton të varfërin për shkak të pamundësisë për të kryer investime dhe si rrjedhim cilësia e ujit është e dobët (Gray, 2001:10). Ndërkohë ekziston një literaturë e gjerë se tregjet private për ujin sjellin përfitime nga efikasiteti dhe janë në gjendje që të alokojnë si duhet ujin në sektorë të tjerë (Easter & Hearne, 1995:9-20; Chang & Griffin, 1992:879-890; Colby, 1990: 1184-1192; Crane, 1994:71-83). Në këtë llogjikë ajo që po debatohet është përfshirja e PPP-ve në sektorin e UK dhe argumenti kryesor është ineffikasiteti e sektorit në vendet në zhvillim. Një element i rëndësishëm i efikasitetit, që është edhe një ndër përfitimet që vijnë nga PPP-të është arritja e ekonomive të shkallës. Një ndër mënyrat e realizimit të ekonomive të shkallës është bashkimi i disa njësive, të cilat do t'i shërbejnë një numri më të gjerë konsumatorësh. Ky koncept po aplikohet sot gjerësisht në sektorin e UK si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim. Termi që përdoret sot në këtë sektor është rajonalizimi i shoqërive të UK.

¹ <http://www.un.org/geninfo/bp/enviro.html>

² <https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Entwicklungsbank/Sectors/Wasser/>

Rajonalizimi shihet si një mundësi për të patur akses ndaj menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)³ e datës 23 Tetor 2000 për menaxhimin e burimeve ujore përcakton kuadrin e përgjithshëm të përdorimit dhe menaxhimit me efikasitet të burimeve ujore dhe ofron një sistem të vetëm menaxhimi të ujit nëpërmjet baseneve të lumenjve si njësi natyrore gjeografike dhe hidrike, në kontrast me kufijtë administrativë dhe politikë.

Në Shqipëri janë të pakta studimet e thelluara mbi rolin e PPP-ve në zhvillimin ekonomik të një vendi. Po kështu nuk ekzistojnë studime të thelluara mbi rritjen e efikasitetit të sektorit të UK. Banka Botërore dhe Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) kanë kryer disa studime në këtë fushë. Konkretisht, Banka Botërore ka kryer studime mbi decentralizimin⁴, rritjen e efikasitetit të sektorit dhe projektet e investimeve, ndërkohë që KfW ka kryer studime për projektet e investimeve të kryera në disa qytete si: Korçë, Pogradec, Kavajë, Kukës, Rrogozhinë, Lushnjë, Berat, Kuçovë, Sarandë, Gjirokastrë, Lezhë dhe Fier⁵. Së fundmi u përgatit master plani i investimeve në sektorin e UK nga një kompani konsulente gjermane mbi nevojat e financimit të sektorit UK deri në vitin 2040.

Ndonëse ekzistojnë disa studime siç u përmend më sipër, ajo që mungon janë studimet akademike sektoriale, të cilat janë të pakta ose jo mirë të dokumentuara. Rajonalizimi është një debat mjaft aktual dhe prioritar në sektorin e UK dhe vlerësohet si një mënyrë për të rritur efikasitetin e tij. Kjo iniciativë propozuar nga Banka Botërore ka hyrë në axhendën e Qeverisë Shqiptare duke u bërë një ndër objektivat e Strategjisë Kombëtare për sektorin e UK 2011-2017. Fokusimi i kërkimit shkencor në shërbim të sfidave konkrete të vendeve tona është arsyeja kryesore përse ndërmarr këtë studim akademik të thelluar duke patur si synim të analizoj faktorët që ndikojnë në uljen e kostos operative të shoqërive të U/K dhe më pas të propozoj një model rajonalizimi në rastin e

³ Direktiva 2000/60/EC amenduar së fundi me direktivën 2009/31/EC më 23.04. 2009

⁴ Studimi mbi Decentralizimin dhe Privatizimin e Sektorit të Ujit në Shqipëri, 2004

Raporti nr. 64412-AL mbi Decentralizimin dhe Realizimin e Shërbimeve në Shqipëri: Qeverisja në Sektorin e Ujit, 2011

⁵ Disa nga studimet e kryera nga KfW që mund të përmendim janë: (i) studimi për UK Korçë me vlerë investimi mbi 60 milionë Euro; (ii) studimi dhe projekti në Pogradec, Kavajë, Kukës, Rrogozhinë, Lushnjë, Berat & Kuçovë; (iii) studimi i besueshmërisë për kanalizimet dhe ujërat e zeza në Shkodër me vlerë investimi 60 milionë Euro; (iv) studimi për projektin që po zbatohet aktualisht në 4 qytete si Saranda, Gjirokastra, Lezha, Fieri me një vlerë investimi prej 25-30 milionë Euro.

Shqipërisë. Që ky model të jetë i zbatueshëm është e rëndësishme gjetja e modelit përkatës të Partneritetit Publik Privat.

Jam shpresëplotë se bashkëpunimi me institucionet e tjera kërkimore shkencore, me autoritetet qendrore e vendore, me entet rregullatore dhe mbikqyrëse do të më ndihmojnë në plotësimin e një studimi shkencor sa më të dobishëm. Synoj që ky studim mund të ofrojë variante alternative të vlefshme për investitorët privatë të interesuar për të investuar në këtë sektor, i vlefshëm për qeverinë qendrore apo vendore për të ofruar bashkëpunim të suksesshëm me privatë në funksion të rritjes së cilësisë dhe kostove optimale të furnizimit me ujë, ose të nxisë studime të integruara dhe më të thelluara për gjetjen e një zgjidhjeje optimale për problemet reale, të vështira dhe të zvarritura në sektorin e UK.

Ky studim doktrature strukturohet në 7 kapituj. Hyrja e prezantuar më sipër përfshin problemin dhe nën-problemet, njësitë e analizës dhe pyetjet kërkimore, objektivat e kërkimit.

Kapitulli i dytë i dedikohet rishikimit të literaturës dhe debateve përkatëse të PPP-ve dhe përfshirjes së tyre në sektorin e UK. Kapitulli ndahet në dy pjesë: pjesa e parë lidhet me evolucionin e PPP-ve si një risi e viteve 1980 për të rritur efikasitetin në ofrimin e shërbimeve publike dhe pjesa e dytë trajton teoritë dhe debatet mbi ujin në përgjithësi në nivel botëror dhe debatet që zhvillohen mbi rritjen e efikasitetit në këtë sektor.

Kapitulli i tretë trajton rajonalizimin dhe eksperiencat ndërkombëtare në sektor. Pjesa e parë e kapitullit i dedikohet përkufizimit të rajonalizimit, faktorëve nxitës dhe pengues. Në pjesën e dytë jepen eksperiencat ndërkombëtare që përfshin si vende të zhvilluara ashtu dhe vendet në zhvillim. Në pjesën e tretë jepen mësimet e nxjerra, të cilat do të shërbejnë për të analizuar rastin e sektorit të UK në Shqipëri.

Kapitulli i katërt trajton kuadrin ligjor, institucional dhe performancën e sektorit të UK. Pjesa e parë lidhet me analizën e kuadrit ligjor dhe institucional që përfshin një përmbledhje të ligjeve, strategjive dhe akteve të tjera nënligjore dhe institucioneve

përgjegjëse në drejtim të menaxhimit të burimeve ujore, hartimit të strategjive dhe politikave të sektorit të ujit, administrimit të sektorit dhe rregullimit të tij. Qëllimi i kësaj analize është i dyfishtë: *së pari*, të rendisë anët pozitive dhe mangësitë e kuadrit ligjor dhe *së dyti*, të përcaktojë ligjet, rregullat, dhe aktet e tjera, të cilat e favorizojnë apo përgatisin terrenin për rajonalizimin. Qëllimi përfundimtar është të shihet sesa i gatshëm është pushteti vendor, pushteti qendror për ta promovuar skemën e rajonalizimit. Pjesa e dytë e këtij kapitulli lidhet me analizën e performancës së sektorit të UK në Shqipëri për periudhën 2006-2012 nëpërmjet analizës së indikatorëve të performancës. Qëllimi është të analizohet në tërësi performanca e sektorit për aspekte të menaxhimit, financiar dhe teknik. Një pjesë e rëndësishme në këtë kapitull i dedikohet analizës së ekonomive të shkallës nëse janë ekzistente ose jo në rastin e Shqipërisë.

Kapitulli i pestë i dedikohet metodologjisë dhe analizës ekonometrike për të analizuar dhe testuar modelet e rritjes së efijencës së shoqërive të U/K. Metodologjia ndahet në atë sasiore dhe cilësore dhe prezantohen mjetet përkatëse. **Krahas metodologjisë jepen mundësitë dhe kufizimet si dhe rëndësia që ka studimi për palët e interesuara.** Analiza ekonometrike trajton modelin ekonometrik të përdorur për efijencën e shoqërive dhe argumentohet se cilët janë faktorët që duhet të analizohen për të minimizuar koston operative të shoqërive U/K. Rezultatet e këtij kapitulli janë të rëndësishme për të vërtetuar hipotezat e ngritura dhe pyetjet kërkimore dhe shërbejnë për dhënien e rekomandimeve përkatëse.

Kapitulli i gjashtë i dedikohet rezultateve nga testimi ekonometrik dhe analizës cilësore. Një pjesë e rëndësishme i dedikohet krijimit të një modeli të rajonalizimit në rastin e Shqipërisë. Kapitulli i shtatë përfshin konkluzionet dhe rekomandimet.

I.1 Përcaktimi i problemit dhe nën-problemeve

“Një problem mund të përkufizohet si çështje që ekziston në literaturë, teori, ose praktikë që çon në domosdoshmërinë për studimin” (Creswell, 1994:50). “Përcaktimi i problemit përshkruan kontekstin për studimin dhe identifikon qasjen e përgjithshme të analizës” (Wiersma, 1995:404).

Në këtë kapitull do të parashtrohet problemi kryesor dhe nën-problemet, të cilat përbëjnë një bazë të fortë për realizimin e këtij studimi. Më pas do të prezantohen njësitë e kërkimit, objektivat, metodologjia, mundësitë dhe kufizimet e studimit dhe rëndësia që paraqet trajtimi i problemit për palët e interesuara.

Sikurse u përmend në hyrje të këtij kapitulli në nivel botëror uji konsiderohet një burim që sa vjen dhe po rrallohet dhe janë disa faktorë që shkaktojnë këtë fenomen të tilla si: (i) ngrohja globale; (ii) rritja e popullsisë që ushtron presion për më shumë ujë dhe (iii) zhvendosja e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane (OECD, 2012:11). Migrimi i popullsisë është veçanërisht shqetësues për vendet në zhvillim ku zhvendosja e popullsisë është e pakontrolluar dhe kjo e bën akoma dhe më të vështirë sigurimin e shërbimeve bazë siç është furnizimi me ujë dhe aksesin ndaj kanalizimeve.

Vendi ynë është shumë i prekur nga zhvendosjet e popullsisë dhe nga problematika e trashëguar e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. Pranë qyteteve më të mëdha të vendit janë krijuar zonat e mëdha të të ardhurve, ku ka munguar tërësisht infrastruktura e furnizimit me ujë dhe kanalizimet (MPPTT, 2011:23). Zhvendosjet e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane kanë krijuar vështirësi edhe për furnizimin e vetë qyteteve, pasi sasia e ujit ka qënë e pamjaftueshme dhe presioni për dëmtime të rrjeteve dhe përfitimeve të ujit pa pagesë është bërë kritike për mbijetesën teknike e financiare të ujësjellësave.

Aktualisht Shqipëria po zbaton Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me objektivin final për t'u bërë pjesë e Bashkimit European. Kjo kërkon përputhje të plotë me direktivat e BE-së në të gjithë sektorët përfshirë atë të ujit. Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE) e datës 23 Tetor 2000 për menaxhimin e burimeve ujore përcakton kuadrin e përgjithshëm të përdorimit dhe menaxhimit me efikasitet të burimeve ujore dhe ofron një sistem të vetëm menaxhimi të ujit nëpërmjet baseneve të lumenjve si njësi natyrore gjeografike dhe hidrike, në kontrast me kufijtë administrativë dhe politikë.

Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore dhe me kapacitetin aktual që disponon është në gjendje të plotësojë nevojat e popullsisë. Sfidat mbetet përdorimi me efektivitet

i burimeve ujore. Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm është 654 milionë m³ (DPUK, 2010:17)⁶, ndërsa volumi mesatar i ujit të prodhuar rezulton 278 milion m³(DPUK,2012). ***Kjo tregon se aktualisht shfrytëzohet vetëm 43% e burimeve ujore.*** Duke supozuar se e gjithë popullsia që jeton në zonën e juridiksionit do të furnizohej me ujë të pijshëm, për shkak të humbjeve në rrjet dhe keq përdorimit për qëllime të tjera, prodhimi i ujit është 31% më i lartë sesa kërkesat për ujë të pijshëm. Ndërsa volumi i ujit të faturuar (shitur) përmbush vetëm 54% të kërkesave në nivel sektori (DPUK,2012).

Këto fakte nxjerrin në pah jo vetëm keqpërdorimin e burimeve, por tregojnë kostot e larta financiare të shoqërive të U/K. Në Shqipëri aktualisht operojnë 58 shoqëri të U/K sipas të dhënave për vitin 2012 dhe indikatorët e performancës tregojnë një situatë jo të shëndetshme financiare, madje kritike. Përgjithësisht shoqëritë përballen pak a shumë me të njëjtat probleme, pavarësisht se shkalla e tyre varion nga një rajon në tjetrin.

Disa nga këto probleme me të cilat ndeshen shoqëritë në nivel sektori sipas të dhënave të Entit Rregullator të Ujit janë (ERRU, 2012:46-48⁷):

- (i) Shkallë relativisht e ulët e furnizimit me ujë: 80 % mbulimi në përgjithësi nga e cila: 90% në zonat urbane dhe 60 % në zonat rurale⁸.
- (ii) Mbulimi me shërbime të kanalizimit të ujërave të zeza është në nivelin e 50% në përgjithësi nga të cilat: 70% në zonat urbane dhe 17% në zonat rurale⁹.
- (iii) Shkalla e humbjes (pjesa e ujit që prodhohet e futet në sistem, por që nuk gjeneron asnjë të ardhur) është përafërsisht 67 %, ndërkohë që shifra në Europën Perëndimore është në masën 20%, kurse standarti sipas ERRU është 30%. Kjo shkaktohet sepse niveli i instalimit të matësve është në nivele të ulëta, ekzistojnë lidhje ilegale në rrjet dhe rrjeti është i amortizuar.

⁶ Raporti “5 vjet Benchmarking”, 2011, fq. 17

http://www.dpuk.gov.al/5_vjet_benchmarking_vilma_bibolli_2011.pdf

⁷ Raporti i Performancës për vitin 2012, fq. 46-48

⁸ Ndarja zona urbane/zona rurale për furnizimin me ujë është llogaritur sipas të dhënave të DPUK për vitin 2012 të: (i) numrit të popullsisë që furnizohet me ujë nga shoqëria në qytet (1'986'919.17 banorë) kundrejt numrit të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit në qytet (2'222'763.58 banorë); (ii) numrit të popullsisë që furnizohet me ujë nga shoqëria në fshat (600'008.83 banorë) kundrejt numrit të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit në fshat (1'008'052.42 banorë).

⁹ Ndarja zona urbane/zona rurale për shërbimet e kanalizimeve është llogaritur sipas të dhënave të DPUK për vitin 2012 të: (i) numrit të popullsisë me lidhje në sistemin e kanalizimeve në qytet (1'558'646.75 banorë) kundrejt numrit të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit në qytet (2'222'763.58 banorë) (ii) numrit të popullsisë me lidhje në sistemin e kanalizimeve në fshat (28'296.42 banorë) kundrejt numrit të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit në fshat (1'008'052.42 banorë).

(iv) Vazhdueshmëria e furnizimit me ujë është mesatarisht 10.8 orë, ndërkohë që standarti në vendet e Europës Perëndimore është në nivelin 24 orë në ditë.

Sipas studimit të Bankës Botërore (BB) të vitit 2010 rreth 80% e shoqërive U/K u shërbejnë qyteteve më të vogla me më pak se 50,000 banorë, fakt ky që tregon se ka një mungesë të ekonomive të shkallës (Padeco, 2009:13). Performanca e dobët e këtyre shoqërive ushtron presione për Qeverinë, e cila është e detyruar të ofrojë subvencione, të cilat ndonëse kanë ardhur duke u zvogëluar mbeten përsëri të larta në nivelin e 8% të Kostove Totale Operative për vitin 2012¹⁰. Për më tepër që këto subvencione jepen për të mbuluar humbjet financiare të shoqërive U/K, ndërkohë që debati i sotëm është që subvencioni duhet të jepet për të ndihmuar shtresat në nevojë.

Vëmendja e institucioneve financiare ndërkombëtare është tërhequr ndaj sektorit të UK në Shqipëri sepse problemet e tij dhe dështimet mund të jenë kërcënimi kryesor ndaj stabilitetit makroekonomik, rritjes së qëndrueshme dhe uljes së varfërisë. Për më tepër që sektori i UK është i ndërlidhur me performancën e sektorëve të tjerë të tilla si: shëndetësia, mjedisi, bujqësia. Financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare si BB, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe donatorët bilateralë ku më i madhi dhe i qëndrueshmi është Gjermania ka qënë burimi kryesor i investimeve në këtë sektor. Donatori më kryesor në këtë sektor është Gjermania e ndjekur nga Italia, Bashkimi European dhe BB.

Një nga çështjet që është debatuar mjaft në Shqipëri lidhet me efektivitetin e pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e UK. Siç evidentohet edhe në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë 2011-2017 pjesëmarrja e sektorit privat nuk ka qënë e suksesshme. Uji është konsideruar gjithmonë një mall tepër i lirë apo social ku Qeveritë, përfshirë edhe vendin tone, kanë qënë ofruesi kryesor i tij dhe me çmime të ulëta të subvencionuara direkt ose indirekt. Është e njohur nga studimet e autorëve dhe insitucioneve të ndryshme se futja e konkurrencës në sektorin e ujit është më e vështirë se në sektorët e tjerë si gaz, energjia dhe telekomunikacioni.

¹⁰ Sipas të dhënave të DPUK për sektorin për vitin 2012 subvencionet në total përbënin 645 milionë lekë ndërsa Kostot totale të operimit 769 milionë lekë.

Karakteristikat teknike të sektorit të ujit ndryshojnë nga ato të sektorëve të tjerë dhe kosto totale e rrjetit privat përbën një pjesë të konsiderueshme të koston totale të ujit duke çuar në monopol të natyrshëm (Mergos,2005:59-75). Konkretisht aktorët konkurrentë nuk mund të ndërtojnë aeroporte paralele apo sisteme të UK paralele në të njëjtin qytet (Urio, 2010:26,30).

Në librin e tij “Ide të gjalla nga ekonomistë të vdekur” Buchholz argumenton se shumë ekonomistë ndjekin këshillën e Marshallit se monopole si uji dhe energjia duhet të rregullohen nga shteti për shkak se ndeshin një kërkesë inelastike. Duke qënë se janë “monopole natyrale” (do të ishte jo efiçiente të kishim shumë shoqëri U/K që të shtronin tubacione për t’i shërbyer një rruge), Marshalli sugjeronte që qeveria duhet t’i nxisë ato të zgjerojnë prodhimin nëpërmjet subvencioneve, ose të paktën nëpërmjet garancive që ato do të mbesin fitimprurëse (Buchholz, 2007:135). Kjo shpjegon ngritjen e enteve rregullatore në vende të ndryshme të botës përfshirë dhe Shqipërinë, të cilat janë të pavarura dhe kanë si rol kryesor mbrojtjen e konsumatorit nga çmimet abuzive.

Përfshirja e PPP-ve në sektorin e UK ka qënë e ulët dhe përvojat variojnë sipas zonës së ndërhyrjes. Konkretisht shembulli i parë i përket konçensionit të Elbasanit që u aplikua me Berlinwasser International në vitin 2002 për ish Ndërmarrjen Shtetërore të UK që i shërbente qytetit të Elbasanit. Ndonëse ky konçesion u dha për 30 vjet zgjati vetëm 5 vjet për shkak të dështimeve financiare me të cilat u përball konçensionari.

Shembull tjetër i PPP-ve në këtë sektor i përket kontratës së menaxhimit të Kavajës, e cila ju dha KfW-së dhe kishte një afat 4 vjeçar. Kontrata përmirësoi funksionimin e shoqërisë së ujësjellësit, por nuk përmbushi objektivat e përcaktuara në kontratë (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, 2011:24)¹¹. Detaje më të hollësishme të faktorëve që çuan në dështimet e dy kontratave në Elbasan dhe Kavajë dhe mësimet e nxjerra jepen në kapitullin 4.

Deri më sot nuk ka ndonjë analizë specifike që të studiojë nga ana empirike PPP-të në Shqipëri dhe rolin e tyre për sektorë të caktuar. I vetmi studim i ndërmarrë është një

¹¹ Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, fq. 24.

vlerësim nga Investitori Strategjik Castalia (Korrik 2007) të mundësisë për pjesëmarrjen e biznesit vendas të sektorit privat në Shqipëri në sektorin e ujit dhe një studim fizibiliteti i kryer nga Banka Botërore në vitin 2009 mbi mundësinë e rajonalizimit në sektorin e UK. Shumëllojshmëria e formave të partneritetit dhe shumëllojshmëria e sektorëve potencialë ku duhet të mbahen parasysh edhe specifikat e tyre, imponojnë kërkime shkencore të thelluara të fokusuara në krahasimin e formave të ndryshme të aplikimit të partneritetit publik privat, ose analiza të thelluara për sektorë të caktuar të ekonomisë ku prioritar mbeten partneriteti që një shërbim i konsideruar publik mund të përmirësohet duke rritur cilësinë e menaxhimit dhe teknologjive të prodhimit dhe shërbimit.

Kam përzgjedhur të angazhohem në një studim të thelluar lidhur me gjetjen e mënyrave për rritjen e efikasitetit të shoqërive U/K si dhe opsionet e partneritetit publik privat në sigurimin e furnizimit me ujë të popullatës, i cili mbetet një objektiv prioritar për qeveritë qendrore dhe vendore. Aksesit në furnizimin me ujë të popullatës është gjithashtu një tregues i monitoruar për t'u përmirësuar edhe në sfidat e mijëvjeçarit në kuadër të objektivit 7 "Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit"¹².

Në këtë kuadër sfida do të jetë gjetja e një modeli që t'i përshtatet kushteve të Shqipërisë (gjeografike, politike, historike, social ekonomike) dhe që të mund të gjejë zbatim. Në të njëjtën kohë në kuadër të përafrimit me Bashkimin Europian lind e nevojshme zvogëlimi i numrit të rajoneve nga 12 në 6 ose edhe në 4. Rajonalizimi kërkon investime të mëdha dhe financimi vetëm nga Qeveria do të jetë i vështirë. Por nga ana tjetër rajonalizimi mund të jetë një mënyrë tërheqëse për investitorët e huaj në formën e PPP-ve me argumentin kryesor të efekteve pozitive që mund të sjellë në uljen e kostove ekonomia e shkallës. Në këtë rast rritja e kompanive sipas rajoneve alternative, ndihmon në uljen e kostove fikse, por edhe të kostove të menaxhimit, jo vetëm ato administrative, por edhe mirëmbajtëse, të cilat kanë një peshë për tu konsideruar në totalin e kostos.

¹² The Millennium Development Goals Report 2011, p.54
http://www.undp.org/content/dam/undp/library/MDG/english/MDG_Report_2011_EN.pdf

Në procesin e decentralizimit, qeveria shqiptare ka bërë kalimin e pronësisë së shoqërive aktuale në pronësi të pushtetit vendor, si edhe ka synuar të rrisë autoritetin dhe efikasitetin e entit rregullator në këtë fushë¹³. Nisur nga pronësia e shoqërive UK tek njësitë e pushtetit vendor sfida ngelet të gjendet forma e përshtatshme e PPP-ve në këtë sektor që do të bashkonte interesat e të dyja palëve.

I.2 Njësitë e analizës dhe pyetjet kërkimore

Njësitë bazë të analizës së këtij studimi janë të gjitha shoqëritë U/K në total që operojnë në Shqipëri. Analiza merr në konsideratë të dyja llojet e shërbimeve që ofrohen, përkatësisht furnizimi me ujë dhe aksesin në sistemin e kanalizimeve. Analiza fillon me vlerësimin e performancës së sektorit UK për periudhën 2006-2012 dhe vazhdon me gjetjen e mënyrave për të rritur eficiencën e shoqërive duke përdorur një model ekonometrik për eficiencën, i cili analizon të dhënat për 29 shoqëri U/K, që përbëjnë kampionin e analizës.

Njësi të tjera që analizohen janë institucionet pjesëmarrëse në sektor në drejtim të politikbërjes, financimit, administrimit dhe mbikqyrjes rregullatore.

Pyetjet kërkimore:

1. Cilët janë faktorët që ndikojnë në koston operative të kompanisë ?
2. Cilat janë karakteristikat e modelit të rajonalizimit që i përshtatet rastit të Shqipërisë ?
3. Cila do të ishte forma më e përshtatshme e PPP-ve në rastin e rajonalizimit të kompanive (konçension, kontratë menaxhimi, leasing, kontratë shërbimi etj) ?

Në vijim të pyetjeve kërkimore hipotezat që ngrenë në këtë punim janë:

¹³ https://www.google.com/search?q=strategjia+e+decentralizimit+&rlz=1C1CHMO_enAL525AL525&oq=strategjia+e+decentralizimit&aqs=chrome.69i59l2j69i57.3900j0j8&sourceid=chrome&respv=210&es_sm=93&ie=UTF-8#q=strategjia+per+decentralizimin+e+ujit+dhe+kanalizimeve

I. Hipotezat Sasiore:

1. Zvogëlimi i humbjeve teknike e ul vëllimin e ujit të prodhuar dhe koston operative vjetore.
2. Efekti i shkallës në lidhje me numrin e popullsisë që shërbehet me ujë/kanalizime, duhet të jetë i rëndësishëm në uljen relative të koston operative vjetore.
3. Shtimi i matësave i rrit koston operative vjetore në mënyrë të ndjeshme.
4. Metodat e deritanishme për renditjen e kompanive sipas eficiencës duhet të ndryshojnë duke marrë parasysh renditjen sipas kushteve të operimit jashtë mjedisit.

II. Hipoteza Cilësore

1. Rajonalizimi i Shoqërive të UK rrit efikasitetin, nxit interesin e sektorit privat dhe lehtëson aplikimin e skemave të PPP sepse arrihen ekonomitë e shkallës.

Përveç sa më sipër studimi ka si synim t'i japë përgjigje këtyre nën-pyetjeve:

1. Cila është performanca aktuale dhe ndër vite e shoqërive UK ?
2. A ekzistojnë premisa për arritjen e ekonomive të shkallës në rastin e Shqipërisë nisur nga performanca e sektorit gjatë periudhës së analizës ?
3. A ekziston ndonjë alternativë partneriteti publik privat, i cili të shërbejë si instrument për zbatimin e rajonalizimit të shoqërive ?
4. A ekzistojnë kushtet administrative, ligjore, institucionale për të bërë të mundur procesin e bashkimit të shoqërive dhe krijimit të rajoneve ?

Këtyre pyetjeve do t'i përgjigjet ky punim doktore mbështetur në analizën e temave përkatëse në secilin kapitull dhe në fund të kapitullit gjetjet do të jepen në formë të përmbledhur si rekomandime.

I.3 Objektivat e kërkimit

Objektivat kryesorë të studimit janë:

- Rishikimi i literaturës për PPP-të dhe debatet bashkëkohore në sektorin e ujit.

- Shqyrtimi i eksperiencës ndërkombëtare të kompanive (shoqërive) të U/K si një alternativë për rritjen e eficiencës së kompanive nëpërmjet rasteve të studimit të vendeve me eksperiencë të gjatë në këtë drejtim dhe vendeve të ngjashme me Shqipërinë për të evidentuar nëse ekziston një model, i cili të mund të aplikohet në Shqipëri.
- Analizimi në detaje i performancës së sektorit të UK për periudhën 2006-2012 nëpërmjet indikatorëve teknikë, financiarë dhe të cilësisë dhe sugjerimi i zgjidhjeve të mundshme për përmirësimin e performancës së sektorit me qëllimin e arritjes së qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe qëndrueshmërisë mjedisore për menaxhimin me efikasitet dhe ruajtjen e burimeve ujore.
- Analizimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe institucioneve përgjegjëse në drejtim të menaxhimit të burimeve ujore, hartimit të strategjive dhe politikave përkatëse dhe administrimit të shoqërive UK dhe rregullimit të sektorit për të parë nëse ekziston terreni institucional dhe ligjor për fillimin e procesit të rajonalizimit në Shqipëri.
- Krijimi i një modeli të rajonalizimit që i përshtatet kushteve social ekonomike, politike, gjeografike, historike etj të Shqipërisë.
- Dhënia e sugjerimeve për kërkime të mëtejshme për sektorin e UK për politikbërësit në nivel vendor dhe qendror, donatorët dhe për studiuesit me fokus interesi sektorin e UK.

KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS PËR PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT DHE PËRFSHIRJA NË SEKTORIN E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

2.1 Hyrje

Partneriteti Publik-Privat (PPP) është mjaft i përhapur dhe ka rezultuar të jetë një nga instrumentat më përfituese si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim nisur nga kontributi që sjellin në zhvillimin ekonomik. PPP-të morën popullaritet në fillim të viteve '80 kur ineficiencat e ndeshura nga institucionet publike çuan në krijimin e të ashtuquajturës Menaxhimi i Ri Publik (MPR) në Mbretërinë e Bashkuar (në kohën e Margaret Thatcher) dhe në vende të tjera Anglo-Saksone. Në vitet 1950 dhe 1960 reformat e sektorit publik shiheshin nga dy këndvështrime: *së pari*, shiheshin më shumë si çështje teknike ose ligjore sesa politike apo ekonomike dhe *së dyti*, shiheshin si çështje kombëtare apo sektoriale dhe nuk ishin bërë ende pjesë e debatit ndërkombëtar (Pollit & Bouckaert, 2011:5). Për shembull, Gjermania, Franca, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kryen reformat e tyre në bazë të rrethanave apo historisë së tyre. Për më tepër që këto vende kishin sisteme ligjore krejt të ndryshme dhe në këtë kuadër kishte pak vend për debat në nivel ndërkombëtar. Kështu në këtë periudhë nuk ekzistonin institucionet ndërkombëtare që sot influencojnë reformat publike të tilla si: Komiteti për Menaxhimin Publik i OECD-së, Rrjeti i Administratës Publike të Kombeve të Bashkuara etj.

Ajo që vihet re në këtë periudhë është se në sferën akademike nuk ekzistonin grupe që të mund të bënin analiza krahasuese përsa i përket reformave të sektorit publik. Kjo situatë ndryshoi në vitet 1970 dhe 1980, periudhë që u shoqërua me përparime në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe me krijimin e grupeve brenda disa Universiteteve që filluan të kryejnë studime për politika më racionale, që do të thoshte riorganizim i pushtetit qendror (Pollit & Bouckaert, 2011:6). Kjo periudhë do të njihej si periudha e “Modernizimit të Qeverisë”. Qëllimi kryesor i kësaj periudhe të re ishte të

përfshinte në sektorin publik principet e menaxhimit të sektorit privat duke i dhënë formë të re strukturës organizative, të modernizonte shërbimet publike dhe përmirësonte menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Për këtë qëllim, me kalimin e viteve shumë qeveri i kanë parë PPP-të si mënyra alternative për menaxhimin e shërbimeve publike dhe financimin e tyre nëpërmjet projekteve komplekse infrastrukturore (Pollit & Bouckaert, 2011:6).

Një tjetër arsye që nxiti ndryshimin i referohet trazirave ekonomike globale në vitet 1970 dhe besimit që qeveritë janë të mbingarkuara dhe ishin kthyer në jo-efiçiente (King, 1976:8-30; Held, 1984:15-30; O'Connor, 1973:40). Në këtë periudhë u bë e qartë dëshira që qeveritë të ktheheshin si bizneset duke patur parimet e tyre në mënyrë që të bëheshin më efiçiente dhe praktikat burokratike të kishin si qëllim që t'u përgjigjeshin nevojave të qytetarëve (Boston & Martin & Walsh, 1996:5; Pollit, 1990:19-21). Disa studjues theksuan se në vitet 1970 ka patur një perceptim se format tradicionale të hierarkisë së qeverisë janë plotësuar në mos zëvendësuar nga tregu dhe ose metodat e qeverisjes nëpërmjet rrjeteve (Jessop, 1998:29-46). Në këtë kuadër shumë vende si Australia, Zelanda e Re, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Holanda, dhe Shtetet e Bashkuara filluan të ndërmarrin programe të mëdha të reformimit të qeverisë qendrore në vitet 80-të. Kjo periudhë do të njihej si MRP, e cila përfshinte shumë reforma dhe që do të përhapeshin në shumë vende.

Një ndër manifestimet e para të MRP-së ishin privatizimet e kryera në kohën e Kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar Zonja Margaret Thetcher, që konsistonte në shitjen e aseteve publike tek sektori privat. Privatizimet nuk ishin karakteristikë vetëm e vendeve të zhvilluara, por edhe e vendeve në zhvillim. Konkretisht, pas viteve 1990 privatizimet u ndërmorrën në masë nga vende të tjera, veçanërisht nga ato vende që ishin në fazën e transformimit nga ekonomi të planifikuara në ato të tregut, kryesisht vendet e bllokut lindor si Hungaria, Rumania, Bullgaria, Çekia përfshirë dhe Shqipërinë.

Në këto vende u zbatuan paketat e reformave të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe BB-së, të cilat kishin në themel dhënien e kredive të zhvillimit me kushtëzimin e

ndërmarrjes së reformave të ristrukturimit të ekonomisë të quajtura “Washington Consensus”- konsensusi i Washingtonit. Në këto paketa reformash liberalizimi i tregjeve dhe privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore ishin kushtëzuese për të përfituar asistencë ndërkombëtare.

Kutia 1 : Konsensusi i Washingtonit

Konsensusi i Washingtonit është emri i dhënë nga ekonomisti John Williamson në vitin 1989 një listë me 10 rekomandime të politikave të vendeve që ishin në rrugën e reformave. Këto rekomandime kanë të bëjnë me 1. Disiplinën Fiskale, 2. Ridimensionimin e shpenzimeve publike, 3. Reformën e Taksave, 4. Liberalizimin Financiar, 5. Adoptimin e një norme të vetme konkurruese të këmbimit valuator, 6. Liberalizimin e tregëtisë, 7. Heqjen e pengesave për investimet e huaja direkte, 8. Privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, 9. Rregullimin e hyrjes në treg dhe të konkurrencës në të dhe 10. Mbrojtja e të drejtave të pronës.

Burimi: John Williamson, Latin American Adjustment: How much has Happened

Të tilla kushtëzime kanë sot edhe paketat antikrizë për vendet e zhvilluara, ku ristrukturimi i ekonomisë dhe zvogëlimi i sektorit publik është pjesë e kushteve për paketat shpëtuese siç është rasti më i fundit në Greqi¹⁴.

2.2 Koncepti teorik i PPP-ve

Partneriteti publik-privat është një bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe atij publik për të ofruar shërbime dhe produkte, të cilat janë të mira publike. Këto lloj bashkëpunimesh realizohen për të investuar kryesisht në infrastrukturën publike, e cila kërkon burime të mëdha financiare, ekspertizë të veçantë teknike, eksperiencë në ndërtimin dhe menaxhimin e objekteve infrastrukturore.

Sipas fjalorit ekonomik të revistës prestigjioze “The Economist”¹⁵, infrastruktura publike mund të përkufizohet si arteria dhe vena e një ekonomie sepse krijon mundësi

¹⁴ <http://www.eesc.europa.eu/resources/docs/grece-en.pdf>

¹⁵ <http://www.economist.com/economics-a-to-z/i#node-21529535>

për njerëzit, mallrat, ujin, energjinë, dhe informacionin që të lëvizin drejt eficiencës. Investimet në infrastrukturë mund të krijojnë të ardhura të mëdha të pritshme sepse ndikon zgjedhjen e njerëzve se ku të jetojnë, me çfarë aktiviteteve të merren etj. Sipas fjalorit të investopedia¹⁶, infrastruktura publike përfshin transportin, ujin, kanalizimet, komunikimin dhe sistemin e energjisë. Duke qënë se këto sisteme kërkojnë investime me kosto të lartë, ato mund të financohen nga sektori publik, privat ose partneriteteve publike-private.

Ka klasifikime të ndryshme akademike të koncepteve të infrastrukturës publike. Sipas Yescombe (2011:1) ekzistojnë dy lloje infrastrukturash konkretisht: (i) ekonomike, që bën të mundur ofrimin e shërbimeve që janë të nevojshme ç’do ditë si energjia elektrike, uji, transporti dhe (ii) infrastruktura sociale, e cila merret me ofrimin e shërbimeve sociale si shkollat, spitalet, libraritë, burgjet etj. Pavarësisht kategorizimit, të dyja llojet e infrastrukturës janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Ajo që njihet gjerësisht është se PPP-të kanë këto karakteristika kryesore (Kappeler & Nemoz, 2010: 3-5):

- Partneritet nënkupton përfshirjen e dy ose më tepër aktorëve ku të paktën njëri është nga sektori privat dhe tjetri nga sektori publik.
- Autonomi do të thotë se secila nga palët është kryesore, gëzon të drejtën e negocimit në interes të tyre dhe është e pavarur nga palë të treta.
- Jetëgjatësi do të thotë bashkëpunim afatgjatë ku parametrat dhe termat negocohen.
- Dedikim dhe zotim do të thotë transferim të burimeve konkrete.
- Së fundmi, ndarje e përgjegjësisë do të thotë përcaktim të objektivave ekonomike, sociale etj, ndarje risku/detyrimesh, përfitime reciproke, në ofrimin e produktit final shërbime ose mallra publike me cilësi dhe përfitueshmëri.

Ekzistojnë disa përkufizime mbi PPP-të. Banka Botërore i përkufizon PPP-të si iniciativa të përbashkëta të sektorit publik në bashkëpunim me sektorin privat ku palët kontribuojnë me burime financiare, teknike dhe informacion. Po kështu studimet e bëra

¹⁶ <http://www.investopedia.com/terms/i/infrastructure.asp>

tregojnë se PPP-të shihen si një metodë për nxitjen e zhvillimit (Agere, 2000: 68). Yescombe (2011:3) i përkufizon PPP-të si *“një kontratë afat-gjatë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat ku palët përfshihen në projektimin, ndërtimin dhe administrimin e infrastrukturës publike”*. Urio (2010:26) i përkufizon PPP-të si një marrëveshje të bërë ndërmjet sektorit privat dhe sektorit publik bazuar në një kontratë që mund të përmirësojë disa nga veprimtaritë bazike të tilla si: projektimi, ndërtimi, financimi dhe operimi.

Ekzistojnë debate lidhur me përkufizimin e PPP-ve në funksion të qasjes së PPP-ve si mjet menaxhimi, qeverisje apo zhvillimi (Khanom, 2010:150-163). Konkretisht, përkufizimi i parë vjen nga studjuesit hollandezë të menaxhimit publik Van Ham and Kopenjam (2001:598), të cilët i përkufizojnë PPP-të si bashkëpunim të një lloj qëndrueshmërie ndërmjet sektorit privat dhe publik ku ata ndajnë së bashku risqet, kostot dhe zhvillojnë produkte dhe shërbime. Collin dhe Hansson (2000:200-216) i përkufizojnë PPP-të në mënyrë më të ngushtë si një marrëveshje ndërmjet një bashkie dhe një ose më shumë firmave ku të gjitha palët ndajnë risqet, fitimin, objektet, dhe investimet nëpërmjet një pronësie të përbashkët të një organizate. Në literaturën që trajton infrastrukturën publike të PPP-ve përmenden bashkëpunime financiare si BOT (Ndërto-Administro-Transfero), BOOT (Ndërto, Administro, Merr në pronësi, Transfero) etj. Sipas këtyre lloj marrëveshjesh infrastrukture ekziston një përkufizim më i ngushtë. Për shembull, Campbell (Khanom, 2010:5) sugjeron se një projekt PPP përfshin projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një objekti publik nga sektori privat për një afat kohor të gjatë.

Departamenti i Çështjeve Fiskale të FMN-së i përshkruan PPP-të si marrëveshje të bëra me sektorin privat, i cili siguron asetet infrastrukture dhe shërbimet që tradicionalisht janë siguruar nga qeveria. Duke qënë se ky përkufizim nuk nxjerr në pah se çfarë konkretisht kryen një PPP një tjetër përkufizim kufizohet në atë që *“një PPP tipike është një marrëveshje e bërë me sektorin privat ku ky i fundit merr përsipër të projektojë, ndërtojë, administrojë dhe mbajë në pronësi mallin apo shërbimin publik sipas skemës Harto-Ndërto-Administro-Merr në Pronësi”* (Urio, 2010:26). Komisioni për PPP-të në Mbretërinë e Bashkuar i përshkruan si marrëdhënie të qëndrueshme ndërmjet aktorëve

privatë dhe publikë, të cilët zhvillojnë bashkarisht produkte dhe shërbime duke ndarë risqet, kostot, dhe përfitimet. Po kështu studimet e bëra tregojnë se PPP-të shihen si një metodë për nxitjen e zhvillimit (Agere, 2000:68). Përkufizimi i PPP-ve është i ndryshëm në varësi të qëllimit për të cilin ato ofrohen. Për shembull, PPP-të që ofrohen për infrastrukturën publike përkufizohen në mënyrë të ndryshme nga PPP-të për uljen e varfërisë. Ndërsa për vendet në zhvillim roli i partive politike, kultura politike e vendit dhe burokracia duhet të merren parasysh kur përkufizohet PPP-ja. (Khanom 2010:12).

Sipas Komisionit të Ekonomisë së Kombeve të Bashkuara për Europën, PPP-të kanë si qëllim financimin, ndërtimin, zbatimin dhe administrimin e veprave publike dhe shërbimeve që lidhen me to. Ato janë kontrata afat-gjata, që karakterizohen nga transferimi i riskut për tek sektori privat.

Ajo që vihet re është se ka një sërë emërtimeve që jepen për PPP-të (Yescombe, 2011:4). Konkretisht:

- Pjesëmarrja private në Infrastrukturë (PPI) një term që veçanërisht përdoret nga Banka Botërore;
- Pjesëmarrja e sektorit privat (PSP) që përdoret veçanërisht në sektorin e zhvillimit bankar;
- P3 që përdoret nga vendet e Amerikës Veriore;
- Projektet e financuar nga sektori privat (PFP) që përdoret në Australi;
- Partneriteti P-P për të evituar ngatërresa që mund të ndodhin me Paritetin e Fuqisë Blerëse (PPP);
- Iniciativë e financimit privat (PFI) një term që e ka origjinën në Britaninë e Madhe dhe tashmë i përdorur në Japoni dhe Malajzi.

Ndonëse ekzistojnë një sërë përkufizimesh të ndryshme për PPP-të, në thelb ato kanë elementë të përbashkëta që i karakterizojnë që përfshijnë: (i) kontratën ligjore ndërmjet palëve përfaqësuese të sektorit publik dhe atij privat ku palët marrin përsipër detyrime, (ii) kanë të drejta dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre për të ofruar shërbimet dhe mallrat e përcaktuara, si dhe (iii) kohëzgjatja e bashkëpunimit është afat-gjatë dhe palët ndajnë së bashku fondet financiare, kostot dhe risqet. Po kështu ekzistenca e këtyre përkufizimeve

zbulon një fakt të rëndësishëm se PPP-të janë komplekse jo vetëm për shkak të elementëve që përmbajnë, por edhe fushës ku ato zbatohen. Historia e angazhimit të sektorit privat në sferën publike janë të hershme përmendim këtu shembullin nga Bibla të Matias si mbledhës privat i taksave, dritat ndriçuese të rrugëve në shekullin e 18-të në Angli, hekurudhat private të shekullit të 19-të, anija e parë që zbarkoi në Amerikë, e cila ishte rezultat i një bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe atij publik (Hodge & Carsten, 2005:2). Megjithatë këto ishin bashkëpunime të hershme dhe argumentat mbi eficiencën, cilësinë e shërbimit dhe përgjegjshmërisë së dy sektorëve u zhvilluan më vonë.

Kuptimi teorik i konceptit të PPP-ve mund t'i dedikohet teorisë së eficiencës $-x$ e zhvilluar nga Leibenstein (1966: 392-415). Ideja e tij ishte që institucionet publike ose korporatat nuk mund të dështojnë për aq kohë sa politikatat monetare dhe ato financiare janë ekspansioniste për të kufizuar probabilitetin e tyre të dështimit. Sipas kësaj teorie ineficiencat në institucionet publike rezultojnë nga ndërhyrjet jo të duhura të qeverisë dhe strukturat organizative të shtetit, të cilat janë tepër burokratike. Prandaj, sipas kësaj teorie PPP-të janë të nevojshme për të ulur burimet e eficiencës x (ineficienca) në organizatat publike dhe për t'i lejuar ato t'i përgjigjen forcave të tregut që të bëhen më konkurruese. Kjo shpjegon përse qeveritë në mënyrë të vazhdueshme i kanë parë PPP-të si alternativa ose mënyra plotësuese për të përmbushur nevojat e publikut dhe të investimeve. Në fakt këto ineficienca çuan në futjen e MRP-së në vitet 1980 në vendet Anglo Saksone, duke propozuar futjen e elementëve të sektorit privat në menaxhimin e institucioneve publike që kanë përgjegjësinë për të ofruar shërbime publike.

Sikurse u përmend më herët në këtë punim deri në vitet 1970 roli i qeverisë ka qenë kryesori në zhvillimin ekonomik të një vendi. Teoria ekonomike që ka mbizotëruar pas luftës së II-të Botërore ka qënë ajo e John Maynard Keynes sipas të cilit me qëllim që të ndalohet depresioni apo kriza ekonomike është e nevojshme që Qeveria të stimulojë kërkesën nga ana e qytetarëve (Buchholz, 2007:295). Sipas Keynes ekonomia private nuk mund të arrijë punësim të plotë, por Qeveria duhet të shtojë konsumin dhe investimet në mënyrë që të nxitet rritja ekonomike. Keynes inkurajonte programet e punëve publike për të nxitur punësimin dhe hidhte poshtë pikëpamjen e Thesarit që

mishëronte pikëpamjen neoklasike që shpenzimet qeveritare shkaktojnë zvogëlimin e investimeve private më shumë se sa krijojnë vende të reja pune.

Në kohën e sotme të cilësuar si “periudha e liberalizmit dhe filozofisë së shtetit “laissez-faire”, Keynes 60 vjet mbas vdekjes së tij, vazhdon të kujtohet për sensin e përgjegjësisë publike në doktrinën e tij ekonomike” (Civici, 2007:69). Trashëguesit e revolucionit të Keynesit qofshin këta të tipit radikal të përfaqësuar nga J. Robinson apo të tipit liberal, të përfaqësuar nga amerikanin Paul Samuelson ndajnë të njëjtën bindje: “*në mënyrë spontane ekonomia nuk siguron dot punësim të plotë dhe shpërndarja proporcionale e të ardhurave dhe ndërhyrja e shtetit është legjitime për të luftuar papunësinë dhe nxitur zhvillimin e ekonomisë*”. (Civici, 2007:71).

Milton Friedman, përfaqësuesi më tipik i shkollës Ekonomike të Çikagos dhe promotori i lëvizjes monetariste, kundërshtoi teorinë e Keynes sepse advokoi për politikën e reduktimit të shtetit dhe mbështeste politikën e “laissez-faire”. Ai shtroi nevojën e privatizimit në Shtetet e Bashkuara. I të njëjtit mendim ishte dhe Fredrick Von Hayek, i cili me librin e tij “Rruga drejt robërisë” dha argumentat e tij.

Në vijimësi të teorive të Friedman, më vonë lindi shkolla e zgjedhjes publike me themeluesin e saj James M. Buchanan që e trajton politikën si biznes duke e trajtuar atë me mjetet e ekonomiksit (Buchholz, 2007:355). Ka mjaft pararendës të teorisë së zgjedhjes publike si Adam Smith, James Mill dhe gjithkënd tjetër të cilët janë kundër burokratëve (Buchholz, 2007:355). Megjithatë, puna kërkimore erdhi pas Luftës së II Botërore dhe sa më shumë që janë zmadhuar qeveritë, aq më shumë janë shtuar dhe kritikët ndaj saj (Buchholz, 2007: 355). Buchanan pretendon se sistemet politike demokratike kanë tendencë të zmadhojnë qeverinë dhe të kenë buxhete të mëdha. Jeremy Bentham mbronte tezën se politikanët për të kënaqur koalicionet e votuesve, rrisin shpenzimet pra nisen nga interesi vetjak. Elektorati kërkon shpenzime të larta dhe taksa të ulëta që përkthehet në deficit buxhetor. Kjo mund të krijojë buzëqeshje në fytyrat e taksapaguesve dhe përfituesve pasi njerëzit mund të shpenzojnë më shumë për veten e tyre (Buchholz, 2007:367), por Buchanan shprehet se shpenzimet buxhetore e injorojnë të ardhmen duke dëmtuar gjeneratat e ardhshme (Buchholz, 2007: 368).

Defiçiti i përngjan taksimit pa përfaqësim shprehet Buchanan. Kjo nxjerr në pah se vetëm ndërhyrja e qeverisë nuk është efiçiente në sigurimin e shërbimeve publike. Teoria e zgjedhjes publike thekson se *“ndërhyrja e qeverisë në çështjet e shoqërisë duhet të kufizohet në plotësimin që i bën tregut duke krijuar kushtet për të drejtat e pronës atje ku ato janë të dobëta ose jo ekzistuese, në mënyrë që forcat e tregut të veprojnë dhe alokojnë burimet në një mënyrë që të jetë përfituese për të gjithë shoqërinë”* (Howlett & Ramesh, 2003:24). Ky argument është ndjekur dhe nga ideologjia kapitaliste siç përmendet nga Adam Smith në librin e tij “Pasuria e Kombeve”.

Sikurse u përmend më herët Friedman advokoi për një qeveri më të vogël. Strategjitë kryesore që do të bënin të mundur uljen e rolit të qeverisë dhe rritjen e rolit të sektorit privat përfshijnë (Friedman & Ross, 1990:3-10):

- Privatizim nëpërmjet tërheqjes, do të thotë që qeveria ndalon përfshirjen e saj nga disa lloj përgjegjësish, siç ishte rasti i shërbimit postar në Shtetet e Bashkuara, debat i cili vazhdon edhe sot.
- Transferimi i aseteve, nënkupton shitjen ose dhënien me qira të tokës, infrastrukturës apo ndërmarrjeve. Si shembuj mund të përmendim parqet shtetërore, libraritë publike etj.
- Kontraktimi ose PPP, që nënkupton se në vend që qeveria të prodhojë dhe ofrojë disa shërbime ajo mund të financojë sektorin privat për ta realizuar këtë gjë. Si shembull përmendim shkollat, burgjet etj.
- Liberalizimi, që do të thotë heqja e monopoleve publike dhe lejimi i operatorëve privatë për ta bërë më efiçiente ofrimin e shërbimeve.

Teoritë e Milton Friedman dhe Fredrick Von Hayek u ndoqën nga vendet anglo-saksone kryesisht Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), në kohën e qeverisjes së Margaret Thatcher në Angli dhe Ronald Reagan në SHBA në 1980. Bëhet e qartë se tashmë të gjitha problemet duhet t’i zgjidhte tregu. Megjithatë zhvillimi i PPP-ve ka qënë mjaft dinamik dhe jo gjithmonë i suksesshëm në vendet që e kanë aplikuar. Ka shumë faktorë që lidhen me suksesin apo dështimin, por ajo që mbetet për t’u theksuar është se globalizimi, avancimi i teknologjisë së informacionit, idetë e

reja novatore kanë ngritur sfida të reja përballë qeverive të vendeve të ndryshme dhe i kanë bërë qeveritë më të përgjegjshme përballë kërkesave në rritje nga ana e konsumatorëve.

2.2.1 Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm

Zhvillimi dhe qëndrueshmëria merren si dy koncepte të ndryshme që janë të lidhura ndërmjet tyre në mënyrë artificiale për t'i dhënë kuptim llojit të zhvillimit të shekullit të XXI. Në këtë kuptim është e nevojshme përkufizimi i tyre në mënyrë të veçantë. Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (PNUD) për zhvillimin njerëzor përshkruan se “zhvillimi” presupozon ndërtimin e aftësive intelektuale njerëzore për të mundësuar njerëzit që të marrin pjesë aktive në qeverisje, të veprojnë në mënyrë ndërtuese në çështjet e rritjes dhe zhvillimit personal, dhe në këtë mënyrë të mbështeten në veten e tyre (Turok, 1993: 401-417). Sipas komisionit botëror për mjedisin dhe zhvillimin, zhvillimi duhet të plotësojë nevojat e gjeneratave të tashme pa kompromentuar aftësinë e gjeneratave të ardhshme për të plotësuar nevojat dhe aspiratat e tyre. Zhvillimi pra nuk duhet të ketë si qëllim zgjidhjen apo përmbushjen vetëm të nevojave të së sotmes, por duhet të jetë e qëndrueshme.

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm i ka rrënjët në teorinë e fillimit të shekullit XX të menaxhimit të burimeve të rinovueshme. Zanafilla e këtij koncepti fillon në konferencën e Stokholmit në vitin 1972 dhe pasqyrohet në Deklaratën e Stokholmit. Më pas ky koncept u zhvillua më tej dhe u bë pjesë e Konferencës së Rio-s në Brazil në 1992 kur 178 qeveri përfshirë Afrikën e Jugut nënshkruan dokumentin “Kapitulli i Tokës”, i cila u zbatua në formën e një program veprimi i quajtur Axhenda 21 (Pearce, 1988: 600). Gjëja më kryesore e Axhendës 21 është angazhimi nga qeveria (si qendrore dhe lokale) për të zgjidhur aspektet ekonomike dhe sociale nëpërmjet luftës ndaj varfërisë, modeleve të paqëndrueshme të prodhimit dhe konsumit; ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve për zhvillimin e qëndrueshëm; fuqizimit të pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit ndaj informacionit dhe zbatimi i rezolutës të Samitit të Tokës (United Nations Conference on Environment and Development, 1992: 14).

Sipas Komisionit Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin të vitit 1987 zhvillimi i qëndrueshëm ka si qëllim të vitalizojë zhvillimin e ekonomisë lokale, të ndryshojë cilesinë e rritjes, të përmbushë nevojat bazike dhe të krijojë vende të reja pune, të sigurojë një nivel të qëndrueshëm të prodhimit ekonomik, të ruajë burimet, të riorientojë teknologjinë, të bashkojë mjedisin lokal me ekonomiksin në vendimmarrje. Më vonë ky koncept u zhvillua dhe teoria e zhvillimit të qëndrueshëm u adoptua si nga vendet e zhvilluara ashtu dhe ato në zhvillim, të cilat filluan të përfshinin në politikat e tyre rritjen ekonomike pa dëmtuar mjedisin. Këto vende kërkojnë të sigurojnë se vendimet në nivelin mikro dhe makro janë në përputhje me burimet që institucionet zotërojnë (Economic Commission for Europe, 1990: 87-116). Kjo do të thotë se vendimmarrësit duhet të marrin në konsideratë efektet afat-gjata të vendimeve të tyre duke integruar rritjen ekonomike me barazinë sociale dhe aspektet mjedisore apo ekologjike.

Një tjetër arritje në zhvillimin e qëndrueshëm është takimi i Johaneshburgut në Afrikën e Jugut në Shtator 2000 ku Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara u mbledh për Samitin e Mijëvjeçarit. Në këtë takim u përcaktuan Objektivat e Sfidës së Mijëvjeçarit që parashtron para qeverive axhendën e përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe uljen e varfërisë. Objektivi kryesor i Sfidës së Mijëvjeçarit është se qeveritë duhet të alokojnë burimet për t'i shërbyer uljes së varfërisë; të nxisin barazinë gjinore; të përmirësojnë arsimin; të përmirësojnë shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dy vite pas Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe 10 vjet pas Deklaratës së Rio-s, në Afrikën e Jugut u mbajt Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm në 2002. Në këtë Samit u ra dakord për Planin e Veprimit të Johaneshburgut të Axhendës 21 dhe Objektivave të Sfidës së Mijëvjeçarit. Nga ky Samit u ra dakord se për të arritur planet e zhvillimit të qëndrueshëm është e nevojshme partneriteti ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë. E rëndësishme është që zbatimi i këtyre rezolutave varion nga vendi në vend.

2.3 Teoria e menaxhimit të ri publik

Që në fillim të këtij kapitulli u prezantua sesi ka evoluar politika publike që nga vitet 1950 dhe deri më sot. Periudha që do të shënonte ndryshimin thelbësor ishin pikërisht vitet 1980 me futjen e menaxhimit të ri publik. Në këtë seksion do të prezantohet më në

detaje sesi ka evoluar ky proces deri në ditët e sotme dhe do të analizohet nëse ekzistojnë modele të tjera përveç MRP që justifikojnë pjesëmarrjen e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike.

Rënia ekonomike globale në vitet 1980 i ndërgjegjësoi qeveritë se duhet të ishin efëiente, dhe të përmirësonin cilësinë e shërbimeve. Në vitin 1990 reformat përsëri ndryshuan fokusin dhe në këtë dekadë flitej sesi mund të arrihej partneriteti, qeverisja, besimi dhe transparenca. Pra, në këtë kuptim axhenda politike filloi të ndryshonte. Këto koncepte të reja nxirrnin në pah problemin e koordinimit që duhej të kishte midis institucioneve të ndryshme dhe në këtë drejtim koncepte të reja u shtuan si “Strategji”, “Joining up”, “Koordinimi ndërmjet shërbimeve”. Një tjetër slogan që u shfaq ishte “e-government” për shkak të avancimeve të teknologjisë që do t’i lejonte qytetarët të përfitonin në mënyrë të shpejtë shërbimet dhe të pakësoheshin rregullat burokratike. Në këtë kuadër qeveritë kryen investime të mëdha në sistemet kompjuterike dhe në sistemet e komunikimit mbi bazë kompjuterike. Sigurisht që kjo solli përfitime, por në mjaft raste pati dhe dështime (Committee of Public Accounts, 2000; Dunleavy & Margetts & Bastow et al., 2006a:5-20; OECD, 2005 a:90-93).

Shpesh herë shumë vende nuk dinin se çfarë emri t’i vinin këtyre ndryshimeve të reformave. Disa e quanin MRP disa të tjerë globalizim. Gjithsesi në fund të viteve 1990 dhe fillim të viteve 2000 qeveritë filluan të humbasin besimin publik dhe qeveritë filluan të mendojnë sesi të informonin publikun në mënyrë sa më transparente (Pollit & Bouckaert, 2011:8). Kjo për shkak të rritjes së rrezikut nga terrorizmi, vështirësive për të përballuar sistemin e pensioneve, apo kujdesin shëndetësor që shumë vende europiane filluan të përballojnë për shkak të plakjes së popullsisë.

Pra ajo që konstatohet është se futja e Menaxhimit të Ri Publik nuk konsistonte thjesht në kopjimin e disa parimeve, teknikave dhe vlerave të biznesit, të cilat do të aplikoheshin nga institucionet publike, por sfidat qëndronin më gjerë. Kjo konsistonte në rradhë të parë në modernizimin e aparatit shtetëror në drejtim të menaxhimit të personelit, në drejtim të rregullave dhe legjislacionit që do të duhej t’i përshtatej filozofisë së re që po fillonte të përqafohej nga qeveritë e shumë vendeve. Kjo pasi vetë

proçesi i MRP nuk konsistonte vetëm në lejimin e sektorit privat për ofrimin e shërbimeve, por siç u përmend më lart vendet duhej të bënin pjesë të axhendave të tyre nocionet e reja që lindën si partneriteti, qeverisja, e-government, pra vendet duhej të adoptonin reforma të reja të menaxhimit të tyre publik.

Sipas Pollit dhe Bouckaert (2011:10) në një nivel më të zakonshëm, MRP përmblihte këto koncepte dhe praktika:

- Fokus më i madh te performanca, veçanërisht nëpërmjet matjes së produkteve;
- Një qeveri më e vogël, e specializuar kundrejt njësive të mëdha dhe multi-funksionale;
- Injektivim në masë të madhe të mekanizmave të tregut duke përfshirë tenderimin konkurrues, dhe pagesën mbi bazë performance;
- Fokus mbi trajtimin e përdoruesve të shërbimit “konsumatorë” dhe mbi aplikimin e teknikave si Menaxhimi i Cilësisë Totale.

Sipas Yescombe (2011:246) MRP inkurajon decentralizimin e shërbimeve, kontraktimin e shërbimeve nga sektori privat, privatizimin e disa shërbimeve publike.

Zbatimi i MRP ka qënë i ndryshëm në vende të ndryshme. Osborne and Gaebler (1992:9) kanë qënë tepër entuziastë përse i përket adoptimit të principeve të biznesit nga Qeveria. Ndërkohë studiues të mëvonshëm si Pollit and Bouckaert kanë kritikuar entuziazmin e autorëve të mëparshëm duke u shprehur se fokusi të MRP ka qënë i papërshtatshëm. Qeveritë e vendeve të ndryshme kanë dhënë emërtime të ndryshme modelesh si psh. modeli i Zelandës së Re (Boston et.al 1996:5), modeli Kanadez La releve (Bourgon,1998:20), modeli Belg Copernicus (Hondeghem & Depre, 2005:123-152) dhe modeli Gjerman “shteti i hollë (Sachverständigenrat Schlanker Staat, 1997:133-150).

Modeli i Zelandës së Re përfshinte shumë elemente të MRP si privatizimin, ndarjen e politikbërjes nga shpërndarja e shërbimeve, transferimin e tyre, krijimin e organizatave me një qëllim të vetëm si psh privatizimin (Boston et. al.1996:5). Sipas Pollit and Bouckaert, reformat e ndërmarra në Zelandën e Re janë ndoshta nga më radikalët ndër

vendet e OECD-së (Pollit and Bouckaert 2004: 280). Sipas Cook (2004:15) faktorët e suksesit të këtij modeli në mënyrë të përmblodhur janë: *”qartësia e objektivave, liria për të menaxhuar, përgjegjshmëria, vlerësimi efektiv i performancës dhe rrjedhja e duhur e informacionit”*.

Modeli Kanadez për MRP filloi të zbatohet në Kanada në fillim të viteve 1990. Sipas këtij modeli qeveria krijoi disa agjenci të reja dhe filloi të zhvendoste shpërndarjen e shërbimeve dhe funksionet rregullatore tek korporatat fitimprurëse dhe jo-fitimprurëse duke ju shtuar një element i ri që është vet-menaxhimi nga industritë rregullatore (Winfield & Kaufman & Whorely, 2000:1-2). Edhe në këtë rast modeli konsistonte në ndarjen e politikbërjes nga administrimi.

Modeli i MRP në Belgjikë ka qënë tepër i kufizuar (Brans & Hondegheem, 2005:823-837; Broucker & Depre & Hondegheem, 2010:31-39; Pollit & Bouckaert, 2009:213-230). Modeli Belg filloi të zbatohet në vitin 2000 ku qeveria federale lançoi reformën e quajtur “Copernicus”. Objektivat e reformës ishin të riformulohej sistemi administrativ belg në drejtim të strukturave organizative dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Reforma kishte si qëllim të ndryshonte rregullat mbi kontrollet administrative dhe buxhetore duke vënë theksin te risqet ex post bazuar në kontrollin e brendshëm dhe auditin për të zëvendësuar kontrollet paraprake, të cilat fokusoheshin më tepër në inpute. Ideja e përgjithshme e kësaj reforme ishte të ridimensiononte strukturat dhe kulturën e shërbimit civil (Joris & De Visscher & Montuelle, 2009:1-14).

Në Gjermani elementët e MRP u adoptuan vetëm në nivelin e pushtetit vendor dhe pothuaj aspak në nivelin qendror (Bach & Jann, 2010:443-468; Jann & Rober & Wollman, 2006:1-25; Wollmann, 2001:151-169). Modeli Gjerman për MRP filloi të zbatohet në fillim të viteve 80 në disa fusha kyçe të administrimit publik si psh. shpërndarja e shërbimeve sociale ku kontraktimi i shërbimeve të operatorët privatë ishte mjaft i përhapur. Ndërkohë administrimi publik sipas standarteve ndërkombëtare vlerësohej mjaft mirë dhe në këtë drejtim nuk u pa e arsyeshme që të reformohej. Tradita e rregullit të ligjit si dhe tradita weberiane administrative paraqisnin pengesa ligjore dhe kulturore kundrejt futjes së elementëve të sektorit privat në sektorin publik (Wollmann, 2012:6).

Do të ishte një punë mjaft e madhe që të hyje nëpër detaje të secilit model dhe nuk është ky qëllimi i trajtimit të këtij punimi, por ajo që është e rëndësishme është se modelet e këtyre vendeve tregojnë origjinalitetin apo unikalitetin e secilit sistem ekonomik. Modelet e trajtuara tregojnë se historitë e vendeve dhe karakteristikat e institucioneve kanë influencuar në shpejtësinë e adoptimit të MRP (Lynn, 2006:5-23). Konkuzioni i përgjithshëm është se vendet që kanë adoptuar MRP janë kryesisht sistemet anglo-saksione si Australia, Zelanda e Re, SHBA dhe Anglia.

2.4 Modele të tjera të reformimit publik

Në seksionin e mëparshëm pamë se MRP-ja nuk u zbatua me të njëjtën shpejtësi në vende të ndryshme. Për më tepër që koncepte të reja lindën të tilla si partneriteti, mirëqeverisja, e-government. Në këtë seksion do të analizohen modele të tjera dhe karakteristikat e tyre në ofrimin e shërbimeve publike dhe do të synohet të analizohen ndryshimet me MRP. Akademikët në fakt kanë qënë të sukseshëm të zbulojnë modele të reja të tilla si modeli Napoloneik (Ongaro, 2009:252-263), modeli i Shtetit Neo-Weberian (NWS Dreschler and Kattel, 2008:95-99; Lynn, 2008:75-90), modeli francez (Bartoli, 2008:14-41) dhe modeli Nordik (Veggeland, 2007:1-15). Për shembull, modeli norvegjez besohet që vë më shumë theksin mbi qeverinë dhe zgjidhjet publike. Ndërsa modeli anglo-sakson vendos më shumë theksin te zgjidhjet e tregut, shpenzime të ulta publike dhe qeveria e kufizuar.

Modele të tjera të përgjithshme që ofrohen nga akademikët në kërkim të zgjidhjeve të tjera përfshijnë:

- Qeverisja e kohës Dixhitale (Dunleavy et al.2006b: 467–494)
- Qeverisja e Re publike (Osborne, 2010:9)

Që nga viti 1990 një literaturë mjaft e gjerë u përhap mbi “rrjetet” (Pollit dhe Bouckaert, 2011:5-7), Manuel Castells në vitin 1996 publikoi një libër me mjaft influencë i titulluar “Rritja e Shoqërisë Ndërvepruese (Network Society).

Pyetja që shtrohet është sesi lidhet ky koncept me Menaxhimin e Ri Publik?

Sipas Pollit dhe Bouckaert (2011:5-7) ata që mbështesin teorinë e rrjeteve trajtojnë me anë të kësaj teorie çështjet komplekse, të cilat karakterizojnë botën tonë moderne në ditët e sotme. Rrjetet besohet që kanë elementë që i bëjnë të jenë superiore ndaj hierarkive dhe tregjeve. Në këtë mënyrë besohet se rrjetet janë një mënyrë alternative e MRP, duke qënë se është një kombinim i hierarkive (udhëheqësit politikë dhe menaxherialë deklarojnë objektiva dhe strategjitë e tyre) dhe tregjeve (njësitë që kryejnë detyra të sektorit publik supozohet të jenë në konkurrencë me njëri tjetrin dhe stafi individual janë në konkurrencë). Ekzistojnë mjaft debate se Qeveritë kanë kohë që funksionojnë mbi bazë rrjetesh dhe si rrjedhim flitet për dicka që mund të ketë ekzistuar tashmë për një kohë të gjatë. Ka të tjerë që debatojnë se rrjetet duhet të jenë të vetë-organizuara, ndërsa të tjerë thonë se ato duhet të organizohen nga një apo dy grupe që janë dominante.

Pyetja tjetër që shtrohet është se çfarë do të thotë zhvendosje nga koncepti i qeverisë tek qeverisja dhe mirëqeverisja?

Termi i qeverisjes është bërë një term mjaft i përhapur si për akademikët ashtu dhe praktikuesit. Koncepti i qeverisjes paraqitet si një koncept më i gjerë se ai i qeverisë. Megjithatë nuk është një alternativë e qeverisë sepse qeveria mbetet institucioni më i rëndësishëm. Koncepti i qeverisjes së mirë u lançua për herë të parë nga Banka Botërore në vitin 1989 dhe i referohej “një shërbimi publik eficient, një sistemi gjyqësor të besueshëm dhe një administrimi, i cili është i përgjegjshëm ndaj publikut” (Andrew, 2008:379–407). Për të bërë të mundur matjen dhe vlerësimin e qeverisjes së mirë në shumë vende Banka Botërore llogarit 5 indekse të quajtura Indikatorët e Qeverisjes Globale¹⁷. Qeverisja e mirë përkufizohet të jetë drejtimi i shoqërisë nëpërmjet rrjeteve dhe partneriteteve ndërmjet qeverisë, korporatave të biznesit, dhe shoqatave të shoqërisë civile (Pollit & Bouckaert 2011:18). Kjo nxjerr në pah lidhjen me konceptin e sqaruar më sipër dhe madje një teoricien i rrjeteve Erik- Hans Klijn përmend konceptin “rrjetet

¹⁷ Keto indekse janë: 1. Përgjegjshmëria 2. Stabiliteti Politik dhe mungesa e dhunës 3. Efektiviteti i Qeverisë 4. Cilësia Rregullatore 5. Rregulli i ligjit 6. Kontrolli i korrupsionit.
<http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#doc>

e qeverisjes” (Klijn, 2008:505-525). Osborne (2010:9) gjithashtu sqaron se modeli i Qeverisjes së Re është i lidhur me teorinë e rrjeteve.

Sipas Bellamy dhe Palumbo, (2010:10) qeverisja do të thotë “një zhvendosje nga format hierarkike të organizimit tek adoptimi i formave të rrjeteve. Do të thotë gjithashtu një rishikim i marrëdhënies ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile në një mënyrë më pjesëmarrëse dhe zhvendosje nga ligji statutor tek forma më fleksibile të rregullimit dhe zbatimit”. Sipas Pollit dhe Bouckaert, (2011:20-22) një pyetje që ngrihet është nëse rrjetet dhe qeverisja funksionojnë. Po sipas tyre është mjaft e vështirë t’i japësh përgjigje sepse në disa raste ka funksionuar mirë dhe në disa raste të tjera ka dështuar. Ashtu siç e tregojnë dhe rastet e studimit të shumë vendeve gjithçka varet nga konteksti i disa karakteristikave të vendit në të cilin aplikohen. Tabela në vijim ndihmon për të përmbledhur ç’ka është thënë për modelet.

Tabela 2.1: Modelet e reformimit publik

Modeli	Karakteristikat	Mekanizmat matës
Menaxhimi i Ri Publik	Bën qeverinë më eficiente që i përgjigjet konsumatorëve duke futur elementë të biznesit/tregut.	Indikatorët e performancës, kontrata konkurruese.
Shteti Neo Weberian	Modernizimi i aparatit të shtetit tradicional në mënyrë që të bëhet më profesionale, më eficiente dhe më përgjegjëse ndaj nevojave të konsumatorëve. Metodat e biznesit mund të kenë një rol dytësor dhe shteti mbetet një aktor i rëndësishëm me rregullat e veta, metodat dhe kulturën.	Autoriteti ushtrohet nëpërmjet një hierarkie të disiplinuar.
Rrjetet	Ka si synim që të bëjë qeverinë më të informuar, më fleksibël duke punuar nëpërmjet rrjeteve vetë organizuese dhe më pak nëpërmjet hierarkive apo instrumentave të tregut.	Rrjetet e aktorëve të ndërruar njëri me tjetrin.
Qeverisja	Ta bëjë qeverinë më efektive dhe të legjitimuar duke përfshirë një rreth të gjerë aktorësh si në politikbërje ashtu dhe zbatim.	Krijimi i rrjeteve dhe partneriteteve ndërmjet aktorëve.

Burimi: Pollit dhe Bouckaert, (2011)

Menaxhimi i Ri Publik sjell risi të reja që reagojnë ndaj metodave tradicionale burokratike dhe qeverisë së madhe. Modeli thekson rëndësinë e futjes së metodave të biznesit me pothuaj të gjitha elementët e saj. Modeli i shtetit neo weberian thekson modernizimin e strukturave të shtetit për ta bërë më eficiente, por sipas këtij modeli metodat e biznesit nuk sjellin përgjigjen e të gjitha pyetjeve. Sigurisht që burokracia tradicionale ka elementë që duhen ruajtur të tilla si: respektimi i ligjit, parashikimi, vazhdimësia etj, por çështja më thelbësore është të gjendet një model që i përfshin edhe qytetarët. Në këtë kuadër, modeli i ri i qeverisjes ka si tendencë të shkojë përtej debateve ndërmjet shtetit dhe biznesit dhe të tregojë se shoqëritë moderne qeverisen më mirë nëpërmjet ndërveprimit të aktorëve që janë qeveria, tregu dhe shoqëria civile.

Modelet e prezantuara në këto dy seksione na tregojnë destinacionin që shumë vende kanë arritur dhe duhet të arrijnë. Duke patur parasysh faktin se PPP-të kërkojnë që vetë qeveritë të jenë të modernizuara, apo eficiente për të përballuar realitetin e PPP-ve atëherë pyetja që lind është si shkohet në këto destinacione?

Kjo është arsyeja përse shumë vende veçanërisht në vitet 1990 ndërmorën reforma në shumë sektorë të vendit për të përballuar ofrimin e shërbimeve më cilësore, për të siguruar transparencë dhe ajo që është më e rëndësishmja dhe e lakuara “qeverisje të mirë”. Mjaft reforma u ndërmorrën në fushën e menaxhimit publik, të menaxhimit të personelit etj. Kjo i jep përgjigje pyetjes që ngritëm se cili ishte terreni që vendet në zhvillim duhej të përgatisnin për të shkuar drejt modelit të MRP. Në të njëjtën kohë, ndërmarrja e reformave të modernizimit të sektorit publik kërkonte fonde financiare apo asistencë teknike, e cila nuk mund të sigurohej vetëm nga qeveria. Kjo ishte arsyeja që institucionet ndërkombëtare si BB u bënë pjesë e këtij procesi duke ndihmuar vendet në zhvillim me ndihma në formën e asistencës ndërkombëtare duke kushtëzuar dhënien e asistencës për zhvillim me përmbushjen nga ana e qeverive të një sërë reformash që kërkoheshin.

Në Shqipëri sfida më e madhe e tranzicionit ishte zhvendosja nga një ekonomi plotësisht e centralizuar drejt ekonomisë së tregut që do ta hapte vendin drejt botës së zhvilluar. Vitet 1991 dhe 1992 ishin vitet e para kur filluan përpjekjet për të

transformuar vendin drejt ekonomisë së liberalizuar dhe heqjes së monopolit të shtetit mbi tregëtinë e huaj. Proçesi i privatizimit në Shqipëri filloi menjëherë pas hartimit të Kushtetutës së re dhe miratimit në gusht 1991 të Ligjit 7512 “Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, iniciativave të lira dhe privatizimit”. Privatizimet filluan të kryhen në vitin 1992. Në konsulencë dhe bashkëpunim me FMN dhe BB, Qeveria e re hartoi një program privatizimi me synimin që deri në vitin 1996 të gjitha privatizimet të ishin kryer. Ky proçes u zhvillua më ngadalë sesa ishte parashikuar dhe u ndërpre gjatë shpërthimit të krizës së firmave piramidale në 1997.

Në vitin 1998 bazuar në “Strategjinë e Privatizimit të Sektorëve Strategjikë”, qeveria ndërmoi hapa për të përshpejtuar proçesin e privatizimit të ndërmarrjeve dhe ristrukturimit të tyre. Që atëherë, shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u shitën, u dhanë me qera, ose u likujduan. Në të njëjten kohë Qeveria filloi privatizimin e sektorëve strategjikë që përfshinte industrinë e mëdha shtetërore (Angjeli, 2011:29-39). Privatizimi i shtëpive, transportit dhe tregëtisë me pakicë është përfunduar. Që prej vitit 2000 janë kryer disa privatizime strategjike të mëdha si shitja e rrjetit të telefonisë celulare AMC-së (shërbim, i cili u liberalizua me futjen e operatorëve të tjerë privatë si Vodafone, Eagle Mobile, Plus), privatizimi i Çimento-s në Fushë Krujë, privatizimi i Bankës Kombëtare Tregëtare, Bankës së Kursimeve, Alb Telekomit. Në sektorin e minierave ferrokromi në Elbasan dhe minierat e kromit në Përrenjas dhe Pojska ju dhanë me konçension një kompanie të huaj dhe shumë të tjera si këto (UNDP & UNCTAD, 2011:19-22).

Si një konkluzion i përgjithshëm, në këtë seksion u analizua koncepti teorik i PPP-ve, modeli i menaxhimit të ri publik dhe modele të tjera plotësuese si qeverisja e mirë, teoria e rrjeteve. Eksperienca e adoptimit të këtyre modeleve në vende të ndryshme tregoi se nuk ekziston një model universal për zvogëlimin e madhësisë së qeverisë dhe rritjen e rolit të sektorit privat. Secili vend ka adoptuar një model të vetin për administrimin e shërbimeve publike si Gjermania, Belgjika, Norvegjia. Ndërkohë vendet që janë iniciatore të këtij modeli janë vendet anglo-saksione si Anglia, Zelanda e Re, Kanada dhe SHBA.

Partneriteti Publik Privat është një mjet i modelit të MRP, por ato përfshijnë një rreth të gjerë aktorësh, të cilët ndërveprojnë mes tyre duke qënë pjesë e modelit të qeverisjes, kanë si filozofi atë të rrjeteve dhe kushtëzuan shumë vende për ndërmarrjen e reformave të modernizimit për të bërë të mundur zbatueshmërinë me sukses të tyre.

Modeli që është zbatuar në Shqipëri është modeli i rekomanduar nga BB dhe FMN, të cilat nxitën politikat liberale dhe të axhustimit strukturor, konceptin e mirëqeverisjes dhe luftën kundër varfërisë. Në këtë kuptim elementët e menaxhimit të ri publik kanë qënë dhe janë pjesë e modelit qeverisës¹⁸.

Punimi im doktoral bazohet në analizën e sektorit të ujësjellës kanalizimeve për shkak se është një sektor me performancë të dobët dhe për këtë arsye jam nxitur të analizoj modelet e rritjes së eficientës në sektor me qëllim propozimin e një modeli të përshtatshëm. Si rrjedhim, kam zgjedhur të bazohem te modeli i qeverisjes nëpërmjet rrjeteve si një mënyrë alternative e menaxhimit të ri publik. Arsyeja kryesore lidhet me numrin e madh të aktorëve pjesëmarrës për mirë administrimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve në nivel të hartimit të politikave, zbatimit, rregullimit dhe financimit të sektorit. Ajo që është më e rëndësishme është se qeverisja në sektorin e ujit ndikon në sektorë të tjerë si shëndetësia, mjedisi, pra është e rëndësishme të analizohet procesi i ndërveprimit të aktorëve në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

¹⁸ Më shumë detaje mbi performancën e reformave të axhustimit strukturor dhe privatizimeve gjenden në dokumentin e Bankës Botërore mbi vlerësimin e performancës së 4 projekteve http://www.wds.worldbank.org/external/default/EDSContentServer/EDSP/IB/2004/08/05/000160016_20040805112514/Rendered/PDF/29638.pdf

2.5 Argumentat pro dhe kundër PPP-ve

Ekzistojnë mjaft debate mbi përfitimet ekonomike dhe financiare që sjellin PPP-të, nivelin e transparencës apo pjesëmarrjen e publikut në projektet e PPP-ve. Sfida kryesore e PPP-ve është balancimi i përfitimeve sociale me motivimin e fitimit që sektori privat synon si dhe mbështetja e novacionit duke ruajtur në të njëjtën kohë standartet (Todd & Ware, 2002:233-250; Moulton & Anheier, 2001:3-19).

Në kuadër të menaxhimit të ri publik, PPP-të inkurajojnë elementët e mëposhtëm:

- Decentralizimin e shërbimeve;
- Ndarjen e përgjegjësisë të blerjes së shërbimeve nga ofrimi i tyre;
- Privatizimin e shërbimeve publike;
- Kontraktimin e shërbimeve nga ana e sektorit privat;
- Matjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve mbi bazën e produktit (output).

Sipas Yescombe (2011:15-28) PPP-të kanë avantazhe dhe disavantazhe, të cilat do t'i paraqesim në seksionin në vijim.

1. Përfitime buxhetore. Për shumë vende sidomos vendet në zhvillim buxheti është një sfidë me të cilën ndeshen qeveritë dhe rindërtimi i infrastrukturës së amortizuar, apo rindërtimi i ekonomive sidomos për ish vendet komuniste ku bën pjesë Shqipëria ushtron presione fiskale. Sipas Nisar (2007:147-156) PPP-të shikohen si instrumenta që lehtësojnë buxhetin pasi projektet publike ndërmerren pa ushtruar presione mbi kontraktimin e borxhit të ri apo rritjen e taksave. Në këtë mënyrë, PPP-të bëhen një instrument nxitës për fondet buxhetore që të përdoren në investime publike në mënyrë eficiente. Ekzistojnë studime që tregojnë se PPP-të jo gjithmonë sjellin përfitim për qeverinë. Konkretisht Quiggin (1995:23-42, 2010:1-5), pasi analizoi disa privatizime të kryera në Australi dhe Britani zbuloi se vetëm disa prej tyre rritën përfitimin neto të qeverisë. Në një artikull të mëvonshëm Quiggin në vitin 2011 sjell rastin e privatizimit të Telekomit në Britani, e cila u shit nën kosto për arsye politike. Në Shqipëri është e nevojshme që të kemi vlerësime lidhur me përfitimet nga privatizimet e kryera jo vetëm për çështje të transparencës së këtyre proceseve, por dhe për të nxjerrë mësimë që të kihen parasysh në privatizimet e mëtejshme.

2. Vlera e shtuar. Vlera e shtuar bazohet në përfitimin që sjell PPP-ja në drejtim të cilësisë dhe kostos. Për të matur vlerën e shtuar një kriter që përdoret është krahasimi i kostove dhe cilësisë përpara se të ndërmerret PPP-ja dhe pas zbatimit që njihet si krahasuesi i sektorit publik (NAO, 2003:1-24). Quiggin analizon vlerën e shtuar në rastin e privatizimeve. Kriteri kryesor për të vlerësuar është të krahasohet interesi i fituar nga shumat e pronës së shitur me interesin që do të fitohej në rast se prona nuk do të privatizohej, por do të mbetej në pronësinë publike.

Ekzistojnë shembuj pozitivë lidhur me eficiencën e kostos. Sipas një studimi të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditit të Mbretërisë së Bashkuar mesatarisht rreth 17% e projekteve të infrastrukturës publike që janë realizuar në Mbretërinë e Bashkuar me anë të PPP-ve janë më efikiente sesa projektet që realizohen nëpërmjet prokurimit publik tradicional. Ky studim shkon akoma më tej duke sqaruar se arsyet e kursimit nga kosto vijnë si rezultat i kostove të ulta të investimit pasi investitori privat e sheh koston e projektit të shtrirë gjatë gjithë periudhës që mund të jetë 20 deri në 30 vjet. Po kështu koha e planifikimit dhe ndërtimit është më e shkurtër pasi investitorët privatë janë më të specializuar dhe kanë praktika më të mira menaxhimi (Urio, 2010:104). Koncepti i vlerës së shtuar është mjaft i debatuar në ditët e sotme pasi teoria makroekonomike debaton që nëse rriten investimet publike atëherë ulen investimet private dhe si rezultat nuk ka ndonjë diferencë nëse investimi kryhet nga sektori publik apo privat. Megjithatë në total raporti nuk ndryshon në rastin e PPP-ve ajo që ndryshon është rritja e efikasitetit të investimeve private në raport me investimet publike. Përsëri ekziston pak evidencë që PPP-të të përjashtojnë investimet private dhe në këtë kuadër ato shihen më shumë si shtesë dhe jo zëvendësues të investimeve publike.

3. Kostoja e financimit të investimeve. Debatohet mjaft se kostoja e investimit nga sektori publik është më e lirë krahasuar me sektorin privat. Konkretisht kostoja e kapitalit për një PPP nga investitorë private është 2-3% më e lartë se kostoja e financimit të PPP-së nga sektori publik pasi investitorët nuk marrin parasysh ndonjë risk kur i japin hua Qeverisë (Yescombe, 2011:18). Ndërkohë që huadhënësit privatë në rastin e një PPP kanë risqe më të mëdha të huasë. Kësaj kostoje i shtohet kostoja e prokurimit duke qënë se PPP-të janë kontrata afat-gjata si dhe i shtohet kostoja e konsulencave ligjore dhe financiare për të përcaktuar fizibilitetin e objekteve të kontratave PPP. Por nga ana tjetër mbajtja e riskut vetëm nga Qeveria është më e

rrezikshme sesa në rastin e sektorit privat ku ka mjaft aksionerë, të cilët e shpërndajnë riskun (Yescombe, 2011:18).

Sipas një studimi të kryer për një grup projektesh PPP në Mbretërinë e Bashkuar, rezultoi se efienca e lartë apo kostoja e transferimit të rrezikut te sektori privat nuk tejkaloi kostot e larta të financimit nga sektori privat dhe kostot e huamarrjes private dhe në disa raste Qeveria është detyruar të ofrojë subvencione për të mbuluar këtë boshllëk (Pollock & Price & Dunningan, 2000:8). Mungesa shpeshherë e fleksibilitetit në kontratat afat-gjata shkakton kosto shtesë për investitorin privat. Në kontratat afat-shkurtra fleksibiliteti është i vogël dhe kjo e ndihmon autoritetin publik që të mos ndryshojë parametrat. Por në kontratat afat-gjata, të cilat mund të shkojnë nga 20-30 vjet mund të mos parashikohet gjithçka duke bërë që fleksibiliteti të jetë në një masë të vogël. Për shembull nëse ndërtohet një shkollë ndryshime të tjera mund të ndodhin nga lëvizja e popullsisë. Nëse rritet numri i popullsisë atëherë do të jetë e nevojshme që shkolla të zgjerohet ose nëse teknologjia avancohet do të jetë e nevojshme zëvendësimi i teknologjisë. Në këtë kuadër, kostot mund të jenë të mëdha dhe të paparashikueshme. Ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë ndërmjet fleksibilitetit dhe vlerës së parasë.

4. Transferimi i riskut te sektori privat. Risku në rastin e PPP-ve lidhet me një ngjarje të pasigurtë që ka ndikim qoftë në ofrimin e shërbimeve (mos arritja e afatit) qoftë në aspektin financiar (humbje ose fitim). Në çdo rast humbja është një kosto që duhet të mbahet nga njëra palë. Në një PPP në përgjithësi risqet janë: risku politik, risku ekonomik, risqet e fazës së ndërtimit, risqet e operimit dhe risqet e përfundimit (Yescombe, 2011:18-24). Sektorit privat i transferohen risqet në varësi të llojit të kontratës së rënë dakord. Risqet më të ulta janë ato që lidhen me kontratën e shërbimit, ndërsa risqet më të mëdha lidhen me kontratat e konçensionit, privatizimit dhe sipërmarrjes. Një pjesë e risqeve që i kalojnë sektorit privat zbuten kur disa shërbime, sektori privat ua kalon nën-kontraktorëve.

Argumenti kryesor në favor të transferimit të risqeve është se risqet mund të menaxhohen më mirë nga sektori privat dhe si rrjedhim kostoja do të jetë më e ulët krahasuar me rastin kur risqet do të mbaheshin nga sektori publik.

4. Ekonomitë e shkallës. Në përgjithësi prokurimet publike për shkak të kufizimeve buxhetore kryhen për segmente më të vogla. E kundërta ndodh në rastin e PPP-ve ku për shkak të financimit të lartë prokurimi kryhet për një segment më të gjerë dhe në këtë kuptim realizohen kursime në koston e kapitalit. Ndërkohë madhësia dhe kompleksiteti i PPP-ve mund të dekurajojë firmat më të vogla duke pakësuar konkurrencën dhe rritur çmimin për përfituesin përfundimtar.

5. Performanca. Ndoshta ndër argumentet më kryesorë që mbështet PPP është të qenit performant në ofrimin e shërbimeve. Ky argument mbështetet në faktin se sektori privat nxitet nga fitimi dhe në këtë këndvështrim është i motivuar për të qenë performant. Në të njëjtën kohë një tjetër argument i rëndësishëm është të qenit novator për kontratat e PPP-së. Autoriteti Publik përcakton specifikimet e produktit që kërkohet dhe nuk vendos kushte mbi inputet apo mënyrën sesi do të përmbushen specifikimet. Kjo i shtyn konkurruesit në garë që të jenë fleksibël dhe me zgjidhje novatore. Ky avantazh ka dhe anën e kundërt pra disavantazhin në rastet kur Autoriteti Publik përcakton specifikimet e inputeve për produktin duke bërë që investitorët privatë të vënë në pikëpyetje pjesëmarrjen e tyre për shkak të risqeve të panjohura psh. në rast se specifikimet e inputeve janë të gabuara nga autoriteti publik, çka do të çonte në dështimin e produktit final duke mbartur risqe të larta.

6. Avantazhe të tjera. Me anë të PPP-ve sektori privat sjell një teknologji të avancuar, për shkak të eksperiencave që fiton në vende të tjera dhe gjithashtu zbut kufizimin e kapitalit, duke marrë në konsideratë se sektori privat ka një akses më të madh ndaj burimeve sesa sektori publik. Në të njëjtën kohë sektori privat ka aftësi në përzgjedhjen e projekteve të duhura pasi tarifat e shërbimit vendosen mbi bazën e kërkesës dhe sektori privat është më i shqetësuar për të zgjedhur vetëm projekte të mira. Zhvillimi i PPP-ve në shumë vende është shoqëruar me krijimin e një njësie të veçantë menaxhuese e quajtur “Special Purpose Vehicle” -Njësia Ekonomike e Veçantë që merr përgjegjësinë e menaxhimit të PPP-ve dhe që kontrollohet nga Qeveria dhe partnerët privatë.

7. Elementi politik i PPP-ve është mjaft i rëndësishëm. Nëse PPP-të kanë mbështetje politike kjo garanton suksesin e tyre, por nëse PPP-të nuk kanë mbështetje atëherë kjo rrezikon suksesin. Faktorët që i bëjnë PPP-të të kenë opozitë politike është se investitorët privatë mund të përdorin PPP-të për të krijuar përfitime të tepërta dhe që

janë në kurriz të qytetarëve. Në të njëjtën kohë investitorët privatë mundet që për hir të përfitimeve të tyre të mos përmirësojnë standartet dhe kushtet e punës. Në këtë kuadër mbikqyrja nga Autoriteti Publik është i nevojshëm. Dobësitë e autoriteteve rregullatore dhe mbikqyrëse, mund të tolerojnë mos arritjen e parametrave të targetuara dhe të mos maksimizimit të përfitimeve të parashikuara për konsumatorët përfundimtarë. Duke marrë rastin e Shqipërisë, diferenca në kohë midis proceseve liberalizuese dhe privatizuese në ekonomi dhe ngritjes ligjore instucionale dhe funksionale të autoriteteve rregullatore e mbikqyrëse, dëmtoi efikasitetin e reformave strukturore të sektorit publik.

2.6 Llojet e kontratave të PPP-ve

PPP-të mund të marrin forma të ndryshme dhe eksperiencia ka treguar se përcaktimi i llojit të kontratës varet nga sektori në të cilin përdoret si dhe mjaft faktorë të tjerë siç do të trajtohet në këtë seksion. Në këtë seksion do të prezantoj llojet e kontratave dhe karakteristikat e tyre. Sipas Yescombe (2011:13) llojet e kontratave të PPP-së marrin disa forma: kontratë menaxhimi, kontratë me qera, konçensione, privatizim i plotë, sipërmarrje dhe PPP-OJF në shërbime publike.

Kontrata e Menaxhimit është një kontratë që palët lidhin ku investitori privat është përgjegjës për menaxhimin dhe operimin, ndërkohë që asetet publike janë në pronësi të sektorit publik. Këto lloj kontratash nuk mbartin risqe të larta. *Kontrata me qera* është një kontratë që palët lidhin për dhënien me qera të aseteve publike për përdorim nga investitori privat, i cili në këmbim të përdorimit paguan qeranë për përdorimin e aseteve. Sektori privat mbart të gjithë riskun tregtar, riskun e grumbullimit të të ardhurave për të shlyer koston dhe siguruar fitimin, ka zgjedhje të lirë për personelin dhe kontroll dhe menaxhim të pakufizuar mbi asetet publike siç është rënë dakord në kontratë.

Konçensionet. Kjo lloj forme financimi përdoret veçanërisht për financimin e veprave publike që kërkojnë investime të mëdha kapitale. Marrëveshja e konçensionit përfshin dy palë ku investitori privat financon një vepër publike dhe ngarkon publikun për të paguar një tarifë përdorimi sipas modelit “përdoruesi paguan” psh. pagesa për

përdorimin e një ure, tuneli. Këto pagesa përdoren për t'i kthyer investitorit privat koston e ndërtimit dhe mirëmbajtjes. Pra investitori privat mbart të gjitha risqet e kontratës me qera plus dhe riskun e ndërtimit. Pas një afati të përdorimit të veprës nga sektori privat, kjo i kthehet më pas autoritetit publik. Të dyja palët hyjnë në marrëveshje sipas një kontrate konçensionit ku përcaktohen termat dhe detyrimet e të dyja palëve. Një formë e tillë njihet si BOT (ndërto, administro dhe transfero).

Një formë tjetër zhvillimi i konçensioneve është francize (Yescombe, 2011:12) që në thelb është e njëjtë me konçensionet, por sektori privat ka të drejtën e shfrytëzimit të një vepre publike duke mos përfshirë fazën e ndërtimit. Investitori privat i kryen një pagesë fikse autoritetit publik për të drejtën e shfrytëzimit të veprës publike. Në terminologjinë e Bashkimit Europian franciza njihet si “konçension shërbimi” ndërsa konçensionit përfshin ndërtimin e infrastrukturës së re.

Privatizimi i plotë është një kontratë sipas së cilës të drejtat pronësore mbi asetet publike i transferohen plotësisht investitorit privat duke mbajtur të gjitha risqet që lidhen me pronësinë e aseteve. *Sipërmarrje* është një kontratë ku investitori privat dhe autoriteti publik bashkohen së bashku për menaxhimin e partneritetit duke ndarë si financimin ashtu dhe mbajtjen e risqeve.

PPP- OJF në shërbimet publike. Organizatat jo fitimprurëse (OJF) – “Not-for-profit firm”- kanë hyrë në tregun e shërbimeve publike në Britaninë e Madhe si një tip tjetër i PPP që në vitet 1990, si p.sh. në edukim dhe shëndetësi. Kontraktimi i shërbimeve publike tek OJF & tek firmat private - “for-profit firm”- bëhet nëpërmjet dy llojeve të ndryshme marrëveshjesh kontraktuale. Lloji i parë i marrëveshjes është kur firmës private i është dhënë e drejta e kontrollit sesi të kryejë shërbimin. Lloji i dytë i marrëveshjes është kur OJF-ja kryen shërbimin, por qeveria ruan të drejtën e kontrollit për kryerjen e shërbimeve.

Në ditët e sotme një model i ri që po diskutohet quhet Partneriteti Publik-Privat për komunitetin ku autoriteti publik dhe investitorët privatë hyjnë në marrëveshje kontraktuale për projekte në fushën e mbrojtjes sociale. Ky model po zbatohet më shumë në vendet në zhvillim si p.sh. India. Në këtë model fokusi kryesor është arritja e

objektivave të mbrojtjes sociale më tepër sesa arritja e fitimit (Bakllamaja, 2011:137-146).

2.7 Rishikimi i literaturës për përfshirjen e PPP-ve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

Në nivel botëror uji konsiderohet një burim që sa vjen dhe po rrallohet dhe janë disa faktorë që shkaktojnë këtë fenomen të tilla si ngrohja globale, rritja e popullsisë që ushtron presion për më shumë ujë dhe ndryshimet demografike nga zhvendosja e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane. Në këtë llogjikë ajo që po debatohet është përfshirja e PPP-ve në sektorin e ujësjellësit, ku përveç faktorëve të përmendur më sipër i shtohen presionet e bëra nga institucionet ndërkombëtare për uljen e borxhit total të qeverisë. Në këtë kuadër një ndër mënyrat që qeveritë marrin në konsideratë është përfshirja e sektorit privat nëpërmjet partneriteteve për të lehtësuar buxhetet qeveritare. Sektori publik megjithëse mund të ofrojë shërbime me çmime të ulta, e dëmton të varfërin për shkak të pamundësisë për të kryer investime dhe si rrjedhim cilësia e ujit është e dobët (Gray, 2001:10). Ndërkohë ekziston një literaturë e gjerë se tregjet private për ujin sjellin përfitime nga eficientia dhe janë në gjendje që të alokojnë si duhet ujin në sektorë të tjerë (Easter & Hearne, 1995:9-20; Chang & Griffin, 1992:879-890; Colby, 1990: 1184-1192; Crane, 1994:71-83).

Shqipëria në dallim me shumë vende të tjera në botë që ndeshen me sfidën e sigurimit të ujit është një vend mjaft i pasur me burime ujore, por sfida është shfrytëzimi me eficientë i këtyre burimeve. Një nga çështjet që është debatuar mjaft edhe në Shqipëri është pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e UK.

Seksioni në vijim do të trajtojë rishikimin e literaturës mbi përfshirjen e PPP-ve në sektorin e UK duke analizuar literaturën për vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim. Synimi është që të analizohet problematika e sektorit si dhe të dalin në pah rastet e suksesit nga të cilat do mund të përfitonim në studimin tonë konkret për Shqipërinë dhe të nxjerrim mësimet mbi rastet e dështimit. Është e njohur nga literatura se futja e

konkurrencës në sektorin e ujit është më e vështirë se në sektorët e tjerë si gaz, energjia dhe telekomunikacioni, sepse karakteristikat teknike të sektorit të ujit ndryshojnë nga ato të sektorëve të tjerë dhe kosto totale e rrjetit privat përbën një pjesë të konsiderueshme të koston totale të ujit duke çuar në monopol të natyrshëm (Mergos, 2005:59-75). Konkretisht aktorët konkurrentë nuk mund të ndërtojnë sisteme të UK paralele në të njëjtin qytet (Urio, 2010:26-30). Quiggin në vitin 2011 argumenton se shumica e rasteve të pronësisë publike ekziston për disa shërbime infrastrukturore si energjia, uji për dy arsye: (i) këto shërbime kërkojnë investime të mëdha dhe kostoja e ulët e huamarrjes publike është më e rëndësishme dhe (ii) këto shërbime janë monopol natyror dhe nëse do të privatizoheshin kjo do të kërkonte rregullim nga ana e qeverisë. Në këtë kuptim zgjedhja është ndërmjet një forme ndërhyrje të qeverisë dhe tjetrës.

Uji së bashku me disa shërbime të tjera si energjia, telekomunikacioni janë monopole natyrore. Kuadri modern për perkufizimin e monopolit natyror u iniciua nga Baumol (1977:809-822). Sipas këtij autori “në një industri ku një firmë e vetme mund të prodhojë të mira për të furnizuar të gjithë tregun me një çmim të ulët për njësi sesa dy apo më shumë firma, ose në një industri ku hyrësit nuk janë të tërhequr në mënyrë të natyrshme dhe janë të paaftë për të mbijetuar, firma e vetme quhet “monopol natyror”. Monopoli natyror ngre pyetjen nëse firma siguron efikasitet të brendshme, minimizon koston dhe nëse burimet përdoren me efikasitet sipas teknologjisë përkatëse të adoptuar? Këto studjohen nga teoria e X-inefikasitetit (Libenstein, 1966:392-415).

Kur analizohet raporti ndërmjet monopolit natyror publik dhe privat të dyja paraqesin avantazhe dhe risqe. Në rastin e pronësisë së monopolit natyror nga shteti duke mos patur aksionerë, qëllimi nuk është arritja e fitimit duke përbërë dhe avantazhin kryesor (Ahoroni, 1986:6-12). Kompania publike shpesh kufizohet nga buxheti. Duke qenë se kërkohet vetëm një nivel i caktuar difference ndërmjet të ardhurave dhe kostove totale, një gjë e tillë mund të kërkojë të maksimizohen shpenzimet totale ose të ardhurat. Mungesa e qëllimit të fitimit sipas kuadrit institucional të pronësisë publike mbart me vete një çmim të lartë për t’u paguar. Në një pronësi publike ku mungojnë aksionerët, ku theksohen qëllimet fiskale dhe performanca shihet nën prizmin e menaxhimit, efikasiteti ekonomik nuk është i garantuar (Depoorter, 1999:498-515). Kur asetet janë

në pronësi publike ato nuk janë të transferueshme prandaj menaxheri nuk është i motivuar për të ulur kostot, përmirësuar cilësinë, apo për të sjellë ide novatore, sepse përfiton vetëm një pjesë të të ardhurave si jo-pronar. Shërbimi postal në SHBA mund të shërbejë si një shembull i kompanisë publike ku për shumë vite u ndoq rregulli i maksimizimit të kostos ose të të ardhurave (Sherman, 1989:265-268).

Në korporatat private, aftësia e aksionerëve për të shitur votat e tyre krijon incentiva që menaxhimi t'i shërbejë interesave të pronarit. Për të arritur këtë, ndiqet rregullimi i çmimit të monopolistit. Sipas Marshall (1907:7-21), qeveria në përgjithësi nuk është novatore. Futja dhe zhvillimi i teknologjive të reja në telekomunikacion, që u shfaq pas privatizimit të kompanive telefonike në SHBA, mund të shërbejë si një shembull i përfitimeve nga pronësia private (Winston, 1998:175-196). Ndryshimet teknologjike kanë ndikim të lartë mbi stukturat e kostos dhe mund të ushtrojnë presion që tregu i monopolit natyror të lëvizë drejt konkurrencës (Shleifer, 1998:133-150). Trajtimi i raportit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat përputhet me specifikën e sektorit të ujit edhe në vendin tonë, sidomos në riskun e mos arritjes së përfitimeve edhe në rastin e sektorit privat psh. konçensioni në Elbasan, apo kontrata e menaxhimit në Kavajë, që do të trajtohen në kapitullin 4.

Në të kaluarën uji trajtohej si një mall i lirë apo mall social, por rritja e konkurrencës për këtë mall që po rrallohet ka çuar në debate mbi një këndvështrim të ri të menaxhimit të ujit. Biswas (2001:1-16) citon se “po i vjen fundi ditës kur uji trajtohet si një mall i lirë, i cili sigurohet në mënyrë automatike nga Qeveria”. Në këtë drejtim më herët Ester dhe Feder (1996:9-20) arritën në konkluzionin se është i nevojshëm një rishqyrtim i metodave të përdorura për të menaxhuar dhe alokuar ujin sipas nevojave të konsumatorëve dhe sektorëve. Tortajada (2001:3-14) analizon se në dekadat e ardhshme problemet e ujit do të rriten dhe do të bëhet e nevojshme analizimi i tij në ndërthurje me sektorë të tjerë siç janë bujqësia, shëndetësia, industria dhe mjedisi. Në këtë kuadër uji do të shihet në kuadrin e zhvillimit të shoqërisë duke patur si objektiva kryesorë uljen e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

Klubi i Tokios konsideroi 2 çështje prioritare lidhur me dialogun e politikës për ujin në rang global të cilat janë (Tortajada, 2001:3-14):

- (i) Zhvillimi i një teorie të re mbi menaxhimin e ujit dhe një politike zhvillimi, dhe
- (ii) Hartimi i një politike të re mbi çmimet e ujit dhe mbulimin e kostove, të cilat duhet të jenë pjesë e politikës për ujin.

Sipas OECD (2006) vështirësitë që sektori i ujësjellësit ka hasur në të kaluarën shërbejnë për të nxjerrë kompleksitetin e këtij sektori si në vijim:

- Kosto të larta fikse të shoqëruara me investime afat-gjata të pakthyeshme;
- Uji nuk është vetëm një nevojë bazike, por ka edhe eksternalite të tjera siç janë mjedisi, shëndeti dhe barazia gjinore;
- Uji menaxhohet në nivel vendor, si rrjedhim sektori privat ndeshet me risqe të nivelit vendor;
- Organizimi i sektorit është kompleks ku ka shumë aktorë dhe përgjegjësitë janë të fragmentuara përgjatë agjencive në varësi të qeverisë.

Rrjedhimisht sfidat e menaxhimit të ujit të shekullit të XXI sipas OECD-së është që të hartohen politika të ujit të cilat kanë këto karakteristika:

- Harmonizimi i interesave të shumë aktorëve, qeverisë, sektorit privat, NGO-ve dhe publikut të gjërë.
- Hartim i politikave të ujit duke patur parasysh eksperiencat e së kaluarës dhe të së ardhmes në kuptimin që politika të ndryshohet sa herë që ka zhvillime të reja dhe të hidhen poshtë ato supozime apo hipoteza, të cilat vërtetohen si të pavërteta.
- Marrja parasysh në menaxhimin e ujit të globalizimit, teknologjisë dhe komunikimit.
- Përfshirja e sektorit privat dhe politikave të çmimit si pjesë të rëndësishme në politikën e ujit.
- Menaxhimi i kërkesës për ujë që do të thotë ngritja e kapaciteteve të pushtetit vendor që do t'i bënte të afta për të menaxhuar ujin.

Po cili është historiku i pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e ujësjellësit dhe në çfarë mënyre merr pjesë?

Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e ujit filloi në Mbretërinë e Bashkuar në fund të viteve 1990 dhe pas viteve 90 filloi të rritej edhe në vendet në zhvillim. Konkretisht deri në vitin 1997, rreth 90% e projekteve të ndërmarra në 35 vendet në zhvillim i përkasin investimeve private në sektorin e ujit. Ajo që vihet re është se pjesëmarrja e sektorit privat në ujësjellës është më e ulët se në sektorë të tjerë dhe ndryshon edhe sipas rajoneve ku zonat e Azisë Lindore dhe Amerikës Latine kanë pjesëmarrjen më të madhe të sektorit privat në ujësjellës.

Ekzistojnë tre lloje pjesëmarrjeje të sektorit privat në sektorin e ujësjellësit (Mergos, 2005:59-75):

- (i) Tipi francez, ku shteti hyn në një marrëveshje me sektorin privat që fillon që nga kontrata e shërbimit deri te konçensionimi që do të thotë që merr në konsideratë të gjitha llojet e kontratave PPP.
- (ii) Tipi anglez ku shteti i shet sektorin privat infrastrukturën dhe asetet.
- (iii) Tipi hollandez ku shteti ka në pronësi asetet dhe infrastrukturën dhe operatori privat është përgjegjës për administrimin.

Banka Botërore promovon kryesisht llojin e parë të pjesëmarrjes private. Tabela e mëposhtme na ndihmon të kuptojmë sesi ndahen përgjegjësitë dhe risqet ndërmjet sektorit publik dhe privat sipas llojit të kontratës së pjesëmarrjes private.

Tabela 2.2 Llojet e kontratave PPP

Lloji i kontratës	Pronësia e Asetit	Administrimi dhe mirëmbajtja	Investimi i kapitalit	Risku tregetar	Kohëzgjatja
Kontratë shërbimi	Publik	Publik/privat	Publik	Publik	1-2 vjet
Kontratë menaxhimi	Publik	Private	Publik	Publik	3-5 vjet
Kontratë me qera	Publik	Private	Publik	Ndare	8-15 vjet
BOT	Private	Private	Private	Privat	20-30 vjet

Kontratë konçensionari	Private	Private	Private	Privat	25-30 vjet
Privatizimi	Privat	Private	Private	Privat	Pa kufizim

Burimi: Brooke-Cowen (1997)

Debati që ngrihet sot për sot në vendet në zhvillim është se cila lloj kontrate do të përdoret për të investuar në sektorin e ujit. Eksperienca ka treguar se kjo do të varet nga risku që merr përsipër sektori privat të mbajë në një investim. Në përgjithësi partneriteti fillon me një kontratë shërbimi për të vazhduar më pas me llojet e tjera të kontratave. Kjo edhe në funksion të kuadrit institucional që e lehtëson pjesëmarrjen e sektorit privat dhe të decentralizimit të funksioneve dhe roleve të pushtetit vendor.

Por nga ana tjetër, pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e ujësjellësit ka disa pengesa. Sipas Mergos (2005:59-75) këto pengesa kanë të bëjnë me strukturat e reja rregulluese që duhet të ngrihen, rritjen e çmimeve dhe investimet që kërkohen. Sot për sot literatura njeh atë që quhet menaxhimi i qëndrueshëm i ujit. Sipas Mergos (1991: 243-250) për të arritur këtë qëndrueshmëri duhet të sigurohet qëndrueshmëria ekologjike, operacionale dhe financiare. Kjo pa dyshim që kërkon investime të mëdha në sektor.

Në Konferencën Ndërkombëtare të Ujit dhe Mjedisit në Dublin, Irlandë në vitin 1992 (Solanes dhe Villarreal, 1999:6-37) u ra dakord mbi 4 principe kryesore të sektorit të ujit për një zhvillim të qëndrueshëm si në vijim:

Principi 1: Uji i freskët është një burim i kufizuar dhe është esencial për të jetuar, për zhvillimin dhe mjedisin. Sipas këtij principi uji është një burim kritik për të siguruar vazhdimësinë e jetës. Uji është jo vetëm i nevojshëm për zhvillimin, por në mënyrë paradoksale është i brishtë ndaj saj. Uji është një burim i kufizuar sepse ciklet hidrologjike sigurojnë mesatarisht një sasi fikse të ujit dhe sasia e burimeve ujore nuk mund të kontrollohet nga njerëzit.

Principi 2: Menaxhimi i politikës së ujit duhet të bazohet në një model pjesëmarrës që përfshin planifikuesit, përdoruesit dhe politikbërësit në të gjitha nivelet. Ky princip është i rëndësishëm sepse duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjitha palëve që preken nga politika ndihmon në ruajtjen e burimeve ujore, përdorimin me efikasitet të tij dhe sigurimin e të ardhurave dhe financimin e tij në mënyrë të qëndrueshme.

Pjesëmarrja gjithashtu ndihmon në koordinimin e interesave të ndryshme, në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në vendimarrje.

Principi 3: Uji ka një vlerë ekonomike dhe duhet të konsiderohet si një mall me vlerë ekonomike po aq sa dhe mall social. Të trajtosh ujin si një mall ekonomik është e nevojshme për vendimarrjen në drejtim të alokimit të ujit ndërmjet sektorëve të ndryshëm, veçanërisht në një mjedis ku burimet ujore janë të rralla. Kur flitet për menaxhim të qëndrueshëm të ujit, vlera ekonomike e ujit i ndihmon politikbërësit për të prioritetizuar investimet. Megjithatë uji është një mall ekonomik ai është njëkohësisht një mall social. Në këndvështrimin e një zhvillimi të qëndrueshëm është e rëndësishme që alokimi i ujit të shihet si një mënyrë për të përmbushur nevojat sociale të barazisë, uljes së varfërisë dhe ruajtjes së shëndetit.

Nevoja për investime në sektorin e ujësjellësit ka lindur si domosdoshmëri nga objektivat e sfidës së mijëvjeçarit, ku aksesimi në furnizimin me ujë të popullatës është gjithashtu një tregues i monitoruar për t'u përmirësuar edhe në sfidat e mijëvjeçarit në kuadër të objektivit 7 "Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit"¹⁹. Nevoja për investime në sektorin e ujit u theksua në vitin 2003 në panelin botëror për financimin e infrastrukturës së ujit ku Paneli i drejtuar nga Z. Michel Camdessus sinjalizoi se objektivat e sfidës së mijëvjeçarit nuk do të mund të arrihen nëse investimet vjetore në sistemin e ujit nuk dyfishohen duke filluar nga niveli i tyre në vitin 2003 (15 miliardë dollarë në 30 miliardë dollarë në vit)²⁰.

Rekomandimet që bëri ky Panel i referoheshin kahut së ofertës. Më vonë lindi nevoja për të bërë rekomandime edhe në drejtim të kërkesës duke patur parasysh se në kuadër të decentralizimit uji menaxhohet në nivel vendor dhe lind nevoja për të punuar në drejtim të menaxhimit të ujit nga bashkitë apo mini bashkitë. Me të drejtë disa pyetje që mund të shtrohen këtu janë:

1. A janë të gatshme pushtetet vendore për të ushtruar përgjegjësitë e deleguara nga pushteti qendror për të menaxhuar ujin ose e thënë ndryshe a janë të mirëpërcaktuara rolet dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor? A ekzistojnë

¹⁹ The Millennium Development Goals Report 2011, p.54

http://www.undp.org/content/dam/undp/library/MDG/english/MDG_Report_2011_EN.pdf

²⁰ http://www.financingwaterforall.org/fileadmin/Financing_water_for_all/Reports/Financing_FinalText_Cover.pdf

kapacitetet e duhura menaxheriale dhe financiare për të përballuar menaxhimin e integruar të ujit?

2. A mund të ketë akses në financim pushteti vendor duke patur parasysh aftësinë e dobët shlyese dhe a do të jetë i vullnetshëm pushteti qendror për të ndihmuar pushtetin vendor me anë të financimeve?
3. A mund të flitet për pjesëmarrje të PPP-ve në sektorin e ujit në kushtet kur decentralizimi i shërbimeve është në hapat e para, veçanërisht në vendet në zhvillim? Konkretisht a janë të rregulluara për të qënë të pavarur nga ndërhyrjet politike në drejtim të përcaktimit të çmimit?
4. Cili lloj i PPP-ve është më i përshtatshëm në sektorin e ujit?

Rekomandimet që u dhanë në panelin botëror për financimin e sektorit të ujit kishin të bënin me këto çështje:

1. Kuptimit që menaxhimi i ujit është një çështje e pushtetit vendor.
2. Vendosja e tarifave të duhura të përballueshme edhe nga shtresat më të varfëra. Nëse investimet që jepen nuk janë të garantuara nga kthimi i tyre atëherë dyfishimi i këtyre fondeve do të ishte pa vlerë. Konsumatorët dhe taksapaguesit janë aktorët kryesorë që bëjnë të mundur kthimin e investimit, por a do të mund të garantohej kthimi i investimit në zonat shumë të varfëra? Ajo që lind si nevojë është ndërhyrja e qeverisë me subvencione për të ndihmuar shtresat e varfëra të paafta për të përballuar tarifat e reja të ujit. Interesi i donatorëve për të financuar këtë sektor lindi nga pengesat që infrastruktura ujore i ka shkaktuar zhvillimit ekonomik dhe social.
3. Vendosja e partneritetit që të përfshijë të gjithë aktorët (qeverinë, pushtetin vendor, donatorët vendas dhe ndërkombëtarë, komunitetin, OJQ-të).
4. Ngritja e kapaciteteve në nivel vendor për të menaxhuar ujin.
5. Zhvillimi i tregjeve të kapitalit vendas.

Çfarë nënkupton zhvillimi i qëndrueshëm i ujit?

Sipas OECD (1998) zhvillimi i qëndrueshëm do të thotë se “konsumimi i ujit duhet të plotësojë nevojat bazë duke mos dëmtuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të

plotësuar nevojat e tyre të ujit duke mbrojtur nevojën për ujë të mjedisit”. Uji është një burim natyror i kufizuar dhe i rrallë (burimet e freskëta të ujit formojnë më pak se 1% të ujit total në të gjithë globin), e rëndësishme për jetën, dhe që sillet në një mënyrë të ndryshme nga elementët e tjerë të biosferës duke qënë se për ujin nuk ka zgjedhje ndërmjet burimeve. Në këtë mënyrë, megjithëse burimet ujore janë të rinovueshme, sistemet e ujit mund të degradohen dhe të humbasin dhe ekosistemi mund të jetë i varur nga një sasi minimale dhe cilësie e ujit, nivel poshtë të cilit mund të jetë e rrezikshme. Në këtë kuadër, zgjedhja që duhet të bëhet në menaxhimin e ujit në mënyrë të qëndrueshme është sesi të alokohet uji dhe të gjendet mënyra më eficiente për këtë qëllim.

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit është një menaxhim i integruar i burimeve ujore dhe në këtë drejtim Komiteti Teknik i Partneritetit Global të ujit jep këtë përkufizim: “një proces që promovon zhvillimin dhe menaxhimin në mënyrë të koordinuar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, me qëllim maksimizimin e mirëqënies ekonomike dhe sociale në mënyrë të barabartë pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve”. Sipas disa ekspertëve (Seckler, 1996:37-53) numri i njerëzve që jetojnë në vendet që kanë rrallësi të ujit do të përfaqësojnë 13-20% të popullsisë globale në vitin 2050. Kjo tregon faktin se uji do të bëhet një faktor kryesor përcaktues i tregëtisë dhe rritjes ekonomike të vendeve.

Duke qënë se uji është një burim i rrallë, nevoja për të ruajtur cilësinë e ujit përkthehet në legjislacion për ujin, si dhe në hartimin e strategjive nga qeveritë e vendeve ku përcaktohen objektivat dhe qëllimet e politikave për ujin. Si rezultat i këtij presioni në problemet e menaxhimit si të sasisë së ujit që përdoret, ashtu edhe në drejtim të cilësisë, në Europë lindi një fushë e re e politikës në këtë sektor. Konkretisht në 23 tetor 2000 u hartua Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)²¹ për menaxhimin e burimeve ujore, e cila përcakton planin e menaxhimit të baseneve lumorë si instrumentin kryesor për të ndihmuar në parandalimin e shkatërrimit të burimeve ujore.

Në vitin 2007 Komisioni European ra dakord për disa çështje që lidhen me rrallësinë e

²¹ Direktiva 2000/60/EC amenduar së fundi me direktivën 2009/31/EC më 23.04.2009
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CONSLEG:2000L0060:20090625:EN:PDF>

ujit duke identifikuar disa fusha të politikës së ujit që duheshin zgjidhur nëse Europës do t'i duhej të ecte përpara drejt një ekonomie eficiente në menaxhimin e ujit. Me qëllim zgjidhjen e sfidave të ujit është e rëndësishme përmirësimi i menaxhimit të kërkesës së ujit. Menaxhimi i kërkesës përkufizohet si zhvillimi dhe zbatimi i strategjive që ndikojnë kërkesën për të arritur një përdorim eficient dhe të qëndrueshëm të ujit. Përveç eficiencës duhet të sigurohet barazia dhe integriteti mjedisor. Strategjitë e menaxhimit të kërkesës konsistojnë në masa jo-strukturore të tilla si: rregulla ligjore dhe ekonomike për të ndryshuar sjelljen e përdoruesve të ujit dhe krijimin e mjedisit institucional dhe politik që e bën të mundur zbatimin (Savenije & Van der Zang, 2002:98-104).

Përmirësimi i menaxhimit të kërkesës për ujë mund të çojë në një rritje të eficiencës së përdorimit të ujit dhe/ose uljen e konsumimit të ujit, me disa përfitime ekonomike dhe mjedisore në një periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë të tilla si:

- Kosto më të ulta të trajtimit të ujit dhe kapacitetit të sistemit të shpërndarjes (përfshirë kapacitetin e infrastrukturës për të mbledhur dhe trajtuar kanalizimet).
- Kursime në shpenzimet kapitale për shkak të investimeve më të pakta në projekte.
- Kursime nga energjia për ngrohjen e ujit si dhe për pompimin dhe trajtimin.
- Përfitime mjedisore nga pakësimi i marrjes së ujit nga lumenjtë duke çuar në ruajtjen e burimeve ekologjike.

Të gjitha këto çështje tregojnë sesa i rëndësishëm është menaxhimi i ujit në mënyrë të integruar jo vetëm në kohët e sotme, por edhe në dekadat e ardhshme. Por, përdorimi me eficiencë dhe njëkohësisht në mënyrë të qëndrueshme të ujit janë dy koncepte që mund të bien në kontradiktë njëri me tjetrin. Baumann (1998:77-94) argumenton se në rastin e burimeve ujore të rralla përdorimi me eficiencë dhe përcaktimi i çmimit mund të nxisin përdorimin e ujit në mënyrë të qëndrueshme. Zbatimi i një sistemi të vendosjes së çmimit të ujit është një nga mënyrat kryesore të përdorimit eficient të tij. Në këtë mënyrë ofruesit e ujit dhe rregullatorët përdorin tarifa për përdorimin e ujit nëpërmjet vendosjes së matësave dhe rritjes së ndërgjegjes së përdoruesve të ujit nëpërmjet programeve të edukimit me qëllim ruajtjen e tij dhe pakësimin e kërkesës së ujit drejt një

niveli të qëndrueshëm (EEA, 2000).

Një çështje e debatuar mbi pjesëmarrjen e sektorit privat në sektorin e ujësjellësit në vendet në zhvillim është eficientia e sektorit. Një element i rëndësishëm i eficiencës, që është edhe një ndër përfitimet që vijnë nga PPP-të është arritja e ekonomive të shkallës. Në teorinë mikroekonomike është e njohur se monopoli natyror ka kosto të larta fikse dhe ekonomitë e shkallës janë avantazhet e kostos që një kompani realizon kur zgjerohet. Konkretisht kur investimi fillestar është kryer kostot mesatare bien me rritjen e çdo njësie të prodhuar (Depoorter, 1999: 498-515).

Një koncept që po aplikohet sot gjerësisht në sektorin e UK si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim për realizimin e ekonomive të shkallës është bashkimi i disa njësive, të cilat mund t'i shërbejnë një numri më të gjerë konsumatorësh. Termi që përdoret sot në këtë sektor është rajonalizimi i kompanive UK. Ekzistojnë mjaft studime mbi faktorët kryesorë të rajonizimit. Sipas një studimi të kryer për rajonizimin në Rumani ndër faktorët kryesorë renditen: (i) rritja e eficiencës nëpërmjet ekonomive të shkallës; (ii) aksesit ndaj burimeve ujore dhe menaxhim i integruar i ujit (iii) ndarja e kostove ndërmjet zonave që ofrojnë shërbimet me kosto të lartë dhe zonave me kosto të ulët (Frone, 2008:185-200).

Debati që zhvillohet përse i përket ekonomive të shkallës është se cili është kufiri ndarës pas së cilës nuk realizohen më përfitime? Ekzistojnë disa studime ndërkombëtare dhe studime kërkimore që kanë si qëllim të shohin nëse ekziston ndonjë lidhje mes madhësisë dhe eficiencës së kompanisë. Për shembull, kërkime më të hershme ekonometrike (Garcia dhe Alban, 2001:5-29) përdorën të dhëna nga vendet me zhvillim të lartë dhe arritën në konkluzionin se ofruesit e shërbimeve të ujit mund të realizojnë përfitime të kostos pavarësisht madhësisë së ndërmarrjeve duke marrë në konsideratë edhe ndërmarrje me madhësi të vogël. Një studim më i mëvonshëm (Tynan dhe Kingdom, 2005:1-4) përdori të dhëna nga vendet me zhvillim të lartë, të ulët dhe të mesme dhe analizoi lidhjen mes madhësisë së kompanisë dhe kostove për njësi të prodhimit.

Rezultati ishte se kompanitë e ujësjellësit mund të ulin kostot operative për konsumator duke rritur shkallën e prodhimit. Ky studim nxorri në pah se ekonomitë e shkallës realizohen më mirë për kompanitë e vogla të ujit që ju shërbejnë më pak se 125,000 konsumatorë sesa për kompanitë e mëdha për të cilat ekonomitë e shkallës fillojnë të ulen. Ekonomitë e shkallës janë një çështje që debatohet veçanërisht për kompanitë e ujësjellësit të vendeve në zhvillim të cilat kanë këto karakteristika:

1. Kompanitë janë inefiçiente dhe si rrjedhim shërbimet e ofruara nuk janë cilësore. Këto kompani nuk kanë mundësi të kryejnë investime për të rregulluar sistemet e vjetra apo të mirëmbajnë sistemet ekzistuese.
2. Për shkak të pamundësisë së kryerjes së investimeve nuk ofrohen shërbime në zonat më të varfëra apo më të largëta. Kjo çon në pabarazi të ofrimit të shërbimeve dhe në ndotjen e mjedisit.
3. Kompanitë e ujësjellësit duke qënë me madhësi të ndryshme janë të fragmentuara dhe përfshirja e sektorit privat është e vështirë për shkak të mosrealizimit të fitimeve që sektori privat kërkon.
4. Performanca e dobët e kompanive ushtron presion për Qeverinë, e cila është detyruar të subvencionojë dhe debati që zhvillohet në këtë drejtim veçanërisht nga institucionet ndërkombëtare është që qeveritë subvencionojnë kostot operationale të kompanive (humbjet financiare) dhe ata që dëmtohen janë shtresat në nevojë.

Këta faktorë i kanë shtyrë qeveritë e shumë vendeve që të shohin rajonalizimin e kompanive të ujësjellës kanalizimeve si një mundësi për të realizuar ekonomitë e shkallës dhe ajo që është më e rëndësishmja për të siguruar akses ndaj fondeve private të financimit.

Rajonalizimi shihet si një mundësi për të patur akses ndaj menaxhimit të integruar të burimeve ujore në kuadër të Direktivës Kuadër të Ujit (2000/60/KE) e datës 23 Tetor 2000 për menaxhimin e burimeve ujore të përmendur më herët në këtë punim. Kjo direktivë krijon premisa për ndërmarrjen e projekteve të mëdha dhe në këtë kontekst bashkimi i njësive më të vogla në më të mëdha duhet të konsiderohet si kusht për të patur akses në fondet e Bashkimit European. Përdorimi i sistemeve të kushtëzimeve apo

incentivave në lehtësimin e bashkimit të kompanive UK përdoret në shumë vende që synojnë bashkimin e kompanive. Një tjetër çështje e trajtuar nga literatura për rajonalizimin në kuadër të realizimit të ekonomive të shkallës është bashkimi i kompanive që kanë kosto të ulta me ato me kosto më të lartë. Ndarja e kostove do të varet nga tarifat e përbashkëta që vendosen. Shpeshherë çështja e koston ka qënë një pengesë në drejtim të rajonalizimit sepse zonat që kanë kosto më të ulët mund të rezistojnë të bashkohen me zonat që janë më të kushtueshme në drejtim të ofrimit të shërbimeve²². Megjithatë çështja e koston ka qënë një ndër faktorët që e ka nxitur rajonalizimin. Për shembull, përmendim rastin e Skocisë ku krijimi i një kompanie të vetme rajonale për ofrimin e shërbimeve ndërmjet rajoneve me kosto të lartë Highlands dhe Islands që karakterizohen nga popullsia mjaft e shpërndarë dhe e vështirë për t'u arrirë dhe rajoneve me kosto të ulët, u realizua nëpërmjet subvencioneve të siguruara nga Qeveria.

Një konkluzion i përgjithshëm është se debati për ujin është bërë një çështje e rëndësishme jo vetëm në rang kombëtar, por edhe atë ndërkombëtar. Uji nga një mall i lirë apo social është kthyer në një mall konsumi dhe mjaft kushte globale që kanë ndodhur dhe po ndodhin kanë çuar në rrallësinë e këtij malli. Si rrjedhim një ndër sfidat e shekullit të XXI është menaxhimi me efektivitet dhe eficiencë i ujit. Madje dhe *teoria e menaxhimit të ujit ka ndryshuar duke futur konceptin e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe lidhjen e tij me sektore të tjerë si shëndetësia, mjedisi, bujqësia dhe industria*. Sfidat për mjaft qeveri janë të sigurojnë investime në këtë sektor. Sektori privat priret nga fitimi dhe debati që zhvillohet sot për këtë sektor është arritja e ekonomive të shkallës, si një ndër përfitimet e PPP-ve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kompanitë e UK që janë inefiçiente dhe të vogla për nga madhësia. Një ndër mënyrat për arritjen e ekonomive të shkallës dhe tërheqjen e investitorëve privatë është nëpërmjet rajonalizimit të kompanive, ose bashkimit të tyre. Një literaturë e gjërë tregon se rajonalizimi funksionon si në vendet e zhvilluara ashtu dhe vendet në zhvillim, të cilat do të trajtohen në kapitullin në vijim.

²² http://www.academia.edu/1344745/Factors_and_challenges_of_regionalization_in_the_water_and_wastewater_sector

KAPITULLI III: RAJONALIZIMI DHE EKSPERIENCA NDËRKOMBËTARE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

3.1 Hyrje

Deri në shekullin e XX-të shumica e shërbimeve të ujit siguroheshin në nivel vendor. Më pas kur filluan të krijohen qendrat urbane, komunitetet e fermerëve, uji filloi të kuptohej si një nevojë vendore që sigurohej dhe ofrohej nëpërmjet institucioneve vendore duke përdorur burimet lokale. Ndërsa në SHBA, Kanada dhe vende të tjera filloi të rritej numri i popullsisë sigurimi i ofrimit të ujit po bëhej çështje problematike. Me rritjen e popullsisë filluan të rriteshin kërkesat për ujin që ushtronte presion mbi burimet vendase të vlefshme, të cilat nuk mund të përballonin kërkesën e lartë. Në shumë vende u bë e qartë se sigurimi i ofrimit të ujit mund të arrihej më mirë mbi baza rajonale nëpërmjet bashkimit gjeografik, ose mbi bazën e mundësive ekonomike, të cilat janë të nevojshme për të financuar shumat e mëdha kapitale të nevojshme për importimin e ujit nga distanca të largëta dhe ruajtjen e tij. Arsye të tjera që kanë çuar në ofrimin rajonal të ujit janë edhe ndryshimet ligjore që shumë vende kanë patur, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të cilësisë, apo të mbrojtjes së mjedisit.

Decentralizimi i ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë tek pushteti vendor ka ngritur sfida si në drejtim të menaxhimit ashtu dhe financimit. Kjo për shkak se pushteti vendor shpeshherë nuk i ka kapacitetet e duhura për t'i shërbyer një numri të madh qytetarësh, si dhe ka vështirësi në sigurimin e financimit të nevojshëm për të mirëmbajtur rrjetet e ujësjellës kanalizimeve si dhe të kryejë investimet e nevojshme. Situata është më e vështirë për ato bashki që ofrojnë shërbimet për një numër të madh konsumatorësh.

Një nga mënyrat e zgjidhjes së kësaj situate është bashkimi i disa kompanive të ujit dhe krijimi i rajoneve siç njihet ndryshe rajonalizim. Ky proces ka ndodhur si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim. Sipas Kingdom (2005:15) ekzistojnë pak publikime për rajonalizimin. Bashkimi Europian dhe Banka Botërore po e promovojnë

këtë skemë në vendet në zhvillim. Arsyeja kryesore për rajonalizim është arritja e ekonomive të shkallës duke i shërbyer një numri të madh konsumatorësh dhe mundësia për akses të financimet e sektorit privat apo fondet e institucioneve ndërkombëtare, të cilët nxiten për të financuar, mbështetur në argumentin e arritjes së ekonomive të shkallës.

Ky kapitull analizon rajonalizimin si koncept së bashku me faktorët nxitës dhe pengues. Ky proces ka si përfitime ashtu edhe kufizime. Në pjesën e parë jepen përkufizime dhe evolimi i konceptit të rajonalizimit. Në pjesën e dytë jepen faktorët kryesorë që favorizojnë rajonalizimin. Në pjesën e tretë jepen eksperiencat ndërkombëtare që përfshin vende të zhvilluara dhe vende në zhvillim. Në pjesën e fundit jepen mësimet e nxjerra, të cilat do të shërbejnë për të analizuar rastin e sektorit të UK në Shqipëri.

3.2 Përkufizimi i rajonalizimit

Ekzistojnë disa përkufizime lidhur me rajonalizimin. Shpeshherë ky term emërtohet si rajonalizim, konsolidim, apo ristrukturim. Në shumicën e punimeve termi që haset më shpesh është rajonalizim, por kjo nuk e përjashton përdorimin e termave të tjerë duke qënë sinonime të njëra-tjetrës. Fondacioni i Kërkimeve në Sektorin e Ujit në raportin Zgjidhjet Rajonale për Sigurimin e Ujit e përkufizon rajonalizimin si *“një formë bashkëpunimi ndërmjet sistemeve të ujit për të përmirësuar shërbimin dhe eficiencën që përfshin edhe uljen e kostove”*. (Awwa Research Foundation, 2008:2). Ky lloj rajonalizimi mund të marrë dy forma:

- Bashkimi fizik i sistemeve dhe ndërlidhjes ku dy ose më shumë njësi ndajnë së bashku një burim të trajtimit të ujit, ose ndërlidhja e sistemeve të shpërndarjes me njëra-tjetrën dhe
- Konsolidim rajonal që konsiston në bashkimin jo fizik dhe më konkretisht në marrëveshje për menaxhimin e sistemeve. Pra njësitë mbeten të ndara fizikisht, por me marrëveshje ndajnë së bashku disa aspekte të menaxhimit.

Sipas një tjetër autori rajonalizimi, ose bashkimi përkufizohet si grupimi i disa bashkive në një strukturë administrative të vetme për ofrimin e një shërbimi të veçantë. Këto struktura të bashkuara mund të ndryshojnë në 3 dimensione (Kingdom, 2005: 5):

- Shkalla: strukturat e bashkuara mund të grupojnë 2 bashki të aftërta me njëra tjetrën, ose disa bashki në një rajon të vetëm, ose përgjatë një territori më të gjerë.
- Qëllimi: strukturat e bashkuara mund të ofrojnë një shërbim të vetëm (për shembull furnizimi në grup i ujit), ose të gjitha shërbimet që nga tërheqja e ujit deri në trajtimin e ujërave të zeza.
- Proçesi: bashkitë mund të formojnë struktura të bashkuara mbi baza vullnetare që mbështeten në interesa të përbashkëta, ose në një nivel më të lartë qeveritar të udhëhequra nga interesi i përgjithshëm publik. Bashkimi mund të jetë i përkohshëm ose i përhershëm.

Një tjetër përkufizim vjen nga (SMC Martin, Inc., 1983: 111) ku rajonalizimi përkufizohet si bashkimi fizik apo administrativ ndërmjet dy ose më shumë sistemeve që ofrojnë ujin për të përmirësuar këtë shërbim duke bashkëpunuar në fazat e planifikimit, operimit dhe menaxhimit. Qëllimi i këtij bashkimi është për të ndarë së bashku kapacitetet teknike, financiare dhe operationale.

Sipas Whitlatch dhe ReVelle (1990:70) rajonalizimi përshkruhet si bashkimi i strukturave administrative, ekonomike, sociale për të përmirësuar objektivat kombëtare, rajonale dhe lokale të shoqërisë. Ndonëse përkufizimet janë nga më të ndryshmet reformat e bashkimit të kompanive të UK ndërmerren kryesisht në vendet ku menaxhimi i shërbimit të UK është jo eficient qoftë kjo sepse njësia ofruese është shumë e vogël për të ofruar një shërbim eficient, apo sepse ky shërbim është decentralizuar në nivel vendor në mënyrë të papërshtatshme. Si një konkluzion i përgjithshëm rajonalizimi ndërmerret për të zgjidhur një problem publik.

3.3 Faktorët nxitës të rajonalizimit: përfitimet dhe kufizimet

Ekziston një literaturë e gjerë me raste studimore të vendeve të ndryshme që kanë aplikuar rajonalizimin si një ndër mënyrat për t'i dhënë zgjidhje sfidave me të cilat ndeshet sektori i UK. Këto raste studimore analizojnë faktorët kryesorë që i kanë shtyrë vendet ta përdorin këtë mënyrë si dhe kufizimet me të cilat është ndeshur sektori i UK. Rajonalizimi është studiuar nga këndvështrimi teorik dhe praktik. Disa studime janë shkencore, të tjera studime janë subjektive. Thelbi i këtyre studimeve është se rajonalizimi sjell përfitime të ekonomive të shkallës dhe përmirësim të mjedisit nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të ujërave (Beecher, 1996:10).

Disa autorë gjithsesi kanë ngritur shqetësime lidhur me disavantazhet e rajonalizimit. Rice (1979:11) argumenton se ky proces sjell konflikte pasi humbet kontrolli i autoriteteve përkatëse vendore mbi shërbimin e UK dhe ka pasoja financiare si rezultat i transferimit të pronësisë tek organizatat rajonale. Autori arrin në konkluzionin se një program rajonal kombëtar nuk do të ishte i përshtatshëm dhe pushtetit vendor i duhet lënë liria për të vlerësuar nevojat e tyre unike, dhe burimet për ofrimin e këtij shërbimi.


3.3.1 Ekonomitë e shkallës

Faktori më kryesor i rajonalizimit është arritja e ekonomive të shkallës. Kjo është veçanërisht e domosdoshme për qytetet e vogla në madhësi për të cilat bëhet e vështirë arritja e ekonomive të shkallës nëse do të vepronin të vetme. Sipas një raporti të projekteve të qyteteve perëndimore (McFarlane, 2003: 7) arsyeja për të ndarë aksesin në burimet ujore janë: financiare, ndërvarësia gjeografike, shqetësimet për shëndetin publik, ndryshimet rregullatore, dhe pritshmëritë e publikut.

Sipas SMC Martin, Inc (1983: 19) rajonalizimi favorizon ekonomitë e shkallës, pasi kostot totale do të ulen me rritjen e numrit të popullsisë së cilës i shërbehet. Gjithashtu në këtë kontribuojnë edhe kursimet që vijnë nga bashkimi i burimeve njerëzore, financiare dhe teknologjike.

Figura në vijim jep një panoramë të qartë të procesit të bashkimit të njësive të vogla dhe krjimin e rajoneve më të mëdha, e cila përmbledh avantazhet, kufizimet dhe mënyrat e menaxhimit të tyre (Kingdom, 2005:21)

Figura 3.1 Ekonomitë e shkallës



Burimi: Kingdom (2005)

Shumë studime janë kryer për të vërtetuar hipotezat e ngritura se shërbimet e UK duke qenë produkt monopoli kanë karakteristikat e ekonomive të shkallës që do të thotë se me rritjen e prodhimit ulen kostot për njësi të prodhimit (Beecher, 1996:5). Megjithatë sipas Beecher nga pikëpamja teknike në literaturë ekzistojnë analiza që tregojnë kufizimet e këtij përfitimi pasi ekonomitë e shkallës që krijohen në nxjerrjen dhe trajtimin e ujërave humbasin nga kostot që lindin nga veprimtari të tjera si transmetimi dhe shpërndarja.

Ekonomitë e shkallës mund të arrihen në të gjitha fazat e procesit të prodhimit për shkak të proceseve eficiente të prodhimit nga teknologjia dhe rritja e aftësisë negociuese për të blerë lëndët e para kryesore. Por arritja e ekonomive të shkallës është efiçiente deri në

pikën ku arrihet “madhësia optimale” dhe sfida për shumë kompani mbetet të identifikojë cila është kjo pikë optimale pas së cilës fitimet e pritshme fillojnë të bien. Sipas studimit të Tynan (2003:1-14) një faktor shkalle e qëndrueshme është 0.8 që do të thotë se me dyfishimin e prodhimit kostot rriten me 80%. Në përputhje dhe me studime të tjera të kryera në këtë fushë ekzistojnë evidenca se ekonomitë e shkallës arrihen më mirë për kompanitë që janë të vogla në madhësi që ju shërbejnë një popullsie prej 125,000 banorë sesa në kompanitë e mëdha ku efektet e ekonomive të shkallës fillojnë të bien shpejt.

Një detyrë e tillë mbetet e vështirë sepse ka disa faktorë që ndikojnë në kompani të tilla si:

- Rregullat e punësimit: nëse në një kompani nuk janë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve atëherë kompania do të ndeshet me kosto shtesë.
- Kushtet topografike në të cilat operon kompania.
- Vlefshmëria e ujit, nëse kompania e siguron ujin nga njësi të tjera apo ka akses të pakufizuar në burimet ujore.
- Aksesit në tregjet ndërkombëtare.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mungesa e ekonomive të shkallës në sektorin e ujit në nivel vendor është një çështje e analizuar që në vitet e mëparshme (Clemens, 1959:765). Jo ç’do studim mbështet idenë se ekonomitë e shkallës janë i vetmi kriter për të justifikuar rajonalizimin. Për shembull, Kim dhe Clark (1988:479-502) arritën në konkluzionin se monopoli natyror mund të mos ekzistojë në sektorin e ujit duke lënë të kuptohet që ekonomitë e shkallës nuk arrihen. Megjithëse ky vëzhgim i veçantë nuk mbështetet nga literatura përsëri kur analizohet rajonalizimi duhet marrë parasysh fakti se jo gjithmonë mund të arrihet eficienca e ekonomive nëpërmjet ekonomive të shkallës, ose e thënë ndryshe ato janë të kufizuara dhe në këtë drejtim vjen një moment kur efektet pozitive fillojnë të bien. Pikërisht kjo do të mbetet sfida kryesore për politikbërësit që të gjejnë pikën optimale se deri në çfarë pike ekonomitë e shkallës japin rezultate pozitive, ndonëse studimet empirike sugjerojnë se kjo mbetet një sfidë e vështirë.

Këto konkluzione mbështeten nga metoda matematikore të tilla si modelimi, simulimi për të matur përfitimet kundrejt kostove lidhur me ekonomitë e shkallës. Me fjalë të tjera ajo që këto teknika bëjnë është të krahasojnë kursimet që psh. arrihen nga trajtimi i centralizuar i ujit kundrejt kostove të tjera të tilla si kostot e infrastrukturës dhe ato të nxjerrjes së ujit. Në ekonomi ky proces njihet si një problem optimizimi që do të thotë përmbushja e standarteve me një kosto minimale. Siç përmend Clark dhe Stevie (1981:9-16) *“duke zhvilluar një marrëdhënie përcaktuese ndërmjet kostove totale dhe koston së blerjes së impiantit dhe transmetim-shpërndarjes është e mundur për të gjetur një pikë në të cilën ekonomitë e shkallës bien*. Ky studim zbulon se duke zgjeruar distancën nga stacioni i trajtimit të ujit ulët kostoja e sigurimit të ujit sepse rritet dendësia e zonës së shërbyer, por rriten kostot e transportit. Studimi tregoi akoma më tej se një distancë prej 8.3-8.5 milje nga stacionet e trajtimit të ujit është e pranueshme për të arritur kosto minimale, por përtej kësaj distance kostot fillojnë të rriten.

Që nga viti 1998 studimet më të rëndësishme që kanë vlerësuar ekonomitë e shkallës në sektorin e ujit janë Kim dhe Klark (1998:479-502) në SHBA, Garcia dhe Thomas (2001:5-29) në France, Kim dhe Lee (1998:3-18) në Kore dhe Mizutani dhe Urakami (2001:211-230) në Japoni. Të gjitha këto studime ekonometrike arritën të tregonin se ekonomitë e shkallës janë më të fuqishme për kompanitë e vogla në ofrimin e shërbimeve të UK dhe se ato janë më të qëndrueshme kur madhësia e kompanisë përcaktohet nga vëllimi i ujit të prodhuar. Po këto studime tregojnë se **ekonomi më të fuqishme të shkallës ekzistojnë kur numri i lidhjeve apo popullsia që i shërbehet përdoret si tregues për madhësinë e kompanisë**” (Tynan & Kingdom, 2005: 4). Rezultati i përgjithshëm është se në të gjitha rastet e analizuara nëpër studime të ndryshme procesi i bashkimit, ose rajonalizimit ka si faktor kryesor përmirësimin e eficiencës nëpërmjet teorisë së ekonomive të shkallës.

Studimet që kryhen për analizimin e ekonomive të shkallës përdorin analizë që marrin në konsideratë të dhëna nga disa vende njëherazi. Kjo për faktin se studimi vetëm për një vend i përshtatet karakteristikave të atij vendi dhe mund të jetë e vështirë që modeli të aplikohet në mënyrë të ngjashme në vende të tjera (Nauges & Van der Berg, 2008:144-163). Gjithashtu, kushtet në të cilat operojnë kompanitë e ujit janë të

ndryshme të tilla si: kushtet institucionale, politike, ekonomike, etj. Së fundmi, sipas këtij studimi nivelet e mëdha të mbulimit kur shërbimi shtrihet në zona më të largëta dhe ku popullsia është më e rrallë bëhet shkak për shtimin e kostove të ofrimit të shërbimit të ujit.

Berg dhe Marques dhe Jane (2010:1-10) kanë arritur të gjejnë 47 studime që trajtojnë ekzistencën e ekonomive të shkallës dhe në veçanti madhësinë optimale të kompanisë për të arritur këto ekonomi. Një numër studimesh shqyrtojnë ekzistencën e kursimeve që vijnë si rezultat i bashkimit të kompanisë dhe ofrimin e ujit dhe shërbimeve të kanalizimeve një numri më të madh banorësh. Debati që zhvillohet përsa i përket ekonomive të shkallës është se cili është kufiri ndarës pas së cilës nuk realizohen më përfitime.

Një tjetër studim nga Tynan dhe Kingdom (2005:1-4) shqyrtoi të dhënat nga vendet me zhvillim të lartë, të ulët dhe të mesme duke analizuar lidhjen mes madhësisë së kompanisë dhe kostove për njësi të prodhimit. Rezultati ishte se kompanitë e ujësjellësit mund të ulin kostot operative për konsumator duke rritur shkallën e prodhimit kundrejt numrit të përfituesve.

Ajo që evidentohet është se me futjen e konceptit të menaxhimit të integruar të ujit, bashkimi i kompanive bëhet një domosdoshmëri pasi kërkohet zhvillim dhe menaxhim në mënyrë të koordinuar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, me qëllim maksimizimin e mirëqënies ekonomike dhe sociale në një mënyrë të barabartë pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Për shembull në Mbretërinë e Bashkuar dhe Wales rritja ekonomike dhe shfaqja e problemeve të ndotjes detyroi qeverinë qendrore që të riorganizonte menaxhimin e burimeve ujore duke bashkuar më shumë se 200 kompani të ujit dhe 1400 kompani të kanalizimeve në vetëm 10 kompani rajonale. Këto kompani kishin si objektiv të menaxhonin ujërat në mënyrë të integruar dhe po ashtu dhe shërbimet e kanalizimeve (Kingdom, 2005:12).

Sipas McFarlane (2003:7) përfitimi financiar sigurohet nga ndërvarësia gjeografike që nënkupton faktin se disa zona mund të kenë probleme në të pasurit akses ndaj burimeve

ujore dhe në këtë mënyrë bashkimi i kompanive të ujit mundëson akses nga zonat që nuk kanë mundësi të aksesojnë ujërat.


3.3.2 Rritja e mundësive për burime financiare

Për çdo njësi të sigurimit të ujit të pijshëm burimet e të ardhurave janë disa: nga taksat vendore, nga arkëtimet e faturave të ujit për shërbimin që ofrohet, nga grantet e siguruara nga pushteti vendor dhe/ose qendror, si dhe nga huatë bankare. Kjo e fundit është veçanërisht problematike për njësitë e vogla, të cilat duke mos patur të ardhura të mëdha ndeshen me problemin e marrjes së huave. Rajonalizimi rrit mundësinë për njësitë që bashkohen që të përfitojnë financime më të mëdha në formën e huave, të cilat nuk do të ishte e mundur të jepeshin nëse njësitë veprojnë si të ndara. Bashkimi do të sillte të ardhura më të larta nga taksat si rezultat i rritjes së numrit të banorëve të shërbyer të cilëve ju ofrohet uji i pijshëm. Po kështu bashkimi sjell mundësi në rritje për të patur akses ndaj programeve rajonale, nga të cilat mund të përfitohen edhe lehtësira në formën e granteve.

Rritja e aksesit në përfitimin e fondeve financiare ju krijon mundësi njërive më të vogla që të investojnë në rrjetet e tyre të amortizuara dhe të dedikojnë fonde për mirëmbajtjen. Një disavantazh që rezulton nga kostot e larta të investimit është tarifa e lartë që i faturohet konsumatorit. Në këtë kuadër mbështetja e qeverisë qendrore është e nevojshme për të mbështetur këto njësi me grante, ose një pjesë të tarifës me anë të subvencioneve për ata konsumatorë që më parë shërbeheshin nga njësi me kosto më të ulët.

Figura në vijim jep një përmbledhje të avantazheve dhe kufizimeve që vijnë nga aksesit në financim duke dhënë dhe mënyrat sesi menaxhohen kufizimet.

Figura 3.2 Aksesit në financim



Burimi: Kingdom (2005)

3.3.3 Ndarja e kostove

Ashtu siç përmendet më herët në këtë kapitull arsyeja kryesore për rajonalizimin e kompanive është përfitimi nga ekonomitë e shkallës. Bashkimi i dy ose me shumë kompanive të ujit çon detyrimisht në ndarjen e kostove dhe mundësi fitimi më të larta në një periudhë afat-gjatë. Ky është avantazh për njësitë me kosto të lartë, të cilët përfitojnë nga njësitë me kosto të ulët, ndërsa për këto të fundit bashkimi përbën disavantazh pasi kosto më e lartë për to do të thotë tarifë më e lartë për konsumatorët e zonës së tyre të shërbyer. Tarifa më e lartë mund të çojë në turbulencia sociale dhe në këtë kuadër negociimi me banorët e zonave me kosto më të ulët është i nevojshëm për të shpjeguar efektet pozitive të këtij bashkimi në një periudhë afat-gjatë. Nga ana tjetër sikurse u përmend në seksionin paraardhës, ndërhyrja e qeverisë në formën e subvencioneve në fazat e para të bashkimit të kompanive do të jetë e nevojshme për të zbutur efektet negative të rritjes së tarifës për njësitë me kosto më të ulët.

3.3.4 Kuadri ligjor

Siç njihet gjerësisht nga literatura dhe praktika, uji si shërbim është i decentralizuar në nivel vendor. Në këtë drejtim, procesi i ofrimit të shërbimit të ujit është në juridiksionin e kuadrit ligjor për decentralizimin. Rajonalizimi i kompanive të ujit mbart me vete një kuadër të ri ligjor që do të rregullojë bashkimin e kompanive në ç’do aspekt të tij. Ky proces megjithë avantazhet e tij shoqërohet me mjaft elementë kompleksë, të cilat duhet të merren parasysh në legjislacionin e ri. Një prej tyre është ekzistenca e aktorëve të shumtë që preken nga ky proces nga të cilët është e nevojshme të merret pëlqimi për të bërë të mundur hartimin dhe zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera nën ligjore. Uji përveçse është një e drejtë bazike për secilin individ është në të njëjtën kohë një mall i tregëtueshëm. Por, ky burim duhet të menaxhohet si duhet për t’ju krijuar mundësinë brezave të ardhshëm që të kenë po të njëjtin akses, pra menaxhimi i tij duhet të jetë i qëndrueshëm. Në këtë drejtim, kuadri i ri ligjor që do të rregullojë bashkimin e kompanive të ujit duhet të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor të decentralizimit dhe politikat përkatëse të ujit për të mos krijuar konflikte të mëtejshme.

Një avantazh i kuadrit të ri ligjor që hartohet vetëm për sektorin e ujit është ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave përkatëse ku palët kanë të përcaktuar përgjegjësitë së bashku me risqet që marrin përsipër. Bashkimi i kompanive të ujit në varësi të shkallës së bashkimit (qoftë ky bashkim i aseteve fizike, apo bashkimi disa funksioneve etj) do të qartësojë rolet e gjithsecilit në këtë proces dhe çon në një menaxhim më të koordinuar ku dhe hallkat e vendimarrjes do të jenë më të ulta. Ajo që rekomandohet në Shqipëri nga institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore është hartimi i një ligji të veçantë për korporatat publike bazuar në principet e autonomisë financiare që duhet të arrijnë shoqëritë UK, i cili ndër të tjera duhet të rregullojë çështjen e menaxhimit të aseteve, tarifave, kushteve të hyrjes dhe daljes nga kompania rajonale (Padeco, 2009:13).

3.3.5 Faktori administrativ

Bashkimi i kompanive konsiston në bashkimin edhe të burimeve njerëzore. Kompania e re që krijohet përfiton një staf më të kualifikuar, të cilët sjellin me vete njohuri. Gjithashtu stafi është më i motivuar për të performuar në mënyrë konkurruese nisur nga paga më të larta të ofruara nga kompania e re rajonale. Një staf më i kualifikuar dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësi ka mjaft të ngjarë të kontribuojë në një menaxhim më të mirë koordinuar. Një ndër disavantazhet që vjen nga bashkimi përse i përket faktorit administrativ ka të bëjë me humbjet e vendeve të punës, të cilat janë të kuptueshme në kuadër të riorganizimit të kompanive të UK. Një ndër indikatorët e eficiencës së stafit për kompanitë rajonale është numri i punonjësve/000 banorë të shërbyer. ERRU ka përcaktuar standardin për këtë indikator si numri i punonjësve/000 lidhje, standard ky që ndryshon në funksion të madhësisë së shoqërive²³. Në këtë kuptim rajonalizimi do të sjellë humbje të vendeve të punës për të arritur eficiencën.

Në planin për zhvillimin e ujit në Texas të SHBA-së hartuar në 2011 (HDR Engineering, 2009:2-3) përcaktohet se faktorët nxitës për rajonalizimin janë: kërkesat teknike për sistemet e ujit, interesa të përbashkëta ndërmjet sistemeve të ndryshme ujore lidhur me planifikimin dhe mbikqyrjen rregullatore, ose probleme rajonale si psh. thatësira në disa zona, apo probleme të cilësisë së ujit. Disa nga përfitimet nga ky proces janë: ekonomitë e shkallës, përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe akses më i mirë për të patur kosto të ulta të kapitalit. Ndërsa disa nga pengesat që përmenden janë: mungesë e fondeve për të plotësuar bashkimin, izolimi gjeografik i sistemeve, rezistenca nga ana e disa njësive, të cilat duan të ruajnë pavarësinë dhe hezitimi për të ndarë shërbimet mbi bazën e ndarjeve administrative, politike, socio-ekonomike apo pengesa ligjore.

3.4. Modelet e rajonalizimit

Rajonalizimi nuk është një proces i lehtë i cili mund të kopjohet lehtësisht nga një vend në tjetrin dhe më pas të zbatohet. Kjo pasi të bashkosh kompani me madhësi të ndryshme, nga zona me karakteristika të ndryshme ekonomike, sociale të cilat janë në

²³ http://www.erru.al/doc/Raporti_i_Performances_2012.pdf

juridiksionin e pushteteve vendore është një tranzicion, i cili duhet rregulluar si duhet në mjaft aspekte, vecanërisht kur ky proces do të kërkojë pjesëmarrjen e shumë aktorëve. Më herët në këtë seksion u përmend se bashkimi duhet të trajtojë tre çështje kryesore: shkallën e strukturave që bashkohen nëse do jenë dy apo më shumë kompani, afërsia gjeografike nëse kompanitë i përkasin vendeve fqinje, funksionet që bashkohen dhe procesi sesi realizohet bashkimi. Ajo që synon të trajtojë ky seksion është krijimi i një modeli referencë duke u bazuar në raste studimore konkrete, model i cili do të shërbejë si praktikë e mirë kur të analizohet rasti i Shqipërisë. Ky seksion ka si qëllim që në përfundim të nxjerrë mësim mbi modelin e rajonalizimit.

Funksionet e një kompanie tipike të ujësjellës dhe/ose kanalizimeve përfshin ato që nga operimi dhe deri te financimi. Në tabelën më poshtë jepen në mënyrë të përmbledhur funksionet dhe detyrat kryesore.

Tabela 3.1 Funksionet tipike të një kompanie tregëtare

Funksioni	Detyrat
Operativ	Drejtimi i sistemit dhe mirëmbajtja Kontrolli i cilësisë Funksionet tregëtare Faturimi i klientëve Marrëdhëniet me klientët
Menaxhim	Menaxhimi teknik dhe financiar Planifikimi strategjik Burimet njerëzore Departamenti Ligjor
Prokurim	Blerja e mallrave dhe shërbimeve
Investim	Investimet për mirëmbajtjen e rrjetit Investimet për projekte të reja
Financim	Gjetja e burimeve financiare për mbarëvajtjen e punës

Burimi: Kingdom (2005)

Sikurse mund të vihet re në tabelën e mësipërme integrimi i funksioneve mund të jetë vertikal dhe horizontal. Situata ideale është kur kompania rajonale që krijohet i merr përsipër të gjitha funksionet dhe detyrat. Kjo nënkupton se kompania rajonale e krijuar merr në pronësi asetet, dhe bashkë me të përgjegjësitë e investimeve dhe financimit dhe ky lloj modeli paraqet përfitime më të mëdha sikurse dhe risqe më të larta. Për njësitë të

cilat nuk janë të konsoliduara dhe që bëhen pjesë e rajonalizimit aplikohen forma më të buta të bashkëpunimit, psh. duke bashkuar funksionet e operimit dhe menaxhimit dhe kur ato konsolidohen mund të kalojnë në bashkimin e funksioneve të tjera si prokurimi, investimi dhe financimi. Kjo është konstatuar në vendet ku procesi i decentralizimit është në hapat e parë.

Praktika tregon se ç'do vend zgjedh një model që i përshtatet karakteristikave historike, social-ekonomike, gjeografike dhe jo në ç'do rast kompania e re që krijohet merr përsipër të gjitha funksionet. Psh. pushteti vendor mund të zgjedhë të ruajë pronësinë e aseteve dhe në këtë kuadër financimi apo investimi mbetet përgjegjësi direkte e pushtetit vendor. Po kështu kompania rajonale mund të marrë përsipër të ofrojë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë, ndërkohë që shërbimi i kanalizimit mbetet përgjegjësi e pushtetit vendor.

Ezistojnë mënyra të ndryshme të modelit të rajonalizimit. Agjencia Amerikane për Mbrojtjen e Mjedisit ka përcaktuar dy modele të rajonalizimit: (i) strukturor dhe (ii) jo-strukturor. Bashkimi jo strukturor nënkupton marrëveshje me njësi të tjera në drejtim të funksioneve menaxheriale ose administrative. Bashkimi strukturor konsiston në krijimin e një njësie plotësisht të re menaxhuese. Sipas këtij kategorizimi bashkimi jo strukturor rezulton në ndryshime proceduriale më tepër sesa ndryshime organizative, por ndryshimet proceduriale mund të çojnë në ndryshime organizative. Ndërkohë bashkimi strukturor çon në riorganizimin e njësive që do të bashkohen (Manning & Barefield & Mays, 2005:6). Duhet theksuar se këto dy modele rekomandohen kryesisht për njësitë që janë të vogla për nga madhësia, që përgjithësisht përcaktohet nga numri i popullsisë së shërbyer.

Tabela 3.2 Format e rajonalizimit

JO STRUKTUROR			STRUKTUROR
Bashkëpunim Joformal	Asistencë Kontraktuale	Agjenci të Bashkuara	Transferimi i Pronësisë
Bashkëpunim me njësi të tjera pa detyrime kontraktuale.	Kontratë me njësi të tjera për të ofruar mbështetje profesionale.	Krijimi i një njësie të re me mandatin për t'ju shërbyer njësive të bashkuara.	Marrja e pronësisë nga një njësi ekzistuese për të krijuar një njësi të re.

Burimi: Manning, P. et al, (2005)

Sipas këtij modeli ajo që konstatohet është se në varësi të formës së kontratës së zgjedhur përcaktohen detyrimet së bashku me risqet që palët marrin përsipër. Lloji i parë i bashkëpunimit është bashkëpunim joformal që kryhet mbi baza vullnetare për të ndarë një shërbim. Zakonisht zbatohet nga kompanitë e vogla, të cilat janë njësi të mirëmenaxhuara, por që vendosin të bashkojnë disa funksione për të rritur eficiencën. Ky lloj bashkëpunimi ka kosto të ulta. Disa nga aktivitetet që njësitë ndajnë janë:

- Ndarja e ambjenteve laboratorike, të magazinave, pajisjeve të faturimit;
- Sigurimi i ujit gjatë periudhave të emergjencave.

Lloji i dytë i bashkëpunimit është një kontratë që njësitë lidhin në drejtim të mbështetjes profesionale që janë shërbime më të specializuara. Disa nga këto shërbime përfshijnë:

- Funksionimi rutinë i sistemit dhe mirëmbajtjes;
- Monitorimi periodik;
- Mbështetje në periudhë emergjence;
- Blerjet me shumicë.

Lloji i tretë i bashkëpunimit është një agjenci e përbashkët që krijohet nga disa njësi, ndërkohë që njësitë operojnë në mënyrë individuale. Bashkëpunimi është më tepër mbi baza partneriteti sesa kontraktual. Zakonisht ky lloj bashkëpunimi realizohet kur njësi të veçanta dëshirojnë të arrijnë një qëllim të përbashkët dhe për këtë qëllim ndërmarrin një projekt. Njësia e re e krijuar merr vendime administrative dhe përfaqëson njësitë më të vogla. Disa nga aktivitetet e këtij lloj bashkëpunimi janë :

- Gjetja e një burimi të ri ujqor;
- Përdorimi i laboratoreve në mënyrë të përbashkët, të magazinave, apo pajisjeve të tjera;
- Ndarja e disa shërbimeve si faturimi dhe arkëtimi, operimi dhe mirëmbajtja.

Lloji i fundit i bashkëpunimit është ai strukturor që përfshin bashkimin e dy apo më shumë njësive. Kjo ndodh kur një njësi nuk është efiçiente për të operuar në mënyrë individuale. Bashkimi sjell mundësi të reja për të patur akses në financime më të mëdha, përfitime në efiçencë dhe një staf më profesional. Një disavantazh që konstatohet në këtë rast është humbja e pavarësisë lokale. Njësia e re që krijohet vendos të bashkojë

disa funksione si menaxhimin, asetet dhe borxhin. Ky lloj bashkëpunimi është opsioni me risqet më të larta po të krahasohet me llojet e tjera të bashkëpunimit.

Sikurse u përmend më herët në këtë studim modelet e rajonalizimit janë të ndryshme në vende të ndryshme. Jo të gjitha studimet i analizojnë modelet në detaje. Psh. disa studime fokusohen në aspekte të veçanta të modelit të rajonalizimit. Konkretisht studimi i kryer nga Kingdom (2005:6) analizon mënyrat e realizimit të rajonalizimit dhe arrijnë në konkluzionin se ekzistojnë 3 mënyra si në vijim:

- Vullnetar, që do të thotë se njësitë e pushtetit vendor që deri më tani kanë menaxhuar dhe ofruar shërbimin e ujit të pijshëm angazhohen në mënyrë vullnetare të bashkojnë njësitë e ndryshme për të përmirësuar këtë shërbim dhe për të përfituar nga ekonomitë e shkallës.
- Rajonalizim i kryer në nivel lokal, por me rregulla të vendosura nga një nivel më i lartë i qeverisë si psh. rregullat financiare.
- Rajonalizim, i cili kryhet me iniciativën e nivelit të pushtetit qendror.

Mënyra e parë vullnetare është procesi më ideal i rajonalizimit. Kjo sepse iniciativa vjen nga njësitë e pushtetit vendor, të cilat angazhohen në mënyrë vullnetare të kryejnë këtë proces nisur nga avantazhet dhe disavantazhet në një periudhë afat-gjatë. Duke qenë se rajonalizimi mbart një humbje të kontrollit të menaxhimit të ujit dhe ofrimit të këtij shërbimi marrja e kësaj iniciative ndihmon në evitimin e konflikteve qoftë me përfituesit dhe në krijimin e një kuadri të duhur ligjor. Po kështu ky proces ka kosto të ulëta administrative. Që të realizohet ky proces është e nevojshme që njësitë që bashkohen të jenë të mirëinformuara mbi kostot dhe përfitimet e tij.

Mënyra e dytë konsiston në një proces që kryhet në nivel lokal, por me rregulla të vendosura nga një nivel më i lartë i qeverisë, që është në disa aspekte i ngjashëm me modelin vullnetar pasi iniciativa mbetet përsëri e pushtetit vendor, por ka një mbikqyrje më të fortë nga pushteti qendror, i cili përcakton rregullat financiare, politike etj. Për shembull, pushteti qendror mund të përcaktojë rregulla financiare të tilla që fondet financiare më të mëdha t'ju jepen atyre njësive të cilat nxiten të bashkohen me njësi të tjera. Ky është rasti i dy shoqërive në Shqipëri Berat dhe Kuçovë, të cilat u nxitën të

bashkoheshin si rezultat i fondeve më të mëdha financiare nga KfW.

Modeli i tretë është ai kur rajonalizimi kryhet me iniciativën e pushtetit qendror. Një gjë e tillë mund të jetë e nevojshme në rastet kur pushteti qendror ka përfitime ekonomike nga rajonalizimi. Ky model ka një paradoks në kushtet kur uji menaxhohet nga pushteti vendor, të cilit i janë deleguar të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë në mënyrë ligjore për ta ushtruar këtë funksion. Një ndër disavantazhet e këtij modeli është koha e gjatë që i nevojitet pushtetit qendror për të bindur pushtetin vendor duke ditur se pushteti vendor humbet kontrollin nga ky proces. Ky model ka kosto të larta administrative dhe mund të kërkojë shumë negociata me aktorë të ndryshëm, përfitues përfshirë këtu konsumatorët, të cilët janë përfituesit përfundimtarë nga ky proces.

3.4.1 Harmonizimi i tarifave

Harmonizimi i tarifave është një politikë që zbatohet nga kompani rajonale, të cilat tarifojnë konsumatorët me të njëjtin çmim në kushtet e ofrimit të shërbimit me të njëjtën cilësi. Në pamje të parë duket një politikë e thjeshtë që sjell avantazhe më tepër për kompaninë rajonale, e cila ka vetëm një tarifë uniforme që aplikon dhe nuk shpenzon kohë për të negociuar apo përcaktuar nivele të ndryshme të tarifave. Po kështu kjo politikë atëherë kur pranohet nga përfituesit përfundimtarë sjell avantazhin që i bën konsumatorët të ndihen banorë të së njëjtës zonë apo komunitet.

Ky koncept është zbatuar në Angli në vitin 1974. Sfida për harmonizimin e tarifave është atëherë kur njësitë me kosto të larta bashkohen me ato me kosto të ulëta. Në këto raste për të arritur tarifa uniforme disa konsumatorë që i përkasin njësisë me kosto më të lartë do të jenë të detyruar të paguajnë më shumë për të subvencionuar konsumatorët e njësisë me kosto më të ulët. Kjo politikë po zbatohet edhe sot në Shqipëri ku kategoritë e konsumatorëve institucione publike dhe private paguajnë një tarifë më të lartë për të kompensuar tarifat e ulëta të konsumatorëve familjarë. Kjo metodë jo gjithmonë mirëpritet nga përfituesit dhe mund të sjellë kundërshtime derisa politika bëhet jo e zbatueshme.

Ekzistojnë shembuj të vendeve të cilat nuk e kanë zbatuar një politikë të tillë ndonëse kanë experiencë të gjatë në drejtim të rajonalizimit. Një rast i tillë është Franca një vend me experiencë 65 vjeçare në fushën e rajonalizimit. Kompanitë rajonale kanë përcaktuar tarifa të ndryshme për ç’do komunë apo njësi, të cilat nuk janë shumë të ndryshme nga tarifrat që aplikonin përpara se të ndodhte ky proces. Një rast tjetër është Hungaria, ku Shoqata e UK Dunavarsany ka përcaktuar se ç’do njësi pjesë e bashkimit duhet të përcaktojë tarifën individuale (Kingdom, 2005:31).

3.5 Eksperienca ndërkombëtare: raste studimore të rajonalizimit

Seksioni në vijim përmbledh raste studimore mbi eksperiencat e disa vendeve në drejtim të rajonalizimit, një punë studimore e kryer nga Kingdom (2005:5-31) për Francën, Hollandën, Italinë dhe Brazilin dhe kompania konsulente PADECO CO.Ltd për Kosovën, Rumaninë, Italinë. Arsyeja e trajtimit të eksperiencës ndërkombëtare shërben për të identifikuar nëse ekziston një model unik, i cili do të mund të zbatohet në rastin e Shqipërisë. Si kritere për përzgjedhjen e rasteve studimore janë përdorur: (i) eksperienca e gjatë në drejtim të rajonalizimit dhe (ii) ngjashmëria e vendeve me Shqipërinë në drejtim të menaxhimit të shoqërive të UK dhe procesit të decentralizimit. Në kriterin e parë bëjnë pjesë vende si Franca, Holanda. Në kriterin e dytë bëjnë pjesë vende si Italia, Rumania dhe Kosova.

3.5.1 Franca

Modeli i rajonalizimit në Francë është një model i konsoliduar i quajtur modeli i “sindikatave” që konsiston në kompani rajonale të krijuara për të ofruar shërbimet e UK dhe përfshijnë kompani të vogla në madhësi të afërta gjeografikisht (fqinje). Shërbimet e UK kanë qenë përgjegjësi e bashkisë që prej kohës së Revolucionit që i përkasin vitit 1798. Vendi karakterizohet nga nivel i lartë i decentralizimit dhe në të gjithë vendin numërohen gjithsej 36,000 bashki shumica e të cilave janë bashki të vogla dhe ju përkasin zonave rurale. Franca ka experiencë të gjatë në drejtim të rajonalizimit dhe ky proces është zhvilluar tërësisht mbi baza vullnetare, megjithatë prefektët si përfaqësues të pushtetit qendror kanë autoritetin për të “detyruar” bashkitë që të bëhen pjesë e

bashkimit.

Kuadri ligjor përcakton format e bashkimit dhe rregullat për rajonalizimin në drejtim të ofrimit të shërbimeve të UK. Këto rregulla përfshijnë: kushtet e hyrjes dhe të daljes nga bashkimi, përcaktimin e tarifave, transferimin e aseteve. Për shembull sipas ligjit njësitë që bashkohen nuk janë të detyruara të bashkojnë të gjitha funksionet operative, por mund të zgjedhin që të bashkojnë vetëm funksionin e mirëmbajtjes. Përfaqësuesit e pushtetit qendror mund të mandatojnë përfshirjen e disa qyteteve në këtë proces. Në Francë sindikatat paraqesin një shembull të mirë të këtyre lloj grupimeve.

Një ndër rajonet më të mëdha të krijuara është Sindikata e Ujit në Strasbourg (SDEA), e cila u krijua në vitin 1939 nga grupimi i 55 bashkive të ngashme në madhësi dhe rajoni është rritur duke arritur të ofrojë shërbime për 453 njësi vendore për një popullsi rreth 655,000 banorë. Miratimi i tarifave është përgjegjësi e bordit mbikqyrës të sindikatës. Asambleja e sindikatës ka në përbërje 450 përfaqësues (1 për ç’do komunitet me më shumë se 3,000 banorë). Asetet janë përgjegjësi e bashkive, ndërsa të drejtat për përdorimin e tyre janë të përcaktuara në marrëveshje. Për bashkitë e vogla lidhet një marrëveshje për ndarjen e aseteve.

Rajoni tjetër në Francë është ai metropolitan Nimes që është një përzierje e njësive në zonat rurale me ato urbane dhe ju shërbejnë një numri popullsie prej 206,616 banorë. Ky rajon u krijua në 2002 me vullnetin e lirë të 14 bashkive. Në këtë rast janë bashkuar vetëm shërbimet e ujit, pasi shërbimet e kanalizimeve janë me kosto mjaft të lartë. Këto të fundit menaxhohen nga vetë bashkitë dhe për këtë subvencionohen nga shteti. Në këtë rajon aplikohet sistemi tarifor i ndryshëm sipas zonave dhe gjithsej ekzistojnë 23 tarifa.

3.5.2 Holanda

Proçesi i rajonalizimit ka nisur në vitin 1965. Ligji për furnizimin me ujë i vitit 1957 kërkonte riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm në rajone të mëdha. Ligji lejon pushtetin qendror që të riorganizojë rajonalizimin në rast se bashkitë nuk

janë të suksesshme për të realizuar këtë proces. Kriteri kryesor për të realizuar rajonalizimin është se ç'do kompani e ujit duhet të ketë të paktën 100,000 lidhje për të siguruar ujin në një zonë më të madhe, si dhe laboratorët përkatës për kontrollin e cilësisë. Numri i kompanive që janë bashkuar deri më sot është 180, duke krijuar 40 rajone në vitin 1994 dhe 13 rajone në vitin 2008. Fenomeni që vihet re në këtë rast është verifikimi fillimisht i përfitimeve dhe më pas zgjerimi i bashkimit.

Të gjitha kompanitë rajonale janë kompani të përbashkëta publike aksionet e të cilave zotërohen nga pushteti vendor, qendror dhe provinca. Kompania më e madhe rajonale (PLC) është një model që ka në përbërje tre kompani kryesore publike dhe që ju shërben 1.6 milionë banorëve të lidhur me rrjetin. Në provincën Friesland procesi i rajonalizimit u realizua më herët se në pjesën tjetër të vendit dhe ishte një proces tërësisht mbi baza vullnetare. Në vitin 1974 procesi i rajonalizimit u shtri në të gjithë provincën. Një tjetër rast bashkimi është provinca jugore e Hollandës ku janë krijuar 35 kompani të ujit në vitin 1975. Gjatë 10 viteve të fundit provinca ndërmori disa iniciativa për të ulur numrin e kompanive dhe për të krijuar rajone. Një rast i tillë i përket vitit 1985 kur u hartua një plan për riorganizimin dhe krijimin e tre rajoneve të mëdha, por ndeshi në rezistencë të 35 kompanive, të cilat hezitonin për t'u bashkuar. Ky plan u finalizua në vitin 1991.

Modeli i rajonalizimit në Hollandë përfshin kompani rajonale që ofrojnë vetëm shërbimin e ujit, ndërkohë që shërbimi i kanalizimeve ofrohet nga bordet e ujit. Një kompani tipike rajonale ju shërben 200,000-600,000 konsumatorëve të lidhur me rrjetin dhe ka nga 1-40 përfaqësues si aksionerë. Lidhur me pronësinë e aseteve në disa raste këto janë në pronësinë e kompanive dhe në raste të tjera në pronësinë e pushtetit vendor. Sistemi tarifor është uniform në territorin ku ofrohet i njëjti shërbim.

3.5.3 Italia

Përpara se të ndodhte procesi i rajonalizimit sektori i UK ishte mjaft i copëzuar. Në Itali gjithsej janë 8101 bashki, të cilat kanë në juridiksionin e tyre 103 provinca dhe 20 rajone. Përpara miratimit të ligjit Galli të vitit 1994 shërbimet e ujit ishin të copëzuara vertikalisht dhe horizontalisht, ekzistonin 13,000 operatorë të ndryshëm dhe mesatarisht

kompanitë ofronin shërbimin e ujit për 9000 banorë dhe 7000 kishin akses në shërbimet e kanalizimeve.

Ligji i vitit 1994 mandatoi krijimin e rajoneve në nivel kombëtar me objektivin kryesor që të ulej fragmentarizimi i kompanive dhe të krijoheshin rajone për të dyja shërbimet: ujin dhe kanalizimet. Ligji parashikonte që bashkimi të bëhej mbi bazat e aksesit në basenet ujorë dhe si rezultat u identifikuan 91 kufij territorialë optimalë. Sikurse vihet re faktori kryesor nxitës për këtë proces ishte përmirësimi i menaxhimit të ujërave në përputhje me Direktivën Europiane të Ujit. Mbi bazën e ligjit kryesor u hartuan akte të tjera nënligjore në nivel rajonal, të cilat zgjatën në kohë nga viti 1995 deri në 2002. Procesi i rajonalizimit ishte i ngadaltë për shkak të interesave politike në nivel vendor dhe të interesave të sektorit privat. Konkretisht, kompanitë më të mëdha publike krijuan një lob që kundërshtonte zbatimin e ligjit. Një tjetër rezistencë ishte çështja e tarifave, të cilat duhej të rriteshin për të mbuluar kostot dhe në këtë drejtim kompanitë hezituan t'ua transferonin përgjegjësitë sektorit privat.

Rajoni i Lazios është një shembull pozitiv në drejtim të zbatimit të ligjit Galli. Përpara krijimit të rajonit, ekzistonin 436 kompani individuale që ju shërbenin 377 komunave. Ky rajon identifikoi 5 kufij territorialë hidrologjikë, të cilët përkojnë me kufijtë administrativë. Sipas ligjit të rajoneve secila zonë territoriale lidhi kontratë me një operator të vetëm. Zona Frosinone i shërben 550,000 banorëve (86 bashkive dhe 3 provinca) dhe ishte e para që ja delegoi përgjegjësinë një operatori privat me anë të një kontrate konçensionit për 29 vjet.

Modeli i zbatuar në Itali përshinte bashkimin e të gjitha funksioneve sepse modeli i rajonalizimit ka si synim kryesor integrimin e menaxhimit të ujit. Kufijtë territorialë optimalë ATO nuk kanë një madhësi standarte, por mesatarisht ju shërbejnë një popullsie prej 640,000 banorë. Numri më i madh i bashkive të asociuara në 1 zonë territoriale optimale të vetme është në rajonin e Sardenjës (377 bashki), ndërsa rajoni i Lombardisë ka një zonë territoriale optimale me një bashki të vetme atë të Milanos.

Procesi i rajonalizimit merr dy forma: (i) konsorciumi që konsiston në krijimin e një kompanie publike të ujit e krijuar nga vetë njësitë vendore që ka autoritetin ligjor dhe

autonominë organizative dhe (ii) rënia dakord ose marrëveshja që konsiston thjesht në nënshkrimin e një marrëveshje ndërmjet njësive ekzistuese ku rajoni cakton një organizatë përgjegjëse vendore për të koordinuar njësitë. Sipas ligjit të ri asetet janë në pronësi të zonave territoriale optimale. Autoriteti për të caktuar tarifat i përket zonës optimale brenda së cilës zbatohet tarifë uniforme. Ndërkohë zonat që kanë patur tarifa të ulta përpara se të bashkoheshin trajtohen si raste të veçanta.

3.5.4 Brazili

Historikisht ofrimi i shërbimit të UK ka qënë përgjegjësi e pushtetit vendor. Në Brazil ekzistojnë 5,561 bashki shumica e të cilave janë mjaft të vogla (4000 që janë më të voglat përbëjnë 66% të të gjitha bashkive dhe ju shërbejnë 20% të popullsisë, ndërsa 45 bashki më të mëdha ju shërbejnë një popullsie më të madhe se 50%).

Në Brazil gjatë viteve 1970 dhe 1980 u krijuan kompanitë shtetërore të ujit dhe një fond për ujin dhe kanalizimet për të mbështetur investimet. Për të qënë pjesë e kompanisë shtetërore bashkitë duhej të lidhnin një kontratë konçensioni me kompaninë, e cila ofronte shërbime të ujit dhe kanalizimeve. Madje bashkitë mund të përfitonin fonde investimi vetëm nëpërmjet kompanive shtetërore të ujit. Aktualisht, kompanitë shtetërore të ujit ofrojnë shërbimet e ujit dhe kanalizimeve për 3892 bashki që ju shërbejnë 77% të popullsisë.

Faktori nxitës i rajonalizimit ishte rritja e aksesit të mbulimit me shërbimet e ujit dhe kanalizimeve nëpërmjet investimeve nga pushteti qendror dhe subvencionit i kryqëzuar. Po kështu arritja e ekonomive të shkallës dhe tërheqja e sektorit privat është një tjetër nxitës. Ligji aktual nuk është i qartë lidhur me procesin e rajonalizimit dhe në këtë kuptim është besuar se ky proces duhet të mbështetet më tepër në bashkëpunimin ndërmjet bashkive dhe pushtetit qendror.

Proçesi i rajonalizimit ishte mbi baza vullnetare teorikisht, por aspekti financiar luajti një rol shumë të madh. Një ndër rajonet e rëndësishme është Mato Grosso ku si rezultat i shërbimit të dobët të ofruar nga kompania shtetërore e ujit ky shërbim u decentralizua

dhe ju kalua bashkive, të cilat u grupuan për të ofruar shërbimin për 200,000 banorë ose më shumë. Në këtë mënyrë mund të përfitoheshin fonde më lehtësisht nga pushteti qendror. Kjo skemë krijonte lehtësira për të lidhur një kontratë konçensionit për të menaxhuar këtë shërbim. Por kjo skemë dështoi për shkak të pushtetit politik që bashkitë më të mëdha kërkonin të kishin.

Rajoni i Dos Lagos në Shtetin e Rio de Janeiro ka qënë rajoni më i suksesshëm që përfshinte një kontratë konçensionit të nënshkruar nga pushteti qendror dhe komunat e bashkuara të cilave ju delegoheshin përgjegjësitë e menaxhimit. Bashkimi u krye mbi bazën e sistemeve fizike, kontrata të cilat u nënshkruan në vitin 1998.

Modeli i Dos Lagos bazohet në bashkimin e dy shërbimeve: ujit dhe kanalizimeve. Grupimi përfshin 5 bashki në një rajon turistik që i shërben një popullsie prej 310,000 në periudha normale, ndërsa në sezonin e verës ky numër varion ndërmjet 390,000 dhe 893,000 banorë. Asetet nuk u bashkuan, por ato mbetën në pronësi të shtetit. Lidhur me sistemin tarifar ato u harmonizuan, por brënda kësaj skeme përfshihej subvencioni i kryqëzuar, ku një grup përfituesish subvencionojnë një grup tjetër, ndërsa standartet e shërbimit ishin të përcaktuara në kontratën e konçensionit.

3.5.5 Kosova

Deri në vitin 1999 kur Kosova ishte pjesë e Republikës së Serbisë ofrimi i shërbimit të ujit dhe kanalizimeve ishin përgjegjësi e pushtetit vendor nën mbikqyrjen e Ministrisë së Pushtetit Vendor. Në vitin 2002 nën autoritetin e UNMIK u krijua Agjencia e Mirëbesimit të Kosovës (AMK) me qëllimin e administrimit të ndërmarrjeve publike. Në vitin 2002 AMK prezantoi një strategji për rajonalizimin e sektorit të UK për të bashkuar 34 kompani dhe për të krijuar rajone. Në këtë drejtim u krijuan 7 rajone të rregjistruara si kompani tregëtare sh.a, të cilat deri në shpalljen e pavarësisë ishin nën administrimin e AMK-së.

Bashkitë lidhën marrëveshje shërbimi me rajonet për të ofruar shërbimet e UK. Aktivitetet e kompanive rajonale u rregulluan nga Enti Rregullator në Kosovë që ishte

krijuar sipas ligjit për ujin. Në vitin 2008, AMK që administronte rajonet i mbylli aktivitetet e saj, por pa i kaluar zyrtarisht funksionet e saj tek ndonjë institucion tjetër. Aktualisht Ministria e Ekonomisë dhe Financës ka marrë në përgjegjësi rajonet.

Rasti i Kosovës është një rast disi i veçantë për t'u marrë në konsideratë në lidhje me modelin e saj të rajonalizimit për shkak të fazave institucionale dhe organizative që ky sektor ka përjetuar dhe që reflektojnë tranzicionin pas konfliktit. Me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare sektori është riorganizuar dhe rajonet funksionojnë përsëri falë burimeve të konsiderueshme financiare dhe pa ndërhyrje politike. Strategjia e konsolidimit synon që kompanitë rajonale të kenë mundësi të marrin grante dhe kredi për investime në infrastrukturë dhe të hyjnë në kontrata menaxhimi, kontrata qeraje afat-gjatë dhe marrëveshje konçensionare. Qëllimi final i strategjisë është që kompanitë të konsolidohen më tej në 4 kompani UK rajonale në përputhje me 4 basenet ujore në Kosovë.

3.5.6 Rumania

Nga viti 1950 deri në vitin 1990 menaxhimi i kompanive të ujit ka qënë një proces i centralizuar. Në vitin 1990 në kuadër të decentralizimit kompanitë u transformuan në kompani tregëtare. Pas vitit 1990 vetëm 32 bashki që ju shërbenin një numri popullsie më shumë se 100,000 banorë kanë përfituar nga programet e investimeve kapitale për rehabilitimin e infrastrukturës ujore dhe të kanalizimeve. Ndërkohë që 230 qytete të vogla në madhësi nuk kanë qënë në gjendje të sigurojnë financime të huaja për sistemet e UK dhe kjo është arsyeja që 15 vitet e fundit këto qytete nuk kanë mundur të kryejnë rehabilitime të rrjeteve të tyre. Proçesi i rajonalizimit në Rumani fokusohet në bashkimin e njësive brenda së njëjtës zonë gjeografike, përcaktuar kjo nga aksesin në basenet e lumenjve dhe/ose kufijtë administrativë. Konkretisht, rajonalizimi po mbështetet nga një program mjedisor i Bashkimit Europian 2007-2013 për të mbështetur 2600 zona që ju shërbejnë 2000 banorëve dhe synohet të arrihen qëllimet e performancës deri në vitin 2018. Programi synon të asistojë kompanitë në drejtim të menaxhimit të UK dhe të krijohen 50 operatorë duke bashkuar njësitë vendore aktuale. Proçesi i rajonalizimit po zbatohet aktualisht në 42 rrethe.

3.6 Mësimet e nxjerra nga rastet studimore

Modelet e rajonalizimit të analizuara në rastet e mësipërme studimore janë të ndryshme nga një vend në tjetrin. Kjo reflektohet nga shumëllojshmëria e modeleve që lidhet me kushtet historike, gjeografike, kulturore dhe social ekonomike. Një mësim i përgjithshëm është që nuk ekziston një model unik apo universal. Numri i parametrave për t'u marrë në konsideratë në rastin e Shqipërisë mund të jetë i ndryshëm nga ato të rasteve studimore. Në këtë kuptim, mund të mos jetë e zbatueshme në rastin e Shqipërisë që të aplikohet një model i ndonjë vendi specifik.

Gjithsesi rastet na ndihmojnë të nxjerrim disa mësimet si në vijim:

- Tendenca e përgjithshme në të gjitha rastet është zhvendosja drejt rajonalizimit. Në shumicën e rasteve arsyet e bashkimit janë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, arritja e ekonomive të shkallës për shkak se kompanitë janë të madhësive të vogla. Në vende të tjera si Brazili, Rumania dhe Kosova rajonalizimi krijonte lehtësira për të siguruar financime.
- Bashkimi vetëm mbi baza vullnetare nga ana e njësive të pushtetit vendor është mënyra më e dëshiruar, por kërkon një kohë të gjatë për t'u realizuar psh. rasti i Francës. Bashkimi vullnetar ishte një tipar i konstatuar në vendet e zhvilluara me një eksperiencë të gjatë në fushën e decentralizimit si Franca, Holanda. Në ato vende ku rajonalizimi vullnetar shfaqte konflikte ndërhyrja e pushtetit qendror ishte një domosdoshmëri (Holanda, Brazili).
- Rajonalizimi është shoqëruar me hartimin e një ligji të posaçëm që rregullonte kushtet e hyrjes dhe të daljes nga grupi i bashkuar, tarifat dhe pronësinë e aseteve.
- Lidhur me politikën tarifore, u konstatua se në shumicën e rasteve tarifat ishin të ndryshme në rajone të ndryshme dhe sistemi tarifor uniform është më i rrallë. Megjithatë atje ku zbatohet, kushti për këtë politikë është që konsumatorët të marrin të njëjtën cilësi shërbimi.
- Ndërmarrja e këtij procesi vetëm nga pushteti qendror mund të jetë efiçient në fillim, por mund të ketë përplasje me politikën e decentralizimit sipas së cilës njësitë vendore ushtrojnë përgjegjësitë e veta të përcaktuara në ligj.

- Së fundmi, në vendet ku decentralizimi është në fazat e para si psh. Rumania, Kosova paraprakisht është e nevojshme një strategji komunikimi dhe edukimi për njësitë e pushtetit vendor, kompanitë e UK, përfituesit përfundimtarë për të sqaruar se rajonalizimi i kompanive nuk ka si qëllim të kundërshtojë parimet e procesit të decentralizimit, por që përveç rritjes së efijencës ky proces ka si qëllim në të njëjtën kohë të mos çënojë vendimarrjen e pushtetit vendor. Qëllimi final është të ofrohen shërbime më cilësore për konsumatorët, ti bëjë kompanitë të afta financiarisht dhe t’ju mundësojë financime më të mëdha nga institucionet ndërkombëtare.

Mësime të tjera të nxjerra në drejtim të modelit të propozuar për rastin e Shqipërisë janë:

- Nuk ekziston një model universal që të mund të zbatohet për Shqipërinë.
- Faktori kohë është esencial për tu marrë në konsideratë në kuptimin që ky proces mund të kërkojë vite për tu zbatuar plotësisht.
- Skema e rajonalizimit mund të jetë që njësitë e pushtetit vendor të krijojnë një shoqatë, e cila të hyjë në kontratë me kompanitë rajonale për ofrimin e shërbimeve ose që njësitë e pushtetit vendor të vazhdojnë të mbeten aksionerë të shoqërive. Kompania rajonale mund të marrë përsipër vetëm funksionet e menaxhimit dhe operimit, por jo të financimit dhe investimit. Një tjetër skemë mund të jetë që kompania rajonale të lidhë një kontratë konçensionari me një operator privat, ose një kontratë menaxhimi për t’i besuar vetëm funksionet e operimit dhe menaxhimit.
- Mundësi për fonde më të mëdha financiare, ose ekzistenca e operatorëve privatë të fuqishëm, të cilët janë të gatshëm të financojnë kompani të mëdha rajonale mund të jetë faktor për të përshpejtuar procesin e bashkimit të kompanive më të vogla dhe krijimin e rajoneve.
- Rajonalizimi bëhet i domosdoshëm në kushtet kur cilësia e ofrimit të shërbimeve nga njësitë e pushtetit vendor nuk është më e pranueshme nga qytetarët (rasti i Italisë).

Nga rishikimi i literaturës rezultati i përgjithshëm është se në të gjitha rastet e analizuara nëpër studime të ndryshme procesi i bashkimit, ose rajonalizimit ka si faktor kryesor përmirësimin e eficiencës nëpërmjet teorisë së ekonomive të shkallës. Kjo është arsyeja ku unë mbështes studimin shkencor dhe modelin që studjon eficiencën e sektorit.

Studimet empirike ekonometrike arritën të tregonin se ekonomitë e shkallës janë më të fuqishme për kompanitë e vogla në ofrimin e shërbimeve të UK dhe se ato janë më të qëndrueshme kur madhësia e kompanisë përcaktohet nga vëllimi i ujit të prodhuar. Po këto studime tregojnë se ekonomi më të fuqishme të shkallës ekzistojnë kur numri i lidhjeve apo popullsia që i shërbehet përdoret si tregues për madhësinë e kompanisë. Nivelet e mëdha të mbulimit kur shërbimi shtrihet në zona më të largëta dhe ku popullsia është më e rrallë bëhet shkak për shtimin e kostove të ofrimit të shërbimit të ujit. Gjithashtu, kushtet në të cilat operojnë kompanitë e ujit janë të ndryshme të tilla si: kushtet institucionale, politike, ekonomike, prandaj bëhet e rëndësishme që përveç faktorit ekonomik që rezultoi më i rëndësishmi të merren në konsideratë dhe faktorët e tjerë.

Për përzgjedhjen e variablave të modelit jam bazuar pikërisht në këto studime. Rekomandimi i një modeli më specifik për Shqipërinë është një ndër qëllimet e këtij punimi dhe konkluzionet e mësipërme duhet të merren në konsideratë gjatë analizës. Megjithatë, përmbajtja e këtij modeli specifik do të jepet në kapitujt e ardhshëm kur të analizohet në detaje sektori i UK në Shqipëri.

KAPITULLI IV: KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL DHE PERFORMANCA E SEKTORIT TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN 2006-2012

Kuadri ligjor në sektorin e ujit synon të përmirësojë performancën e sektorit dhe marrëdhëniet ndërmjet institucioneve apo aktorëve të përfshirë. Shqipëria ashtu si vende të tjera që kaluan nga sistemi i komunizmit në atë të ekonomisë së tregut u përball me transformime ligjore dhe institucionale, të cilat ndonëse janë hartuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, kanë shfaqur probleme në drejtim të zbatimit. Kjo si rezultat i eksperiencës së pakët dhe kontraditave të ligjeve njëra me tjetrën. Decentralizimi ishte një ndër reformat më të rëndësishme pas privatizimeve të kompanive shtetërore. Ndonëse decentralizimi si proces ligjor pati ecuri, zbatimi i tij ishte me probleme, kjo pasi decentralizimi mbart me vete përgjegjësi të reja ligjore, institucionale dhe financiare për të cilat njësitë e pushtetit vendor nuk ishin të përgatitura.

Në këtë kapitull do të analizohet kuadri ligjor ekzistues dhe institucionet përgjegjëse në drejtim të:

1. Hartimit të politikave, strategjive, planifikimit dhe monitorimit të investimeve.
2. Administrimit të shërbimeve të UK dhe
3. Kuadrit rregullator.

Në përfundim të analizës do të arrihet në konkluzionin nëse mjedisi ekzistues ligjor dhe institucional e favorizon ose jo rajonalizimin.

4.1 Hartimi i politikave dhe strategjive

Menaxhimi i Burimeve Ujore në Shqipëri rregullohet me anë të ligjit nr. 8093 datë 21.03.2006 “Për rezervat ujore²⁴”. Autoritetet kryesore të krijuara në bazë të këtij ligji janë Këshilli Kombëtar i Ujërave, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave

²⁴ Azhornuar me Ligjin nr.8375, datë 15.07.1998, Ligjin nr.8605, datë 20.04.2000, Ligjin nr.8736, datë 01.02.2001, Ligjin nr.9837, datë 03.12.2007 dhe Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009

dhe Këshillat e Baseneve të Lumenjve. Këshilli Kombëtar i Ujërave kryesohet nga Kryeministri dhe është i ngarkuar me përcaktimin e politikave dhe me marrjen e vendimeve kryesore që lidhen me burimet ujore. Ky ligj i rishikuar inkurajon fuqizimin e menaxhimit të burimeve ujore nga perspektiva e baseneve të lumenjve. Nga këndvështrimi i rajonalizimit një gjë e tillë favorizon bashkimin e shoqërive të UK, të cilat ndajnë të njëjtat burime ujore përgjatë baseneve në emër të eficiencës së kontrollit të ndotjes së ujërave dhe alokimit të burimeve financiare për investimet në infrastrukturën ujore.

Sipas VKM nr. 775 datë 28.10.1996, në Këshillin Kombëtar të Ujërave përveç Kryeministrit bëjnë pjesë ministritë kryesore të linjës ku përfshihen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, si dhe gjashtë prefekturat kryesore të baseneve përkatëse të lumenjve. Kjo përbërje tregon për një strukturë institucionale të konsoliduar dhe gjithëpërfshirëse. Në bazë të ligjit “Për rezervat ujore” dhe me qëllimin për t’u përafruar me Direktivën Europiane të Ujit, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) është ngritur Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Ujërave që është organi kryesor për menaxhimin e burimeve ujore. Kjo strukturë është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për menaxhimin e ujit dhe bashkërendimin social, kombëtar dhe ndërkufitar.

Nga nga viti 2002 janë krijuar në nivel vendor 6 Këshilla të Baseneve të Lumenjve për të menaxhuar burimet ujore në basenet përkatëse. Këto këshilla janë përgjegjëse për përgatitjen e planit të menaxhimit të burimeve ujore sa i përket sasisë dhe cilësisë, si dhe lëshojnë autorizime për nxjerrjen dhe përdorimin e ujit, si dhe shkarkimin e ujërave të zeza në mjedisin natyror. Këshillat e Baseneve të Lumenjeve përbëhen nga zyrtarë të pushtetit qendror dhe vendor dhe nga komuniteti i biznesit. Ç’do këshill i baseneve të lumenjve kryesohet nga Prefekti i Qarkut në të cilin operon Këshilli i Basenit të Lumit. Në përputhje me ligjin është ngritur dhe Agjencia e Bazeneve të Lumenjve si agjenci ekzekutive e Këshillave të Baseneve.

Monitorimi i cilësisë së ujit në burimet sipërfaqësore është përgjegjësi e Institutit të Ujit, Energjisë dhe Mjedisit, ndërkohë që për ujërat nëntokësore përgjegjësinë e ka Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve monitoron ndikimin e shkarkimeve të ujërave të zeza në ujërat sipërfaqësore (lumenjtë dhe zonat bregdetare), ndërkohë që Instituti i Shëndetit Publik monitoron higjienën dhe kushtet e tjera që lidhen me cilësinë e ujit.

Hartimi i politikave lidhur me sektorin e ujit është i përqëndruar në nivelin e qeverisjes qendrore. Ministria e Transportit dhe Punëve Publike (MPPT) është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, planifikimin e investimeve dhe shpërndarjen e tyre, si dhe vlerësimin e performancës së investimeve publike në sektor. MPPT në vitin 2011 ka hartuar strategjinë sektoriale për periudhën 2011-2017²⁵ në të cilën përcaktohen vizioni, objektivat e misionit dhe planeve të veprimit në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore, së bashku me përgjegjësitë që i takojnë ç’do institucioni. Kjo Strategji tregon se Shqipëria është e angazhuar që t’i përgjigjet çështjes globale për ta bërë të barabartë për ç’do qytetar dhe një të drejtë të njeriut “Aksesin në Ujë të Pijshëm të Sigurt dhe Shërbimet e Kanalizimeve”.

4.2 Administrimi i shërbimeve të ujës-jellës kanalizimeve

Decentralizimi i funksioneve nga pushteti qendror te ai lokal ka krijuar një bazë të re të marrëdhënieve ndërinstitucionale në Shqipëri. Statusi i Njërive të Qeverisjes Vendore (NJQV) ndryshoi pas nënshkrimit nga Shqipëria të Kartës Europiane të Vetë-Qeverisjes Vendore në Maj 1998 dhe miratimit të Kushtetutës së re. Kushtetuta përcakton Shqipërinë si një shtet unik me dy nivele të qeverisjes vendore: bashki/komuna në nivelin e parë dhe qarqe në nivelin e dytë. Modeli i Shqipërisë me decentralizimin dhe autonominë vendore mori formë kur Qeveria Shqiptare miratoi në vitin 2000 Strategjinë Kombëtare të Decentralizimit dhe Autonomisë Vendore. Parlamenti Shqiptar miratoi në vitin 2000 ligjin nr. 8652 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore”. Ky ligj përcakton tre tipe funksionesh për NJQV: (i) ekskluzive të tyre (ii) të

²⁵ http://www.rru.al/doc/Strategjia_Kombetare_sektoriale_e_sherbimeve_te_furnizimit_me_uje_dhe_kanalizime_2011_-_2017.pdf

përbashkëta/ndara me të tjerë; dhe (iii) të deleguara (të detyrueshme dhe jo të detyrueshme).

Tabela 4.1: Funksionet dhe shërbimet e pushtetit vendor

Funksioni	Ekskluzive të tyre	Përbashkëta/ndara	Deleguara
Shërbimet në kompetencë.	-Në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike; -Shërbime me karakter social, kulturor dhe sportiv; - Zhvillimi Ekonomik Vendor; - Rendi dhe mbrojtja civile.	-Arsimi parashkollor dhe parauniversitar; - Shërbimi parësor shëndetësor dhe mbrojtja e shëndetit publik; -Kujdesi social, zbutja e varfërisë; - Rendi dhe mbrojtjen civile; -Mbrojtja e mjedisit	- Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj nga institucionet qendrore; -Komunës, bashkisë ose qarkut, mund t'u delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.

Burimi: Ligji nr. 8652 datë 31.7.2000

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve i përket kategorisë së parë mbi bazën e të cilës njësitë vendore kanë autoritetin administrativ dhe financues në sigurimin e këtij shërbimi. Proçesi i decentralizimit mund të ndahet në dy faza. Faza e I-rë nga 2000-2006 rezultoi në transferimin e aseteve të 137 sistemeve të pavarura në 12 bashki dhe 52 komuna dhe të pesë kompanive dhe katër ndërmarrjeve shtetërore, respektivisht në nëntë NJQV (Banka Botërore, 2011:12-23). Kjo fazë ju referua Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 550 i vitit 2002. Faza e dytë nisi me VKM nr. 660 datë 12.9.2007 nëpërmjet të cilit u bë realitet transferimi i të gjitha kompanive të mbetura dhe sistemeve të UK tek NJQV. Ky vendim përcaktonte se kompanitë do të transferoheshin nën pronësinë e përbashkët të të gjitha NJQV të cilave ato u shërbenin, me aksione të ndara në bazë të numrit të popullsisë së secilës NJQV brenda zonës së shërbimit të shoqërisë së UK (Banka Botërore, 2011:12-23).

Ligji nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” përcakton se NJQV janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në zonat e tyre përkatëse të shërbimit, i ndryshuar me ligjin nr. 9208 datë 18.03.2004. Neni 10 i ligjit përcakton se komuna dhe bashkia kanë kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore për funksionet e veta dhe këto funksione i kryejnë duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione pushteti qendror mund të vendosë standarte e norma, por pa cënuar autonominë e tyre. Ligji nr. 8652 u miratua në vitin 2000 dhe zbatimi i tij presupozohet që do të përfundonte brenda 2 vjetësh. Megjithatë kishte mungesë të detajimit dhe qartësisë së rregullave dhe procedurave duke shkaktuar vonesa në zbatimin e ligjit deri në vitin 2007. Që prej asaj periudhe shumica e shoqërive të UK kanë krijuar Asamblatë e Aksionerëve dhe Këshillat Mbikqyrës përkatës. Pushteti qendror në zbatim të ligjit ka ndërmarrë reforma që konsistojnë në 3 grupe kryesore masash: (i) masa ligjore (ii) masa administrative dhe (iii) masa për financimin dhe zbatimin e projekteve.

Sipas Ministrisë së Brendshme²⁶, deri në vitin 2012, 94% e aksioneve të shoqërive të UK ishin transferuar NJQV përveç UK të Durrësit, detajet e të cilit do të jepen në seksionet në vijim. Në kuadër të decentralizimit të këtij shërbimi dispozita bazë ligjore për ndërmarrjet publike shtetërore është neni 213 i ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”. Ndërmarrjet e ujësjellësit në Shqipëri konsiderohen shoqëri aksionere përsa i përket formës së tyre të organizimit dhe rregullohen me ligjin nr. 9901. Sipas VKM nr. 678 datë 3.10.2007 veprimtaria ligjore e ndërmarrjeve aksionere të UK përcaktohet si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe mirëmbajtja e të dy shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Aksionet e shoqërive janë në zotërim të aksionerëve qeveri vendore, ndërkohë që asetet dhe detyrimet janë nën pronësinë e vetë shoqërive.

Aksionerët janë të përfaqësuar nga një Asamble e Përgjithshme e Aksionerëve që është e njëjtë me Këshillat Bashkiakë, në rastin kur shoqëria i shërben një NJQV të vetme. Këshilli Mbikqyrës është organi drejtues i shoqërive aksionere të UK sipas statutit të ndërmarrjeve. Ai është i kufizuar në gjashtë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e


²⁶ Intervista e zhvilluar me shefen e Sektorit të Monitorimit të Buxhetit, Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Brendshme. Intervista e plotë gjendet në shtojcën 8.

Zakonshme e Aksionerëve dhe mandati i anetarëve është tre vjet. Këshilli Mbikqyrës raporton tek Asambleja e Aksionerëve lidhur me detyrimet e tij për mbikqyrjen e përputhjes së veprimtarisë së shoqërisë me aktet ligjore në fuqi, si dhe me standartet dhe parimet e zbatueshme të kontabilitetit. Administrimi i kompanive bëhet më i vështirë kur dy ose më shumë NJQV ndajnë pronësinë mbi të (shih figurën 4.1 më poshtë).

Në këtë kuadër sipas ligjit për shoqëritë tregëtare shoqëritë e UK presupozohet që aktivitetin e tyre duhet ta zhvillojnë me synimin e mbulimit të kostove dhe sigurimit të fitimeve. Realiteti tregon që shumica e shoqërive janë inefiçiente dhe subvencionohen nga shteti për të siguruar mbulimin e humbjeve të tyre financiare. Shoqëritë e UK janë i vetmi shembull me status shoqëri aksionere në sektorin publik apo korporatave në pronësi të një apo më shumë NJQV. Kjo strukturë paraqitet komplekse duke patur parasysh që decentralizimi sapo është kryer në Shqipëri dhe në këtë drejtim NJQV kanë pak eksperiencë në ushtrimin e rolit mbikqyrës të shoqërive të tilla.

Pozicioni i kryetarit të njësisë vendore ka influencë të kufizuar në funksionimin e shoqërive të UK, kjo pasi vendimmarrja lidhur me administrimin e UK është përgjegjësi e këshillave vendorë, që mund të pengojnë ecurinë e shoqërisë në varësi të influencës politike të anëtarëve të këshillit bashkiak/vendor. Kontradita në këtë rast qëndron në faktin se kryetari i bashkisë/njësisë vendore si kreu i ekzekutivit të ngarkuar në sigurimin e të gjitha shërbimeve bashkiake është fytyra publike e njësisë vendore. Si rrjedhim, popullsia ka tendencën ta bëjë atë përgjegjës për mbarëvajtjen e këtyre shërbimeve, përfshi këtu edhe atë të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Figura 4.1 Struktura institucionale e shoqërisë së ujësjellës kanalizimeve



Burimi: Përpunimi Autori

Megjithë përcaktimin ligjor në Shqipëri jo të gjitha shoqëritë i ofrojnë të dyja llojet e shërbimeve. Për nga eficientia ekonomike menaxhimi në mënyrë të ndarë i këtyre 2 shërbimeve nuk është kosto efektive sepse shërbimet menaxhohen nga dy institucione në nivele të ndryshme dhe kanë po ashtu burime fondesh të ndryshme. Problemi kryesor për DPUK-në mbetet grumbullimi i të dhënave nga bashkitë që menaxhojnë shërbimet e kanalizimeve duke e bërë të vështirë konsolidimin e të dhënave që është mjaft i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së sektorit dhe parashikimin e investimeve të nevojshme.

Në intervistën e zhvilluar me shefen e sektorit të monitorimit të buxhetit pranë Ministrisë së Brendshme u ngrit çështja e ndarjes së dy shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve dhe u diskutuan arsyet të cilat përmbledhen si në vijim:

1. Arsyeja kryesore e ndarjes së shërbimeve lidhet me përmbajtjen e vetë kuadrit ligjor që i jep të drejtën pushtetit vendor të zgjedhë mënyrën e menaxhimit të tyre. Konkretisht, kur është bërë transferimi i funksioneve nga pushteti qendror te ai vendor në kuadër të decentralizimit (përfshirë shërbimet e UK) në shumicën e rasteve bashkia ka patur kontraktorë për shërbimet e kanalizimeve dhe i ka menaxhuar duke patur kapacitetet e nevojshme në dispozicion. Meqënëse këto funksione janë kompetenca të pushtetit vendor kuadri ligjor përkatës ja ka lënë

të drejtën e zgjedhjes së menaxhimit të shërbimeve pushtetit vendor dhe në këtë kuadër bashkimi i shërbimeve nuk ka patur fuqi detyruese. Madje edhe investimet janë bërë më vete.

2. Shërbimi i furnizimit me ujë është shërbim bazik, kurse shërbimi i kanalizimeve nuk është bazik. Në rastet kur është parë se bashkimi i të dy shërbimeve ka qënë efektiv ato i janë kaluar shoqërisë qoftë me vullnetin e vetë bashkisë, ose me ndihmën e donatorëve, të cilët kanë financuar projekte me lehtësisht kur këto shërbime ishin të bashkuara.

Çështja e ndarjes së dy shërbimeve u diskutua me Z. Avni Dervishi, Kryetarin e ERRU për të kuptuar këndvështrimin e tij për këtë çështje. Sipas Z. Dervishi kjo çështje është një element që duhet rregulluar dhe së fundmi vetë ERRU është angazhuar në këtë proces. Aktualisht ekzistojnë 26 shoqëri që kanë vetëm shërbimin e ujësjellësit, ndërsa shërbimin e kanalizimeve e ushtrojnë njësitë vendore apo bashkia. Hapi i parë nga ERRU ishte kërkesa që ju bëri njësive vendore që të liçensoheshin për shërbimin e kanalizimeve. Ka patur ecuri të mirë në drejtim të kalimit të këtij shërbimi te shoqëria dhe konkretisht 3 bashki që kanë bërë transferimin janë: Tepelena, Delvina dhe Vlora. Ndërkohë bashkitë apo njësitet vendore të tjera kanë gjykuar ta mbajnë vetë si shërbim pasi shoqëritë nuk e kanë kapacitetin e duhur për t'i menaxhuar të dyja shërbimet.

Gjatë periudhës 2007-2009 pushteti qendror ka ndërmarrë një sërë reformash në sektorin e UK për transferimin e pronësisë së shoqërive të UK te njësitet e pushtetit vendor. Kjo politikë e transferimit qeveriset nga ligji nr. 8652 dhe ligji nr. 8744 të përmendur më sipër.

Për nga perspektiva e nxitjes së rajonalizimit si një iniciativë e pushtetit qendror për të rritur eficiencën e sektorit të ujit, ligji bazë nr. 8652 i jep më shumë fuqi NJQV nëpërmjet këshillave bashkiakë për të patur ndikim në administrimin e shoqërive të UK. Në një vend si Shqipëria, e cila është ende në hapat e parë të ekonomisë të tregut procesi i decentralizimit ndonëse është pozitiv mund të sjellë një efekt të kundërt në kushtet kur NJQV janë pronarë të shoqërive **dhe kur mungojnë marrëveshjet kontraktuale ndërmjet NJQV dhe shoqërive për monitorimin e performancës së shërbimeve**

UK. Kjo lloj ndërhyrje është veçanërisht problematike kur shqyrtohen propozimet e ndryshimit të tarifave të bëra nga shoqëritë, të cilat në mjaft raste nuk miratohen nga Këshillat Mbikqyrës që janë më tepër të interesuar për të kënaqur elektoratin së cilit i shërbejnë.

4.3 Kuadri rregullator i sektorit

Kuadri rregullator i sektorit UK realizohet nga ERRU, një rregullator i cili është i pavarur në nivelin e qeverisë qendrore. ERRU është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 ”Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar me ligjin nr. 9352 datë 3.03.2005 dhe ligjin nr. 9915 datë 12.05.2008.

ERRU është një institucion kombëtar i cili është themeluar në vitin 1996 dhe është nga rregullatorët e parë dhe më të vjetër në rajon. Pavarësia e tij mbështetet në përpjekjet për të siguruar transparencë në ushtrimin e funksioneve si rregullator. Kompetencat e tij përfshijnë²⁷:

- i. Liçencimin e shoqërive tregëtare të UK;
- ii. Miratimin e tarifave dhe pagesave për shërbimin me shumicë dhe pakicë;
- iii. Përcaktimin e standarteve të performancës dhe të shërbimit për shoqëritë e liçencuara dhe t’i detyrojë ato për plotësimin e tyre;
- iv. Përgatitjen e metodologjisë për hartimin e tarifave për shërbimin me shumicë dhe pakicë të UK;
- v. Vendosjen e standarteve për programet e investimeve dhe shitjen e aseteve;
- vi. Raportimin në Qeveri për situatën e sektorit të UK bazuar në informacionin e marrë nga shoqëritë;
- vii. Organizimin e seancave dëgjimore me publikun sa herë që Kryetari i ERRU e gjykon të arsyeshme.

Situata e liçensimit është përmirësuar në vitet e fundit sepse nga 24 shoqëri që ishin në

²⁷ Ligji nr. 8102, neni 14, pika (b) ndryshuar nga ligji nr. 9915

vitin 2008 kjo shifër është ka shkuar në 55 operatorë. Përgjatë vitit 2013 ka patur kërkesa për pajisje me liçencë apo rinovim liçence 31 operatorë UK. Proçesi i liçensimit ka përfunduar për 26 operatorë dhe është në vazhdim për pesë të tjerët²⁸.

Sipas intervistës së zhvilluar me Zj. Ana Metohu, Shefe e sektorit ekonomik dhe monitorimit pranë ERRU, proçesi i liçensimit në përgjithësi nuk paraqet probleme. I vetmi problem që mund të ketë ekzistuar është mungesa e stafit të kualifikuar me profesion inxhiner për të drejtuar SHUK në disa zona të vogla që është një ndër kushtet e liçensimit. Kushtet e tjera për liçensimin janë të thjeshta për t'u plotësuar. Po zhvillohen mjaft debate që të ndryshojë legjislacioni edhe për liçensimin ku të rriten vitet e eksperiencës që kërkohen për një teknik: të ketë të paktën mbi 15 vjet eksperiencë pune në sektorin e ujit. Aftësitë financiare të shoqërive UK është një tjetër kusht që kërkohet për liçensim, por ERRU nuk e ka marrë parasysh duke vënë më shumë theksin tek eksperiencia e kërkuar për drejtuesin e shoqërisë.

ERRU siguron të dhënat nga vetë operatorët si dhe nga Njësia e Monitorimit pranë DPUK. Duke qënë se të dhënat mund të mos paraqesin situatën reale, ERRU organizon seanca dëgjimore me publikun dhe siguron informacion nga ankesat e konsumatorëve.

Sipas ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 i ndryshuar dy herë, objektivi kryesor i ERRU është të mbrojë konsumatorët nga mbifaturimi ose nga situata e monopolit, si dhe t'u bëjë të mundur të liçensuarve të mbulojnë kostot e tyre duke përfshirë dhe mundësinë e sigurimit të një fitimi të investimit të tyre. Ndër objektivat më të afërta është që të mbulohen së pari kostot operative dhe si objektiva më afatgjatë kostot totale përfshirë interesat dhe amortizimin (MPTT, 2011:23). Synimi i ERRU është që të shkohet drejt mbulimit të kostove totale në përputhje me Direktivën e BE-së për ujin. Pikërisht kjo do të përbëjë dhe sfidën për të gjetur balancën mes mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të sektorit të UK.

Përveç kuadrit kombëtar ligjor dhe kuadrit për politikat, puna e ERRU bazohet dhe në disa rezoluta, dokumente dhe direktiva, të tilla si Direktiva e Ujit e BE-së, e Drejta e

²⁸ Raporti i Performancës 2013 për shoqëritë UK, fq. 8
http://www.erru.al/doc/UK-Albanian_B_lowres_opt.pdf

Njeriut për Ujë të Pijshëm të Sigurt dhe Higjienë, si dhe në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Direktiva e Ujit ka një sërë objektivash të tilla si parandalimi dhe ulja e ndotjes duke nxitur përdorimin e qëndrueshëm të ujit, mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e ekosistemeve ujore dhe pakësimin e efekteve të përmbytjeve dhe thatësirës. Shqipëria si një vend që synon të anëtarësohet në BE synon të arrijë përputhshmëri me Direktivat Europiane të Ujit ²⁹ si më poshtë:

- Direktiva Kuadër e Ujit (2006/60/KE), datë 23 Tetor 2000;
- Direktiva e Ujit të Pijshëm (98/83/KE), datë 3 Nëntor 1998;
- Direktiva e Trajtimit të Ujit të Ndotur Urban (91/27/KE), datë 21 Maj 1991;
- Parimet e Mbulimit të Kostos së Plotë sipas KOM (20000) 477.

Nëpërmjet bashkëfinancimit të Rezolutës së Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) “E Drejta e Njeriut për Ujë të Pijshëm të Sigurt dhe Higjienë” (miratuar më 28 Shtator), qeveria shqiptare është angazhuar për miratimin e një qasje bazuar në të drejtat e njeriut për sektorin e ujit dhe konkretisht Rezolutën e KDNJ 18/1, e miratuar në 28.9.2011 “E Drejta e Njeriut për Ujë të Pijshëm të Sigurt dhe Higjienë”.

Në Shtator 2000³⁰ Shqipëria së bashku me 180 kombe të tjera miratoi Deklaratën e Mijëvjeçarit në Samitin e Mijëvjeçarit, duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015, që konsiston në përgjysmimin e varfërisë në nivel global deri në vitin 2015.

Në korrik të vitit 2003 Parlamenti Shqiptar miratoi rezolutën në mbështetje të Deklaratës së Mijëvjeçarit : *“Arritja e Objektivit 7 të Zhvillimit të Mijëvjeçarit – Sigurimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Mjedisor – është një ndër objektivat kryesore të politikave për sektorin shqiptar të ujit. Strategjia Kombëtare e Sektorit të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 reflekton angazhimin e Shqipërisë për Synimin 10: për të përgjysmuar, deri në vitin 2015, përqindjen e njerëzve që nuk marrin shërbimet bazë të furnizimit me ujë të pijshëm të sigurt dhe me higjienë”*.

²⁹ <http://www.erru.al/mat.php?idr=62&idm=77&lang=1>

³⁰ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara 55/2, miratuar në 18 Shtator 2000.

Sikurse u përmend më sipër një ndër funksionet e mandatuara të ERRU është përcaktimi i standarteve kombëtare për shërbimet, si dhe standartet për programin e investimeve dhe shitjen e aseteve, standarte që ndihmojnë për të matur performancën dhe subvencionet që pushteti qendror parashikon. Sipas intervistës së zhvilluar me shefen e zyrës ekonomike dhe monitorimit pranë ERRU në konceptin e ERRU kur flitet për standartet për programin e investimeve i referohet më tepër kriterëve për shpërndarjen e investimeve pasi disa shoqëri ju janë alokuar më tepër investime se të tjerave. Ato që do të përbëjnë standarte janë prioritetet për të cilat do të analizohet përfitueshmëria e investimeve, menaxhimi i tyre dhe rezultatet e pritshme nga investimet. Aktualisht, ERRU sapo ka nisur bashkëpunimin me GIZ dhe BB për këtë qëllim.


Po sipas intervistës së zhvilluar me shefen e zyrës ekonomike, lidhur me shitjen e aseteve, paraprakisht duhet të përcaktohet sesi do të kryhet vlerësimi i tyre. Aktualisht ekziston një vlerësim që është mbështetur në standarte të vjetra, por në të njëjtën kohë janë futur investime sipas standarteve të reja. Ekziston një përplasje me ligjin e rregjistrimit të pasurive sipas të cilit vlerësuesit privatë janë të ngarkuar të kryejnë vlerësimin, ndërkohë që autoriteti i tatim taksave procedon sipas një tjetër vlerësimi. Ndërsa kur flasim për standartet kombëtare kjo i referohet shërbimit ndaj klientit ku synimi kryesor është furnizimi 24 orë me ujë të pijshëm, dhe ofrimi i tij cilësor sipas parametrave të shëndetit të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

4.4 Politika tarifore

Siç u përmend më sipër sipas ligjit bazë për kuadrin rregullator një ndër funksionet e mandatuara të ERRU është miratimi i tarifave. Secila shoqëri UK që dëshiron të rrisë tarifën paraqet propozimin më parë në këshillin përkatës në nivel bashkiak/vendor. Ky i fundit paraqet propozimin të ERRU, i cili pasi e shqyrton vendos ose jo për rritjen e tarifave mbi bazën e analizës përkatëse. ERRU i vendos tarifën duke u bazuar në metodologjinë e hartuar në vitin 2011, e cila është hartuar sipas eksperiencave ndërkombëtare. Rritja vetëm e tarifave sigurisht që do të sillte të ardhura për operatorin,

por kjo gjë mund të kundërshtohet nga konsumatorët në rast se ky veprim nuk shoqërohet me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Në këtë drejtim, ERRU miraton vetëm ato tarifa që kushtëzohen nga përmirësimi i performancës teknike dhe financiare të operatorëve. Figura më poshtë jep në mënyrë të përmblëdhur procedurën e aplikimit për tarifën.

Figura 4.2 Procedura e aplikimit për tarifën



Burimi, ERRU³¹

Sipas metodologjisë së miratuar në vitin 2011, neni 4, objektivat e strukturës tarifore kanë si qëllim:

a) *Mbulimi i kostos.* Kjo nënkupton që niveli i arkëtimeve duhet të tejkalojë atë të kostove. Konkretisht operatorët duhet të rrisin nivelin e arkëtimeve në mënyrë graduale deri sa të arrihet mbulimi i plotë i kostove:

- Të ardhurat mbulojnë kostot e plota operative dhe të mirëmbajtjes;
- Të ardhurat mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe
- Amortizimin;
- Të ardhurat mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, amortizimin si dhe tarifën e interesit mbi huatë (nëse ka)- (Interesat janë pjesë e kostove operative, ndërsa kthimi i principalit është pjesë investimi).

Ky qëllim është një përcaktim ligjor për shoqëritë, të cilat veprojnë sipas ligjit tregëtar

³¹ <http://www.erru.al/mat.php?idr=56&idm=71&lang=1>

dhe po kështu është një objektiv i përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Sektorit 2011-2017, që të gjitha SHUK të shkojnë drejt mbulimit të plotë të kostove të tyre. Është evidente fakti se shoqëritë më të dobëta duhet të fillojnë të mbulojnë së pari kostot e plota operative dhe të mirëmbajtjes për të vazhduar me mbulimin e plotë të të gjitha kostove totale. Kjo është e rëndësishme për të arritur autonominë financiare, për të lejuar shoqërinë të kryejë investime, të përmirësojë shërbimet e saj dhe të lehtësojë buxhetin e shtetit nga subvencionet, të cilat në shumicën e rasteve mbulojnë humbjet financiare të shoqërive, siç do ta trajtojmë më poshtë.

b) *Efikasiteti menaxhues.* Kjo nënkupton që rritja e kërkuar e tarifave duhet të bëhet në përputhje me përpjekjet për të përmirësuar performancën teknike dhe financiare të operatorëve. Kjo përbën dhe kushtin që ERRU të miratojë rritjen e tarifave.

Ky objektiv është i ndërlidhur me objektivin e parë në kuptimin që rritja e tarifave kërkohej jo vetëm për të mbuluar kostot (ky është një fakt që pranohet nga pikëpamja e efikasitetit ekonomike), por argumentimi duhet të vazhdojë më tej se rritja duhet të justifikojë vetveten, pra shoqëria duhet të përdorë në mënyrë efektive të ardhurat nga rritja e tarifave për të përmirësuar performancën teknike dhe financiare duke përmirësuar në të njëjtën kohë menaxhimin.

c) *Përballueshmëria.* Struktura e tarifave duhet të përcaktojë një tarifë të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulta, veçanërisht për ato zona ku skemat e subvencioneve ende nuk janë përcaktuar. Në përputhje me standartet ndërkombëtare, shtresat me të ardhura të ulta të popullsisë nuk duhet të paguajnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve³². Sipas raportit vjetor të ERRU për vitin 2013 ky kriter u zbatua për 6 shoqëritë të cilat aplikuan për tarifa ku ky nivel luhatej mes intervalit 2%-4.6%³³. Interesimi tim nëse ka elemente subvencionues apo amortizues kur faturimi është më i madh se ky kufi, komisionieri pranë ERRU, Z.Jovani ju përgjigj se deri tani nuk kanë dalë probleme të këtij lloji.

³² Shqipëria ka njohur zyrtarisht këto standarte të të drejtave të njeriut përmes bashkë-sponsorizimit të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara (UN) mbi të Drejtat e Njeriut për Ujë të Pijshëm dhe kanalizime, në këshillin e të Drejtave të Njeriut në 24 mars 2011.

³³ Përqindja e vlerës së faturës kundrejt të ardhurave për familje për 6 shoqëritë e UK paraqitet si në vijim: 1. UK Ersekë-2.1%, 2. UK Gjirokastrë-2% 3. UK Korçë-4.6%, 4. UK Lezhë-3.4%, 5. UK Pukë-2.2% dhe 6. UK Sarandë-2%.

Ky është një objektiv që mbron shtresat në nevojë dhe siguron barazi në drejtim të ofrimit të shërbimit për të mos penalizuar atë shtresë të popullsisë, e cila nuk konsumon atë volum të ujit si kategoritë e tjera të konsumatorëve. Përballueshmëria kompensohet me anë të skemës së subvencionit të kryqëzuar ku kategoritë që konsumojnë një volum uji më të lartë “paguajnë” një tarifë më të lartë.

d) *Efikasiteti mjedisor.* Struktura e tarifave duhet të përcaktojë tarifa më të larta, për konsumatorët me nivel të lartë konsumi me qëllim inkurajimin e ruajtjes së burimeve dhe një nivel konsumi të qëndrueshëm, duke patur parasysh edhe çështjet mjedisore.

Këto objektiva synojnë jo vetëm qëndrueshmërinë financiare, por dhe atë mjedisore që do të bënte të mundur ruajtjen e burimeve mjedisore në kuadër të Direktivës Europiane të Ujit dhe sfidave në nivel global për ruajtjen e këtij burimi. Objektivi i efikasitetit mjedisor është gjithashtu i rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij burimi për brezat e ardhshëm.

Për të siguruar barazi në drejtim të politikës tarifore, ERRU kërkon nga operatorët e ujit të aplikojnë tarifa më të larta për konsumatorët, që konsumojnë përtej kufirit minimal që është 40 litra/frymë/ditë dhe tarifa të ulta për ata që konsumojë më pak metër kub ujë³⁴. Normativa ditore për një familje është 150 litra/frymë/ditë. Nga intervista e zhvilluar me komisionerin pranë ERRU, Z. Jovani debatet që zhvillohen në Shqipëri lidhur me kufirin zhvillohen jo për kufirin minimal, por për normativën ditore. Kjo pasi norma mesatare në vendet e BE-së është 100-120 litra/frymë/ditë dhe debati që zhvillohet është ulja e kësaj normative. Edhe nëse tendenca do të vazhdojë të jetë në rënie, ulja nuk duhet të prekë minimumin jetik.

Sipas Metodologjisë së miratuar për tarifat nga ERRU i vitit 2011, parashikohet një tarifë në dy pjesë:

- Pjesa e parë është një tarifë fikse, të cilën do ta paguajnë të gjithë konsumatorët, tarifë e cila mbulon kryesisht kostot fikse që lidhen me shpenzimet e

³⁴ Këto përcaktime janë bërë në Metodologjinë për Vendosjen e Tarifave, të vitit 2012, nenet 7 dhe 8.

përgjithshme administrative të nevojshme për ç' do shoqëri dhe

- Pjesa e dytë është një tarifë variabël që do të mbulojë kostot variabël dhe është e përcaktuar në disa blloqe. Tarifat do të variojnë sipas 4 blloqeve apo më shumë, nëse operatori e shikon të domosdoshme. Kjo do të thotë që tarifa në bllokun e parë do të jetë më e ulët dhe në blloqet e tjera do të vijë duke u rritur.

Tabela 4.2 Strukturimi i tarifave

Kategoria e Konsumatorëve	Blloqet e Strukturave të Tarifave (metra kub në muaj)			
	< 4.5	4.5 - 20	20 - 30	>30
Familiare	1 herë	1 - 3 herë	1.5-4 herë	2.5-6 herë
Publike	1 - 2 herë	1-3 herë	1.5-5 herë	2.5 - 10 herë
Private	1 - 2 herë	1.5-4 herë	2-6 herë	3-12 herë

Burimi: Metodologjia për Vendosjen e Tarifave, ERRU, 2011

Sikurse mund të shihet nga tabela e mësipërme blloku i parë është blloku që do të faturohet deri në 4.5 metra kub ujë në muaj për konsumatorë, ndërsa blloqet e tjera vijnë duke u rritur, nga 4.5 deri në 20, nga 20 deri në 30 dhe mbi 30 metra kub ujë në muaj. Ajo që vihet re është se metodologjia përcakton se si do të variojë tarifa nga blloku i parë në blloqet në vijim, që do të thotë, nëse tarifa në bllokun e parë është 1 lekë, ajo nuk mund të jetë më shumë sesa 3 lekë për bllokun pasardhës, në bllokun e tretë jo më shumë se 4 lekë dhe në bllokun në vijim jo më shumë se 6 lekë për kategorinë e parë të konsumatorëve që janë familjarët. E njëjta llogjikë ndiqet edhe për kategoritë e konsumatorëve të tjerë dhe kështu me rradhë. Kjo lloj metodologjie mbron konsumatorët dhe në të njëjtën kohë i ndërgjegjëson ata për përdorimin me efikasitet të ujit.

Me qëllim që të aplikohet kjo metodologji dhe të jetë e suksesshme është e nevojshme

që të gjithë grupet e konsumatorëve, veçanërisht ata familjarë të jenë të pajisur me matësa. Në nivel sektori për vitin 2012 numri total i lidhjeve me matës për të treja kategoritë familjare, publike dhe private është në nivelin 55% nga ku për kategorinë familjare është 53%, për kategorinë institucione publike është 77% dhe për njësitë private është 74% (DPUK, 2012). Kategoria familjare mbetet më problematike në drejtim të pajisjes me matësa pasi është në nivelin 55%. Ky nivel i ulët lë vend për abuzime si në drejtim të faturimit ashtu dhe përdorimit me efikasitet të ujit. Kjo pasi konsumatorët familjarë janë të inkurajuar të kryejnë lidhje të paligjshme në mungesë të matësive. Një tjetër efekt negativ rëndon mbi dy kategoritë përkatësisht institucione publike dhe ato private, të cilat bartin ngarkesë më të madhe financiare në tarifa për të kompensuar kategorinë familjare nëpërmjet subvencionit të kryqëzuar.

Përveç metodologjisë së hartuar nga ERRU në vitin 2011 për tre kategoritë e përmendura, ka një iniciativë që mbështetet te metodologjia e tarifave për të hartuar udhëzues për tarifat për shoqëritë e vogla. Sipas intervistës së zhvilluar me ekspertin në fushën e ujit Prof. Asoc.Dr. Arben Bakllamaja, drafti është përfunduar së bashku me formularët që kompanitë duhet ti plotësojnë kur bëjnë aplikimin e tarifave. Përgatitja e këtyre udhëzuesve është një hap tjetër për të lehtësuar shoqëritë e vogla dhe lejon ERRU për të monitoruar impaktin që do kenë tarifat në performancën e tyre.

Sipas intervistës me kryetarin e ERRU, metodologjia e tarifave është ndërtuar mbi konceptin e mbulimit të kostove, ka parimin e fleksibilitetit dhe shoqëritë kanë të drejtën të zgjedhin formën e aplikimit mbi bazën e strukturës tarifore që ju jepet shoqërive. Aktualisht struktura ekzistuese është ajo e përbërë nga tarifa fikse dhe variabël dhe në vendet me fluks turizmi si psh. Pogradeci, Vlora aplikohet tarifa fikse për shpenzimet që shoqëria kryen jashtë sezonit dhe që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit në funksionim, printimin e faturave etj. Nuk ekziston një tarifë sezonale në mënyrë specifike, por ERRU merr parasysh kostot shtesë (gjatë procesit të aplikimit) që operatorët kanë gjatë sezonit turistik.


Sipas sheshe së zyrës ekonomike dhe monitorimit në ERRU, Zj. Metohu në përgjithësi të gjitha shoqëritë kërkojnë rritje çmimi. Tarifa me dy pjesë ka nisur të zbatohet dhe shoqëritë e kanë kuptuar që baza fikse mbulon një paketë shpenzimesh më të domosdoshme për t'u shlyer. Kjo lloj tarife i ndihmon shoqëritë sepse qëllimi është që të rritet qëndrueshmëria financiare. Tarifa variabël ndonëse ka avantazhin për të kategorizuar grupet e ndryshme të konsumatorëve në funksion të konsumit që ato kryejnë, që të jetë e zbatueshme kërkon infrastrukturë të zhvilluar me matësa dhe databazën e nevojshme për hedhjen e të dhënave.

Në vitin 2011 Banka Botërore në dokumentin e saj të hartuar për decentralizimin parashikoi se duke filluar nga viti 2012 ERRU do të aplikojë një sistem tarifar 3 vjeçar dhe aprovimi do të bazohet në biznes planet e përgatitura nga kompania. Sipas sheshe së zyrës ekonomike dhe monitorimit pranë ERRU biznes planet kanë filluar të përgatiten nga disa shoqëri. Konkretisht, janë paraqitur 4 shoqëri dy prej të cilave kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave. ERRU po bashkëpunon me GIZ për një metodikë sesi do kërkohej nga ERRU ky informacion dhe si do përpunohet. Në metodologjinë ekzistuese parashikohet që shoqëritë mund të aplikojnë për ndryshim tarife për më shumë se 1 vit nëse kanë përgatitur planet e biznesit. Ka patur eksperiencë ku shoqëritë për 2 vjet rrjesht kanë përdorur të njëjtën tarifë, kjo pasi investimet kërkojnë disa vite dhe impakti i vërtetë i tyre rezulton pas disa vitesh. Biznes planet janë 5 vjeçare ku si vit bazë llogaritet viti në të cilin aplikohet.

Po e njëjtja çështje u ngrit gjatë intervistës me kryetarin ERRU. Sipas Z. Dervishi rregullatori ka hartuar draftin e parë të biznes planit që do jetë i detyrueshëm për 10 shoqëritë e grupit të parë që përformojnë më mirë dhe mbulojnë 75 % të popullsisë. Në vitin 2014 shoqëritë ishin të detyruara për të patur biznes planin lidhur me aplikimin për rritje të tarifave. Ky biznes plan duhet të jetë i diskutuar më parë me pronarët, por nuk mjafton vetëm kjo pasi është e nevojshme për të patur biznes planin rregullator në të cilin përfshihet plani i zhvillimit tarifar 3-5 vjet. Risia e këtij sistemi është përputhja e objektivave me treguesit. Tarifat e vitit të 2-të do jenë tregues të performancës më të mirë.

Politika tarifore është mjaft e lidhur me politikën e subvencionimit. Në seksionin në vijim do të paraqesim situatën e politikës tarifore me qëllimin e evidentimit të masave që duhet të ndërmerren për uljen e subvencionit operativ. Politika tarifore në përgjithësi ka një ndjeshmëri të lartë politike, veçanërisht kur bëhet fjalë për ujin që konsiderohet një e drejtë bazike për individin. Aq më tepër po të marrësh parasysh se ekziston ende mentaliteti jo vetëm në Shqipëri, por në nivel global se uji është një mall social. Në Shqipëri në përgjithësi ka patur një rezistencë nga ana e pushteteve vendore për të rritur tarifat e ujit të pijshëm në nivelin e mbulimit të kostove operative.

Grafiku 4.1 Ecuria e tarifave të ujit të pijshëm për periudhën 2006-2012



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, DPUK, Përpunimi autori

Politika tarifore e përdorur në Shqipëri është ajo e tre llojeve: a) familjare, b) buxhetore dhe c) private. Sipas grafikut të mësipërm vihet re që tarifat për kategorinë familjare është më e ulta kundrejt dy kategorive të tjera. Kjo politikë lejon zbatimin e politikës së “subvencionit të kryqëzuar” midis tre kategorive të konsumatorëve. Sipas grafikut tarifat më të larta janë për bizneset private. Si rregull këto tarifa e mbulojnë koston e shërbimit. Po ashtu dhe tarifat për institucionet publike janë në nivele të tilla që e mbulojnë koston e shërbimit. Në grupin familjarë tarifat janë ndërmjet 20-40 lek/m³ dhe që mesatarisht në shumë shoqëri UK tarifat janë më ulta se kostoja e shërbimit. Është e rëndësishme të kemi parasysh së çfarë peshe zënë në shoqëri të ndryshme kategoritë e sipërpërmendura nisur nga konsumi i ujit. Gjithashtu, tarifat e mësipërme janë një


mesatare e të gjitha shoqërive të UK, të cilat ndryshojnë sipas shoqërive nga ku shoqëritë më të mëdha kanë tarifën më të lartë.

Subvencioni i kryqëzuar është një politikë që i vjen në ndihmë kategorisë së familjarëve. Por politika e subvencionit nuk është zgjidhja në vetvete sepse nuk mund të vazhdojë si politikë pafundësisht. Sikurse përmendet më herët në këtë seksion mbulimi i kostos vetëm me rritjen e tarifave nuk do të ishte një politikë e dëshirueshme. Në këtë drejtim shoqëritë duhet që të përmirësojnë menaxhimin dhe rritja e tarifave duhet të shoqërohet me përmirësimin e shërbimit dhe kryesisht me kryerjen e investimeve kapitale dhe duhet të synohet ulja e kostove si një rrugë për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive.

Ajo që vihet re nga grafiku është se të treja llojet e tarifave kanë pësuar rritje nga 2006 deri në vitin 2008 ku tarifat kanë pësuar rënie dhe më pas deri në vitin 2012 tarifat kanë ardhur duke u rritur. Rënia e tarifave në vitin 2008 mund të shpjegohet me faktin se ky vit ishte një periudhë tranzicioni sepse në përputhje me VKM nr. 660 VKM datë 31.12.2007 u bë realitet transferimi i të gjitha shoqërive të mbetura dhe sistemeve të UK tek NJQV nën pronësinë e përbashkët të të gjitha NJQV të cilave ato u shërbenin. Ky transferim u krye me aksione të ndara në bazë të numrit të popullsisë së secilës NJQV brenda zonës së shërbimit të shoqërisë së UK.

Përveç tarifave të ujit të pijshëm në fillim të viteve 2000 mjaft shoqëri kanë filluar të aplikojnë tarifa për kanalizimet. Duhet theksuar se jo të gjitha shoqëritë i menaxhojnë të dyja llojet e shërbimeve dhe në këtë kuadër të dhënat mund të mos reflektojnë realitetin. Disa bashki/komuna menaxhojnë shërbimin e kanalizimeve dhe për këto bashki nuk ekziston informacion mbi tarifat. Grafiku i mëposhtëm tregon se edhe për këtë shërbim tarifat më të larta janë për kategorinë e bizneseve private, e ndjekur nga kategoria e institucioneve publike dhe familjare. Ndryshe nga ecuria e tarifave për ujin e pijshëm, ecuria e tarifave për këtë shërbim është e ndryshme. Konkretisht tarifat për të treja kategoritë kanë ardhur në rënie për periudhën 2006-2008 dhe më pas deri në vitin 2012 janë rritur.

Grafiku 4.2 Ecuria e tarifave të kanalizimeve për periudhën 2006-2012



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, DPUK, Përpunimi autori

Ashtu si në rastin e tarifave me ujë të pijshëm, edhe në këtë rast aplikohet politika e subvencionit të kryqëzuar. Banka Botërore në një studim të saj ka bërë propozimin për politikën e ardhshme të subvencionit për të varfrit ku paraqiten 3 alternativa: 1) rritja e shumës së ndihmës ekonomike për familjet e varfra duke përfshirë tarifën e shërbimit të UK, 2) dhënia e subvencionit direkt tek shoqëritë e ujit vetëm për tarifat sociale dhe 3) tarifat në rritje në bllok me një kufi jetësor të konsumit për të varfrit (Banka Botërore, 2007:19-20). Politika e rritjes së shumës së ndihmës ekonomike mund të jetë një politikë veçanërisht e nevojshme për shtresat e varfëra. Kjo është një politikë e cila është në vëmendjen e qeverisë dhe përmendet në Strategjinë sektoriale 2011-2017. Për këtë kërkohet një angazhim nga ana e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (sot Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë) për të përcaktuar listën e familjeve me të ardhura të ulta.

4.5 Politika e subvencionimit

Sipas literaturës ndërkombëtare ekzistojnë dy lloje subvencionesh në sektorin e UK: a) subvencioni për investime dhe b) subvencioni për mbulimin e shpenzimeve operative. Sipas përkufizimit të Ministrisë së Financave subvencioni mbulon diferencën ndërmjet çmimit mesatar dhe kostos së shërbimit. Në buxhetin e shtetit termi subvencion përdoret


për mbulimin e diferencës ndërmjet çmimit dhe kostos. Ndërsa financimet që bën shteti për investimet kapitale për shërbimet publike nuk përkufizohen në buxhetin e shtetit si subvencione. Për këtë qëllim në këtë pjesë nuk do të flitet për subvencionet për investime, por për subvencionet për mbulimin e shpenzimeve operative, i cili në rastin e shoqërive të UK në shumicën e rasteve është dhënë për të paguar faturat e energjisë elektrike, kimikatet (klorin), pagat e nënpunësve, sigurimet shoqërore dhe ndonjë riparim, ose mirëmbajtje të domosdoshme. Në të njëjtën kohë edhe kalimi i ujësjellësave tek pushteti vendor u bë me këtë filozofi që bashkitë dhe komunat të përmirësojnë qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, ndërsa qeveria të vazhdonte të mbulonte investimet e nevojshme, një pjesë e të cilave mund të realizoheshin edhe nga PPP-të siç është rasti i Vlorës, ku qeveria del garant për një kredi të marrë për investime në UK dhe projekti zbatohet nga kompania partnere.

Aktualisht subvencioni realizohet në dy mënyra: subvencionim i kryqëzuar i strukturës tarifore dhe subvencionim i drejtpërdrejtë i operatorëve nga Qeveria përmes pushtetit vendor. Planifikimi i fondeve të nevojshme për subvencione bëhet nga DPUK në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Nevojat e shoqërive U/K për subvencion llogariten nga DPUK në bazë të planit financiar vjetor që hartojnë kompanitë nga ku nxirret diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Zakonisht në buxhetin e shtetit masa e subvencionit të miratuar është më e vogël se kërkesat sikurse ndodh edhe me zërat e tjerë të buxhetit. Në këto kushte DPUK zbaton një metodologji që e lejon të bëjë një shpërndarje sa më të drejtë bazuar në këto kriterë: a) madhësinë e shoqërisë, b) kushtet në të cilat sistemi i ujit funksionon, me gravitet apo me pompë, c) zonën e shërbimit dhe d) raportin e subvencionit të kërkuar ndaj defiçitit të llogaritur (Bakllamaja, 2011:137-146).

Fondet për subvencionimin e ujësjellësve janë të planifikuara në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit, e cila bën shpërndarjen e këtij subvencioni në buxhetin e NJQV brenda 10 ditëve nga miratimi i Ministrisë së Financave. Shuma e subvencionit përcaktohet dhe përdoret në përputhje me Udhëzimin nr. 6569 datë 27.06.2006 “Për kriteret e procedurat për përdorimin e subvencioneve shtetërore për sh.a dhe ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve”.

Sipas grafikut të mëposhtëm 4.3 vihet re se tendenca e subvencionit është karakterizuar nga një rënie nga viti 2006-2012 përveç vitit 2008 ku subvencioni ka një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2007. Pësia specifike e subvencionit operativ ndaj kostos totale operative në vitin 2012 ishte rreth 8% kundrejt 38.4% në vitin 2006, një fakt pozitiv ky që megjithë tendencën e ndryshueshme masë e subvencionit ka ardhur duke rënë. Ulja e subvencionit mund të vijë si rezultat i rritjes së çmimit ose uljes së kostove. Në kushtet kur shoqëritë ende ndeshen me kosto të larta, ulja e subvencionit ka ardhur më tepër nga rritja e çmimit. Duhet vënë në dukje se subvencioni faktik nuk është ai i planifikuar në ç'do vit. Borxhi i këtyre shoqërive ndaj të tretëve akumulohet ç'do vit duke e detyruar qeverinë që të marrë vendime të herëpashershme për të paguar borxhet e akumuluar të shoqërive të ujit. Konkretisht, faturat më të mëdha janë ato të energjisë ndaj Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, faturat e të cilit janë paguar nga buxheti qendror (Bakllamaja, 2011:137-146).

Grafiku 4.3 Ecuria e subvencioneve në raport me Koston Totale Operative 2006-2012



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Përpunimi autori

Politika e subvencionit në Shqipëri tregon që shoqëritë që shpërblehen më shumë janë ato që krijojnë më shumë humbje, pra ato që tregojnë një menaxhim më të dobët. Kjo lloj politike dekurajon shoqëritë e tjera dhe inkurajon vazhdimin e humbjeve të mëdha dhe në të njëjtën kohë shpërdorimin e ujit nga konsumatorët. Është për t'u theksuar që një politikë mjaft e rëndësishme që DPUK ka ndërmarrë është krijimi i njësisë të

monitorimit dhe benchmarkut të të dhënave, e cila ndihmon politikbërësit drejt një analize më realiste dhe transparente për çështjen e subvencionit.

Sipas intervistës së zhvilluar me Drejtorin e Njesisë së Monitorimit dhe Benchmarkut në DPUK Zj. Bibolli në përgjithësi kërkesa për subvencion është më e lartë nga ajo që alokohet nga Ministria e Financave. Shpërndarja e subvencionit bëhet me koeficientë në mënyrë që të ketë një shpërndarje të arsyeshme ndërmjet shoqërive. Subvencioni sipas udhëzimit duhet të përdoret për paga, sigurime shoqërore, klorifikim dhe energji elektrike. Në realitet ajo që vihet re është se subvencioni shpeshherë ndryshon destinacionin duke u përdorur më shumë për energji elektrike, ç'ka deformon në këtë mënyrë diferencën e kostos që përbën themelin bazë të përcaktimit të subvencionit. Në këto kushte disa ndërmarrje dalin me fitim sepse ju janë alokuar më shumë subvencione se të tjerat dhe si rrjedhim, ky fitim mund të mos mbështetet domosdoshmërisht në realizimin e të ardhurave më të larta, apo në një menaxhim më të mirë nga shoqëria, por në sigurimin e një shume më të lartë subvencioni nga pushteti qendror.

Sipas njesisë së benchmarkut politika aktuale është që subvencioni mbështet më shumë shoqëritë që kanë humbje më të mëdha dhe ekziston rreziku që shoqëria të mos përmirësojë menaxhimin duke ditur se subvencioni sigurohet nga pushteti qendror. Nuk duhet neglizhuar fakti se subvencioni duhet të jepet për shtresat e varfëra dhe jo për kostot. Konkluzioni i përgjithshëm është se politika ekzistuese e subvencionit dhe mënyra e shpërndarjes së tij nuk inkurajon shoqëritë e UK dhe nuk i shërben ngushtimit të hapësirës ndërmjet të ardhurave nga aktivitetet kryesore dhe kostos operative.

Paradoksi aktual është që megjithëse pronësinë e shoqërive në kuadër të decentralizimit e ka pushteti vendor, pushteti qendror financon më anë të subvencioneve humbjet financiare të shoqërive. E vërteta e këtij fakti është se transferimi i pronësisë u shoqërua me kalimin e aseteve tek shoqëritë UK, të cilat karakterizoheshin nga rrjete mjaft të amortizuara që krijuan probleme si për shoqëritë ashtu dhe pushtetin qendror. Në këto kushte pushteti qendror ka dy rrugëdalje: (i) e para, të vazhdojë politikën e subvencionit duke e financuar nga buxheti i qeverisë qendrore, por duke e kushtëzuar dhënien e tij me arritjen e disa treguesve të performancës operationale dhe financiare të shoqërive

(ii) e dyta, kalimi i përgjegjësisë për dhënien e subvencionit pushtetit vendor (Bakllamaja, 2011:68). Rruga e parë është e vështirë duke patur parasysh që menaxhimi i shoqërisë është në administrimin e vetë, por vendimet merren nga pushteti vendor si pronar i tyre. Ndërsa rruga e dytë do të kërkonte një kohë më të gjatë duke patur parasysh detyrimet e reja financiare që i lindin pushtetit vendor. Pushteti vendor tashmë duhet të ndërgjegjësohet se decentralizimi kërkon forcimin e financave të saja vendore nëpërmjet grumbullimit eficient të të ardhurave dhe përdorimit me efikasitet të shpenzimeve të tyre. Nga ana tjetër, pushteti qendror ka përgjegjësinë për të ndihmuar me financime zonat më pak të zhvilluara dhe veçanërisht kryerja e investimeve është një funksion për të cilin pushteti qendror duhet ta mbështesë pushtetin vendor. Në të njëjtën kohë, pushteti qendror ka përgjegjësinë që të vazhdojë financimin me anë të subvencionit për zonat e varfëra nëpërmjet të ashtuquajturës subvencioni kryqëzuar. Por kjo nuk duhet të përjashtojë shoqëritë nga mosarritja e treguesve të performancës dhe përmirësimin e situatës së tyre financiare.

Ka patur përpjekje nga ana e Qeverisë Shqiptare për të ulur masën e subvencionit. Konkretisht, Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Bankën Botërore në kuadrin e programit të saj të ofruar për Qeverinë Shqiptare “Development Policy Operation” në vitin 2007, parashikuan përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale. Ndër veprimet e parashikuara për t’u ndërmarrë ishte reduktimi, ose eliminimi i subvencionit operativ në katër vitet në vijim dhe për këtë parashikohej reduktimi prej 10% në vit i subvencionit, i cili do të shoqërohej me një kontratë të shërbimit midis shoqërive të ujit dhe pushteteve vendore (World Bank, 2007:19-20).

Në këtë kontratë parashikohej që të përfshiheshin tregues të matshëm për shërbimin që do të shërbente si input kryesor për rishikimin e politikës së subvencionit operativ dhe asaj për investime kapitale në sektor. Në thelb politika e propozuar e subvencionit u propozua jo vetëm me qëllimin e lehtësimit të barrës fiskale të pushtetit qendror, por synonte që menaxherët e shoqërive të ujit dhe bashkitë dhe komunat të ndërgjegjësoheshin mbi përgjegjësitë e tyre të mandatuara në kuadër të decentralizimit për të mbuluar koston operative dhe atë totale. Paralelisht me pakësimin e subvencionit parashikohej rritja e fondeve për investime kapitale.

Kjo politikë nuk arriti të materializohej megjithëse u mbështet si nga Ministria e Financave ashtu dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Aktualisht pushteti qendror vazhdon të alokojë fonde në buxhetin e shtetit për subvencione për mbulimin e defiçiteve operationale për shoqëritë.

Sipas ekspertit të pavarur në fushën e UK Z. Arben Bakllamaja zerimi i subvencionit për një afat 4 vjeçar ishte një politikë e gabuar sepse të realizosh këtë objektiv duhet patjetër të jenë shumë faktorë që të bashkëveprojnë në mënyrë pozitive. Për shembull disa faktore të tillë janë: qeverisja në pushtetin vendor, çështja e investimeve, politika e rritjes së tarifave, qeverisja në SHUK dhe të tjera të tilla si këto. Si konkluzion janë shumë faktorë që duhet të merren në konsideratë, të cilat mund të kërkojnë një periudhë 10 vjeçare dhe jo 4 vjet siç u përcaktua. Por është evident fakti që ka një tendencë pozitive nga ana e shoqërive, të cilat po rrisin të ardhurat dhe po arrihen të mbulohen.

Në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, pushteti qendror ka deklaruar se një ndër masat është hartimi dhe zbatimi i një programi subvencionesh për familjet e varfra. Po kështu në raportin “5 vjet Benchmarking” të hartuar nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking si sfidë e ardhshme përmendet forcimi i rolit të Njesisë në aspektin e vlerësimit të nevojave për subvencione nëpërmjet hartimit të metodikave e skemave sa më efikase të subvencionimit me qëllim reduktimin e tyre nëpërmjet rritjes së performancës dhe aplikimi i subvencioneve për shtresat në nevojë. Sipas intervistës së zhvilluar me drejtorin e njësisë së monitorimit dhe benchmarkut metodikat nuk janë hartuar pasi fillimisht duhet të miratohet udhëzimi përkatës dhe më pas metodika bëhet pjesë e kësaj filozofie.

Subvencioni është një politikë që zbatohet nga shume vende në botë dhe nuk është domosdoshmërisht politikë e gabuar. Për të kuptuar filozofinë e subvencionimit sipas eksperiencës ndërkombëtare zhvillova një intervistë me ekspertin në fushën e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Sipas Z. Bakllamaja politika e subvencionit zbatohet edhe në vendet e zhvilluara. Konkretisht në konferencën më të fundit të organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA) në Tiranë në vitin 2013, u konkludua se qeveria japoneze

ndjek politikë sociale në këtë sektor duke subvencionuar ujin. Aktualisht ekzistojnë dy standarte: nga njëra anë kemi shembullin e Japonisë një vend i zhvilluar, por jo anëtar i BE-së që ndjek këtë politikë dhe nga ana tjetër kemi vetë BE që kërkon uljen e subvencionit. Në teori ekziston që ka dy koncepte që e shohin ujin si mall publik dhe mall ekonomik. Qeveritë janë të lira të zgjedhin atë politikë që e shohin të arsyshme. Nëse një qeveri vendos që një pjesë të kostos ta mbulojë me subvencion dhe i ka mjetet financiare për ta realizuar këtë mundësi atëherë kjo nuk përbën ndonjë problem. Një vendim i tillë përmban në vetvete politikën sociale ndaj shtresave që nuk janë në gjendje ta përballojnë. Por duhet theksuar se në rastin e Japonisë jo të gjitha kompanite subvencionohen, por vetëm ato që e kanë të nevojshme.

Ndonëse ulja e subvencionit është një politikë e dëshiruar e Qeverisë dhe që aktualisht po zbatohet përsëri është e nevojshme të analizohet se cilat janë mjetet për të kompensuar apo plotësuar uljen. Literatura e jep përgjigjen me anë të rritjes së performancës nga ana e kompanive. Po çfarë do të thotë kjo në rastin e SHUK në Shqipëri? Rritja e tarifave sigurisht që është përgjigja e mundur, por kjo rritje duhet të shoqërohet me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në mënyrë që konsumatori t'i përgjigjet politikës tarifore. Cilësia e shërbimeve nënkupton rritjen e investimeve të nevojshme dhe mbi të gjitha përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të shoqërisë.

Sipas intervistës së zhvilluar me ekspertin e pavarur Z. Arben Bakllamaja, kur analizohet shërbimi i ujit është e nevojshme të kuptohen burimet e financimit. Shërbimi i ujit mund të financohet nga tarifat, taksat lokale dhe subvencionet (që janë taksa të shtetit), pra indirekt paguan qytetari, por në dallim nga taksat lokale subvencioni ka një subvencion të kryqëzuar nga të gjithë qytetarët. Nëse qytetari paguan për shërbimin e ujit, në të njëjtën kohë ai paguan për shërbimin e ujit edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë pasi burimi i subvencionit janë taksat. Si rezultat qytetari nëpërmjet taksave paguan për shërbimin e ujit që në vetvete është një politikë sociale. Pra qytetari paguan si për shërbimin e ofruar ashtu dhe shërbimin që ju ofrohet të tjerëve. Politika më e mirë do të ishte që bashkitë që kanë ekonomi të zhvilluar të mund të financojnë subvencionin nëpërmjet tarifave dhe taksave lokale të tyre.

Një çështje e rëndësishme për politikën e subvencionit është besueshmëria e të dhënave që përcaktojnë masën e tij. Siç u përmend më sipër subvencioni përcaktohet nga DPUK që bën përcaktimin e tij dhe propozimin ja paraqet Ministrisë së Financave (MeF). Sipas ekspertit Z. Bakllamaja çështja e besueshmërisë lidhet me aspektin e zbatimit ku përgjegjës janë MPPT dhe DPUK që materializojnë nevojat në bazë të planeve të biznesit dhe në bazë të raporteve të benchmarking. Saktësia e të dhënave sigurisht që ndikon në masën e subvencionit pasi në të kundërt qeverisë do t'i duhej të financonte më shumë nga ç'është e nevojshme. Për të zgjidhur këtë çështje është e nevojshme të ketë bashkëveprim ndërmjet ERRU dhe DPUK sepse ERRU merr propozimet e tarifave bashkë me gjithë dokumentacionin që kërkohet të jetë sa më i besueshëm që të kuptohet pse duhet të rriten tarifat. ERRU ka njohuri jo të pakta për shoqëritë dhe në këtë drejtim nëse ka një informacion të ndërsjelltë lidhur me treguesit e performancës kjo do të ndihmonte në përcaktimin real të masës së subvencionit.

Përveç subvencioneve, nga buxheti i shtetit jepen transferta të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara për pushtetin vendor sipas udhëzimit në fuqi për zbatimin e buxhetit të shtetit. Në disa raste transferta e pakushtëzuar është përdorur për mbështetjen e shoqërive UK kur këto shoqëri e kanë patur të pamundur pagesën e faturave të energjisë. Kjo skemë është zbatuar në rastet kur subvencioni ka qenë i pamjaftueshëm për të mbuluar koston operative. Sipas udhëzimit për shpërndarjen e subvencionit në parim subvencioni duhet të shpërndahet sipas kriterëve pa diskriminuar shoqëritë. Megjithatë, në raste të veçanta kjo politikë ka qenë e ndryshme. Përmendim rastin e shoqërisë UK Durrës ku sipas MeF (intervista zhvilluar me Zj. Prodani, shtojca 9) në një vit të caktuar nuk mund të siguronte të ardhura për të mbuluar kostot për shkak të shumë arsyeve si ndërhyrje në rrjetet e paligjshme, shtrirjes së madhe dhe migrimit të popullsisë. Për të mbuluar kostot e larta të energjisë MeF vendosi të akordojë 80% të të gjithë subvencionit pasi kompania CEZ shpërndarje do të penalizonte këtë ndërmarrje dhe pasojat do ishin jo vetëm për shoqërinë, por në sektorin e ekonomisë në tërësi, për më tepër që ishte periudhë e sezonit të verës. Në dallim nga granti i pakushtëzuar që jepet si bllok pushtetit vendor pa kushte, granti i kushtëzuar mund të jetë për ndihmën ekonomike, si një funksion i pushtetit vendor.

Politika e dhënies së subvencionit direkt te shoqëritë vetëm për tarifatat sociale është një politikë e ngjashme me atë të ndihmës ekonomike. Politika e rritjes së tarifave në bllok me një kufi jetësor të konsumit për të varfrit konsiston në konsumin falas të një sasive të ujit të pijshëm dhe në Shqipëri është bërë një përpjekje e tillë në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Projekti Bashkiak i Ujit dhe Kanalizimeve” që u zbatua në bashkitë e Durrësit, Fier, Lezhë dhe Sarandë. Shoqërive në këto qytete ju kërkua që të zbatonin një politikë tarifore sociale që konsistonte në konsumin falas të 20 litra/person/ditë, por një nga kushtet ishte që familjet e varfëra të pajiseshin me matësa. Sikurse u shpjegua në seksionin e politikës tarifore, tarifa në rritje në bllok po aplikohet aktualisht në Shqipëri për të treja kategoritë siç shpjegohet më sipër.

Si përfundim, pavarësisht nga humbjet e mëdha që kompanitë UK përballen dhe subvencionet e larta nga pushteti qendror, tendenca e përgjithshme është që subvencioni në një periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë do të shkojë drejt rënies. Eksperienca në Shqipëri tregon se disa shoqëri të tilla si Korça, Pogradeci, Librazhdi, Elbasani, Lushnje realizojnë arkëtime totale që mbulojnë koston direkte të shërbimit të U/K. Prandaj është e nevojshme të nxirren mësim nga eksperienca e këtyre shoqërive dhe të zbatohen nga shoqëritë e tjera. E rëndësishme është që shoqëritë të ndërgjegjësohen të operojnë si shoqëri tregëtare duke përmirësuar menaxhimin e tyre.

Për qëllim të këtij studimi, kam zhvilluar intervistë me Zj. Gelardina Prodani, ish Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të Buxhetit në Ministrinë e Financave, lidhur me politikën e MeF për mbështetjen e sektorit kryesisht nëpërmjet subvencioneve. Në vijim jepen në mënyrë të përmbledhur çështjet e diskutuara.

- **Përdorimi i subvencionit.** Udhëzimi në fuqi për subvencionet Nr. 6569 datë 27.06.2006 specifikon që subvencioni nuk duhet të jepet vetëm për paga dhe sigurimet shoqërore, por jepet në bazë të performancës me qëllim që t’i nxisë shoqëritë të performojnë më mirë. Subvencioni jepet për klorifikim, energji. Evident është fakti se shoqëria UK Durrës ka faturën e energjisë më të lartë. MeF sqaroi se dhënia e subvencionit për të mbuluar fatura të larta për energjinë është bërë për të evituar një ngërç tjetër që mund të krijohet ndaj një sektori

tjetër publik siç është energjia ku ndjeshmëria është e madhe. Sikurse u përmend më herët në këtë paragraf MeF nuk e kushtëzon subvencionin vetëm për paga, por për klorifikim, energji dhe shoqëritë kanë përgjegjësinë që me të ardhurat e tyre të mbulojnë kostot e pagave. Sipas MeF kjo është mënyra për t'i nxitur shoqëritë që të menaxhojnë më mirë shoqërinë dhe të sigurojnë të ardhura.

- **Verifikimi i të dhënave për përcaktimin e subvencionit.** MeF merr të dhëna nga DPUK, MPPT dhe në këndvështrimin e MeF janë këto institucione të cilat mbajnë përgjegjësinë për të dhënat që sigurojnë.
- **Reduktimi i subvencionit.** MeF e mbështet politikën e reduktimit të subvencionit. Në vizionin e saj pushteti qendror nuk mund të mbështesë shoqëri të cilat janë jo performante për periudha të gjata kohore. Në raste të tilla për të lehtësuar pushtetin qendror nga barra fiskale dhe për të ndihmuar shoqëritë zgjidhja mund të ishte privatizimi i shoqërive.

4.6 Kuadri rregullator për marrëdhëniet Operator-Bashki/Komunë-Klientë

Deri tani është trajtuar kuadri ligjor dhe ai rregullator në tërësi për sektorin UK duke evidentuar institucionet përgjegjëse në nivele të ndryshme, përgjegjësitë e tyre dhe ecurinë e reformave të ndërrmarra. Në këtë seksion do të analizohet kuadri rregullator në mënyrë specifike në drejtim të marrëdhënies zinxhir kompani-pushteti vendor dhe klientë si përfitues përfundimtarë. Qëllimi i këtij trajtimi është për të kuptuar sesa mirë të rregulluara janë këto marrëdhënie dhe për të nxjerrë konkluzione për procesin e rajonalizimit.

- **Kontrata model.** Marrëdhëniet mes shoqërive, Bashkisë apo Komunës dhe Klientëve duhet të rregullohen me marrëveshje për të qartësuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë dhe për të ndihmuar në shqyrtimin e ankesave për shërbimet e ofruara. Sipas ERRU, deri në vitin 2011 ekzistonin kontrata formale mes shoqërive dhe klientëve të tyre, ku në shumicën e rasteve këto kontrata shpesh favorizonin interesin e operatorëve duke i lënë klientët të paqartë mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre. Kjo e bënte të vështirë shqyrtimin e ankesave dhe kërkimin e dëmshpërblimit lidhur me shërbime jo cilësore apo gabime në

faturim. Komisioni Kombëtar Rregullator me anë të Vendimit nr. 8 datë 4.02.2011 ka miratuar “Kontratën Model” që është i detyrueshëm për të gjithë klientët e rinj publikë dhe privatë. Kjo kontratë mbulon të gjithë elementët standartë të tilla si: kushtet e shërbimit, tarifat dhe pagesat, matjet, ndërprerjen e shërbimit, trajtimin e ankesave.

Sipas ERRU një studim i kohëve të fundit³⁵ mbi shërbimet ndaj klientit të ofruara nga shoqëritë UK në Shqipëri nxori në pah mangësi të konsiderueshme për t’u përmirësuar lidhur me cilësinë e ndërveprimit ndërmjet operatorëve dhe klientëve të tyre. Duke filluar nga faturimi dhe arkëtimi, e duke vijuar deri tek marrja e opinionëve dhe menaxhimi i ankesave, shërbimi ndaj klientit është larg praktikës më të mirë ndërkombëtare krahasuar me nivelin mesatar të një operatori.

Për këtë arsye, ERRU po harton aktualisht një Udhëzues për Shërbimet ndaj Klientit për të inkurajuar operatorët të rivlerësojnë përparësitë e tyre dhe të përshtasin qasjen e tyre menaxhuese në përputhje me këto udhëzime. Shoqërive do t’u rekomandohet të trajtojnë mangësitë ekzistuese teknike dhe njerëzore për të ofruar një shërbim të mirë për klientët dhe për t’i kushtuar rëndësi më të madhe marrëdhënies së mirë me publikun. Udhëzuesi do të plotësojë kontratën ekzistuese të shërbimit ndaj klientëve dhe objektivat përkatës të performancës.

- ***Marrëveshjet e performancës dhe kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizime***

Marrëdhëniet mes shoqërive dhe Bashkisë/Komunës duhet të rregullohen me marrëveshje të performancës duke patur parasysh që NJQV janë pronare ndërsa shoqëritë administratore. Shoqëritë përfitojnë nga subvencione të pakushtëzuara dhe subvencione të kushtëzuara nga pushteti qendror. Pushteti qendror ka në vizionin e tij reduktimin e subvencioneve për mbulimin e kostove operative apo humbjeve financiare dhe rritjen e granteve të kushtëzuara dhe konkretisht grante që jepen të kushtëzuara për kryerjen e investimeve nga ana e shoqërive të UK, si dhe një skemë të targetuar subvencionesh për shtresat në nevojë. Është e njohur gjerësisht se kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ndihmon për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet ligjore të

³⁵ Studimi kombëtar mbi shërbimet e klientit në shoqëritë e UK.
http://www.erru.al/doc/Studim_mbi_perceptimin_e_Konsumatorit_mbi_sherbimet.pdf

operatorit kundrejt NJQV. Ky kod dokumenton të drejtën e konsumatorit dhe detyrimin e shoqërisë kundrejt tyre. Hartimi i kodit ndihmon për të përcaktuar kushtet specifike të shërbimeve eficiente, të besueshme dhe kosto efektive, standartet e shpërndarjes së shërbimeve dhe mbrojtjen e shëndetit.

Për këtë qëllim me anë të VKM nr. 1304 datë 11.12.2009 është miratuar modeli i rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK që përbën kodin e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Kjo rregullore synon ³⁶:

- Sigurimin e një furnizimi me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi;
- Një shkarkim efikas mjedisor dhe higjienikisht të përshtatshëm të ujërave të ndotura të zonës së shërbimit;
- Dhënien e një instrumenti ligjor në shërbim të shoqërisë UK për performancën, mbrojtjen dhe ruajtjen e aseteve të sistemit të UK, të ujërave të ndotura e të impiantit të trajtimit të tyre;
- Garantimin në përgjithësi të një sistemi teknikisht të përshtatshëm të furnizimit me ujë, përfshirë dhe mbrojtjen e burimeve ujore;
- Garantimin në përgjithësi të një sistemi teknikisht të përshtatshëm të mbledhjes së ujërave të ndotura dhe me cilësi uji të ndotur të pranueshme për t’u derdhur në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura;
- Të kontribuojë në zvogëlimin e humbjeve dhe/ose të sasisë së ujit të pafaturuar në sistemin e furnizimit me ujë, për rrjedhojë logjike dhe për kanalizimet, rritjen e të ardhurave nga faturimi, si dhe zvogëlimin e shpërdorimeve dhe vjedhjeve në sistem;
- Të kontribuojë në rritjen e lidhjeve me sistemin publik të largimit të ujërave të ndotura.

Nga perspektiva e rajonalizimit, heqja e subvencioneve dhe përfshirja e marrëveshjeve mbi bazën e performancës ndërmjet NJQV dhe shoqërive është e dëshirueshme në kuptimin që nxit një kulturë të profesionalizmit dhe disiplinës financiare, si dhe një optimizim të kostove dhe kursimeve nga shoqëritë që është një parakusht për

³⁶ http://www.erru.al/doc/Kodi_i_Furnizimit_me_Uje_dhe_Kanalizimeve.pdf , fq. 14

menaxherët e shoqërive dhe vendimmarrësit e pushtetit vendor për të kuptuar vlerën ekonomike të bashkimit.

Nga këndvështrimi i rajonalizimit, kodet teknike dhe profesionale për sektorin e ujit ndihmojnë për të krijuar një klimë profesionalizmi dhe përgjegjshmërie. Këto kode mund të ndihmojnë për të rritur ndërgjegjësimin e shërbimeve të mira të ujit dhe ndihmojnë në rritjen e presionit publik për përmirësimin e shërbimeve dhe pranimin e tarifave që mbulojnë kostot.

4.7 Përmbledhje e kuadrit ligjor ekzistues nga perspektiva e rajonalizimit

Sic edhe u përmend në këtë kapitull në sektorin e UK operojnë mjaft institucione, të cilat kanë kompetenca të ndryshme dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre është mjaft i rëndësishëm për të realizuar reforma të rëndësishme, ku më e fundit që po debatohet është rajonalizimi. Mjaft elementë të kuadrit ligjor ekzistues të përmendur në këtë kapitull e lehtësojnë rajonalizimin. Në këtë seksion do të përmbledhim elementët e kuadrit ligjor ekzistues nga perspektiva e lehtësimit të bashkimit të shoqërive të UK.

- Menaxhimi i Burimeve Ujore nga perspektiva e Baseve të Lumenjve

Për menaxhimin e burimeve ujore zbatohet Ligji nr. 8093 datë 21.03.2006. Ky ligj i rishikuar inkurajon fuqizimin e menaxhimit të burimeve ujore nga perspektiva e baseneve të lumenjve. Nga këndvështrimi i rajonalizimit, favorizohet bashkimi i shoqërive të UK, të cilat ndajnë të njëjtat burime ujore përgjatë baseneve ujorë në emër të efijencës së kontrollit të ndotjes së ujërave dhe alokimit të burimeve financiare për investimet në infrastrukturën ujore.

- Qëndrueshmëria financiare e shoqërive

Ligji bazë për Entin Rregullator të Ujit nr. 8102 datë 28.3.1996 i ndryshuar në vitin 2008 synon që shoqëritë të shkojnë drejt mbulimit total të kostove në përputhje me direktivën e BE-së, pra inkurajon qëndrueshmërinë financiare të shoqërive. Nga ana tjetër ligji është në mbështetje të mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet misionit të saj për të siguruar transparencë kundrejt publikut rreth efijencës së kostos së shërbimit në

kushtet e rritjes së tarifave. Nga pikëpamja e rajonalizimit sfida do të jetë sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

Shoqëritë përfitojnë subvencione nga pushteti qendror. Pushteti qendror është duke planifikuar reduktimin e subvencioneve të pakushtëzuara me grante të kushtëzuara dhe konkretisht grante që jepen të kushtëzuara për kryerjen e investimeve nga ana e shoqërive të UK, si dhe një skemë e targetuar subvencionesh për të varfërit. Nga perspektiva e rajonalizimit reduktimi i subvencioneve dhe përfshirja e marrëveshjeve mbi bazën e performancës ndërmjet NJQV dhe shoqërive është e dëshirueshme në kuptimin që nxit një kulturë të profesionalizmit dhe disiplinës financiare si dhe një optimizim të kostove dhe kursimeve nga shoqëritë, që është një parakusht për menaxherët e shoqërive dhe vendimmarrësit e pushtetit vendor për të kuptuar vlerën ekonomike të bashkimit.

ERRU i vendos çmimet në përputhje me metodologjinë e hartuar në 2011 sipas eksperiencave ndërkombëtare. ERRU miraton vetëm ato tarifa që kushtëzohen nga përmirësimi i performancës teknike dhe financiare të operatorëve. Nga perspektiva e rajonalizimit objektivat e politikës tarifore janë në favor të performancës së shoqërive pasi synojnë mbulimin e plotë të kostos, mbështetjen e shtresave në nevojë dhe ruajtjen e burimeve ujore në nivele të qëndrueshme konsumi.

- Ndhima sociale për shtresat e varfra

Në Shqipëri ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve marrin subvencione në bazë të Udhëzimit nr. 6569 datë 27.06.2006 “Për kriteret dhe procedurat për përdorimin e subvencioneve shtetërore sh.a. dhe ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve”. Subvencionet jepen ç’do vit në përputhje me parashikimet në buxhetin vjetor të shtetit për të mbuluar kostot e energjisë dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Politika e qeverisë synon të ulë subvencionet që jepen për të mbuluar humbjet e shoqërive, veçanërisht kostot operacionale dhe të zhvendoset drejt subvencionimit të të varfërve që mund të preken nga rritja e tarifave, ose siç njihet ndryshe subvencionim i kushtëzuar. Kjo politikë do të ndihmonte në drejtim të ndërgjegjësimit për efikasitet nga ana e

shoqërive. Nga pikëpamja e rajonalizimit kjo politikë është në mbështetje të përmirësimit të efijencës së shoqërive.

- Marrëdhënie të institucionalizuara mes NJQV-Shoqëri UK-Klientë

Me anë të Vendimit nr. 8 datë 4.02.2011 është miratuar “Kontrata Model” që rregullon marrëdhëniet ligjore mes SHUK dhe Klientëve. Kjo kontratë mbulon të gjithë elementët standartë të tilla si: kushtet e shërbimit, tarifat dhe pagesat, matjet, ndërprerjen e shërbimit, trajtimin e ankesave. Nga këndvështrimi i rajonalizimit, kontrata model ndihmon për të krijuar një klimë profesionalizmi dhe përgjegjshmërie si nga ana e shoqërive ashtu dhe të klientëve. Kjo kontratë mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit të shërbimeve më të mira të ujit dhe ndihmojnë në rritjen e presionit publik për përmirësimin e shërbimeve dhe pranimin e tarifave që mbulojnë kostot.

Një tjetër iniciativë pozitive është VKM nr. 1304 datë 11.12.2009 me anë të së cilës është miratuar modeli i rregullores “Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve” që përbën kodin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Këto kode ndihmojnë për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet e operatorit kundrejt NJQV dhe në të njëjtën kohë dokumentojnë të drejtën e konsumatorit dhe detyrimin e shoqërisë kundrejt tyre. Hartimi i këtyre kodeve ndihmon për të përcaktuar kushtet specifike të shërbimeve efijente, të besueshme dhe kosto efektive, standartet e shpërndarjes së shërbimeve dhe mbrojtjen e shëndetit. Nga këndvështrimi i rajonalizimit, ky kod për sektorin e ujit ndihmon për të krijuar një klimë profesionalizmi dhe përgjegjshmërie për të dyja palët.

- Planet 5-vjeçare të Biznesit

DPUK me mbështetjen e BB ka marrë asistencë në drejtim të hartimit të plan bizneseve për shoqëritë UK si dhe për hartimin e udhëzuesve të detajuar për zbatimin e modelit në përgatitjen e plan biznesit 5 vjeçar. Ky hap është mjaft i rëndësishëm duke ditur se plan bizneset janë një mjet i rëndësishëm menaxhimi për të ndihmuar shoqëritë të përcaktojnë indikatorë të matshëm të performancës financiare dhe teknike e mbështetur kjo dhe nga një plan shumë vjeçar investimi të kapitalit. Duke patur plane 5 vjeçare në vend të planeve 1 vjeçare i ndihmon shoqëritë UK për të monitoruar në mënyrë

periodike performancën kundrejt planifikimit. Nga këndvështrimi i rajonalizimit përgatitja e këtyre plan bizneseve ndihmon shoqëritë për të përmirësuar menaxhimin dhe po kështu ERRU në përcaktimin e tarifave mbi bazën e performancës teknike dhe financiare.

Si përfundim, kuadri ligjor në sektorin e UK synon të përmirësojë performancën e sektorit dhe marrëdhëniet ndërmjet institucioneve apo aktorëve të përfshirë. Kjo evidentohet më së miri nga një sërë aktesh ligjore dhe amendime të tyre për të rregulluar transformimet ligjore dhe institucionale me të cilat Shqipëria është përballur si rezultat i kalimit në ekonominë e tregut. Ndonëse aktet ligjore janë hartuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, ato kanë shfaqur probleme në drejtim të zbatimit sepse decentralizimi është një proces i ri në Shqipëri dhe pushtetet vendore kanë mjaft përgjegjësi në këtë kuadër. Megjithatë, trajtimi i kuadrit ligjor për nga perspektiva e rajonalizimit nxorri në pah se ekzistojnë baza të mira ligjore dhe institucionale që ky proces të fillojë të ndërmerret në Shqipëri.

4.8 Një vështrim i përgjithshëm i sektorit të ujësjellës kanalizimeve

Në Shqipëri shoqëritë e UK në shumicën e rasteve janë inefiçente, si rezultat i sistemeve të amortizuara dhe paaftësisë financiare për të mbuluar kostot nga të ardhurat. Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e UK në Shqipëri ka qënë e ulët dhe faktori kryesor ka qënë mos arritja e ekonomive të shkallës për t'i siguruar një nivel fitimi që do të justifikonte pjesëmarrjen e tyre.

Në këtë pjesë të dytë të kapitullit do të analizohet situata e sektorit të UK për periudhën 2006-2012 nëpërmjet 6 indikatorëve të performancës për të gjitha shoqëritë U/K. Këta indikatorë janë përzgjedhur sepse kanë një ndikim të madh mbi qëndrueshmërinë financiare të një shoqërie tipike të UK. Konkretisht indikatorët e analizuar janë si në vijim:

- Numri i stafit për 1000 lidhje përfshirë kanalizimet dhe vazhdimësia e shërbimit;
- Kosto totale operative për metër kub të ujit të prodhuar, të shitur dhe çmimi mesatar;

- Kosto direkte operative si përqindje e të ardhurave dhe arkëtimeve;
- Pjesa e lidhjeve të matura dhe uji i shitur i matur;
- Prodhimi, shitja dhe uji pa të ardhura;
- Mbulimi me shërbimet e sistemit të UK.

Për këtë analizë është përdorur metodologjia e njësisë të monitorimit dhe benchmarkut në analizën që i është bërë sektorit për periudhën 2006-2010. Të dhënat sipas 6 indikatorëve deri në vitin 2010 janë marrë nga njësia e monitorimit dhe benchmarkut, ndërsa për vitet e tjera 2011 dhe 2012 të dhënat e indikatorëve janë marrë nga faqja zyrtare e DPUK, të cilat janë llogaritur më pas.

Në pjesën vijuese të analizës do të studjohen faktorët për arritjen e efijencës së sektorit të UK në Shqipëri me qëllimin e gjetjes së kufirit minimal për arritjen e ekonomive të shkallës nëpërmjet metodës statistikore të mesatares së ponderuar. Rezultati i analizës arrin në konkluzionin se shoqëritë e UK në Shqipëri janë favorizuese për arritjen e ekonomive të shkallës, pasi 80% e tyre i shërbejnë një numri popullsie më të vogël se 50,000 banorë (sipas studimit të Bankës Botërore të kryer në vitin 2009). Në mënyrë që të realizohet kjo efijencë bashkimi i shoqërive dhe krijimi i rajoneve mund të jetë zgjidhja që kjo efijencë të realizohet. Për këtë qëllim kapitulli 5 në vijim analizon modelet e rritjes së efijencës në sektorin UK dhe rajonalizimin si një mundësi për rritjen e efijencës së shoqërive UK dhe tërheqjen e investitorëve të huaj në formën e PPP-ve.

Në bazë të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996, të gjithë operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura, duhet të kenë liçencë për të kryer këto shërbime dhe të përdorin tarifa sa më efikase. Liçensimi është një funksion i mandatuar i ERRU dhe është i rëndësishëm si proces sepse garanton publikun e gjerë se shërbimet e ofruara janë të miratuara dhe se ofrimi i tyre bëhet mbi bazën e standarteve. Aktualisht janë 58 shoqëri UK që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura dhe ofrojnë një ose disa prej shërbimeve (furnizim me ujë, trajtim të ujit të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura). Çdo operator ka për detyrë t'i shërbejë popullsisë në zonën e tij të shërbimit dhe

përgjegjësia e ç'do operatori është që të mbulojë të gjithë zonën e juridiksionit. Të dhënat faktike tregojnë se jo e gjithë popullsia në zonën e juridiksionit mbulohet me shërbimin e UK. Popullsia totale që jeton në juridiksionin e të gjithë operatorëve për vitin 2012 është mesatarisht 3.2 milionë banorë nga të cilët 2.2 milionë në qytet dhe 1 milionë në fshat. Nga 58 shoqëri vetëm 32 prej tyre ofrojnë të dyja shërbimet: furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, por në analizën tonë kampioni përbëhet nga 29 shoqëri.

Popullsia e Shqipërisë ka patur zhvendosje të mëdha ku ndërthuret emigrimi në vende të huaja me migrimin brenda vendit nga zonat rurale në zonat urbane. Migrimi i popullsisë ka qenë një fenomen i vazhdueshëm që në fillim të vitit 1990, të cilat kanë çuar në ndryshime ekonomike dhe shoqërore. Migrimi i pakontrolluar ka ushtruar presione për pushtetin qendror dhe vendor në drejtim të menaxhimit të territoreve të zonave urbane dhe ofrimit të shërbimeve bazë përfshirë furnizimin me ujë dhe shërbimet e kanalizimeve. Kjo zhvendosje ka përkeqësuar gjendjen financiare si të shoqërive të UK në zonat urbane sepse për mungesë investimesh janë shtuar lidhjet informale është rritur përdorimi jo ligjor i ujit dhe i mospagimit të detyrimeve, por edhe i shoqërive në zonat nga buron emigrimi sepse janë pakësuar përdoruesit dhe pagesit e detyrimeve.

Ndaj aktualisht një fenomen gjerësisht i njohur janë lidhjet e paligjshme, të cilat çenojnë performancën financiare të shoqërive dhe përdorimin pa kriter të burimeve ujore duke përkeqësuar edhe qëndrueshmërinë mjedisore të vendit.

Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore dhe me kapacitetin aktual plotësohen nevojat e popullsisë. Sfidat mbetet përdorimi me efektivitet i përdorimit të burimeve ujore. Duke u mbështetur në të dhënat e vitit 2012 rezulton se prodhohet më shumë sesa kërkesa e popullsisë dhe volumi i ujit të faturuar përmbush vetëm një pjesë të kërkesave. Faktet konkrete paraqiten si në vijim (DPUK, 2012):

- Volumi mesatar i ujit të prodhuar gjatë vitit 2012 rezulton 278 milionë/m³ nga të cilat 208 milionë/m³ ose 75% prodhohet nga sistemet me ngritje mekanike dhe 69 milionë/m³ ose 25% me rrjedhje të lirë. Ajo që vihet re është se 75% e volumit të përgjithshëm të ujit të prodhuar është siguruar nëpërmjet sistemeve

me ngritje mekanike që do të thotë që shoqërohet me konsum të energjisë elektrike.

- Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm aktualisht është 654 milionë m³. Kjo tregon se koeficienti i shfrytëzimit të kapacitetit ujqorë të vendit tonë është vetëm 43%³⁷.
- Kërkesat për ujë të pijshëm të llogaritur për të gjithë popullsinë e zonës së juridiksionit duke marrë në konsideratë normativën e faturimit 150 l/f/d dhe humbjet 20% për vitin 2012 është vlerësuar 212 milionë m³ ujë në vit.
- Kërkesat për ujë të pijshëm të llogaritura për popullsinë e zonës së shërbimit të shoqërive të monitoruara duke marrë në konsideratë normativen e faturimit 150 l/f/d dhe humbjet 20% janë vlerësuar 169 milionë m³ në vit.
- Volumi total i ujit të faturuar për të gjitha kategoritë e klientëve është 91 milionë m³, ose vetëm 32.73 % e ujit që shpërndahet në të gjitha rrjetet e përdorimit të tij.

Kutia nr.2 Statistika për prodhimin e ujit

*Prodhoet 31% më shumë nga sa janë vlerësuar kërkesat.

*Prodhimi është 64% më i lartë se kërkesat për ujë të pijshëm llogaritur për popullsinë e zonës së shërbimit.

*Volumi i ujit të faturuar përmbush vetëm 54% të kërkesave.

Këto statistika ndihmojnë të arrijmë në disa konkluzione si në vijim:

1. Prodhoet 31% më shumë ujë nga sa janë vlerësuar kërkesat për ujë të pijshëm duke supozuar se e gjithë popullsia që jeton në zonën e juridiksionit do të furnizohej me ujë të pijshëm³⁸.
2. Prodhimi është 64% më i lartë se kërkesat për ujë të pijshëm llogaritur për popullsinë e zonës së shërbimit³⁹.
3. Volumi i ujit të faturuar përmbush vetëm 54% të kërkesave për këtë zonë⁴⁰.

Burimi: Përpunim nga Autori

³⁷ Ky koeficient është llogaritur si raport i volumit mesatar të ujit të prodhuar prej 278 milionë m³ me kapacitetin mesatar vjetor prej 654 milionë m³.

³⁸ Kjo shifër ka dalë si rezultat i raportit (278-212)/212

³⁹ Kjo shifër ka dalë si rezultat i raportit (278-169)/169

⁴⁰ Ky koeficient është llogaritur si raport i volumit total të ujit të faturuar prej 91 milione m³ me kërkesën për ujë të pijshëm prej 169 milionë m³ për popullsinë e zonës së shërbimit.

Në përputhje me statistikat e paraqitura më sipër lidhur me përdorimin e burimeve ujore arrihet në konkluzionin se ka mosefektivitet në përdorimin e burimeve ujore duke prodhuar më shumë sesa janë kërkesat dhe keqmenaxhim financiar duke faturuar vetëm gjysmën e kërkesave të ujit.

Performanca e shoqërive të UK në Shqipëri është e dobët dhe këtë e tregojnë indikatorët e performancës në këtë sektor. Përgjithësisht shoqëritë përballen pak a shumë me të njëjtat probleme, pavarësisht se shkalla e tyre varion nga një vend në tjetrin. Disa nga këto probleme janë si në vijim: (DPUK, 2012) :

1. Shkallë relativisht e ulët e furnizimit me ujë: 80% mbulimi në përgjithësi nga e cila 90 % në zonat urbane dhe 60 % në zonat rurale.
2. Humbje e madhe e ujit si pasojë e amortizimit dhe sasi të mëdha uji të pallogaritur. Shkalla e humbjes (pjesa e ujit që prodhohet e futet në sistem, por që nuk gjeneron asnjë të ardhur) është përafërsisht 67%, ndërkohë që shifra në Europën Perëndimore është në masën 20%. Kjo shkaktohet sepse niveli i instalimit të matësive është në nivele të ulëta rreth 55% të lidhjeve dhe në të njëjtën kohë ekzistojnë lidhje ilegale në rrjet.
3. Mbulimi me shërbime të ujërave të zeza është në 50 % në përgjithësi, nga të cilat 17 % në zonat rurale dhe 70% në zonat urbane.
4. Tarifat e ujit të pijshëm janë ende në nivele që nuk e përballojnë koston.
5. Vazhdueshmëria e furnizimit me ujë është 10.8 orë, ndërkohë që kjo shifër në vendet e Europës Perëndimore është në nivelin 24 orë në ditë. Vetëm dy nga shoqëritë e ujësjellësit (Korça dhe Librazhdi) mund të ofrojnë ujë 24 orë me presion.

4.9 Monitorimi i te dhënave të sektorit UK

Sot është rritur numri i studimeve sasiore që analizojnë faktorët që çojnë në eficiencën e shoqërive të UK. Nje çështje e debatuar mbi pjesëmarrjen e sektorit privat në sektorin e UK në vendet në zhvillim është eficienca e këtij sektori. Të dhënat krahasuese nëpërmjet metodologjisë benchmarking ndihmojnë për të kryer analiza të sektorit duke përdorur të dhënat e të gjitha shoqërive.

Një përfitim tjetër që vjen nga benchmarking lidhet me rolin që ka kuadri rregullator në eficiencën e sektorit. Berg et. al (2010:1-10) identifikuan 21 studime dhe arritën në konkluzionin se rregullat mbikqyrëse e kanë përmirësuar eficiencën dhe produktivitetin e kompanive të ujit bazuar në metodat e mëparshme rregullatore. Studime të tjera pasqyrojnë metoda më strikte rregullatore duke përdorur benchmarking si metodë për të përcaktuar tarifat, ose mbikqyrur cilësinë e shërbimeve duke argumentuar se në këtë mënyrë mbrohet interesi publik. Në rastet kur kompanitë nuk garantojnë parametrat, ose kërkojnë mbulimin e kostove vetëm me rritje tarifash, kjo mund të rezultojë kundër produktive, sidomos në vullnetshmërinë e pagimit të detyrimeve apo në vështirësitë e arkëtimit të të ardhurave.

Së fundmi, benchmarking shërben për të matur eficiencën në nivel rajoni, apo për të krahasuar vende të ndryshme duke përdorur disa tregues të eficiencës. Ekzistojnë 66 studime të kryera në sektorin e UK që analizojnë benchmarking për të matur eficiencën relative të kompanive të ujit në një vend të caktuar, rajon ose kampion nga disa vende. Studimet trajtojnë çështje të tilla si cilësia e shërbimit, qëndrueshmëria financiare dhe faktorët e eficiencës ekonomike. Në mënyrë të ngjashme ekzistojnë studime që analizojnë performancën ekonomike me raport me mjedisin dhe rrallësinë e burimeve ujore. Këto çështje kanë nevojë për më shumë vëmendje në të ardhmen. Në disa studime kërkuesit kanë përdorur cilësinë e shërbimeve si kriter për t'i kategorizuar kompanitë me qëllimin e zhvillimit të kuadrit nxitës (Berg & Lin, 2008:793-805).

Këta studiues kanë arritur në konkluzionin se pak analistë angazhohen në kërkim të vazhdueshëm në këtë fushë: 213 kërkues kanë publikuar 120 artikuj. Ky vëzhgim qëndron në kontrast po të kemi parasysh rëndësinë e sektorit për zhvillimin ekonomik dhe mirëqënien sociale. Është evident fakti se vlefshmëria e të dhënave ndikon tendencën e publikimeve. Rritja e studimeve sasiore në dekadat e fundit erdhi si rezultat i rritjes së aksesit ndaj transparencës së të dhënave të kërkuar në këto vende.

Po cilat janë arsyet e përdorimit të monitorimit të të dhënave dhe benchmarking në Shqipëri?

Së pari, decentralizimi dhe transferimi i përgjegjësiive të shërbimeve të UK drejt NJQV kërkon një burim informacioni objektiv për shoqëritë UK. Si pronar i tyre i ligjshëm pushteti vendor duhet të ketë në dispozicion të dhëna në mënyrë që marrëdhëniet ndërmjet pronarit dhe ofruesve të këtyre shërbimeve të jenë mbi baza profesionale.

Së dyti, prej shumë vitesh në Shqipëri donatorë si BB, KfW, USAID etj. kanë investuar në sektorin e UK dhe në këtë kuadër këta aktorë kërkojnë të dhëna për të ditur sesi janë shpenzuar fondet e tyre dhe matur efektivitetin në mënyrë që të përcaktojnë drejtimit e ardhshme të financimeve të tyre në sektor. Në mënyrë të ngjashme, në rastet e investimeve nëpërmjet kredive, bankat kreditore kërkojnë informacion sesi janë përdorur kreditë e tyre. Vëmendja e partnerëve ndërkombëtarë është tërhequr ndaj sektorit të UK në Shqipëri sepse problemet e tij dhe dështimet duken të jenë kërcënimi kryesor ndaj stabilitetit makroekonomik, rritjes së qëndrueshme dhe uljes së varfërisë. Financimi nga donatorët dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë ka qënë burimi kryesor i investimeve në këtë sektor. Donatori më kryesor në këtë sektor është Gjermania me 32.8% e ndjekur nga Italia 11.5%, BE-ja 10.6% dhe Banka Botërore 7.8% (Banka Botërore, 2011)⁴¹.

Së treti, natyra monopol e shërbimeve të UK bën që nga njëra anë të ketë kërkesa të larta për transparencë dhe efikasitet, dhe nga ana tjetër të zhvillohen politika të duhura sektoriale duke ngritur nevojën e informacionit sa më të hollësishëm.

Së katërti, benchmarking përdoret nga shoqëritë e UK për të përmirësuar performancën edhe nga rregullatorët si mjet për të vendosur tarifatat ose për të detyruar ofruesit e shërbimeve të përmirësojnë cilësinë. Çmimet që ngarkohen nga shoqëritë për shërbimet e ujit janë shpesh nën koston e plotë të ofrimit të këtyre shërbimeve. Mbulimi i plotë i kostos përfshirë kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, si dhe kostot e investimit duhet të jenë një qëllim afat gjatë për shoqëritë publike sepse ju siguron atyre autonomi

⁴¹ http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/Water_Albanian.pdf

financiare. Në këtë kuptim kjo metodologji ndihmon rregullatorët për të përcaktuar strukturën e tarifave, e cila duhet të jetë në harmoni me shërbimet e përmirësuara.

Së pesti, monitorimi i të dhënave dhe benchmarking përdoret jo vetëm për të konkluduar mbi performancën e sektorit, por për të nxjerrë konkluzione mbi rastet më pozitive të performancës së disa shoqërive. Këto raste mund të shërbejnë si referencë për shoqëritë e tjera që performojnë më dobët për të nxjerrë mësimet dhe për t'i nxitur drejt përmirësimit të ecurisë së tyre.

Në Shqipëri monitorimi i performancës dhe Benchmarking zbatohet që prej vitit 2005 nga njësia e ngritur pranë DPUK dhe konsiston në matjen dhe monitorimin në vazhdimësi të performancës së sistemeve të UK dhe vlerësimin e progresit të tyre. Ky vlerësim bëhet mbi bazën e disa treguesve standartë që kjo metodologji përdor në aspektet teknike, financiare dhe menaxhimit dhe cilësisë së shërbimeve. Këto dy vitet e fundit monitorimi i performancës dhe Benchmarkut kryhet nga ERRU mbi bazën e bashkëpunimit me njësinë e monitorimit pranë DPUK. Seksioni në vijim ka si qëllim të paraqesë gjendjen aktuale të performancës të 58 shoqërive të U/K nëpërmjet treguesve kryesorë për periudhën 2006-2012.

Për të kuptuar procesin e monitorimit dhe Benchmarkut në Shqipëri për sektorin UK në vijim do të paraqes çështjet kryesore të diskutuara në intervistën e zhvilluar me drejtorin e kësaj njësie.

1. Rregjistrimi dhe verifikimi i të dhënave për shoqëritë e ujit dhe/ose kanalizimeve

Sipas raportit “5 vjet Benchmarking” të dhënat për sektorin grumbullohen mbi bazë 3-mujore dhe në total janë rreth 203 të dhëna sasiore mbajtur me bazë mujore nga të gjitha shoqëritë e përfshira në programin e monitorimit (këto të dhëna ndryshojnë pasi mund të shtohen). Të dhënat grumbullohen mbi bazën e pyetësorëve të shpërndarë, më pas këto të dhëna regjistrohen në program, bëhet verifikimi i tyre dhe nëse identifikohen

gabime, bëhen korrigjimet përkatëse. Sipas drejtorit të njësisë së benchmarkut verifikimi i të dhënave bëhet në dy forma:

- *Së pari*, nga vetë programi, i cili llogarit treguesit dhe duke i krahasuar me periudhat e kaluara evidenton treguesit e deformuar. Psh. nëse një tregues në trendin e një shoqërie është 58% dhe rezultati nga programi del 90% verifikohet nëse hedhja e të dhënave është e gabuar dhe nëse kjo gjë nuk verifikohet kontaktohet me shoqërinë nëse kanë raportuar gabim.
- *Së dyti*, ç'do vit në mbyllje të periudhës, organizohet kalendari i vizitave tek shoqëritë që kanë patur problematika me të cilat bëhet verifikimi i të dhënave. Në 2012 njësia bëri një raport vizitash të përbashkëta me ERRU kjo për arsye se njësia ka shumë detyra për të përmbushur, por nuk ka kompetenca për t'i ushtruar, ndërkohë që ERRU i ka këto kompetenca sipas ligjit në fuqi. Verifikimi në fjalë u realizua vetëm për të dhënat financiare, sepse për të dhënat e shitjeve dhe prodhimit të ujit nuk ishte e mundur të grumbulloheshin pasi njësia nuk dispononte mjetet e nevojshme. Baza e të dhënave që u krahasuan ishin bilancet me të dhënat e monitorimeve. Vëzhgimet u zhvilluan në shoqëritë më të mëdha pasi janë ato që kanë dominancë.
- *Së treti*, kryhet verifikim nga ERRU, i cili merr të dhënat si nga njësia ashtu dhe nga shoqëritë dhe kryen rakordimin. Gjithashtu ERRU merr dhe të dhëna të tjera për çështjet e liçensës dhe tarifave, e cila është përgjegjësi direkte e ERRU.

ERRU së fundmi ka raportuar se ekzistojnë shumë sisteme ujësjellësish që ofrojnë shërbim të palicensuar gjithsej 132 njësi në 12 qarqet e vendit, të cilat ofrojnë shërbim të ujësjellës dhe/ose kanalizime, por nuk janë pjesë e sistemit të liçensimit. Në këtë kuadër, ERRU zbatoi një projekt që nga Nëntor 2013 që kishte si qëllim të grumbullonte të dhëna teknike, ligjore, menaxheriale dhe dha rekomandime mbi hapat që duhen ndërmarrë për thjeshtimin e procedurave, për liçensimin dhe prezantimiin e një standarti liçense, që do të vihet në dispozicion të liçensimit të ofruesëve të shërbimit në këto zona.

2. Monitorimi i të dhënave

Monitorimi i të dhënave kryhet për shërbimet e furnizimit me ujë që ofrohen nga të gjitha shoqëritë, ndërsa monitorimi i të dhënave për shërbimet e kanalizimeve është më i selektuar pasi jo të gjitha shoqëritë i ofrojnë të dyja shërbimet.

Në raportin e Benchmarkut përmendet zgjerimi i juridiksionit të zbatimit të programit të monitorimit nëpërmjet përfshirjes në të edhe të shërbimit të kanalizimeve në rastet kur nuk është, si dhe përfshirjen e të gjithë operatorëve të tjerë të licensuar (komuna) që ofrojnë shërbimin e UK. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që të jepet një panoramë më e plotë për sektorin, në nivel kombëtar, zgjerimi i programit të monitorimit nëpërmjet përfshirjes në të, të informacionit për impjantet e trajtimit të ujrave të përdorura urbane, si dhe disa të dhënave dhe treguesve shtesë, të cilët do të mundësojnë analiza edhe më cilësore e gjithëpërfshirëse, në vazhdim. Në intervistën e zhvilluar me drejtorin e njësisë së monitorimit dhe benchmarkut një ndër çështjet e diskutuara ishte të kuptohej kontributi i njësisë për monitorimin e të dhënave të kanalizimeve dhe të impjanteve të trajtimit të ujërave të përdorura urbane.

Sipas drejtorit të njësisë pyetësi për të grumbulluar të dhënat e kanalizimeve nuk ju shpërndahet pushtetit vendor. Aq më tepër në kuadër të rajonalizimit kur të dyja shërbimet do të menaxhohen nga dy shoqëri të ndryshme, por me të njëjtin pronar. Hapi i parë është të bashkohen shërbimet pasi është më efikase sepse edhe në këto shoqëri që nuk kanë shërbimin e kanalizimeve komuniteti nuk paguan në bazë të kostos që kanë, por mbi bazën e të një tarife të vendosur nga komuna/bashkia pa marrë parasysh koston dhe as cilësinë e shërbimit që kërkohet. Nëse këto dy shërbime bashkohen atëherë informacioni për volumin dhe koston sigurohet nga matësat, të cilat janë përcaktuese të tarifës që duhet të paguhet nga publiku. Nëse publiku paguan mbi bazën e kostos reale atëherë shërbimi në të ardhmen do të jetë i përmirësuar sepse me të ardhurat e siguruara realizohen investimet e nevojshme që ndikojnë në përmirësimin e shërbimit.

Monitorimi i të dhënave shërben për të paraqitur situatën e performancës së sektorit ku shoqëritë klasifikohen në tre grupe sipas performancës së tyre. ERRU në raportin vjetor jep një panoramë të qartë të shoqërive ku shqyrtohet performanca individuale e

shoqërive dhe e krahasuar kjo me performancën e shoqërive të tjera duke vënë në dukje si shoqëritë me performancën më të mirë, ashtu dhe ato me performancën më të dobët. Ky raport shërben që vetë operatorët të mund të vlerësojnë performancën e tyre duke u krahasuar me atë të operatorëve të tjerë të këtij shërbimi që operojnë në mjedise të ngjashme dhe të dallojnë pikat e forta dhe të dobëta dhe të mësojnë nga praktikat më të mira operacionale dhe menaxhuese.

Në intervistën e zhvilluar me drejtorin e njësisë së benchmarkut u ngrit pyetja nëse njësia kryen ndonjë klasifikim të shoqërive sipas performancës së tyre. Sipas drejtorit në një raport të fundit ç’do vit bëhet klasifikimi i shoqërive, nga 5 më të mirat deri te e 58-ta që është më e keqja. Klasifikimi kryhet mbi bazën e një benchmarku, sipas grupeve që krahasohen me njëra tjetrën. Benchmarku konsiston në nxjerrjen e një mesatareje të Republikës për ç’do shoqëri dhe ç’do tregues vlerësohet me mesataren nga ku nxirret kompania me performancën më të mirë dhe më të dobët.

3. Të dhënat për investime

Në raportin “5 vjet Benchmarking” të dhënat për investimet që shoqëritë raportojnë nëpërmjet pyetësorit, vazhdojnë të jenë të pabesueshme. Sipas njësisë së monitorimit ekzistojnë faktorë objektivë dhe subjektivë që ndikojnë në saktësinë e këtij lloj informacioni.

Në rastet kur investimet kryhen me fondet e vetë shoqërisë si psh. Tirana, Durrësi, Korça, të dhënat janë të besueshme dhe në këtë kuadër bëhet më i lehtë raportimi. Problematike mbeten ato raste kur investimet kryhen me fondet e huaja, të cilat zbatohen nga njësia përkatëse dhe shoqëria nuk është pjesë e skuadrës së investimit. Në mjaft raste shoqëria njihet me detajet e investimeve pasi ky proces është përfunduar dhe raportimi është i vështirë. Një mënyrë e ndjekur nga njësia për të zgjidhur këtë problem është grumbullimi i të dhënave të investimeve nga burime të ndryshme si DPUK, Fondi i Zhvillimit Shqiptar apo dhe donatorë të tjerë. Realiteti është se në sektor kryhen më shumë investime sesa ato që raportohen duke e bërë të vështirë parashikimin e nevojave për investime në sektor. Në raportin e Benchmarkut një ndër sfidat e ardhshme që

përmendet është forcimi i rolit të Njesisë në aspektin e vlerësimit të nevojave për investimet në sektor, i cili do të mundësohet nëpërmjet hartimit të Masterplanit Kombëtar të Investimeve dhe monitorimit të tij. Vlerësimi i nevojave për investime në sektor duket se arrihet deri diku nëpërmjet Programit Buxhetor Afat-mesëm (PBA) ku përcaktohen objektiva që maten me indikatorë. Në PBA jepen në mënyrë të detajuar shpenzimet sipas projekteve në periudhë afat-mesme (PBA, 2013-2015:22-23).

Konkretisht:

- Deri në vitin 2020 raporti mesatar i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë popullsinë e vendit do të jetë 98% nga 80.8 % në vitin 2011.
- Raporti mesatar i mbulimit me shërbime kanalizime ujërave të zeza do të jetë 77% nga 50.8 % në vitin 2011, si dhe mbulimi me shërbim të trajtimit të ujërave të ndotura në impjantë trajtimi do të arrijë në 50% nga 4% në vitin 2011.
- Orientimi i shoqërive të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove drejt Mbulimit 100% të Kostos Direkte të Operimit (KDO) me të ardhurat deri në 2015 në të gjitha shoqëritë UK dhe më tej mbulimin e të gjitha kostove në vitin 2020.
- Rritja e kapaciteteve të stafit menaxhues dhe të operim mirëmbajtjes. Progres drejt harmonizimit të legjislacionit Shqiptar me direktivat e BE-së për sektorin si dhe inkurajimi i bashkimit të shoqërive të UK.

Siç shohim në PBA objektivat përcaktohen deri në vitin 2020, ndërkohë në Strategjinë UK objektivat jepen deri në vitin 2017. Pyetja që ngritëm në intervistën e zhvilluar me Njësinë e Benchmarkut është nëse ekziston përputhshmëri mes dy dokumentave ?

Sipas drejtorit të njesisë së monitorimit nëse fondet do ishin në përputhje me ato që ka përcaktuar Strategjia atëherë këta tregues do të ishin të përputhshëm.

Sipas drejtorit të hartimit të buxhetit në MeF në konceptimin e ligjit organik të buxhetit nuk është detyra e Ministrisë që të bejë rakordimin e të dhënave mes PBA dhe Strategjisë. Kjo është një përgjegjësi e Departamentit të Koordinimit të Ndihmës së

Huaj pranë Këshillit të Ministrave, i cili jep një deklaratë të MeF për këtë qëllim. Përgjegjësia e MeF në këtë drejtim është të sigurojë që prioritetet lidhen me PBA-në.

Pozitive për sektorin është përfundimi i Master Planit⁴² nga një konsulent i pavarur gjerman që parashikon nevojat për investime deri në vitin 2040 duke vendosur objektiva afat-shkurtër, afat mesëm dhe afat-gjatë. Sipas drejtorit të njësisë kjo e fundit nuk ka qënë pjesë e Master Planit. Ajo që është e rëndësishme nuk është vetëm hartimi i Master Planit, por monitorimi i zbatimit të tij. Një pjesë e të dhënave janë siguruar nga njësia e monitorimit, por Master Plani merr vlerë kur informacioni mbi investimet azhurnohet për të evidentuar nevojat për investime në vitet në vijim. Do të ishte e rekomandueshme që në të ardhmen Njësia të kishte databazën e investimeve që jepen për arritjen e disa objektivave të matshëm duke treguar nevojën dhe masën e plotësimit të objektivave nëpërmjet investimeve. Në këtë kuadër lidhja organike e të dyjave bën që ç’do informacion në sektor të jetë i besueshëm dhe vendimarrja realiste dhe e mbështetur me të dhëna konkrete.

4.10 Tendenca e performancës së sektorit për periudhën 2006-2012


Ky seksion pasqyron tendencën e indikatorëve kryesorë në aspektin teknik, financiar dhe cilësisë së shërbimeve për periudhën 2006-2012. Indikatorët e periudhës 2006-2010 janë marrë të përllogaritura nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut pranë DPUK. Ndërsa indikatorët për vitet 2011 dhe 2012 janë llogaritur duke përdorur të dhënat e benchmarkut sipas mesatares së ponderuar duke patur si bazë “popullsinë e shërbyer”. Llogaritja e indikatorëve sipas kësaj metode është bërë për të pasqyruar gjendjen sa më reale të sektorit duke marrë parasysh se shoqëritë UK kanë karakteristika të ndryshme dhe llogaritja me mesataren e thjeshtë nuk do të pasqyronte realitetin për sektorin në tërësi.

Analizimi i kësaj tendence është i rëndësishëm për të nxjerrë në pah problemet e sektorit dhe arsyet e performancës së dobët të shoqërive UK dhe si rezultat të sektorit si një i

⁴² Departamenti i bashkërendimit të strategjive dhe kordinimit të ndihmës së huaj
http://www.dsdc.gov.al/dsdc/Prezantohet_Master_Plani_per_Sektorin_e_Ujesjelles_Kanalizimeve_ne_Shqiperi_527_1.php

tërë. Rezultatet janë të nevojshme për të mbështetur analizën e mëtejshme të gjetjes së mënyrave të zgjidhjes së problemeve të sektorit.

Grafiku 4.4 Prodhimi, shitja dhe uji pa të ardhura (në milionë m³)




Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.4 pasqyron prodhimin dhe shitjen e ujit nëpërmjet treguesve përkatës, llogaritur për frymë të popullsisë së shërbyer, si dhe treguesin e ujit pa të ardhura llogaritur si përqindje e ujit të pafaturuar me atë të prodhuar. Sipas grafikut, prodhimi ka patur tendencë pozitive pasi ka ardhur duke u zvogëluar nga viti 2006 deri në 2012 mesatarisht me 50 litër/frymë/ditë. Në kushtet kur në Shqipëri prodhohet shumë më tepër se kërkesat e llogaritura për të, kjo tendencë konsiderohet pozitive.

Nga grafiku vihet re se vetëm një pjesë e volumit që prodhohet shitet duke sjellë përqindje të larta të ujit që nuk sjell të ardhura. Këto shifra të larta ndikojnë në ineficiencën e shoqërive duke e bërë të vështirë për ERRU miratimin e rritjeve të tarifave. Përgjithësisht niveli i pranuar për ujin pa të ardhura është 20-25%⁴³, ndonëse ka eksperiencë pozitive si Singapori që këtë shifër e ka 4% (Banka Botërore, 2011:12-23).

⁴³ Raporti 5 vjet Benchmarking” Monitorimi I performances per sektorin e UK ne Shqiperi, f. 20
http://www.dpuk.gov.al/5_vjet_benchmarking_vilma_bibolli_2011.pdf


Grafiku 4.5 Raporti i mbulimit me shërbimet e ujësjellës dhe kanalizimeve⁴⁴



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Siç mund të shihet nga grafiku i mësipërm 4.5 zona e shërbimit si për furnizimin me ujë ashtu dhe kanalizimet është zgjeruar deri në vitin 2009 ndërsa në vitet 2010-2012 ka një rritje të ulët. Në tendencën pozitive të këtyre dy treguesve deri në vitin 2009 kanë ndikuar investimet e kryera në sektor nga buxheti i shtetit dhe investitorët e huaj. Është evidente gjithashtu se një rritje në popullsinë që i shërbehet lidhet normalisht me një rritje të dendësisë së popullsisë duke kontribuar në efikasitet. Në një pozicion më të dobët qëndron ofrimi i aksesit për shërbimet e kanalizimeve, ende në nivele të ulta.

Grafiku 4.6 Niveli i matjes së konsumimit të ujit




Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

⁴⁴ Këta indikatorë janë raport i popullsisë që furnizohet me shërbimet UK ndaj popullsisë totale në zonën e juridiksionit.

Në grafikun 4.6 paraqitet përqindja e ujit të faturuar të matur si dhe përqindja e lidhjeve të matura. Treguesi i matjes së konsumit i shprehur si numër i lidhjeve të pajisura me matës uji ka tendencë pozitive. Ndërsa përqindja e volumit të ujit të shitur të matur nuk shkon në përpjestim të drejtë me shtimin e matësave dhe kjo mund të jetë pasojë e tendencës së kursimit të ujit nga klientët e pajisur me matësa.


Grafiku 4.7 Kosto Direkte Operative dhe çmimi mesatar (lek/m³)



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, DPUK, Përpunimi autori

Siç shihet nga grafiku 4.7 ndryshesa ndërmjet çmimit mesatar me koston direkte operative (KDO) rezulton të ketë tendencë pozitive. Diferenca ndërmjet çmimit dhe KDO ka ardhur duke u zvogëluar nga 10 lek/m³ në vitin 2008, në 3.59 lek/m³ në vitin 2012. Vetëm në vitin 2011 diferenca është pozitive, pra çmimi mund të mbulojë koston direkte të operimit, por duhet theksuar se kjo situatë mund të jetë e favorshme vetëm për disa shoqëri UK që i shërbejnë një numri më të madh popullsie dhe jo për të gjitha. Tendenda e përgjithshme për sektorin është se çmimi nuk arrin të mbulojë koston direkte operative. Pozitiv mbetet fakti se diferenca është pakësuar.


Grafiku 4.8 Mbulimi i KTO me të ardhura, arkëtime dhe subvencione (përqindje %)



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Në grafikun 4.8 më sipër tregohet se raporti i mbulimit të kostos totale operative me arkëtime ka ardhur duke u rritur duke ngushtuar diferencën për faturat e paarkëtuara. Gjithashtu është e dukshme se pjesa e kostos totale që mbulohet nga subvencionet është zvogëluar, por në të njëjtën kohë është rritur pjesa e kostos së mbetur të pa mbuluar. Pra vihet re se humbja financiare nga viti 2006 në 2012 është rritur duke evidentuar tendencën negative të sektorit nga pikëpamja financiare.


Grafiku 4.9 KTO për m³ ujë të prodhuar, shitur dhe çmimi mesatar



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Siç vëzhgohet në grafikun 4.9 rezulton se kosto e prodhimit ka trend rritës pra negative. Kosto totale e shitjes së ujit ka pësuar rritje deri në vitin 2008 dhe më pas rënie deri në vitin 2010 për t'u rritur përsëri në vitin 2011 dhe ulur në vitin 2012. Nisur nga fakti se çmimet janë akoma shumë të ulta e larg kostos së shitjes përsëri ecuria e tyre ka një trend pozitiv, pasi çmimi mesatar është rritur ndërkohë që është zvogëluar diferenca ndërmjet çmimit dhe kostos së shitjes. Situata më e keqe përsa i përket kostos së shitjes paraqitet në vitet 2011-2012 e cila është rritur, por po të shohim çmimin mesatar ai është rritur ndjeshëm nga viti 2010 duke ngushtuar diferencën ndërmjet tyre në vitin 2011, ndërsa më e pafavorshme paraqitet situata në vitin 2012 ku kjo diferencë është rritur ndjeshëm.

Grafiku 4.10 Cilësia e shërbimit



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Një aspekt i rëndësishëm i performancës është menaxhimi i burimeve njerëzore dhe cilësia e shërbimit. Grafiku i mësipërm 4.10 pasqyron trendin pozitiv të shtimit të orëve mesatare të furnizimit me ujë që është rritur nga 8.9 orë në 2006 në 11 orë në 2012. Megjithë trendin pozitiv për këtë tregues, në nivel mesatar sektori është akoma shumë larg standartit ndërkombëtar prej 24 orë/ditë. Po kështu treguesi i numrit të stafit për 1000 lidhje ka ardhur duke rënë përveç dy viteve të fundit ku ka një rritje mesatare.

Të gjithë indikatorët e analizuar më sipër pasqyrojnë ecurinë e performancës së sektorit të UK në Shqipëri. Siç shihet nga grafikët mjaft indikatorë janë përmirësuar, por disa

prej tyre janë larg standarteve ndërkombëtare të përcaktuar. Analiza historike e tendencës për 2006-2010 e kryer nga njësia për monitorimin e të dhënave dhe benchmarking për sektorin e UK kanë shërbyer në përcaktimin e prognozës së sektorit deri në vitin 2017.

Përmirësimi i performancës së sektorit përcaktohet si prioritet i Qeverisë Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017. Në këtë Strategji përcaktohen vizioni, objektivat dhe planet e veprimit në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore së bashku me përgjegjësitë për secilin institucion. Çdo vit njësia bën krahasimin e treguesve të performancës të arritur me ato të vendosura në strategji vit pas viti. Duhet theksuar se dokumenti i strategjisë është në mbështetje të plotë të procesit të decentralizimit.

Sipas strategjisë pesë janë objektivat kryesorë për përmirësimin e sektorit (Strategjia Kombëtare 2011-2017:20-25):

- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të UK;
- Orientimi i shoqërive të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostos;
- Përmirësimi i drejtimit dhe rregullimit të sektorit;
- Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit dhe;
- Progres drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat e BE-së.

Sipas këtyre objektivave ajo që synohet është që deri në vitin 2017 mbulimi me ujësjellës të jetë në nivelin 98% në zonën urbane dhe 85 % në zonën rurale, ndërsa kanalizimet për zonën urbane të jetë në nivelin 87% dhe për zonën rurale në nivelin 45%. Ndërsa përsa i përket mbulimit të kostos direkte të operimit ajo që synohet është që të mbulohen në nivelin 100% si me të ardhurat ashtu edhe arkëtimet.

Debati që zhvillohet sot për përmirësimin e performancës së sektorit është mundësia e bashkimit të disa shoqërive dhe krijimi i rajoneve në mënyrë që të përfitohet nga ekonomitë e shkallës. Kjo zgjidhje mbështetet nga Qeveria Shqiptare jo vetëm për të

permirësuar eficiencën e sektorit, por shihet si një mundësi për të tërhequr investitorët privatë në formën e partneriteteve publike private.

Rajonalizimi është një synim i Qeverisë Shqiptare i përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për sektorin 2011-2017. Në këtë strategji përcaktohen në mënyrë sasiore numri i shoqërive që pritet të bashkohen në mënyrë graduale vit pas viti. Konkretisht nga 57 shoqëri UK në vitin 2010 parashikohet të reduktohet në 26 në vitin 2017 (Strategjia Kombëtare, 2011-2017:39).

Si konkluzion, decentralizimi i shërbimeve të UK, natyra monopol e ujit dhe prezenca e shumë aktorëve në këtë sektor e bëjnë të nevojshme monitorimin e të dhënave dhe vlerësimin e performancës së sektorit. Analiza në pjesën e parë të këtij kapitulli mori në konsideratë vlerësimin krahasues të treguesve të performancës së sektorit për periudhën 2006-2012 dhe ndihmoi për të kuptuar performancën e sektorit në tre aspekte kryesore: teknike, financiare dhe menaxhimit të cilësisë. Sfida për politikbërësit mbetet gjetja e mënyrave për të rritur eficiencën e shoqërive UK. Ekzistojnë mjaft studime për sektorin e UK, por pak studime përqëndrohen në eficiencën e shoqërive të UK. Ky observim qëndron në kontrast po të kemi parasysh rëndësinë e sektorit për zhvillimin ekonomik dhe mirëqënien sociale dhe lidhjen e këtij sektori me sektorë të tjerë si shëndetësia, bujqësia dhe energjia.

Në këtë kapitull u analizuan 6 indikatorë të performancës që kanë më shumë rëndësi në situatën financiare të shoqërive të UK në Shqipëri. Studimi nxorri në pah se shumica e shoqërive të UK nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot operative si pasojë e disa faktorëve: tarifat e ulëta, arkëtim i ulët i faturave, niveli i lartë i ujit të pafaturuar dhe eficientia e përgjithshme e mangët. Tendenca për periudhën 2006-2012 tregoi një përmirësim të indikatorëve dhe performancës së sektorit, por ende mbetet larg standarteve ndërkombëtare.

Duke qënë se sektori i UK ka rëndësi për politikën publike të Shqipërisë kjo rrit interesin që të ketë studime më përfshirëse të performancës. Në këtë drejtim benchmarking mund të ndihmojë për të adresuar dhe vlerësuar zgjidhjet e mundshme të

sektorit, siç është bashkimi i shoqërive dhe krijimi i rajoneve për realizimin e ekonomive të shkallës. Seksioni në vijim do të analizojë eksperiencën pozitive të performancës së shoqërive të UK në Shqipëri dhe së fundmi seksioni që vijon do të shqyrtojë arsyet se përse rajonalizimi mbetet një nga mënyrat e zgjidhjes së problemit të efikasitetit të shoqërive dhe të sektorit në tërësi.


4.11 Eksperiencën pozitive të performancës së SHUK-ve në Shqipëri

Analiza e performancës së sektorit tregoi se performanca në nivel sektori paraqitet larg standarteve ndërkombëtare. Megjithatë ekzistojnë eksperiencën pozitive në nivel shoqërie. Sikurse u përmend një ndër përfitimet e monitorimit të të dhënave dhe benchmarking është renditja e shoqërive sipas performancës së tyre. Rastet pozitive të performancës janë mësimet për shoqëritë që performojnë më mirë dhe nxitje për përmirësimin e situatës së tyre financiare. Në këtë seksion do të paraqesim rastet e dy shoqërive që kanë performancë të mirë financiare: Korça dhe Pogradeci.

Shoqëria Ujësjellës -Kanalizime Pogradec

Pogradeci është një qytet turistik në juglindje të Shqipërisë, buzë liqenit të Ohrit me një popullsi prej 58,603 banorë në juridiksionin e shoqërisë, nga të cilët marrin furnizimin me ujë 58,141 ose 99% e popullsisë dhe shërbimet e kanalizimeve 43,884 banorë ose 75% e popullsisë⁴⁵. Ecuria e disa prej indikatorëve paraqitet si në grafikët në vijim:

Grafiku 4.11 Stafi për 1000/lidhje




Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

⁴⁵ www.dpuk.gov.al

Sipas grafikut 4.11, stafi/1000 lidhje ka patur tendencë zbritjeje deri në vitin 2010 për t'u rritur në 2011 dhe për të rënë përsëri në vitin 2012. Tendenca e këtij indikator është e lidhur me numrin e lidhjeve ujësjellës dhe kanalizimeve, të cilat kanë ardhur duke u rritur deri në vitin 2011, por një trend rënës konstatohet në vitin 2012 (nga 95% në vitin 2011 në 92% në vitin 2012). Në kushtet e Shqipërisë ky indikator konsiderohet pozitiv po të marrim parasysh shifrën e lartë që rregjistrohet për shoqëritë e tjera ku kjo shifër është tepër e lartë psh. 38 në Gjirokastrë Fshat, apo 25 në Patos etj.


Grafiku 4.12 Niveli i matjeve dhe uji pa të ardhura



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.12 tregon qartë se me rritjen e përqindjes së lidhjeve me ujëmatës, ulet niveli i ujit pa të ardhura. Vendosija e matësave ndikon në kontrollin e konsumit të ujit dhe si rrjedhojë në uljen e humbjeve.


Grafiku 4.13 Mbulimi KDO me ardhura/arkëtime/subvencione



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.13 pasqyron tendencën rritëse të përqindjes së mbulimit të KDO me të ardhura dhe arkëtime. Siç duket nga grafiku shoqëria duke filluar nga viti 2009 arrin të mbulojë plotësisht koston direkte operative si me të ardhurat ashtu dhe arkëtimet. Kjo tregon se niveli i faturimeve përputhet me atë të arkëtimeve duke dalë në konkluzionin se ka efikasitet në drejtim të menaxhimit. Kjo tendencë pozitive e mbulimit të koston është një sinjal pozitiv për financat e vendit, pasi që nga viti 2010 subvencionet kanë arritur në nivelin zero.

Grafiku 4.14 Kohëzgjatja e furnizimit orë/ditë




Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.14 tregon se ky indikator tregon një përmirësim të performancës që shfaqet në zgjatjen me orë/ditë të furnizimit me ujë. Tendenca është pozitive po të krahasojmë se në vitin 2006 orët mesatare të furnizimit me ujë ishin vetëm 5.4 dhe në vitin 2012 ka arritur në 21. Kjo është rezultat i shumë faktorëve si teknikë ashtu dhe menaxherialë.

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Korçë

Korça është një qytet turistik në juglindje të Shqipërisë, me një popullsi prej 87,500 banorë në juridiksionin e shoqërisë, nga të cilët marrin furnizimin me ujë 87,500 banorë, pra 100 % e popullsisë dhe shërbimet e kanalizimeve 77,400 banorë ose 88 % e popullsisë⁴⁶. Ecuria e disa prej indikatorëve paraqitet si në grafikët në vijim:

Grafiku 4.15 Stafi për 1000/lidhje




Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Sipas grafikut 4.15, stafi/1000 lidhje ka tendencë mjaft pozitive duke qënë sa standarti ndërkombëtar me 2 persona/1000 lidhje. Tendenca e këtij indikator është e lidhur me përqindjen e lidhjeve me ujëmatës që është në nivelin 100 % për të gjithë periudhën e analizës.

⁴⁶ www.dpuk.gov.al


Grafiku 4.16 Niveli i matjeve dhe uji pa të ardhura



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.16 tregon se përqindja e lidhjeve me ujëmatës është në nivelin 100 % fakt ky tepër pozitiv. Ndërkohë uji pa të ardhura ka një trend rënës deri në vitin 2010 dhe më pas në dy vitet e fundit është rritur. Për të konkluduar në rezultate realiste, është e nevojshme të analizohet prodhimi krahasuar me shitjet. Të dhënat për të njëjtën periudhë tregojnë se niveli i prodhimit është tepër i lartë krahasuar me shitjet, që do të thotë se uji që faturohet për shitje është më pak nga ai i prodhuar duke shkaktuar këtë nivel të ujit pa të ardhura.

Grafiku 4.17 Mbulimi KDO me të ardhura/arkëtime




Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Ashtu si në rastin e shoqërisë UK Pogradec, grafiku 4.17 pasqyron tendencën pozitive të mbulimit të KDO me të ardhura dhe arkëtime. Ndonëse jo një trend rritës si në rastin e Pogradecit, përsëri shoqëria UK Korçë arrin të mbulojë plotësisht KDO me të ardhura dhe arkëtime.

Siç duket nga grafiku shoqëria ka patur një nivel të lartë të mbulimit të KDO në vitin 2008, i cili ka rënë deri në vitin 2011 për tu rritur përsëri në vitin 2012. Edhe në këtë rast niveli i faturimeve përputhet me atë të arkëtimeve duke dalë në konkluzionin se ka efizienzë në drejtim të menaxhimit. Subvencionet nga buxheti i shtetit janë zero.


Grafiku 4.18 Mbulimi KTO me të ardhura/arkëtime



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.18 tregon se mbulimi KTO me të ardhura dhe arkëtime ka patur një trend jo uniform nga viti 2008 deri në vitin 2012. Performanca më e mirë shfaqet në vitin 2008 ku mbulimi me të ardhurat është pothuaj 100 % dhe në vitin 2011 ndonëse jo në nivelet e vitit 2008. Performanca e mirë e mbulimit të KTO tregon se shoqëria arrin që me të ardhurat e saj të kryejë investime dhe të përballojë shpenzimet e amortizimit, apo të interesave bankare. Megjithatë shoqëria duhet të përmirësojë menaxhimin në drejtim të përmirësimit të mbulimit të KTO me të ardhura dhe arkëtime.

Grafiku 4.19 Kohëzgjatja e furnizimit orë/ditë



Burimi: Njësia e Monitorimit dhe Benchmarkut, Shqipëri, DPUK, Përpunimi autori

Grafiku 4.19 tregon se është arritur performanca sipas standarteve ndërkombëtare pasi qytetarët furnizohen 24 orë pa ndërprerje me ujë. Ky është rezultat i shumë faktorëve si teknikë ashtu dhe menaxherialë.

Në përfundim duke u nisur nga eksperiencat pozitive mund të nxjerrim disa konkluzione të cilat shërbejnë për shoqëritë me një performancë jo të kënaqshme:

- Ka një lidhje të drejtpërdrejtë të lidhjeve me ujëmatës dhe ujit pa të ardhura. Vendosja e matësave ndikon në kontrollin e konsumit të ujit dhe si rrjedhojë në uljen e humbjeve.
- Rritja e numrit të lidhjeve me ujëmatës dhe kanalizime çon në reduktimin e numrit të stafit/1000 lidhje, duke përmirësuar menaxhimin e shoqërisë.
- Është e nevojshme të rritet eficienca në menaxhimin e normës së arkëtimeve duke ngushtuar diferencën mes nivelit të faturimeve me arkëtimet. Kjo do të ndihmojë jo vetëm në mbulimin e kostove të shoqërisë, por do të jetë një sinjal pozitiv për financat e shtetit duke ulur masën e subvencionit.
- Në këtë analizë treguam vetëm aspektet teknike dhe financiare, por këto nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin e përmirësimit të performancës. Përmirësimi i menaxhimit duhet të shoqërohet edhe me investime të nevojshme në sistemet që jo vetëm do të përmirësojnë shërbimet, por do të ndikojnë në uljen e humbjeve, amortizimeve.

4.12 Përse rajonalizim të shoqërive të UK si zgjidhje për eficiencën e sektorit dhe nxitjen e partneritetit publik privat në Shqipëri?


Decentralizimi i ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimeve tek pushteti vendor ka ngritur sfida si në drejtim të menaxhimit ashtu dhe financimit. Këto vështirësi dhe përgjegjësitë e menaxhimit të ujit në nivel vendor reflektohen në ineficiencën e shoqërive të UK të pasqyruar nga indikatorët e performancës. Një çështje e debatuar mbi pjesëmarrjen e sektorit privat në sektorin e UK në vendet në zhvillim është eficienta e këtij sektori. Një element i rëndësishëm i eficiencës, që është edhe një ndër përfitimet që vijnë nga PPP-të është arritja e ekonomive të shkallës.

Sikurse u paraqit në kapitullin 3 qëllimi i bashkimit të SHUK është për të ndarë së bashku kapacitetet teknike, financiare dhe operationale. Sipas Whitlatch & ReVelle (1990:70-80) rajonalizimi përshkruhet si bashkimi i strukturave administrative, ekonomike, sociale për të përmirësuar objektivat kombëtare, rajonale dhe lokale të shoqërisë. Shqipëria po zbaton Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me objektivin final për t'u bërë pjesë e Bashkimit European. Në kuadër të përafrimit me Bashkimin European lind e nevojshme zvogëlimi i numrit të rajoneve nga 12 në 6 ose edhe në 4, të cilat do të duhet të merren në konsideratë dhe të trajtohen nga modeli që do të propozohet. Rajonalizimi kërkon investime të mëdha dhe financimi vetëm nga Qeveria do të jetë i vështirë. Nga ana tjetër rajonalizimi mund të jetë një mënyrë tërheqëse për investitorët e huaj në formën e partneritetit publik privat me argumentin kryesor të realizimit të ekonomive të shkallës. Nisur nga pronësia e shoqërive nga njësitë e pushtetit vendor sfida mbetet të gjendet forma e përshtatshme e PPP-ve në këtë sektor që do të bashkonte interesat e të dyja palëve.

Në Shqipëri nga 57 shoqëri aktive në total sipas vitit 2012, 42 prej tyre i shërbejnë një popullsie më pak se 50,000 banorë dhe nga këto shoqëri 30 i shërbejnë një popullsie më pak se 22,000 banorë, çka tregon se ka një mungesë të theksuar të “ekonomive të shkallës”. Përveç kësaj ajo që vihet re është se gjatë 15 viteve të fundit ka migracion drejt zonave urbane duke sugjeruar se ekzistojnë mundësi për ekonomi të shkallës.

Madhësia e popullsisë së shërbyer përbën diferencën dhe si një rregull i përgjithshëm ofrimi i shërbimeve një popullsie mbi 100,000 është atje ku fillojnë të shfaqen përfitimet e ekonomisë së shkallës. Sipas të dhënave për vitin 2012 të gjitha shoqëritë në total i shërbejnë një popullsie prej rreth 2.5 milionë banorë. Në seksionin në vijim paraqitet numri i shoqërive sipas grupeve të popullsisë së shërbyer.

Grafiku 4.20 Numri i Shoqërive sipas Pop. së Shërbyer/Mesatare e ponderuar sipas grupimit të shoqërisë



Burimi: Databaza e të dhënave nga Programi i Monitorimit dhe Benchmark, 2012 , përpunimi autori

Ashtu siç sugjeron Tynan dhe Kingdom në analizën e bërë për 270 kompani të ujësjellës kanalizimeve për 33 vende, madhësia optimale për kompanitë është më e ndjeshme ndaj karakteristikave të konsumatorit sesa të ujit të prodhuar. Këto rezultate dhe përfundime mbështesin edhe rastin e Shqipërisë sipas analizës së bërë në vijim. Për të vërtetuar këtë kam analizuar 3 indikatorë të performancës që kanë ndikim në qëndrueshmërinë financiare të një shoqërie tipike të ujit. Këta indikatorë u llogaritën duke përdorur të dhënat nga Programi Benchmarking për monitorimin e performancës së sektorit të UK për vitin 2012. Këta indikatorë janë:


- Numri i stafit për 1000 lidhje U&K;
- Kosto totale operative për m³ ujë të prodhuar dhe shitur;
- Kosto direkte operative bazuar në të ardhurat dhe arkëtimet.

Të dhënat u llogaritën mbi bazën e mesatares së ponderuar sipas grupeve të shoqërive duke përdorur kriterin “popullsia totale e shërbyer” si bazë të ndërtimit të shkallës.

Indikatori i eficiencës së stafit të punësuar për 1000 banorë i paraqitur në grafikun 4.21 tregon për një përmirësim të eficiencës në numrin e stafit me rritjen e popullsisë që i shërbehet. Kjo është e evidente pasi një rritje në popullsinë e shërbyer normalisht lidhet me rritjen e dendësisë së popullsisë, e cila ndikon direkt në eficiencën e stafit.

Grafiku 4.21 Stafi për 1000 lidhje

Mesatare e ponderuar sipas grupimit të shoqërive




Burimi: Databaza nga të dhënat e Njësisë së Monitorimit dhe Benchmarkut, DPUK, 2012

Përpunimi nga autori

Siç mund të shihet nga grafiku 4.22 megjithëse ekonomia e shkallës nuk është aq e evidente sa ajo që lidhet me eficiencën e forcës së punës, diferencat gjithsesi ekzistojnë. Konkretisht po të shohim raportin e shkallës së humbjes ndaj kostos totale operative për m³ ujë të shitur ky raport për grupin >100,000 është përmirësuar në 68% kundrejt dy grupeve të tjera.

Grafiku 4.22 KTO për m³ ujë të shitur dhe prodhuar


Mesatare e ponderuar sipas grupimit të shoqërive



Burimi: Databaza nga të dhenat e Njësise së Monitorimit dhe Benchmarkut, DPUK, 2012, përpunimi nga autori

Deri tani është trajtuar efienca lidhur me punën dhe çështjen e kostos për njësi të ujit, por ajo që mbetet është të analizohet gjenerimi i flukseve për të paguar për të. Grafiku 4.23 konsideron “Raportin e mbulimit të Kostos Direkte Operative” si një përqindje të të ardhurave (totali i shumave të faturuar klientit) dhe arkëtimeve (totali i shumave të arkëtuara nga të gjithë konsumatorët). Siç duket nga grafiku shoqëritë më të mëdha fatojnë një përqindje më të lartë të kostove të tyre direkte operative dhe mbulojnë nëpërmjet arkëtimeve një përqindje më të lartë të kostove të tyre direkte operative.

Grafiku 4.23 Mbulimi i KDO me të ardhurat&arkëtimet/Mesatare e ponderuar sipas grupimit të shoq.



Burimi: Databaza nga të dhenat e Njësise së Monitorimit dhe Benchmarkut, DPUK, 2012, përpunimi nga autori

Fakti që shoqëritë më të vogla nuk arrijnë të faturojnë shuma të mjaftueshme për të mbuluar kostot direkte operative mund të shpjegohet me faktin se kostot e tyre për njësi të prodhimit janë të tilla që ato nuk mund të faturojnë klientët e tyre për shumat e plota.

Si përfundim, ky seksion analizoi nëse ekzistojnë kushtet në Shqipëri për të konsideruar rajonalizimin. Shumë studime të mëparshme ekonometrike kanë arritur në përfundimin se ekonomitë e shkallës ekzistojnë kur numri i lidhjeve me matës, ose popullsia e shërbyer përdoret si indikator për madhësinë e kompanisë. Në rastin e Shqipërisë studimi mori në konsideratë të gjitha shoqëritë në total 58 për vitin 2012 dhe u evidentua fakti se shumica e shoqërive i shërbejnë një numri më pak se 50,000 banorë. Ky fakt tregon se ekzistojnë argumenta të forta për ekzistencën e ekonomive të shkallës. Duke llogaritur tre indikatorët e performancës me metodën e mesatares së ponderuar u arrit në konkluzionin se një rritje në numrin e popullsisë që i shërbehet do të lidhet me rritjen e dendësisë së popullsisë, e cila ndikon direkt në arritjen e ekonomive të shkallës.

Meqenëse shoqëritë e mëdha arrijnë të sigurojnë eficiencën, në vijim do të analizojmë rastet e dy shoqërive rajonale siç janë Durrësi dhe Tirana.

4.13 Tendenca e performancës së shoqërive rajonale: Durrës dhe Tiranë

SHUK Durrës

Më herët në këtë punim u përmend fakti se në Shqipëri transferimi i pronësisë së shoqërive të UK tek njësitë e pushtetit vendor ka përfunduar në masën 94% deri në vitin 2012 që lidhet me rastin e shoqërisë së UK Durrës. Për nga pikëpamja e rajonalizimit është e rëndësishme të analizohet rasti i shoqërisë UK Durrës si kompani rajonale. Shoqëria UK Durrës operon në një zonë shërbimi që shtrihet në 500 km² dhe mbulon 500'000 banorë duke mbuluar 72% të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit (Raporti Vjetor, 2011:1-20). Shoqëria është një shoqëri aksionere ku aksionerët janë të përfaqësuar nga njësitë vendore: Bashkia e Durrësit, Bashkia e Vorës, Bashkia e Sukthit, Bashkia e Manzës dhe komunat: Thumanë, Ishëm, Xhafzotaj, Rrashbull, Katund i Ri, Prezë e Fushë-Kuqe. Ndonëse është shoqëri aksionere aktualisht njësitë

vendore pronare janë në procesin e institucionalizimit të strukturave drejtuese të shoqërisë, si Asambleja e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë (Raporti Vjetor, 2011:1-20).

Për të kuptuar arsyet e mostransferimit të aseteve deri në vitin 2012 zhvillova një intervistë me shefen e sektorit të monitorimit të buxhetit pranë Ministrisë së Brendshme. Sipas Zj. Damnori në kuadër të decentralizimit dhe ligjit për transferimin e aksioneve të shoqërive të NJQV në 12 qarqet është bërë kapitalizimi i pasurisë në kushtet kur NJQV sipas ligjit bëhen pronarë të shoqërive. Në rastin e Bashkisë Durrës ka patur problem në drejtim të inventarizimit të kapitaleve kryesisht për investimet e reja pasi kontratat nuk ishin të besueshme. Kontabilizimi nuk reflektonte të dhëna të besueshme përfshirë edhe donacionet nga investitorët, pasi ato janë dhënë në formën e sponsorizimeve, të cilat nuk janë reflektuar në kontabilitet. Në këto kushte Bashkia Durrës mbarte rrezikun për të qënë aksioner për një vlerë kontabile më të vogël nga ç'ishte në të vërtetë. Aktualisht, transferimi i aseteve të SHUK Durrës ka përfunduar.

Sipas Drejtorit të shoqërisë UK Durrës, bashkitë nuk kanë zbatuar ligjin për kalimin e aseteve nga pushteti qendror në pushtetin vendor ku vlen të përmendet fakti se Bashkia Durrës ka përqindjen më të lartë të aseteve. Shoqëria UK Durrës ndonëse është një shoqëri rajonale është ende larg autonomisë financiare siç e tregojnë treguesit e performancës. Seksioni në vijim pasqyron ecurinë e këtyre treguesve. Shoqëria ka një normë arkëtimi të përgjithshme 81.21% në vitin 2012 nga të cilat: 81.96% nga konsumatorët familjarë, 71.77% nga institucionet private dhe 120.25% nga institucionet publike. (DPUK, 2012)⁴⁷. Mbulimi me ujësjellës në përgjithësi është në nivelet e 79.09 % ndërkohë që mbulimi me kanalizimet është 52.84 %. Mbulimi i kostove direkte operative me të ardhurat është në nivelin 62.7% në vitin 2012, ndërsa mbulimi i kostove totale 57.53%.

Uji që nuk sjell të ardhura është në nivele të larta 68.04 % në vitin 2012. Një pikë ndërkombëtare reference për ujin e papaguar është shifra prej 25%, çka na bën të arrijmë në konkluzione që megjithëse shoqëria UK Durrës është një shoqëri rajonale do

⁴⁷ Treguesit për periudhën 2008-2012 për shoqërinë UK Durrës
http://www.dpuk.gov.al/ndermarre_info_txt.php?id=966&idn=14

të ishte e pamundur të arrihej autonomia financiare. Orët e furnizimit me ujë janë në nivele të ulta mesatarisht 6.21 orë/ditë. Numri i stafit për 1000 lidhje është në nivele të kënaqshme rreth 4 punonjës për 1000 lidhje krahasuar me nivelin ndërkombëtar që është 2 punonjës për 1000 lidhje. Ndërprerja e furnizimit me ujë është veçanërisht më e zakonshme në zonat bregdetare ku numri popullsisë gjatë sezonit turistik shkon deri në 400'000 banorë. Disa nga treguesit kryesorë të performancës së kompanisë për vitet 2008-2012 paraqiten në tabelën e mëposhtme. Të dhënat krahasohen me standartin e ERRU sipas të cilit vlerësohen shoqëritë dhe klasifikohen ç' do vit.

Tabela 4.3 Situata financiare e shoqërisë UK Durrës për periudhën 2008-2012

Treguesi	2008	2009	2010	2011	2012	Standarti ERRU
Mbulimi i Furnizimit me Ujë (%)	53.2	79.0	70.1	72.6	79.09	80
<i>Urbane</i>	64.1	90.1	74.7	82.8	89.29	91
<i>Rurale</i>	39.2	53.4	58.6	45	51.43	60
Mbulimi me Kanalizime	35.9	25.2	48.7	48.8	52.84	
<i>Urbane</i>	35.9	25.2	48.7	48.8	52.84	83
<i>Rurale</i>	0	0	0	0	0	11
Uji qe nuk sjell të ardhura (%)	70.2	73.9	64.3	66.5	68.04	30
Lidhje me matës %	34.6	35.3	34.9	64	63.86	85
Staf për 1000 lidhje	4.2	4.2	4	4.8	4.66	4
Orët e Furnizimit me Ujë	2	2	6.6	5.1	6.21	24
Norma e arkëtimit %	58.9	53.6	60.9	74.8	81.21	> 80 %
Mbulimi i kostos direkte operative (ark& sub)	86.5	57.1	149.5	42.9	116.1	100
Mbulimi i kostos totale operative (ark&sub)	61.7	58.8	61.9	55.2	57.53	80
Plotësimi i Standartit të Cilësisë së Ujit: Klori mbetës	100	98.7	90.4	90.7	88.91	95

Burimi: DPUK, Njësia e Monitorimit dhe e Benchmarkut

Sikurse shihet nga tabela mjaft tregues janë larg standartit të vendosur nga ERRU për performancën e sektorit. Për të kuptuar arsyet që çojnë në një performancë jo të kënaqshme kam zhvilluar intervistë me Drejtorin e shoqërisë UK Durrës dhe njëkohësisht kryetari i Shoqatës së shoqërive të UK, përmbledhja e çështjeve të diskutuara paraqitet si në vijim:

1. Zhvillim i pakontrolluar urban dhe peri-urban dhe çështja e tarifave

Në rrethin e Durrësit ekziston fenomeni i migrimit të pakontrolluar të popullsisë nga zonat e tjera të Shqipërisë. Në këto kushte shoqëria UK Durrës mund të mos mbulojë me rrjet të gjithë zonën e shërbimit prej rreth 500 km². Zhvillimi urban është shumë specifik sepse është i pakontrollueshëm përmendim këtu zonën e Gjirit të Lalzit. Përpara zonat problematike kanë qënë ato të Kënetës dhe Shkozetit. Zona e kënetës është e mbuluar me ujë të pijshëm, por jo me kanalizimet. Zhvillimi urban i pakontrolluar vihet re edhe brenda qytetit të Durrësit, psh. te kodra e Durrësit zonë në të cilën ka majft ndërtime dhe çdo ditë vendosen familje të reja që kërkojnë furnizimin me ujë. Kontratat për furnizimin me shërbimet e UK rriten me mbi 10,000 për rreth 40,000 banorë, të cilat çojnë në rritjen e nevojave për investime dhe në këto kushte në rritjen e abuzivitetit. Problematike mbetet mos bashkëpunimi i shoqërisë UK Durrës me Bashkinë për planin urban, apo për çështje të tjera. Po kështu në kushtet kur lidhjet ilegale nuk dënohen, shoqëria përpiket të përshtatet me situatën që ekziston për t'i ofruar qytetarit shërbim më të mirë që të justifikojë rritjen e tarifës. Miratimi i tarifës së ujit nuk ndjek të njëjtën rrugë si në rastin e shoqërive asetet e të cilave u janë transferuar NJQV-ve. Konkretisht, pasi bëhet vlerësimi i kostove reale të çmimit të ujit dhe pasi bëhet propozimi nga shoqëria atëherë i çohet për mendim këshillit të qarkut (vetëm 400,000 banorë furnizohen me ujë dhe kjo bie në juridiksionin e këshillit të qarkut), i cili shprehet në mënyrë pozitive ose jo. Më pas kërkesa i drejtohet ERRU.

2. Mungesa e Investimeve

Rrjeti i ujësjellësit të Durrësit është ndërtuar në vitin 1970 periudhë kur Durrësi kishte 30,000 banorë dhe që prej asaj periudhe nuk ka patur ndonjë investim tjetër. Në total për 23 vjet është investuar rreth 60 \$/ frymë, ndërkohë që është qyteti i fundit në Shqipëri

për investimet në ujësjellës. Po të marrim si shembull rastin e Korçës në shoqërinë UK Korçë është investuar 2300 Euro/frymë pra rreth 50 herë më shumë investime. Në Durrës ka rrjet krejtësisht të amortizuar, abuzivizëm dhe gjithmonë është investuar për të rehabilituar rrjetin ekzistues. Problemi kryesor është migrimi i popullatës ku kanë ardhur mbi 100,000 banorë dhe ndërkohë ky proces nuk është shoqëruar me investime. Mungesa e investimeve është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në performancën e shoqërisë, por ndërkohë ka edhe arsye të tjera që kanë ndikuar në këtë performancë siç janë çështjet menaxheriale, kualifikimi jo i duhur i stafit, si dhe mosbashkëpunimi me pushtetin lokal.

Atëherë shtrohet pyetja se përse donatorët nuk financojnë? Sipas ish drejtorit të shoqërisë kjo është një çështje interesi. Aktualisht janë përfunduar procedurat për një projekt të Durrësit me Bankën Botërore për një financim rreth 85 milionë US\$, i cili është miratuar nga Banka Botërore në Dhjetor 2013⁴⁸. Ky projekt do të garantojë 100% furnizimin me ujë për 24 orë si dhe rehabilitimin e kanalizimeve, të cilat ishin projektuar për një numër popullsie prej 30,000-40,000 banorë.

Shoqëria UK Tiranë

Zona e shërbimit të shoqërisë së UK Tiranë përfshin Bashkinë e Qytetit të Tiranës me një popullsi rreth 848,750 banorë për vitin 2012 që jetojnë në zonën e juridiksionit plus 15 komuna Bashkinë e Kamzës dhe Bashkinë Vorë, e cila ndonëse nuk furnizohet nga UK Tiranë është pronar i aseteve të shoqërisë. Shoqëria arrin të sigurojë furnizimin me ujë për 828,200 banorë ose 97.5 % dhe lidhjet me sistemin e kanalizimeve për 655,000 banorë ose 76 % (DPUK, 2012)⁴⁹.

Aksioneri kryesor i shoqërisë së UK Tiranë është Bashkia Tiranë me 72.5% të aksioneve dhe pjesa tjetër e pronësisë ju përket komunave, Bashkisë së Kamzës dhe Bashkisë Vorë sipas rregullit të madhësisë së popullsisë së shërbyer. Proçesi i transferimit të aksioneve ka përfunduar në vitin 2011 dhe në zbatim të VKM 660 për

⁴⁸ <http://www.worldbank.org/projects/P102733/water-sector-investment-project?lang=en>

⁴⁹ Treguesit e performancës për shoqërinë UK Tiranë 2008-2012
http://www.dpuk.gov.al/ndermarrije_info_txt.php?id=1010&idn=15

transferimin e aseteve të pushtetit vendor, në rastin e Bashkisë Tiranë ky transferim u krye me vonesë.

Sipas ekspertit në fushën e ujit Z. Arben Bakllamaja kjo rezistencë nga ana e Bashkisë Tiranë kishte të bënte me aspektin ligjor që e ka bazën në ligjin për shoqëritë tregtare. Konkretisht, Këshilli Mbikqyrës i Bashkisë së Tiranës zgjedh Bordin Mbikqyrës të shoqërisë që është autoriteti kryesor për miratimin e planit të biznesit dhe përcaktimin e tarifave që më pas i kalojnë ERRU për miratim. Këshilli Bashkiak duke patur në përbërje anëtarë të forcave të ndryshme politike mund të dominohet nga një parti dhe vendimmarrja mund të jetë më tepër politike. Nga ana tjetër, Kryetari i Bashkisë ka përgjegjësinë kryesore para qytetarëve të saj lidhur me cilësinë e shërbimeve dhe transparencën në përdorimin e fondeve dhe në këtë kuadër vendimmarrja nga ana e Këshillit Bashkiak mund të kompromentojë autoritetin e nevojshëm që Kryetari i Bashkisë duhet të ketë si përgjegjësi kryesore përpara qytetarëve të saj.

Ndërkohë sipas Drejtorit të Punëve Publike pranë Bashkisë së Tiranës Z. Taulant Zenelaj, arsyeja e vonesës në marrjen e pronësisë nga Bashkia Tiranë ka qenë politike. Kjo pasi Kryetari i Bashkisë i asaj periudhe kërkonte që pronësia nga ana e Bashkisë së Tiranës të ishte vetëm për pjesën e qytetit të Tiranës dhe jo për komunat. Ky vendim binte në kundërshtim me vetë strukturën e ujësjellësit pasi qyteti i Tiranës furnizohet nga disa burime dhe në këtë kuadër është e vështirë të fragmentohet pronësia. Për më tepër që efektiviteti i ujësjellësit arrihet kur i shërbehet një numri të madh konsumatorësh dhe kostoja do të ishte më e ulët si rezultat i ekonomisë së shkallës.

Disa nga treguesit kryesorë të performancës së shoqërisë për vitet 2008-2012 paraqiten në tabelën e mëposhtme. Kollona e fundit është standarti i ERRU sipas të cilit vlerësohen shoqëritë dhe klasifikohen ç’do vit.

Tabela 4.4 Situata financiare e shoqërisë UK Tiranë për periudhën 2008-2012

Treguesi	2008	2009	2010	2011	2012	Standarti ERRU
Mbulimi i Furnizimit me Ujë (%)	90.3	90.2	91.8	91.7	100	80

Urbane	100	100	100	100	100	91
Rurale	61.6	61.3	61.4	59.9	100	60
Mbulimi me Kanalizime	74.6	74.6	78.8	79.4	76.2	
Urbane						83
Rurale						11
Uji që nuk sjell të ardhura (%)	76.1	72.8	57.5	56.3	68.23	30
Lidhje me matës %	57.4	59.9	62.2	65.6	70.21	85
Staf për 1000 lidhje	3.9	3.9	3.9	3.7	3.57	4
Orët e Furnizimit me Ujë	10.3	12.2	11.8	11.1	11.32	24
Norma e arkëtimit %	86.3	76.3	93.6	86.7	109.5	> 80%
Mbulimi i kostos totale operative	92.6	98.8	155.9	157.7	167.9	100
Mbulimi i kostos totale U&K	83.2	88.5	98.1	110.8	103.46	80
Plotësimi i Standartit të Cilësisë së Ujit: Klori mbetës	100	99.9	100	100	100	95

Burimi: DPUK, Njësia e Monitorimit dhe e Benchmarkut

Sikurse shihet nga tabela e mësipërme treguesit e performancës në shumicën e tyre tregojnë për një situatë të stabilizuar financiare. Konkretisht, të gjithë qytetarët në zonën e juridiksionit të shoqërisë arrijnë të ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë në masën 100% si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Mbulimi me kanalizime është ende larg standartit të vendosur nga ERRU. Uji që nuk sjell të ardhura është në nivele të larta prej 68% krahasuar me standartin ERRU prej 30%. Normalisht duke u nisur nga indikatori i përqindjes së lidhjes me ujëmatës uji pa të ardhura duhej të ndiqte një tjetër tendencë, por shkak për këtë mund të jetë prodhimi i lartë krahasuar me shitjet që na çon në konkluzionin se sasia e ujit që futet në sistem për faturim është më e ulët sesa ajo që prodhohet.

Norma e arkëtimit për atë sasi uji që faturohet është në nivele të kënaqshme dhe po kështu shoqëria arrin të mbulojë si kostot totale operative ashtu dhe koston totale. Pra

shoqëria është një shoqëri fitimprurëse, por sfida që mbetet është të menaxhojë si duhet burimet ujore duke kombinuar prodhimin me shitjet. Po kështu sfidë mbetet shtrirja e kanalizimeve dhe rritja e përqindjes së popullsisë që të ketë akses në këtë lloj shërbimi.

Sipas intervistës së zhvilluar me Drejtorin e Punëve Publike Z. Taulant Zenelaj uji pa të ardhura ka ardhur duke rënë nga 80% ka shkuar në 68.23% shifër kjo ende e lartë. Arsyet e kësaj shifre janë lidhjet e paligjshme dhe mungesa e matësave. Por është pozitive fakti që shoqëria arrin të sigurojë fitim, një pjesë të të cilit e përdor për investime.

Sikurse u përmend më sipër shoqëria UK Tiranë ndeshet me problemin e arkëtimeve të ulta në disa komuna veçanërisht zonat e fshatit. Në këto kushte pamundësia e arkëtimeve ushtron presione për qytetarët e Tiranës, të cilët përmes skemës së subvencionit të kryqëzuar duhet të paguajnë një tarifë më të lartë. Sipas ekspertit në fushën e ujit Z. Bakllamaja ky fakt ka qenë një tjetër arsye nga Bashkia e Tiranës për të mos marrë pronësinë sepse ata konsiderojnë një ndarje të pabarabartë të përgjegjësi, e cila mund të shoqërohet me një subvencion të kryqëzuar, ku qyteti paguan më shumë dhe fshati më pak. Në këto kushte Bashkia Tiranë ka preferuar të jetë përgjegjës vetëm për zonën që i shërben Tiranës.

Sipas Drejtorit të Punëve Publike pranë Bashkisë së Tiranës Z. Taulant Zenelaj qytetari i Tiranës jo domosdoshmërisht paguan një tarifë më të lartë për të subvencionuar mosarkëtimin nga zonat rurale. Zonat rurale kanë një tarifë më të ulët kryesisht sepse janë më pranë burimeve të ujit dhe si rezultat kostoja për shërbimin e ofruar është më e ulët. Bashkia Kamëz dhe komunat kanë nevojë për investime për të rritur aksesin me ujë të pijshëm dhe kanalizime. Pushteti qendror duhet të gjejë një zgjidhje për të ndihmuar këto shoqëri.

Trajtimi i dy shoqërive të UK perkatësisht Tiranë dhe Durrës ishte i rëndësishëm për të parë performancën e tyre si shoqëri rajonale, të quajtura si të tilla nisur nga numri i madh i popullsisë së shërbyer. Nga të dhënat e treguesve të performancës të dyja shoqëritë në mjaft tregues janë pozitive dhe arrijnë të mbulojnë kostot dhe sigurojnë

fitim. Arsyet janë numri i madh i popullsisë së shërbyer dhe ekzistencës së tre llojeve të kategorive të klientëve: konsumatorë familjarë, institucione publike dhe private, veçanërisht në Tiranë ku janë të përqëndruara numri më i madh i insitucioneve publike dhe private. Në një pamje të përgjithshme, krijohet përshtypja se të dyja këto shoqëri janë shembuj pozitive, por po të analizohen elemente të veçantë si uji pa të ardhura, apo cilësia e ujit, atëherë ky konstatim mund të mos jetë plotësisht i vërtetë.

4.14 Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e UK


Financimi nga donatorët bilateralë dhe multilateralë është burimi kryesor i investimeve në sektorin e UK në Shqipëri. Në një vend si Shqipëria ku mjetet e financimit nga pushteti qendror janë të kufizuara, roli i donatorëve ka qenë vendimtar jo vetëm për ngritjen e kapaciteteve dhe kryerjen e reformave, por dhe në sigurimin e financimeve të investimit. Karakteristikë e donatorëve në përgjithësi në Shqipëri dhe jo vetëm në sektorin e UK është kombimini i investimeve me fonde për ngritjen e kapaciteteve, pasi vetëm burimet financiare nuk mund të japin efektet e tyre pa u siguruar që këto fonde do të menaxhohen në mënyrën e duhur.

Në këtë seksion do të jepet situata e financimeve nga donatorët bilateralë dhe multilateralë për periudhën 2000-2012. Analizimi i të dhënave vetëm për këtë periudhë nuk nënkupton faktin se financimet kanë filluar nga viti 2000. Financimet e donatorëve në sektorin e UK kanë filluar me herët, por kanë qenë të fragmentuara dhe pasqyrimi i tyre veç e veç mund të mos tregonte situatën reale të financimeve në sektor. Me ngritjen e Departamentit për Koordinimin e Donatorëve në Këshillin e Ministriave, financimet e të gjithë donatorëve në të gjithë sektorët janë të koordinuara që të sigurojnë përputhjen me:

- (i) Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013;
- (ii) Programin Buxhetor Afatmesëm 2013-2016;
- (iii) Buxhetin vjetor të Shtetit;
- (iv) Programin e Aderimit të Shqipërisë në BE dhe objektivat strategjike të NATO-s.


Në këtë kuadër, të dhënat ekzistuese për financimin e donatorëve janë të konsoliduara për periudhën e analizuar 2000-2012. Në pjesën e parë të këtij seksioni analizohet tendenca e financimeve nga të gjithë donatorët, ndërsa në pjesën e dytë të seksionit paraqitet eksperiencia e projekteve gjermane të KfW të zbatuara në formën e PPP-ve në sektorin e UK. Sipas çështjeve të analizuar analizës do t'i shtohen edhe gjetjet nga intervista e zhvilluar me Z. Bledar Dollaku, Kordinatori kryesor për projektet e KfW-së. Ndonëse ishte parashikuar intervistë me përfaqësuesin e Bankës Botërore, kjo nuk u bë e mundur. Totali i fondeve të angazhuara nga të gjithë donatorët për sektorin për periudhën 2000-2012 është 662.98 milionë Euro nga ku niveli i disbursimeve për këtë periudhë është 354.16 milionë Euro ose 54%. Financimi nga KfW-ja për sektorin në periudhën 2000-2012 është 277,7 milionë Euro, ndërsa niveli i disbursimeve është 153,9 milionë Euro ose 55% (Departamenti për Koordinimin e Donatorëve, 2012).

Grafiku 4.24 Totali i financimeve të angazhuara dhe disbursuara si përqindje /2000-2012



Burimi: Departamenti për Koordinimin e Donatorëve, Këshilli i Ministrave

Grafiku 4.25 Totali i financimeve të angazhuara dhe disbursuara në vlerë absolute 2000-2012



Burimi: Departamenti për Koordinimin e Donatorëve, Këshilli i Ministrave

Sikurse shihet nga grafiku 4.25 i mësipërm Gjermania (KfW) është donatori kryesor si nga grupi i donatorëve bilaterale ashtu dhe multilateralë e ndjekur më pas nga Banka Botërore. Në total projektet e zbatuara me fonde të Qeverisë Gjermane janë 17 dhe janë në përgatitje 4 projekte. Duke qenë se KfW është donatori kryesor është e nevojshme të kuptohet qasja e ndërhyrjes në Shqipëri dhe ndikimi që projektet kanë patur në përmirësimin e performancës në përputhje me objektivat strategjike të programeve të financimit.

KfW ka përcaktuar sfidat apo problemet e sektorit të UK dhe qasjen e ndërhyrjes së saj mbi bazën e këtyre sfidave. Konkretisht sipas zyrës së KfW në Shqipëri sfidat me të cilat ndeshet sektori janë (Zyra KfW Shqipëri, 2012):

- Normë e lartë e ujit pa të ardhura > 62%, norma e aksesit ndaj ujit të pijshëm 80%, kanalizime 40%, orët e furnizimit me ujë 9.
- Nevoja shumë të larta për investime, por burime financiare të kufizuara.
- Mbulimi i pamjaftueshëm i kostos duke çuar në cilësi të ulët shërbimesh dhe mungesë mirëmbajtjeje.
- Kapacitet i kufizuar për zbatimin si në nivel qendror ashtu dhe bashkiak/komunë.
- Aftësi të kufizuara për huamarrjen qoftë financiare, ligjore dhe politike.

- Mungesa e eksperiencës nga ana e bashkive/komunave dhe kompanive në lidhje me investimet e financuara nëpërmjet kredive.

Në përputhje me sfidat e identifikuarat qasja e KfW për financimin e sektorit të UK synon sa më poshtë:

- Të ofrojë zgjidhje fleksibile të financimit duke ju përshtatur nevojave të financimit në sektor dhe tërhequr dhe burime të tjera të financimit.
- Investime të lidhura me asistencën teknike për të përmirësuar kapacitetet manaxheriale dhe siguruar zbatim të qëndrueshëm edhe pas përfundimit të ndihmës së huaj.
- Investime që sigurohen në mënyrë graduale sipas fazave mbështetur në kapacitetet zbatuese dhe kriteret e performancës.
- Monitorimi i vazhdueshëm për të siguruar zbatim eficient sipas standarteve të larta të cilësisë.
- Programe të ofruara mbi bazën e performancës së synuar.
- Vlerësim i zbatimit të projektit që realizohet nga vlerësues të pavarur të jashtëm me fokusin në zhvillimin e qëndrueshëm.
- Reforma politikash në sektor duke mbështetur kryerjen e studimeve afat-gjata për nevojat e sektorit si psh. Master plani i sapo hartuar për nevojat e sektorit deri në vitin 2040⁵⁰.


Ndonëse KfW është donatori kryesor me financimet më të mëdha në sektor ajo që vihet re nga grafiku është se niveli i disbursimeve është mjaft i ulët për periudhën 2000-2012 në nivelin 55%. Nga intervista e zhvilluar me Koordinatorin e Projekteve të KfW-së në Tiranë, Z. Bledar Dollaku arsyëja e këtij niveli të ulët disbursimesh lidhet me qasjen e investimeve të këtij donatori. Konkretisht në 3 vitet e fundit KfW e ka ndryshuar qasjen e ndërhyrjes së saj për të mos punuar me projekte të veçanta ose me faza projektesh, por mbi bazën e programeve të mëdha financimesh. Për të krijuar lehtësira financimesh portofoli i investimeve ngrihet mbi bazën e nevojave dhe më pas lëvrimi i fondeve bëhet mbi bazën e performancës së arritur. Si shembull mund të përmenden 2 programe të

⁵⁰ Departamenti i bashkërendimit të strategjive dhe koordinimit të ndihmës së huaj
http://www.dsdc.gov.al/dsdc/Prezantohet_Master_Plani_per_Sektorin_e_Ujesjelles_Kanalizimeve_ne_Shqiperi_527_1.php

infrastrukturës bashkiake ku përveç financimit nga KfW ekzistojnë donatorë të tjerë si bashkëfinancues të tillë si Zvicra, BE.


Qasja mbi bazën e programeve ka filluar të theksohet pas vitit 2005. Në përputhje me rekomandimet e axhendës së Parisit ku mblidhen të gjithë donatorët analizohen nevojat e Qeverisë Shqiptare, konkludohet në identifikimin e tyre dhe më pas Qeveria Gjermane bashkërendon punën e saj me donatorët e tjerë. Negociatat ndërmerren ç’do 2 vjet dhe rezultati është hartimi i dokumentit bazë të qeverisë gjermane ku përcaktohen ndërhyrjet në sektor (në bashkëpunim me GIZ). Siç u përmend një ndër konceptet e qasjes mbi bazën e programeve është që disbursimet të bëhen mbi bazën e treguesve të përmirësimit të performancës së shoqërive. Kryesisht treguesit lidhen me mbulimin e kostos operative dhe në varësi të kushteve të shoqërisë dhe performancës së arritur auditohet nga auditorë të jashtëm gjermanë të cilët bëjnë vlerësime 3 mujore për treguesit. Në këtë drejtim, ***sipas KfW mos arritja e treguesve të performancës në nivelin e dëshiruar shpjegon nivelin e ulët të disbursimeve.***

Grafiku 4.26 Totali i financimeve të angazhuara dhe disbursuara 2000-2012



Burimi: Departamenti për Koordinimin e Donatorëve, Këshilli i Ministrave

Grafiku 4.27 Totali i financimeve të angazhuara dhe disbursuara 2000-2012



Burimi: Departamenti për Koordinimin e Donatorëve, Këshilli i Ministrave

Lidhja e financimeve në raport me performancën kërkon që para-përgatitja, detajimi i treguesve dhe i afateve duhet të jetë sa më real, i plotë dhe i testueshëm paraprakisht. Problemet që mund të lindin në këte skemë lidhen me vonesat në zbatim pas fillimit të një projekti sepse ndalja apo zvarritjet rrezikojnë ta rrisin koston e investimit si nga pikëpamja financiare ashtu edhe sociale. Pra, nisja e projektit nënkupton që studimi ku përfshihen të gjithë faktorët e performancës së zbatimit të projektit janë testuar si të mundshëm dhe projekti mund të rrezikohet vetëm për raste shumë të veçanta dhe të ketë vonesa sa më të shkurtra. Financimi nga donatorët bëhet kryesisht mbi bazë projektesh investimi. Projekte në formën e PPP-vë në sektorin UK janë ato të financuara nga KfW dhe në një rast nga Banka Botërore. Në vijim do të analizohet ecuria e këtyre projekteve dhe vlerësimi i bërë nga KfW dhe Qeveria Shqiptare lidhur me performancën e tyre.

a) Konçensionit i Elbasanit

Shembulli i parë i kontratës me pjesëmarrje të sektorit privat ka qenë kontrata e konçensionit që ju dha Berlinwasser International në vitin 2002. Konkretisht, marrëveshja e Konçensionit e formës "BOT" (Build Operate, Transfer) u lidh ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (sot MZHETS), Bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe Berlinwasser International, GmbH për

Ndërmarrjen e Ujësjetës dhe Ujësjetës-Kanalizimeve Elbasan, marrëveshje e miratuar me ligjin nr.8783, datë 7.5.2001.

Për të bërë të mundur zbatimin e projektit u krijua kompania “Elber” sh.p.k dhe u lidh një marrëveshje huaje ndërmjet Ministrisë së Financave dhe KfW për shumën 23.5 DM konvertuar në Euro 12.36 milionë (me kursin e përcaktuar në marrëveshje 1 Euro=1.9 DM në 1 Janar 2002). Marrëveshja u miratua me ligjin Nr.8801, datë 17.5.2001 dhe palët që lidhën këtë marrëveshje janë KfW dhe Republika e Shqipërisë përfaqësuar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe kompanisë së krijuar Elber sh.p.k. Kompania private Elber u krijua sipas ligjeve shqiptare me aksionerë BWI (95%) dhe firma inxhinierike Rodeco (5%). Sipas pikës 1.2 të nenit 1 të këtij ligji, huaja do të përdorej ekskluzivisht për "Promovimin e Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet investimeve në Infrastrukturën e komunës Elbasan -Kanalizimi dhe Furnizimi me ujë – Elbasan”.

Nga vlerësimi i bërë nga Qeveria Shqiptare konçensionit i Elbasanit rezultoi në mospërfundim dhe zgjati vetëm 5 vjet nga 30 vjet që ishte parashikuar. Ka disa argumenta për mospërfundimin, por arsyeja kryesore ishte se konçensionari u përball me humbje të mëdha financiare dhe për të shmangur humbje të mëtejshme, konçensionari ia shiti shoqërinë e projektit ELBER Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës. Në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 raportohet se pavarësisht dështimit financiar, shoqëria e projektit Elber solli disa përmirësime në funksionimin e ndërmarrjes: rriti orët e furnizimit, rriti arkëtimet dhe uli konsumin e energjisë.

Sipas vlerësimit të bërë nga KfW (zyra KfW për Shqipërinë) për projektin objektivat e projektit nuk u arritën në pjesën më të madhe dhe ndikimi institucional ishte i kufizuar. Në këtë kuptim projekti u vlerësua si jo i kënaqshëm. Modeli i konçensionit u vlerësua si i papërshtatshëm për disa arsye të tilla si: nuk ekzistonte një databazë e besueshme, mbulimi i kostos nuk mund të arrihej dhe mungonte mirëkuptimi i konsumatorëve dhe vullneti politik për rritjen e tarifave. Sipas vlerësimit të KfW një kontratë menaxhimi do të kishte qënë modeli më i përshtatshëm. Nga intervista me komisionerin pranë ERRU,

Z. Jovani mendimi i tij personal është se tarifa u vendos e lartë pa u kryer fillimisht investime.

Situata e treguesve kryesorë të performancës paraqitet në tabelën si më poshtë:

Tabela 4.5 Situata e treguesve kryesorë të performancës –konçesioni Elbasan

Treguesit	Objektivi	Realizimi
Norma e lidhjes me ujë të pijshëm	98%	95%
Pakësimi i humbjeve të ujit	<35%	Mbeti 81%
Numri i orëve të furnizimit me ujë	24 orë	6 orë ose 25%

Burimi: Zyra KfW, Shqipëri

Sikurse vihet re nga treguesit e mësipërm deri në momentin kur projekti u mbyll treguesit ishin larg objektivave. Përveç treguesit të parë, i cili pati një lloj arritje, dy treguesit e tjerë janë larg objektivave të vendosura.

Nëpërmjet intervistës së zhvilluar me Koordinatorin e Projekteve pranë zyrës së KfW në Tiranë u synua që t'i jepej përgjigje dy çështjeve:

- i) Mësimet e nxjerra nga rasti i konçesionit të Elbasanit dhe
- ii) Cilat ishin arsyet e konkluzioneve të KfW se kontrata e menaxhimit mund të kishte qenë më e përshtatshme kur dihet se kontrata e menaxhimit do të duhej gjithsesi të arrinte disa tregues të performancës si: mbulimi i kostos, rritja e tarifave dhe patja e një databaze të besueshme?

Në vijim jepen rezultatet e intervistës së zhvilluar me përfaqësuesin e KfW.

1. KfW e ka vlerësuar projektin e Elbasanit shumë të rëndësishëm në nxjerrjen e mësimave. Mësimi kryesor është që përfshirja në formën e modeleve të ndryshme PPP kërkon një sërë kushtesh që duhen studjuar mirë përpara dhe nëse maturimi i tyre është i vërtetuar mirë atëherë duhet të aplikohen rastet e kontratave PPP. Duke u nisur nga rastet e PPP-ve në Shqipëri, KfW është tërhequr nga modelet PPP. Një tjetër dështim i kësaj lloji kontrate ka qenë edhe në Jordani. Konkluzioni i parë është që u vu

në pikëpyetje modeli i PPP-ve në vendet në zhvillim. Aq më shumë që kishte projekte zhvillimi në Shqipëri që funksionin mirë pa qënë e nevojshme ndërhyrja në formën e PPP-ve. Megjithë dështimin në Elbasan ndërhyrja e KfW ka patur ndikim pozitiv pasi menaxhimi i shoqërisë ka qënë më mirë sepse ka përfituar 5 vjet. Elbasani është qytet i rëndësishëm, por për shkak të mos arritjes së suksesit KfW nuk e sheh më si mundësi investimi pasi kuadri institucional nuk është zgjidhur ende. Konçensionit ju shit METE me 1 euro për të mbyllur kontratat.

2. Në dallim nga kontrata e konçensionit në Elbasan, KfW mendon se kontrata e menaxhimit mund të ishte një mundësi me një risk më të ulët pasi nuk mbart detyrime për investime. Në rastin e konçensionit të Elbasanit kompania konçensionare BWI kishte përgjegjësinë e kryerjes së investimeve që përfshinte përveç financimit të nevojshëm bërjen e projektit, mbikqyrjen dhe investimin. Edhe në rastin e konçensionit rreziku ishte minimal sepse investimi sigurohej nga Qeveria në formën e huasë së përfituar nga KfW dhe në këtë drejtim nuk kishte arsye që palët të përfshiheshin në kontratë konçensionit. Si rrjedhim, mund të kishte qënë më efikase lidhja e një kontrate menaxhimi me investim nga qeveria. BWI nuk kishte asnjë lloj hapje ndaj konkurrencës pasi gjithçka realizohej prej tyre dhe ishin disa arsye si: faktorët institucionalë, politikë, etikë. Ndërkohë që një tjetër avantazh që do të vinte nga kontrata e menaxhimit ishte hapja ndaj konkurrencës. Modelet në formën e PPP-ve rezultuan të pasuksesshme edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, siç do të shpjegohet në seksionet në vijim. Këto raste mossuksesi siç vetë KfW i ka vlerësuar i kanë shërbyer që kjo e fundit të tërhiqet nga këto lloj kontratash.

b) Kontrata e Menaxhimit të Kavajës

Një rast tjetër ndërhyrjeje të KfW në formën e kontratave PPP është rasti i kontratës së menaxhimit në qytetin e Kavajës. Me anë të VKM nr. 314 datë 15.5.2003 u miratua Kontrata e Menaxhimit për sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sha Kavajë ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga organi shtetëror i autorizuar dhe Aquamundo GMBH. Kontrata u lidh në 23 dhjetor 2002 me afat 4 vjeçar mes organit shtetëror të autorizuar dhe Aquamundo një shoqëri e themeluar në përputhje me rregullat e

Republikës Federale të Gjermanisë. Objektivi i kësaj kontrate menaxhimi ishte të përmirësonte menaxhimin dhe funksionimin pa financime shtesë për investime kapitale. Në këtë kuadër huaja e dhënë nga KfW ishte e kufizuar te menaxhimi i tarifave dhe nxitja e pagesave dhe nuk parashikonte fonde për financimin e investimeve kapitale.

Sipas nenit 7.1 të marrëveshjes, pagesa bazë është në shumën prej 713, 820 Euro, ndërsa pagesa e suksesit do të llogaritej në bazë të kriterëve të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në marrëveshje. Pagimi i pagesës së suksesit nga ana e Autoritetit Shtetëror të përcaktuar nga pala shqiptare nënkupton pranimin e rezultateve të arritura në vitin pararendës që vlerësohen në bazë të raportit vjetor që dorëzon kontraktori menaxhues. Kontrata përmirësoi funksionimin e shoqërisë së ujësjellësit, por nuk përmbushi objektivat e përcaktuara në kontratë siç paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela 4.6 Treguesit e projektit të Kavajës

Treguesit	Objektivi	Arritja
Norma e lidhjes me shërbimet e kanalizimeve	50%	50%
Humbjet e ujit	<35%	81%
Numri i orëve të furnizimit me ujë	24 ore	6 ore ose 25% e objektivit

Burimi: Zyra KfW, Shqipëri

Projekti i Kavajës përfshinte dy komponentë perkatësisht ndërtimin e impjantit për grumbullimin e ujërave të zeza dhe komponentin e furnizimit me ujë në fshatrat e Kavajës specifikisht Manskuria. Sipas vlerësimit të bërë nga KfW pas përfundimit të projektit, të dy këto komponentë janë vlerësuar mjaft mirë përse i përket ndikimit që patën për zhvillimin e turizmit në këto zona. Komponenti i ujërave të zeza u vlerësua të ishte efektiv duke qenë se u arrit që 50% e popullsisë siç ishte planifikuar të lidhej me sistemin e kanalizimeve. Ndërsa komponenti i furnizimit me ujë të zonës Manskuria nuk arriti që të përmbushte objektivin e arritjes së normës së lidhjeve me sistemin e ujit prej 95%, i cili u vlerësua si një objektiv jorealit për shkak të rritjes së aktivitetit të ndërtimit në mënyrë të pakontrolluar.

Projekti arriti që të përmirësonte disa tregues të performancës. Megjithatë mbulimi i kostos totale operative mbetet sfida e projektit. Kjo për shkak të tarifave të ulta dhe kostove të larta të energjisë. Llogaritjet e bëra për koston e prodhimit tregojnë se edhe me një normë të mbledhjes së të ardhurave në masën 100%, vetëm 88% e kostove totale operative do të mund të mbulohej. Tarifa që kërkohet për mbulimin e plotë të kostove llogaritet të jetë 60 lekë. Megjithatë tarifa duket se është larg këtij realiteti pasi në vitin 2010 arriti në 38 lekë nga 31 lekë në vitin 2007. E njëjta situatë mund të përmendet për tarifën për kanalizimet, e cila u rrit nga 2.5 lekë në 15 lekë. Megjithatë mbulimi i kostove operative për kanalizimet është rritur në 40% ende mbetet larg arritja e objektivit për 100 % siç u parashikua në vlerësimin e projektit.

Një tjetër problem i evidentuar ishte mbledhja e të ardhurave sipas faturave. Si fillim vetëm 70% e ujit të prodhuar faturon. Kjo për shkak të lidhjeve ilegale. Përveç këtij fakti vetëm 50-70% të detyrimeve të faturuara arrijnë të paguhet. Arsyeja kryesore është se duke qenë zonë turistike, shumë turistë kthehen në vendet e tyre dhe në këtë drejtim kompania e ka të vështirë mbledhjen e pagesave. Shoqëria e UK Kavajë u asistua nga operatori privat BWI në fushat e kontabilizimit, mbledhjes së borxheve dhe marrëdhënies me publikun. Për arsyet e nivelit të ulët të tarifimit të turistëve dhe mos mbledhjes së të ardhurave komponenti i ujit të pijshëm u vlerësua jo i kënaqshëm në drejtim të efijencës. Nga e gjithë shuma e faturuar për konsumimin e ujit vetëm 70% paguhet nga konsumatorët dhe tarifatat e ujit arrijnë të mbulojnë vetëm 85% të kostove operative. Për këtë qëllim qëndrueshmëria e projektit vlerësohet jo e kënaqshme.

Nga sa përmendet më sipër edhe në rastin e kontratës së menaxhimit për projektin e Kavajës projekti vlerësohet i pakënaqshëm. Gjatë intervistës së zhvilluar me Koordinatorin e Projekteve pranë zyrës së KfW në Tiranë u synua që të kuptoheshin mësimet e nxjerra nga rasti i Kavajës, të cilat përmbledhen si në vijim.

1. Sipas KfW projekti në Kavajë u ndikua nga faktorë të jashtëm dhe vlerësimi jo i kënaqshëm jo domosdoshmërisht nxjerr në pah dështimin nga ana e KfW. Manskuria është impjanti për trajtimin e ujit të pijshëm sepse ka bazën ku futet uji. Sipas projektit uji do të shpërndahej në Kavajë nga Manskuria me një linjë transmetimi, e cila u

parashikua për t'u financuar nga Qeveria Shqiptare. Ky financim u vonua dhe si rezultat i ndërtimit të rrugës së re u bë një devijim dhe tashmë Manskuria duhej të furnizonte me ujë të pijshëm zonën e Golemit. Vlerësuesit e projektit arritën në konkluzionin që ndonëse rasti i Manskurisë pati një efekt pozitiv pasi ndikoi në zhvillimin e zonës turistike, përsëri nuk arriti objektivat e projektit.

2. Një efekt pozitiv që ky projekt pati ishte përmirësimi i menaxhimit me sistemin e të dhënave të klientëve, matësave, eficientia e faturimeve të cilat ishin të kënaqshme, por niveli i arkëtimeve ishte mjaft i ulët. Problemi kryesor kishte të bënte me klientët sezonalë. Një ndër mësimet e nxjerra ishte që faturat nga ana e turistëve duhet të parapaguheshin. Së fundmi, pjesa e kanalizimeve quhet e suksesshme në Kavajë sepse impjanti i financuar nga KfW është impjanti i parë, i cili funksionon dhe sot dhe përmbush kriteret e trajtimit të ujit të ndotur. Për këtë impjant është arritur marrëveshja që të zgjerohet me anë të një projekti të BE-së.

c) Projekti i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Krujë

Për këtë projekt analiza sigurohet vetëm nga vlerësimet e bëra nga KfW pas përfundimit të projektit. Kjo pasi personi i intervistuar në KfW nuk ka qënë përgjegjës për këtë projekt dhe nuk kam arritur të marr informacion mbi mësimet e nxjerra.

Projekti pati si synim sigurimin e vazhdueshëm dhe të duhur të furnizimit me ujë për popullsinë që jeton në zonat urbane dhe shkarkimin e duhur të ujërave të zeza. Pothuaj 95% e popullsisë u lidh me sistemin e ujësjellësit dhe 65% me sistemin e kanalizimeve ashtu siç ishte parashikuar. Konsumimi i ujit vazhdon të jetë i lartë pavarësisht se objektivi i vendosur është 120 l/frymë/ditë dhe po kështu orët e furnizimit me ujë janë larg arritjes së objektivit 24 orë në ditë.

Përsa i përket eficientës indikatorët si humbjet teknike të ujit, eficientia në faturimin, eficientia e mbledhjes së të ardhurave, mbetën në nivele të ulta megjithë përmirësimet e arritura nga projekti dhe janë larg pritshmërive. Vetëm 22% e kostove operative arrijnë të mbulohen, një nivel që është i papranueshëm. Në këtë drejtim vlerësimi përsa i përket eficientës nuk është aspak i kënaqshëm. Qëndrueshmëria që sigurohet për projektin vlerësohet e pakënaqshme. Kjo për shkak të tarifave të ulta, të cilat nuk arrijnë të

mbulojnë kostot dhe normës së ulët të grumbullimit të të ardhurave sipas tarifave. Megjithëse sigurohen subvencione nga shteti përta i përket kostove operative të ardhurat nuk arrijnë të sigurojnë mirëmbajtjen dhe operimin e duhur të pajisjeve dhe makinerive.

Si përfundim, mund të konkludojmë se rastet e ndërhyrjes në Shqipëri në formën e PPP-ve kanë qenë jo të kënaqshme. Nga projektet e analizuara të KfW dhe nga intervista e zhvilluar u arrit në konkluzionin se ndërhyrjet të këtyre lloj kontratash duhet të kryhen pasi të jenë maturuar kushtet paraprake institucionale dhe politike. KfW në vizionin e saj nuk parashikon përfshirjen e ardhshme në forma të tilla.

KAPITULLI V: MODELI EKONOMETRIK PËR EFIÇIENCËN E SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE: KUADRI TEORIK

Metodologjia e punës kërkimore mbështetet në modelin sasior dhe cilësor, por modeli sasior zë një vend të rëndësishëm në këtë punim aq më tepër kur flitet për matjen e efiçencës së shoqërive të UK. Në këtë kapitull do të trajtohet në mënyrë të zgjeruar kuadri teorik i modelit ekonometrik të përzgjedhur për efiçencën duke treguar funksionin matematikor dhe variabellet e përdorura. Më pas në kapitullin 6 do të jepen rezultatet e testimit të efiçencës së bashku me rekomandimet përkatëse.

5.1 Metodologjia e kërkimit

Metodologjia e kërkimit është një llogjikë procedurale që ndiqet me qëllimin e testimit të një hipoteze kryesore ose dhënies së përgjigjeve nga pyetje kërkimore (Palys, 1997: 3-4) për të mundësuar kërkuesin për të parashikuar dhe shpjeguar një fenomen specifik duke analizuar fakte shkencore të ndryshme në një përpjekje për të “vërtetuar hipotezën apo pyetjen kërkimore të ngritur” (Mouton & Prozesky, 2001:4). Faktet shkencore (Palys, 1997:4) duhet të jenë të besueshme dhe të vlefshme. Palys (1997:4) argumenton se besueshmëria nënkupton faktin se “vëzhgimet e përsëritura të të njëjtit fenomen duhet të prodhojnë të njëjtat rezultate dhe vëzhguesit e ndryshëm që ndjekin të njëjtën metodologji kërkimore, ose procedura duhet të arrijnë tek të njëjtat rezultate”. Vlefshmëria do të thotë të matësh atë për të cilin dikush ka nevojë” (Palys, 1997:4). Sipas Bulmer (1984:4) metodologjia kërkimore tregon “studimin sistematik dhe llogjik të principeve që qeverisin analizën, përmban pyetjet sesi kërkuesi përcakton njohurinë sociale dhe si ai apo ajo mund të bindë të tjerët se njohuria e tij apo e saj është e duhura”. Në këtë punim doktrature u përdorën disa metoda kërkimi siç do t’i paraqesim në vijim.

Për t’ju përgjigjur këtyre pyetjeve shërben kërkimi që propozoj të ndërmarr. Për ata që janë të përfshirë në negocimin dhe hartimin e politikave që lidhen me sektorin UK

qëllimi i këtij kërkimi është të tregojë dhe rekomandojë një model të përshtatshëm të rajonalizimit për sektorin UK në Shqipëri. Ajo që dua të krijoj është analizimi i modeleve të rritjes së eficiencës në sektorin UK në Shqipëri nga ku të rekomandoj modelin më të mirë si dhe të rekomandoj një model të rajonalizimit që t'i përshtatet kushteve social ekonomike, gjeografike, politike, historike etj. të Shqipërisë. Po kështu ky model do të trajtojë formën e duhur të PPP-së (leasing, konçension, kontratë menaxhimi etj), si një instrument që mundëson zbatimin e skemës së rajonalizimit në këtë sektor.

Metodologjia e punës konsiston në kërkimin sasior dhe cilësor dhe konkretisht në: (i) rishikimin e literaturës që të trajtojë nga ana teorike PPP dhe në veçanti sektorin UK; (ii) rishikimin e studimeve mbi rajonalizimin në vendet e rajonit apo më gjerë; (iii) analizën e problematikës së sektorit të UK dhe rolet e institucioneve në nivele të ndryshme vendimmarrëse dhe (iv) analiza e modeleve të rritjes së eficiencës në sektorin UK.

Për qëllimet e mbledhjes së të dhënave kam përdorur këto burime:

1. Databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të UK⁵¹ për të grumbulluar të dhëna për të gjitha shoqëritë UK sipas indikatorëve teknikë, financiarë dhe cilësorë.
2. Databazën e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit⁵², Ministrisë së Brendshme⁵³ veçanërisht për kuadrin ligjor të sektorit, strategjitë dhe politikat sektoriale.
3. Databazën e Entit Rregullator të Ujit⁵⁴ mbi politikat e ndjekura për mbikqyrjen dhe rregullimin e sektorit.

⁵¹ <http://www.dpuk.gov.al/>

⁵² <http://www.mppt.gov.al/>

⁵³ <http://www.moi.gov.al/>

⁵⁴ www.rru.al

4. Databazën e investimeve nga Departamenti i Koordinimit të Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave⁵⁵, institucione ndërkombëtare si BB, KfW për të evidentuar rolin e tyre në sektor.

5. Intervista *gjysmë të strukturuar* me persona kyçë përfaqësues të institucioneve më kryesorë, të cilët janë aktivë në sektorin UK.

5.2 Modeli cilësor

Kërkimi cilësor është një *“formë kërkesë që eksploron dukurinë në gjendjen e saj natyrore dhe përdor metoda të shumëllojta për ta interpretuar, kuptuar, shpjeguar dhe për t’i dhënë kuptimin e duhur”* (Anderson & Arsenhault, 1998: 119). Kërkimi cilësor përqëndrohet në *“mbledhjen dhe analizimin e informacionit bazuar në cilësinë e tij dhe jo në sasinë. Mund të përdorë një llogjikë të pa-strukturuar për të zbuluar kuptimin e kërimit, ç’ka do të thotë që nuk ka rregulla që ndiqen hap pas hapi, terma ose procedura që duhet të ndiqen”* (ibid). Kërkimi cilësor është një *“fushë ku shumë disiplina takohen, që përfshin një kuptim të thellë të sjelljes njerëzore dhe arsytet që qeverisin sjelljen njerëzore. Në këtë punim doktoral kërkimi cilësor bën të mundur që kërkuesi të investigojë pse-në dhe si-në e vendimmarrjes”* lidhur me rritjen e efijencës së sektorit të UK nëpërmjet bashkimit të shoqërive dhe krijimit të rajoneve. Punch (2005:2) shkruan se kërkimi cilësor është një *“kërkim empirik ku të dhënat nuk janë në formën e numrave”*.

Kërkimi i parë lidhur me mundësinë e arritjes së efijencës së shoqërive të UK ka filluar në vitin 2009 nga BB, e cila përpiloi një studim fizibiliteti mbi mundësinë e rajonalizimit të shoqërive të UK në Shqipëri. Unë si kërkues nuk isha pjesë e këtij procesi dhe ky studim përdoret si referencë për të vazhduar më tej dhe konkluduar në gjetjen e një modeli të përshtatshëm të rajonalizimit duke përdorur analizë sasiore dhe cilësore, që do t’i përshtatej kushteve specifike të Shqipërisë, ashtu siç rekomandon BB në këtë studim.

⁵⁵ <http://www.dsdc.gov.al/>

Metodat sasiore janë mjaft të ndryshme dhe komplekse dhe në këtë kuadër analiza tematike duhet të shihet si baza e këtyre metodave (Holloway & Todres, 2003:345-357). Si kërkues kam zhvilluar intervista me përfaqësuesit e institucioneve në nivele të ndryshme përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive, administrimin e shoqërive, mbikqyrjen dhe rregullimin e sektorit dhe financimin e tij.

Gjatë periudhës së kryerjes së analizës cilësore, nga procesi i intervistimit u mblodhën informacione dhe u analizuan për t'i integruar gjetjet në punim në mënyrën e duhur. Metoda e përdorur për t'i integruar gjetjet është ajo tematike. Analiza tematike është një metodë për të identifikuar, analizuar dhe raportuar temat brenda të dhënave. Minimalisht këto analiza organizojnë dhe përshkruajnë të dhënat në shumë detaje (Braun & Clarke, 2006:77-101). Shumë shpesh këto analiza tematike shkojnë përtej të dhënave ekzistuese dhe interpretojnë aspekte të ndryshme të çështjes për të cilin ndërmerret kërkimi (Boyatzis, 1998:1-14). Në këtë mënyrë gjetjet u integruan në punim sipas temave të trajtuara.

Ka mënyra të ndryshme ose metoda të ndryshme për të zhvilluar kërkimin cilësor si në vijim:

- Kërkim veprues - që është metodologjia ku kërkuesi është një pjesëmarrës aktiv në procesin që studjohet si dhe ka edhe rolin e vëzhguesit.
- Historia verbale që merr të dhëna nga një person dëshmitar i ngjarjeve të kaluara ose i një seri ngjarjesh.
- Vëzhgim i pjesëmarrësit ku kërkuesi manipulon një grup ose pjesëmarrës në një studim qoftë brenda grupit ose jashtë tij.

Në këtë studim u ndoq metoda e kërkimit veprues duke qënë se kërkuesi ka qënë aktiv për të ndjekur nga afër çështjet që analizohen. Gjithsej janë zhvilluar 14 takime me përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në mbarëvajtjen e sektorit në nivelin qendror, vendor, autoritetit mbikqyrës, si dhe donatorët kryesorë (*lista e të intervistuarëve me pyetjet përkatëse gjenden në shtojcat 2-14*). Këto intervista bënë të mundur që unë si kërkues të studjoja dhe analizoja në detaje sesi janë hartuar politikat, si zbatohen, si dhe të kuptoja rolin e secilit institucion dhe bashkëveprimin mes tyre për mbarëvajtjen e sektorit. Gjithashtu, këto intervista me shërbyen për të kuptuar rolin e secilit institucion

në procesin e rajonalizimit dhe të kuptoja avantazhet dhe disavantazhet e kësaj iniciative në rastin e Shqipërisë sipas këndvështrimit të institucioneve të intervistuar.

5.2.1 Intervistat gjysmë të strukturuar

Kërkimi cilësor përdoret për të dhënë një perspektivë subjektive të veprimit njerëzor dhe ka si qëllim kryesor të përshkruajë dhe kuptojë sjelljen njerëzore. Në këtë punim, qëllimi i përdorimit të kërkimit cilësor është kuptimi i problematikës së sektorit në drejtim të aspekteve ligjore, institucionale dhe financiare, të marrë këndvështrimin e institucioneve mbi rajonalizimin dhe të krijohet modeli i përshtatshëm që i përshtatet rastit të Shqipërisë.

Intervistat gjysmë të strukturuar⁵⁶ më lejuan të shtoj pyetje të reja të pamenduara më parë në varësi të informacionit që jepte pala e intervistuar. Megjithatë në këtë rast kërkuesi duhet të ketë eksploruar më parë fushat e interesit dhe të ketë përgatitur pyetjet. Objektivi i këtyre intervistave është të kuptohet këndvështrimi i personit që intervistohet dhe jo të përgjithësohet çështja apo fenomeni që studjohet.

Duhet theksuar që intervistat plotësojnë me informacion rezultatet e testimit ekonometrik dhe nuk e zëvendësojnë atë. Për më tepër që këto intervista ndihmojnë në sugjerimin e modelit më të mirë dhe të përshtatshëm në rastin e Shqipërisë.

Intervistat e këtij lloji funksionojnë më mirë kur punohet me kampion të vogël dhe janë të vlefshme kur studjohen situata specifike për të plotësuar informacionin e marrë nga burime të tjera. Plus kësaj duke qenë se këto lloj intervistash janë opinione dhe perceptime të të intervistuarve, ato janë efektive për të kuptuar problemet, të cilat nuk janë të perceptueshme menjëherë, por që janë shqetësim në fusha të caktuara, ose në segmentë të caktuara të popullsisë.

Këto lloj intervistash paraqesin avantazhin se është një metodë e thjeshtë, fleksibël, efektive duke krijuar raporte pozitive mes dy personave pjesëmarrës në intervistë (Braun & Clarke, 2006:77-101). Në të njëjtën kohë intervistuesi ka mundësi të diskutojë

⁵⁶ Këto intervista janë intervista me pyetje të hapura, të ndërtuara mbi bazën e pyetjeve të para caktuara, që pasurohen gjatë procesit të intervistimit.

çështje komplekse në detaje dhe të kuptojë mjaft çështje për të cilat informacioni mund të mos jetë i vlefshëm në ndonjë formë tjetër.

Për qëllime të këtij punimi kam zhvilluar 14 intervista me pyetje gjysmë të strukturuar dhe duhet theksuar se pyetjet nuk janë të njëjta për ç'do intervistues. Kjo pasi secili institucion ka një rol specifik dhe ushtron funksione të veçanta ashtu siç përcaktohet në kuadrin ligjor përkatës.

Konkretisht institucionet e intervistuar janë:

- Enti Rregullator i Ujit (4 përfaqësues);
- Ministria e Transportit dhe Punëve Publike;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Brendshme;
- Njësia e Monitorimit të Performancës së sektorit të UK;
- Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) si donator kryesor;
- Kompania Valu Add Management Services e specializuar në fushën e UK;
- Konsulent i Bankës Botërore për çështjet e sektorit UK;
- Shoqëria UK-Tiranë;
- Shoqëria UK- Durrës;
- Bashkia Tiranë.

Pyetjet u formuluan me qëllim që të kuptohej roli i tyre në sektor, kuadri ligjor që rregullon marrëdhëniet e institucioneve të ndryshme, këndvështrimi i institucionit lidhur me iniciativën e re të Qeverisë në drejtim të rajonalizimit (bashkimit të shoqërive) dhe barrierat që ekzistojnë për të realizuar këtë proces sipas këndvështrimit të tyre. Intervistat u hartuan në gjuhën shqipe dhe u regjistruan me audio. Pas zbardhjes së të gjitha përgjigjeve të intervistuesve gjetjet u integruan në këtë punim në mënyrë të përmbledhur sipas çështjeve/temave të diskutuara. Lista e personave të intervistuar sipas institucioneve që ata përfaqësonin dhe pyetjet gjenden në fund të këtij punimi në pjesën e Anekseve.

5.2.2 Metodatat deduktive dhe induktive

Në këtë punim janë përdorur të dyja metodat: deduktive dhe induktive. Është e rëndësishme të përshkruhen këto metoda përpara se të prezantohet sesi ato janë përdorur në këtë punim. Palys (1997: 3) shprehet se metoda e kërkimit induktiv përdoret në kërkimin cilësor dhe fillon me *“specifikat dhe i përdor këto për të nxjerrë principet”*. Një kërkues duhet të fillojë me zbatimin e metodologjisë së kërkimit të tij/saj të vëzhgimit përpara se ti drejtohet teorisë. Në lidhje me këtë punim janë zhvilluar disa takime me ekspertë të fushës për të grumbulluar informacion empirik lidhur me rajonalizimin si një mekanizëm që do të sillte eficiencën e sektorit të UK dhe do të tërhiqte më shumë investime private nëpërmjet instrumentit PPP. Metoda induktive e plotësoi informacionin e marrë nëpërmjet metodës deduktive. Metoda induktive më ndihmoi që në pozitë të kërkuesit të justifikojë rajonalizimin nga teoritë e eficiencës ekonomike dhe teoritë e pjesëmarrjes së PPP-ve.

Siç Palys (1997:47) shprehet, metoda deduktive e mundëson kërkuesin për *“të identifikuar principet e përgjithshme që mund të përdoren për të interpretuar rezultatet e sjelljes të të intervistuarve në studim”*.

5.2.3 Vlerësimi i literaturës

Siç thekson Eco (1981: 67-73) kur punohet mbi *“vepra të botuara atëherë një punim i dorës së parë mund të jetë edhe një botim origjinal, ose një botim kritik i veprës në fjalë”*.

Në këtë punim si burime parësore të literaturës janë përdorur punime kërkimore në fushën e PPP-ve dhe rajonalizimit, punime në konferenca shkencore, ligje të ndryshme të miratuara nga Parlamenti, raporte vjetore, studime të kryera nga studio konsulence për sektorin UK në Shqipëri.

Përmbledhjet e bëra nga autorë të tjerë qofshin edhe të pasura me shumë citime nuk mund të quhen burim. Ato e shumta janë burim dytësor (ibid). Në këtë punim si burime dytësore janë përdorur përmbledhje të bëra nga disa autorë për evolucionin e konceptit PPP

dhe tendencën e zbatimit të tyre në vende të ndryshme dhe librat akademikë. Burimet kanë shërbyer për orientimin e fokusimit të kërkimit. Ato burime kanë shërbyer për të bërë një përmbledhje të rolit që PPP-të kanë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të nënvizojnë faktin se PPP-të janë risi në 30 vitet e fundit duke shërbyer si instrumenta për përmirësimin e eficiencës së ofrimit të shërbimeve publike. Së fundi, meqënëse në Shqipëri nuk ka ndonjë studim që të rendisë në mënyrë kronologjike PPP-të që nga lindja e konceptit të tyre dhe shtrirjen më pas, burimet dytësore të përdorura kanë shërbyer për të sjellë teoritë bazë dhe shkollat përkatëse në mënyrë kronologjike dhe të japë një panoramë të qartë të rolit PPP-ve në ekonomi. Në këtë punim si burime të tjera dytësore janë përdorur përmbledhje të bëra nga disa autorë për modelet e ndryshme të rajonalizimit të përdorura si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim. Ky rishikim i burimeve dytësore shërben për të analizuar nëse ekziston një model universal i rajonalizimit në sektorin e UK.

5.3 Modeli sasior

Ky studim kombinon kërkimin sasior me atë cilësor. Bless dhe Higson-Smith (2000:28) citon se kërkimi sasior “*mbështetet në matjen për të krahasuar dhe analizuar variabla të ndryshme*”. Kërkimi sasior në këtë punim ka disa qëllime: së pari, të testojë variablet që ndikojnë në koston operative dhe rrjedhimisht në eficiencën e shoqërive të UK; së dyti mbi bazën e variablave të identifikuara të rendisë shoqëritë sipas eficiencës së tyre. ERRU si autoriteti mbikqyrës i sektorit analizon performancën e shoqërive ç’do vit duke i renditur për nga performanca në krahasim me nivelin e benchmarkut të vendosur nga ERRU. Për këtë qëllim renditja e shoqërive nga kërkuesi me anë të modelit ekonometrik ka si synim të krahasojë të dyja llojet e renditjeve dhe t’i rekomandojë ERRU gjetjet nga ky kërkim shkencor.

Qëllimi primar ishte të testohet bashkimi i shoqërive, por që kjo të arrihet duhet të ekzistojnë të dhëna, të cilat në këtë fazë do të ishin supozime përderisa ky proces ende nuk ka filluar. Ky informacion nuk është i vlefshëm dhe si rrjedhim gjetja e një modeli të mundshëm të rajonalizimit që i përshtatet kushteve social ekonomike, gjeografike, politike, historike të Shqipërisë arrihet nëpërmjet analizës cilësore.

Kërkimi sasior u realizua duke përdorur modelin ekonometrik për eficiencën e shoqërive të UK i përdorur në një studim të kryer për eficiencën relative të kompanive të UK në Brazil (Sabbioni, 2006:3-6).

Arsyet e përdorimit të këtij modeli në rastin e Shqipërisë janë:

1. Qëllimi i studimit për kompanitë UK në Brazil përputhet me qëllimin e studimit të këtij punimi doktoral. Konkretisht, studimi në rastin e Brazilit synon të analizojë performancën relative të kompanive të UK dhe t'i rendisë kompanitë nga më performuese në më pak performuese. Ky qëllim përkon edhe në rastin e Shqipërisë siç shprehet në paragrafin e parë të këtij seksioni.
2. Modeli në rastin e Brazilit përdor variabla financiare, teknike dhe operacionale, të cilat janë të ngjashme për nga metodologjia e përlllogaritjes së tyre me ato në rastin e Shqipërisë. Të dhënat për sektorin e UK si në rastin e Brazilit ashtu dhe në rastin e Shqipërisë janë të publikuara në faqe zyrtare të institucioneve përkatëse.
3. Vëzhgimet e nevojshme për të kryer një testim me model ekonometrik janë pothuaj të përafërta në të dyja rastet. I vetmi ndryshim përta i përket vëzhgimeve është se në rastin e Brazilit të dhënat analizohen vetëm për një vit duke konsideruar numrin më të madh të kompanive, ndërsa në rastin e Shqipërisë të dhënat analizohen për periudhën 2006-2012.

Arsyet e analizës së të dhënave në rastin e Shqipërisë për 7 vjet mbështeten në këto fakte:

(i) testimi ekonometrik kërkon një numër të madh vëzhgimesh në mënyrë që analiza të ketë kuptim dhe në rastin e Shqipërisë analiza e shoqërive UK vetëm për një 1 vit nuk është e mjaftueshme. Analiza fillon me vitin 2006 sepse: (i) ky është viti i parë që të dhënat për sektorin janë bërë publike në faqen zyrtare të DPUK; (ii) renditja e shoqërive sipas eficiencës relative ndër vite jep një informacion më të saktë për të kuptuar cilat shoqëri kanë një performancë më të dobët dhe cilat më të shëndoshë dhe përbën një kontribut shkencor, i cili krahasohet me renditjen që ERRU kryen për shoqëritë.

Modeli i mundshëm i rajonalizimit që i përshtatet kushteve të Shqipërisë nuk bazohet në një model specifik të aplikuar në ndonjë vend tjetër (Brazil nuk analizon çështjen e rajonalizimit), por duke analizuar eksperiencën ndërkombëtare dhe rezultatet e intervistave gjysëm të strukturuar. Në këtë kuptim modeli synon të japë një kontribut të vetin në rekomandimin e një modeli rajonalizimi për Shqipërinë.

Siç argumenton Sabbioni (2006:3) kur diskutohet matja e eficiencës nëpërmjet modelit ekonometrik, analistët kanë dy opsione: funksionet e kostos dhe funksionet e prodhimit. Sabbione krahason të dyja funksionet mbi bazën e avantazheve dhe disavantazheve dhe arrin në konkluzionin se maksimizimi i fitimit të një kompanie tipike të UK mund të analizohet më mirë duke përdorur funksionin e kostos. Argumentat e përdorura janë të duhurat edhe në rastin e Shqipërisë dhe këto gjenden në formë më të zgjeruar në vijim kur trajtohen detajet e modelit ekonometrik të përdorur.

Burimet e informacionit për kërkimin sasior janë të dhëna dytësore të publikuara në faqen zyrtare të DPUK për periudhën 2006-2012. Të dhënat sipas variablave të përdorura u grumbulluan për të gjitha shoqëritë UK në Shqipëri në total dhe prej këtyre kompanive u përzgjedh kampioni prej 29 shoqëri, për të cilat të dhënat ishin të disponueshme për të dyja shërbimet: furnizimi me ujë dhe kanalizimet. Më pas, këto të dhëna u përpunuan në formatin e serive kohore dhe u testuan me ndihmën e programit STATA 2011. Fillimisht, u ndërtuan tre modelet bazë të regresionit OLS dhe modeli përfundimtar OLS për të parë rëndësinë e variablave të pavarura në koston operative vjetore, që është variabla e varur. Më pas u ndërtua modeli Stokastik i Funksionit të Kostos (Stochastic Cost Frontier) për të renditur shoqëritë sipas eficiencës së tyre nga më performante në më pak performante. Detajet e secilës variabël jepen në kapitullin 6.

5.4 Kampioni i përzgjedhur

Kampioni i kërkimit duhet të zgjidhet në mënyrë të kujdesshme dhe të jetë i përcaktuar qartë. Terreblanche dhe Durrhemi (2002:274) pohojnë se kampioni është *“një proces që përdoret për të zgjedhur pjesëmarrësit dhe t’i përfshijë ata në studimin kërkimor”*.

Të dhënat e grumbulluara përfshijnë SHUK, 54 në total për periudhën 2006-2012 për të gjitha variablet e modelit. Aktualisht në Shqipëri operojnë 58 shoqëri U/K dhe disa prej këtyre shoqërive nuk kanë ekzistuar gjatë periudhës 2006-2012. Si rezultat i kësaj u konstatua se për periudhën tonë të analizës 54 shoqëri ishin operative për të 7 vitet dhe kjo është arsyeja që nga 58 shoqëri aktuale u mblodhën të dhënat për 54 prej tyre.

Nga analiza e të dhënave konstatohet që jo të gjitha shoqëritë ofrojnë të dyja shërbimet ujin dhe kanalizimet. Në këtë kuadër analiza u reduktua nga 54 në 29 shoqëri që përbën kampionin e përzgjedhur. Kampioni prej 29 shoqëri përbën 54% të totalit të shoqërive, dhe është një kampion përfaqësues pasi mbulon 81% të konsumatorëve të shërbyer (lista me emrat e shoqërive të përzgjedhura në kampion gjendet në Shtojcën 1).

Të dhënat për 25 shoqëritë e mbetura i përkasin shoqërive të vogla dhe shumica prej tyre ofrojnë vetëm shërbimin e ujit, sepse shërbimi i kanalizimeve ofrohet nga bashkitë/komunat. Duhet theksuar se në kampion përfshihen edhe shoqëri që ofrojnë vetëm shërbimin e ujit, por duke qënë se të dhënat për kanalizimet ekzistojnë për ta bërë analizën më të plotë vendosa të përfshij këto shoqëri në kampionim.

Si konkluzion, shoqëritë që nuk përfshihen në analizën e të dhënave pasi ofrojnë vetëm shërbimin e ujit apo dhe ato shoqëri të ujit që janë në kampion do të jenë pjesë e rekomandimeve që shoqëritë të konvergojnë drejt bashkimit të dy shërbimeve në një për të ulur kostot për të treja palët: pushtetin vendor, pushtetin qendror, investitorin dhe përfituesit e shërbimeve.

5.5 Mundësitë dhe kufizimet

Studimet në fushën e UK në Shqipëri janë të pakta. Të vetmet studime që mund të përmenden janë ato të realizuara nga Banka Botërore, të cilat janë hartuar nga ekspertë të sektorit me të dhëna nga puna kërkimore në terren. Për nga dijenia ime nuk ekziston ndonjë studim i publikuar që të përdorë model ekonometrik për të analizuar eficiencën e sektorit. Ky punim doktore është i pari që analizon në mënyrë sasiore çështje të këtij sektori. Një kufizim i studimit të sektorit të UK është mungesa e të dhënave për

shërbimet e kanalizimeve për disa shoqëri, të cilat ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë pasi shërbimet e kanalizimeve janë nën administrimin e bashkive/komunave. Të dhënat për sektorin kanë filluar të rregjistrohen në vitin 2005 në kuadër të projektit të Bankës Botërore duke përdorur metodologjinë e benchmarkut të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit⁵⁷, Rrjetit Ndërkombëtar të Benchmarking dhe Shoqatës Amerikane të Ujit. Mbështetur në këtë metodologji u përzgjedhën treguesit e performancës që do të monitoroheshin. Ndonëse të dhënat e sektorit mund të kenë ekzistuar edhe më parë në databazën e institucioneve përgjegjëse, ajo që ka munguar është grumbullimi i të dhënave në mënyrë të organizuar dhe llogaritja e treguesve të performancës që do të mund të mbështesnin analiza të ndryshme të nevojshme për sektorin.

Në të njëjtën mënyrë studimet në fushën e PPP-ve në Shqipëri janë të pakta, kjo dhe për faktin sepse PPP-të kanë vetëm disa vite që kanë filluar të aplikohen në Shqipëri. Në fushën e UK forma më e përhapur e PPP-ve ka qënë nëpërmjet kontratave të menaxhimit dhe një rast kontrate konçensioni, të cilat nuk kanë rezultuar të jenë të suksesshme. Në këtë kuadër, një kufizim i studimit mund të jetë mungesa e informacionit mbi eksperiencën e PPP-ve në këtë sektor për të evidentuar problematikën dhe mundësitë e mëtejshme dhe studime empirike. Së fundmi, të dhënat për investimet nga donatorët dhe institucione bilaterale në sektorin e UK janë të vlefshme nga 2000-2012 dhe mungesa e të dhënave për periudhën përpara vitit 2000 nuk jep një situatë reale të të gjitha investimeve të kryera nga investitorët.

Mundësitë e këtij kërkimi shkencor janë: (i) përdorimi i gjetjeve nga ERRU, shoqëritë e UK, donatorët në sektor dhe studjues të interesuar për fushën e politikave publike; (ii) vendosja e një ure bashkëpunimi me ERRU për të vazhduar kërkime të mëtejshme shkencore për sektorin.

⁵⁷ https://www.ib-net.org/en/texts.php?folder_id=118

5.6 Rëndësia e studimit

Për ata që janë të përfshirë në negocimin dhe hartimin e politikave lidhur me sektorin e UK qëllimi i këtij kërkimi është të analizojë modelet e rritjes së eficiencës së sektorit dhe të rekomandojë një model rajonalizimi për Shqipërinë duke përdorur PPP si instrument që mundëson zbatueshmërinë e tij. Alternativat që do të burojnë nga ky studim do të botohen në faqen zyrtare web të Universitetit Europian të Tiranës dhe do t'i propozohen Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ERRU, DPUK, donatorëve të interesuar dhe politikbërësve në këtë fushë. Në të njëjtën kohë rezultati i këtij studimi nuk do t'i japë vetëm një zgjidhje problemit publik që Qeveria Shqiptare po ndesh lidhur me këtë sektor, por do t'i shërbejë gjithashtu popullsisë si përfitues përfundimtar, e cila është e prekur nga problematikat e furnizimit me këto shërbime. Studimi do t'i shërbejë studiuesve akademikë që kryejnë studime më të thelluara, të cilët studjojnë problematikën e sektorit dhe PPP-të si pjesë e politikës publike.

Ajo që është më e rëndësishme është se studimi fokusohet në një iniciativë të Qeverisë Shqiptare të shprehur në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017 lidhur me bashkimin e disa kompanive dhe krijimin e rajoneve. Kjo tenton ta bëjë një punim studimor të aplikueshëm për sfidat konkrete të një prioriteti konkret, ose të ndihmojë cilësinë e politikave publike në një sektor të vlerësuar problematik. Së fundmi ky punim është aktual në kuadër të reformës së re territoriale.

5.7 Kuptimi teorik i maksimizimit të fitimit të shoqërisë U&K

Matja e performancës relative të firmave është një çështje mjaft e komplikuar. Ekzistojnë dy metodologji, seicila me avantazhet dhe disavantazhet: modelet ekonometrike dhe modeli jo parametrik DEA (Sabbione, 2006:3). Nuk është ende e qartë se cili model duhet të përdoret në ç'do situatë të veçantë (Estache & Rossi, 1999:1-23; Berg & Lin, 2005:1-20). Studime të mëparshme të kompanive të ujësjellës kanalizimeve kanë përdorur në përgjithësi njërin ose tjetrin. Megjithatë disa studime janë përpjekur të përdorin të dyja metodologjitë kur rendisin firmat për nga

performanca, duke shqyrtuar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë e renditjeve sipas efijencës (Cubbin & Tzanidakis, 1998:75-85; Berg & Lin, 2005:1-20).

Ky punim mbështetet në teknikat ekonometrike, të cilat përdorin parametra ose variabla. Në përgjithësi modeli jo-parametrik DEA mund t'i japë përgjigje disa pyetjeve të rëndësishme. Megjithatë ky punim mbështetet në modelin e parametrave për të vlerësuar parametrat më të rëndësishëm dhe për të testuar rëndësinë relative të variablave (Cubbin & Tzanidakis, 1998:75-85; Berg & Lin, 2005:1-20). Kur duhet të zgjedhim sesi të matet efijenca me modelin ekonometrik, analistët kanë dy opsione: funksionet e kostos dhe funksionet e prodhimit. Asnjë prej këtyre nuk është perfekte, për shkak të të dhënave të kufizuara. Preferenca për njërin ose tjetrin varet nga rrethanat e veçanta në 5 fusha siç analizohet nga Sabbione (2006:4-5):

- 1) *Mjedi ku operohet*: Ky është një faktor institucional që tregon mjedisin brenda të cilit vepron kompania që kryen aktivitetet e saj. Kur flasim për maksimizimin e fitimit, një funksion prodhimi mund të jetë një zgjedhje e natyrshme për një kompani, e cila mund të zgjedhë nivelin e saj të prodhimit. Megjithatë, nëse kompania ka një “detyrim për të shërbyer”, asaj do t'i duhet të prodhojë aq sa kërkohet nga konsumatorët. Në këtë drejtim, funksioni i prodhimit mund të mos jetë më i përshtatshmi.

Në rastin e Shqipërisë mund të jetë më e aplikueshme një funksion kostoje sepse shoqëritë janë të madhësive të ndryshme dhe zonat e shërbimit janë po ashtu të ndryshme. Shoqëritë kanë për detyrim t'i shërbejnë popullatës dhe në këtë drejtim është më e përshtatshme që një shoqëri të prodhojë sa kërkohet nga konsumatorët. Në kushtet kur 42 shoqëri ju shërbejnë një numri konsumatorësh më të vogël se 50,000 banorë ky fakt tregon se ka mungesë ekonomie shkalle dhe maksimizimi i fitimit mbi bazën e prodhimit nuk do të ishte i përshtatshëm.

- 2) *Të dhëna të kufizuara*: Vlefshmëria e të dhënave është thelbësore në përzgjedhjen e modelit empirik. Përdorimi i funksionit të prodhimit kërkon të dhëna mbi shumën e njësive fizike të të gjitha inputeve dhe produkteve, ndërsa funksioni i kostos kërkon më tepër çmimet e inputeve, sesa sasinë, për të përfutur

produktet e vrojtuar. Një problem me funksionin e kostos është se çmimet relative të inputeve raportohen rrallë në databazë. Vetëm, çmimi i punës, e llogaritur si shuma e pagave ndaj numrit të punonjësve të kompanisë është në përgjithësi e vlefshme.

Ky konstatim vlen në rastin e Shqipërisë. Në hyrje të këtij punimi u përmend fakti se një nga kufizimet e këtij studimi është mungesa e të dhënave. Analiza në këtë punim fillon në vitin 2006, kjo pasi ky është viti që përkon me grumbullimin e të dhënave në nivel sektori dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të DPUK. Qëllimi fillestar i punimit ishte që analiza të kryhej të paktën për 10 vitet e fundit.

- 3) *Përkufizimi i produktit*: Një çështje që del kur përdoret qoftë funksioni i prodhimit apo i kostos është përkufizimi i produktit. Variablet e përdorura në studimet e mëparshme kanë përfshirë numrin e konsumatorëve të shërbyer, numrin e lidhjeve dhe/ose volumin e ujit të shpërndarë. Të gjitha këto janë matësa të mundshëm të produktit të kompanive të ujësjellës kanalizimeve. Disa studime konsiderojnë mundësinë e më shumë se një produkti (Saal and Parker, 2001:253-268). Shumëllojshmëria është e vështirë për t'u zgjidhur me anë të funksionit të prodhimit, duke qenë se na kufizon për të zgjedhur vetëm një produkt.

Ky përfundim vlen në rastin e Shqipërisë. Shoqëria ka disa objektiva që duhet të arrijë dhe kjo matet përmes produkteve që ajo parashikon vit pas viti. Synimi për ç'do shoqëri është që të rrisë fitimin dhe kjo realizohet duke përmbushur disa objektiva që maten me produktet si psh. rritja e numrit të konsumatorëve të shërbyer, rritja e numrit të lidhjeve etj. Në këtë kuadër, matja e efijencës vetëm me një produkt siç parashikon funksioni i prodhimit nuk do të jepte një panoramë të qartë të shoqërisë. Pra, funksioni i kostos është më i përshtatshëm në rastin e shoqërive UK në Shqipëri.

- 4) *Specifikimi teknologjik*: Së fundmi, në të dyja rastet si në funksionin e prodhimit ashtu dhe të kostos vlera e parametrave të jashtëm mund të përfshihet nëse supozojmë se ato ndikojnë teknologjinë e përdorur nga kompania. Disa nga variablet e mjedisit jashtë kompanisë janë përfshirë në studimet e mëparshme: pjesa e ujit të shpërndarë te konsumatorët rezidentë (të vegjël) kundrejt

konsumatorëve tregëtare (mëdhenj), densiteti i popullsisë në zonën e shërbyer, raporti i ujit që vjen nga sipërfaqja kundrejt burimeve nënujore, raporti i lidhjeve që maten, lloji i trajtimit që aplikohet për ujin (klorifikimi, dizifektimi), niveli i korrupsionit dhe qeverisja (kur bëhen studime në disa vende), pronësia publike kundrejt pronësisë private, faktorë rajonalë (për të kapur faktorët teknologjikë), pjesa e ujit të blerë kundrejt ujit të furnizuar vetë dhe numrit të zonave të shërbyera etj.

Ndonëse shumë nga këto variabla ngjajnë të arsyeshme, shumë studime kanë arritur në konkluzionin se disa variabla duhen hequr për shkak të mungesës së koeficientëve sinjifikativë që do të justifikonin ekzistencën e variableve. Për shembull, Feigenbaum dhe Teeplws (1983:672-678) argumentojnë se dendësia e popullsisë ka një ndikim pozitiv në kosto, ndërsa kërkuesit e tjerë arrijnë në konkluzionin se kjo variabël ka ndikim negativ. Pra, për të përcaktuar sesi variabellet e jashtme ndikojnë koston kërkohet një specifikim i kujdesshëm i modelit. Kur analizohet ky faktor në rastin e Shqipërisë, nuk gjejmë ndonjë arsye për të përjashtuar variabellet që konsiderohen të jashtme. Kjo pasi mjedisi i Shqipërisë mund të nxjerrë në pah se një variabël e tillë ndikon mjaft në mjedisin operativ të brendshëm të kompanisë. Në këtë drejtim, ajo që mbetet është marrja parasysh e variablave, testimi i tyre dhe nxjerrja e konkluzioneve përkatëse.

Si përfundim, nuk ekziston në formë të prerë një marrëveshje se cili model është më i miri, siç u analizua më sipër. Kjo është arsyeja që në këtë punim doktoral kombinohet analiza sasiore me atë cilësore. Vlen të theksohet se ky punim duhet parë si kërkimor në kuptimin e të kuptuarit të variablave që ndikojnë koston operative vjetore të shoqërisë. Rezultatet do të jenë sugjeruese dhe nxitëse për të kryer studime të mëtejshme në të ardhmen në kushtet kur ky studim sasior me model ekonometrik është i pari i këtij lloji në Shqipëri për sektorin e UK.

5.8 Përshkrimi matematikor i funksionit të koston

Mbështetur në arsyet e shpjeguara më sipër mbi diferencat ndërmjet funksionit të koston dhe asaj të prodhimit dhe pas argumentave të dhëna mbi përshtatshmërinë në rastin e

Shqipërisë, ky studim do të përdorë funksionin e kostos. Supozojmë se një shoqëri UK mund të maksimizojë fitimin duke minimizuar koston e prodhimit të një niveli prodhimi të dhënë, duke supozuar se ekziston teknologjia (dmth kostoja e prodhimit). Sipas Sabbione (2006:6) zgjidhja për problemin e optimizimit është një funksion kosto:

$$C = f(Y, W, Z)$$

Ku Y është vektori i prodhimit, W është vektori i çmimeve të inputeve, dhe Z vektori i variablës jashtë mjedisit të shoqërisë. Supozojmë se funksioni i koston C mund të zbërthehet në dy funksione $g(\cdot)$ dhe $h(\cdot)$. Funksioni i koston $g(\cdot)$ do të ketë si argumenta çmimet e inputeve W dhe prodhimin Y, ndërsa funksioni $h(\cdot)$ do të përfshijë variablën e jashtme Z që ndikon teknologjinë e firmës. Kostoja e funksionit do të jetë:

$$C = g(Y, W) h(Z)$$

5.9 Të dhënat

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve ka publikuar të dhënat për shoqëritë U/K duke filluar nga viti 2006. Të dhënat janë publike në faqen zyrtare të DPUK dhe ky program administrohet nga Njësia për Monitorimin e të Dhënave dhe Benchmarking. Të dhënat janë online për secilën shoqëri U/K dhe përfshijnë një grup variablesh të përlllogaritura (financiare, operacionale, teknike etj.). Për këtë punim u përdorën të dhënat e përmendura, të cilat në disa raste ishin të përlllogaritura, ndërsa në disa raste të tjera u përlllogaritën psh. paga. Të dhënat për periudhën 2006-2012 përbëjnë përafërsisht 203 vëzhgime. Megjithatë në disa raste të dhënat nuk ishin të vlefshme dhe kjo e uli madhësinë e kampionit, por siç e përmendëm më sipër kampioni prej 29 kompani është përfaqësues.

5.10 Karakteristikat e funksionit të koston

Pasi kemi prezantuar anën matematikore të funksionit të koston ky seksion analizon modelin e regresionit të përdorur dhe rezultatet e testit të rëndësisë së modelit. Modeli i

përdorur është regresioni linear i shumëfishtë pasi analizohen disa variabla që ndikojnë në efikasitetin e shoqërisë së UK. Teorikisht modeli ka formulën e mëposhtme (Ramanathan, 2002:144):

$$Y_t = \beta_1 + \beta_2 X_{t2} + \dots \beta_k X_{tk} + \mu_t$$

Ku:

t është numri i vëzhgimeve të kryera që varion nga 1 te t

Y_t është variabla e varur shpjeguese

β_1 është konstantja

$\beta_2, \dots, \beta_k$ janë koeficientët këndorë për t 'u përcaktuar

$X_{t2}, \dots, X_{tk}$ janë variablet e pavarura shpjeguese dhe

μ_t është termi i gabimit

Në ekonometri për të shpjeguar variablën e varur përveç variablave sasiore përfshihen edhe variabla cilësore që mund të jenë shpjeguese shumë të mira të fenomenit që analizohet. Një variabël cilësore e quajtur “dummy” i referohet teknikave të përdorimit të variablave të koduara në mënyrë binare apo dikotomike (të koduara 0 dhe 1) që përfaqësojnë kategoritë e ndryshme të një niveli nominal të variablës. Në përgjithësi një variabël cilësore shpreh karakteristika diskrete.

Në ekonometri metoda më e përdorshme për regresionin linear të shumëfishtë është metoda e katrorëve të vegjël (OLS). Kjo metodë bën të mundur që të përcaktojë vijën e drejtë që është më afër të dhënave të analizuara që nënkupton se shumica e mbetjeve në katror është në minimum (Ramanathan, 2002:80).

Një aspekt i rëndësishëm i një kërkimi empirik është ngritja e hipotezave dhe testimi i tyre. Për testimin e hipotezave tre janë hapat që ndiqen (Ramanathan, 2002:153-154): (i) formulimi i dy hipotezave të kundërta me njëra tjetrën; (ii) përdorimi i testit statistikor dhe identifikimi i shpërndarjes së kampionit dhe (iii) marrja e vendimit për zgjedhjen e një prej hipotezave të ngritura. Testi statistikor shërben si rregull i vendimarrjes për të refuzuar hipotezën zero, ose për të mos e refuzuar hipotezën zero (Ramanathan, 2002:154).

Konkretisht hipotezat që ngrihen marrin këtë formë:

H_0 : $b_1 = b_2 = \dots = b_k = 0$ që do të thotë se nuk ekziston relacion linear

H_0 do të pranohet nëse vlera e F-statistik është më e vogël se vlera teorike F. Kjo do të thotë se $\text{Prob}(F\text{-statistik}) > 0.05$.

H_1 : të paktën një koeficient nuk është 0 që do të thotë se të paktën një variabël X ndikon linearisht mbi Y .

H_1 do të pranohet nëse vlera e F-statistik është më e madhe se vlera teorike e F. Kjo do të thotë se $\text{Prob}(F\text{-statistik}) < 0.05$.

Në rastin e këtij punimi variabla e varur është kostoja operative vjetore e shoqërisë, duke përjashtuar detyrimet e amortizimit. Në Shqipëri shumica e shoqërive janë me humbje dhe subvencionet nga pushteti qendror alokohen për të mbuluar kostot operative vjetore.

Në Shqipëri sfida për të gjitha shoqëritë siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare Sektoriale 2011-2017 është që shoqëria fillimisht të arrijë të mbulojë kostot operative dhe më pas si objektivi final është mbulimi i kostove totale, që do të jetë një tregues që shoqëria kalon në autonomi financiare. Konkretisht në Strategji përcaktohet se deri në vitin 2017 mbulimi i kostos direkte të operimit me të ardhurat dhe arkëtimet duhet të arrijë nivelin 100%. Ky është një argument i fortë për shoqëritë që të kuptojnë se cilat variabla ndikojnë më tepër në ndryshueshmërinë e variablës së varur.

Seti i parë i rezultateve përbëhet nga 3 specifikime të ndryshme për funksionin e kostos, mbështetur në variablet e prodhimit të zgjedhura: Modeli i Volumeve, Modeli i Popullsisë dhe Modeli i Lidhjeve. Këto versione quhen Modele bazë OLS pasi përjashton variablën e jashtme Z . Megjithatë ka mungesë informacioni, specifikimet tregojnë se një përqindje e lartë e ndryshueshmërisë në koston operative të firmave

shpjegohet vetëm me variablet e zgjedhura të pavarura që janë variablet e prodhimit dhe çmimin e inputeve W . Ky fakt shpjegohet nga koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 për këto regresione, i cili është më i lartë se 0.80 duke vërtetuar faktin se më shumë se 80% e ndryshueshmërisë së kostos operative vjetore shpjegohet nga variablet e pavarura të zgjedhura.

Secili model ka një variabël prodhimi që lidhet me shërbimin e ujit dhe një variabël prodhimi që lidhet me shërbimin e grumbullimit të kanalizimeve si në vijim:

Variablet e pavarura grupohen në 3 kategori (Sabbione, 2006:9-10):

1. Modeli i Volumeve përveç pagës përfshin variablet:

- Volumi i ujit të prodhuar në (000 m³)
- Volumi i kanalizimeve i grumbulluar (000 m³)
- Vëllimi i ujit të matur në (000 m³)

2. Modeli i Popullsisë përveç pagës përfshin variablet:

- Numri i popullsisë që shërbehet me ujë
- Numri i popullsisë që ka akses te shërbimet e kanalizimeve

3. Modeli i Lidhjeve përveç pagës me sistemin e ujësjellës kanalizimeve përfshin variablet:

- Numri total i lidhjeve me sistemin e ujit
- Numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve.

Variablet e pavarura janë përdorur në rastin e analizës për Shqipërinë pasi këto variabla janë të llogaritura për shoqëritë UK të analizës sonë dhe të publikuara në faqen zyrtare të DPUK.

Hipotezat teorike janë si në vijim:

Hipoteza H_0 : kosto operative vjetore nuk ndikohet nga variablet e pavarura të të treja modeleve dhe në këtë rast nuk ka relacion linear.

Hipoteza alternative $H_1 \neq H_0$: kosto operative vjetore ndikohet në mënyrë sinjifikative nga variabellet e pavarura të të treja modeleve, ose të paktën një prej variablave ndikon linearisht mbi variablën e varur që në këtë rast është kosto operative vjetore.

Hipotezat që ngrenë në këtë punim për modelin sasior janë:

1. Zvogëlimi i humbjeve teknike e ul vëllimin e ujit të prodhuar dhe koston operative vjetore.
2. Efekti i shkallës në lidhje me numrin e popullsisë që shërbehet me ujë/kanalizime duhet të jetë i rëndësishëm në uljen relative të koston operative vjetore.
3. Shtimi i matësave e rrit koston operative vjetore në mënyrë të ndjeshme.
4. Metodatat e deritanishme për renditjen e kompanive sipas efijencës duhet të ndryshojnë duke marrë parasysh renditjen sipas kushteve të operimit jashtë mjedisit.

Me anë të këtyre hipotezave do të testohen: (i) masa e uljes së vëllimit të ujit të prodhuar dhe atij që shkon për kanalizime që ndikon në uljen e koston operative vjetore; (ii) masa e rritjes së numrit të popullsisë së shërbyer që ndikon në uljen e koston operative vjetore dhe (iii) masa e rritjes së matësave që ndikon në rritjen e koston operative vjetore dhe (iv) faktorët jashtë mjedisit që duhet të merren parasysh në renditje.

Për të vlerësuar nivelin e efijencës së shoqërive kam ndërmarrë tre modele stokastike të funksionit të koston. Regresionet OLS ishin të vlefshme për të identifikuar variabellet sinjifikative që shpjegojnë ndryshueshmërinë e koston operative vjetore, por ndërtimi i renditjes sipas efijencës duhet të marrë parasysh inefijencën dhe po ashtu termin e gabimit. Termi i gabimit shpjegon faktorët e rastit që vijnë nga katastrofa natyrore apo kushte të tjera që janë të jashtme nga shoqëria dhe nuk varen prej saj si psh, pozita gjeografike me vendndodhje në një zonë që i shërben një numri të kufizuar popullsie, ose largësia nga aksesit në basene lumorë. Inefijenca është konstantja në funksionet stokastike që realizon ndarjen nga termi i gabimit duke shpjeguar efijencën e shoqërisë

pavarësisht kushteve të jashtme jo të favorshme të shoqërisë, të cilat mund ta kishin penalizuar.

Kapitulli në vijim jep rezultatet e testimit ekonometrik si dhe të kërkimit cilësor që bazohet në intervistat me drejtuesit e institucioneve të ndryshme të përfshirë me çështjet e sektorit UK.

KAPITULLI VI: REZULTATET PËR EFIÇIENCËN E SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

Ky kapitull jep rezultatet e testimit të tre Modeleve Bazë OLS, ku siç e përmendëm më sipër variabla e jashtme nuk merret parasysh $h(Z)$. Në këtë kuptim $C(\cdot)=g(\cdot)$.

6.1 Rezultatet e modelit bazë OLS

Tabela 6.1 Përmbledhje e Statistikave për Modelet Bazë OLS

Për Modelin e Volumeve:

Variabla	Vëzhgime	Mesatarja	Devijimi Standart	Minimumi	Maksimumi
LN KOSTO OPERATIVE	203	10.78009	1.354354	8.317204	14.45287
LN PAGA	203	5.844669	0.3050549	5.072671	6.808056
LN VËLLIMI UJIT TË PRODHUAR	203	7.500128	1.658615	4.60517	11.59958
LN VËLLIMI KANALIZ GRUMBULLUAR	186	6.167105	1.523327	2.079442	9.917996

Për Modelin e Popullsisë:

Variabla	Vëzhgime	Mesatarja	Devijimi Standart	Minimumi	Maksimumi
LN KOSTO OPERATIVE	203	10.78009	1.354354	8.317204	14.45287
LN PAGA	203	5.844669	0.3050549	5.072671	6.808056
LN POP SHËRB UJË	203	10.06328	1.466459	7.482214	13.7233
LN POP AKSES KANALIZ	195	9.698738	1.579222	5.607639	13.57662

Për Modelin e Lidhjeve:

Variabla	Vëzhgime	Mesatarja	Devijimi Standart	Minimumi	Maksimumi
LN KOSTO OPERATIVE	203	10.78009	1.354354	8.317204	14.45287
LN PAGA	203	5.844669	0.3050549	5.072671	6.808056
LN LIDHJET ME UJË	199	8.15966	1.947109	0.6931472	12.02472
LN LIDHJET ME KANALIZ	196	8.292021	1.414973	5.62852	11.92949

Burimi: Autori

Tabela 6.1 më sipër jep një përmbledhje statistikore të shpërndarjes nga mesatarja të ç'do variable sipas tre modeleve të analizuara. Të dhënat përfshijnë variabellet e mjedisit të brendshëm të shoqërisë, numrin e vëzhgimeve për ç'do variabël, mesataren, shpërndarjen nga mesatarja dhe pikat e minimumit dhe maksimumit që përbëjnë intervalin rreth të cilit luhaten vlerat e variableve.

Nga tabela e mësipërme mund të nxjerrim disa konkluzione si në vijim:

Së pari, në të treja modelet konstatohet se vlerat e variablës paga rreth mesatares janë më të përqëndruara se variabellet e tjera sepse shpërndarja e vlerave është 0.3 njësi nga mesatarja (5.8) dhe kjo shpërndarje është më e ulta. Kjo tregon se kjo variabël ka shpërndarje të përqëndruar gjatë gjithë periudhës së analizës 2006-2012.

Së dyti, në të treja modelet variabla e dytë më e mirë për nga shpërndarja pas pagës është kosto operative duke patur një mesatare rreth 10 njësi me një shpërndarje nga mesatarja prej 1.3 njësi, që tregon se dhe në këtë rast shpërndarja është e përqëndruar gjatë periudhës sonë të analizës. I njëjti konkluzion mund të arrihet për të gjitha variabellet e tjera, të cilat kanë shpërndarje të përqëndruar të vlerave të variableve të tyre rreth mesatares. Gjetjet e mësipërme ndihmojnë për të arritur te konkluzioni se interpretimi i mëtejshëm i variableve me anë të modelit ekonometrik do të ketë besueshmëri të lartë për shkak se variabellet kanë shpërndarje të përqëndruar të vlerave të variableve të tyre rreth mesatares.

Tabela 6.2 Modelet Bazë OLS për periudhën 2006-2012

Variabla e Varur: Kosto Operative

Variabla	MODELI		
	Volumit	Popullsisë	Lidhjeve
Konstante	3.850199*** (4.82) vlera t (0.000) vlera p	-0.1922845 (-0.30) vlera t (0.764) vlera p	2.971766*** (3.83) vlera t (0.000) vlera p
Paga	0.231528 (1.61) vlera t (0.110) vlera p	0.4476861*** (4.01) vlera t (0.000) vlera p	0.0913152 (0.65) vlera t (0.517) vlera p
Vëllimi Ujit të Prodhuar	0.6544855*** (12.05) vlera t (0.000) vlera p		
Vëllimi Ujit që shkon për kanalizimet	0.107497* (1.84) vlera t (0.067) vlera p		
Popullsia që shërbehet me ujë		0.6366187*** (8.94) vlera t (0.000) vlera p	
Popullsia që ka akses në kanalizime		0.2021717*** (3.02) vlera t (0.003) vlera p	
Lidhjet me matësa të ujit			0.0770307*** (2.67) vlera t (0.008) vlera p
Lidhjet me matësa të kanalizimeve			0.8050484*** (20.56) vlera t (0.000) vlera p
Vëzhgimet	186	195	192
R ²	0.8364	0.8918	0.8498

Burimi: Autori

Tabela 6.2 paraqet variabelt e pavarura të përdorura (të gjitha në formë logaritmike), koeficientët e vlerësuar dhe në kllapa jepen vlerat statistike dhe vlerat e probabilitetit p. Variablet përdoren në formë logaritmike sepse njësiti matëse të tyre janë të ndryshme dhe në këtë drejtim të gjitha interpretimet e variableve jepen në përqindje.

Nga kjo tabelë mund të nxirren disa konkluzione. *Së pari*, shohim se koeficienti i variablës PAGA është gjithmonë pozitiv, por jo gjithmonë i rëndësishëm. Paga është më e rëndësishme kur zgjedhim prodhimin duke patur si produkt popullsinë që i shërbehet. Në të treja rastet konfirmohet hipoteza se kostoja operative e firmës do të rritet nëse çmimi i punës rritet, por konfirmimi i hipotezës bëhet më specifik kur zgjedhim të prodhojmë mbi bazën e popullsisë së shërbyer pasi të gjithë treguesit janë pozitivë dhe sinjifikativë.

Konkretisht në mënyrë matematikore lidhja mes variableve jepet si më poshtë:

1. Modeli i volumit

Kosto operative = $3.8 + 0.23 \times \text{Paga} + 0.65 \times \text{Vëllimi i ujit të prodhuar} + 0.11 \times \text{Vëllimi i ujit që shkon për kanalizimet} + 0.54$

Kjo formulë tregon se duke mbajtur konstante të gjithë koeficientët e tjerë:

- Konstantja ka një marrëdhënie pozitive me kostot operative sepse një rritje me një përqind do t'i rrisë kostot operative me 3.8%.
- Një rritje me një përqind të pagave do t'i rrisë kostot operative me 0.23%.
- Një rritje me një përqind të vëllimit të ujit të prodhuar i rrit kostot operacionale me 0.65%.
- Një rritje me një përqind të vëllimit të ujit që shkon për kanalizimet i rrit kostot operative me 0.11%.

Rezultati është se variablet sipas modelit të volumit kanë një lidhje lineare pozitive me kostot operative.

2. Modeli i Popullsisë

Kosto operative = $-0.19 + 0.45 \times \text{Paga} + 0.64 \times \text{Popullsia që shërbehet me ujë} + 0.20 \times \text{Popullsia që ka akses ndaj shërbimeve të kanalizimeve} + 0.44$

Kjo formulë tregon se duke mbajtur konstante të gjithë koeficientët e tjerë:

- Konstantja ka një marrëdhënie negative me kostot operative sepse një rritje me një përqind do t'i ulë kostot operative me 0.19%.
- Një rritje me një përqind të pagave do t'i rrisë kostot operative me 0.45%.
- Një rritje me një përqind të popullsisë së shërbyer me ujë i rrit kostot operative me 0.64 %.
- Një rritje me një përqind të popullsisë që ka akses ndaj shërbimeve të kanalizimeve i rrit kostot operative me 0.20%.

Rezultati është se variablet sipas modelit të popullsisë kanë një lidhje lineare pozitive me kostot operative, përveç konstantes.

3. Modeli i Lidhjeve

Kosto operative = $2.9 + 0.09 \times \text{Paga} + 0.07 \times \text{Lidhjet me matësa për faturimin e shërbimeve të ujit} + 0.8 \times \text{Lidhje me matësa për faturimin e shërbimeve të kanalizimeve} + 0.52$

Kjo formulë tregon se duke mbajtur konstante të gjithë koeficientët e tjerë:

- Konstantja ka një marrëdhënie pozitive me kostot operative sepse një rritje me një përqind do t'i rrisë kostot operative me 2.9%.
- Një rritje me një përqind të pagave do t'i rrisë kostot operative me 0.09%.
- Një rritje me një përqind të lidhjeve me matësa për faturimin e shërbimeve të ujit i rrit kostot operative me 0.07%.
- Një rritje me një përqind të lidhjeve me matësa për faturimin e shërbimeve të kanalizimeve i rrit kostot operative me 0.8%.

Rezultati është se variablet sipas modelit të lidhjeve kanë një lidhje lineare pozitive me kostot operative.

Në të treja modelet koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 është i lartë që tregon se 83% e ndryshueshmërisë së kostos operative vjetore shpjegohet me variablet e modelit të

volumit, 89% me variabellet e modelit të popullsisë dhe 85% me variabellet e modelit të lidhjeve.

Të treja modelet kanë R^2 të lartë për të shpjeguar ndryshueshmërinë e kostos operative vjetore dhe asnjëra prej tyre nuk përjashtohet, por ndër tre modelet, modeli që shpjegon më tepër ndryshueshmërinë e kostove operative vjetore është modeli i popullsisë me koeficientin e përcaktueshmërisë prej 89%.

Analiza në vijim vlerëson ndryshimet në modelet bazë OLS duke marrë në konsideratë çështjet mjedisore që mund të ndikojnë teknologjinë e firmës. Konkretisht, do të kontrollohet efekti i faktorit të jashtëm duke përfshirë $h(Z)$ në analizën tonë. Në modelin përfundimtar OLS të treguar më poshtë, funksioni i kostos paraqitet si në vijim:

$$C = g(Y, W) + h(Z)$$

Variablet e jashtme testohen për të analizuar efektin e tyre në koston operative vjetore dhe për ta vlerësuar në detaje. Është e rëndësishme të kujtohet se duke patur PAGËN dhe vetëm një variabël prodhimi si për ujin dhe kanalizimet kjo ka bërë që të kemi një koeficient përcaktueshmërie R^2 të madhe dhe koeficientë sinjifikativë për variabellet sipas modeleve bazë OLS siç tregohet në tabelën 6.2.

Variabla e jashtme që është përfshirë në $h(Z)$ është si në vijim:

- Volumi i ujit i matur (000 m^3) është një variabël mjedisore.

Përpara se të kalojmë në analizën e regresionit do të vlerësohen të gjitha variabellet e brendshme dhe të jashtme nga ana statistikore.

Tabela 6.3 Përmbledhje statistikash për modelet përfundimtare bazë OLS

Për Modelin e Volumeve:

Variabla	Vëzhgime	Mesatarja	Devijimi Standart	Minimumi	Maksimumi
LN KOSTO OPERATIVE	203	10.78009	1.354354	8.317204	14.45287
LN PAGA	203	5.844669	0.3050549	5.072671	6.808056

LN VËLLIMI UJIT PRODHUAR	203	7.500128	1.658615	4.60517	11.59958
LN VËLLIMI KANALIZ GRUMBULLUAR	186	6.167105	1.523327	2.079442	9.917996
LN VËLLIMI I UJIT TË MATUR	186	5.612998	1.955937	-1.07881	10.57029

Për Modelin e Popullsisë:

Variabla	Vëzhgime	Mesatarja	Devijimi Standart	Minimumi	Maksimumi
LN KOSTO OPERATIVE	203	10.78009	1.354354	8.317204	14.45287
LN PAGA	203	5.844669	0.3050549	5.072671	6.808056
LN POP SHËRB UJË	203	10.06328	1.466459	7.482214	13.7233
LN POP AKSES KANALIZ	195	9.698738	1.579222	5.607639	13.57662
LN VËLLIMI UJIT TE MATUR	186	5.612998	1.955937	-1.07881	10.57029

Për Modelin e Lidhjeve:

Variabla	Vëzhgime	Mesatarja	Devijimi Standart	Minimumi	Maksimumi
LN KOSTO OPERATIVE	203	10.78009	1.354354	8.317204	14.45287
LN PAGA	203	5.844669	0.3050549	5.072671	6.808056
LN LIDHJET ME UJË	199	8.15966	1.947109	.6931472	12.02472
LN LIDHJET ME KANALIZ	196	8.292021	1.414973	5.62852	11.92949
LN VËLLIMI UJIT TË MATUR	186	5.612998	1.955937	-1.07881	10.57029

Burimi: Autori

Tabela 6.3 e mësipërme jep një përmbledhje statistikore të shpërndarjes nga mesatarja të ç'do variable të analizës sonë sipas tre modeleve të analizuara, me ndryshimin se në këtë rast përveç variableve të mjedisit të brendshëm të kompanisë përfshihet dhe një variabël e mjedisit jashtë shoqërisë. Edhe në këtë rast konstatohet se variabla që ka shpërndarjen më të përqëndruar të vlerave të saj nga mesatarja është variabla paga e

ndjekur nga kosto operative. Megjithëse në këtë rast përfshihet një variabël shtesë përsëri të gjitha variablet e tjera sipas tre modeleve kanë shpërndarje të përqëndruar të vlerave të tyre rreth mesatares. Edhe në këtë rast arrihet në konkluzionin se variablet e brendshme dhe të jashtme kanë shpërndarje të përqëndruar të vlerave rreth mesatares që tregon se interpretimi i rezultateve të tyre kanë besueshmëri sepse ato janë mjaft përfaqësuese.

Tabela 6.4 Modelet OLS për periudhën 2006-2012 vetëm për variablën mjedisore-Vëllimi Ujit të Matur

Variabla	Variabla e Varur: Kosto Operative		
	MODELI		
	Volumit	Popullsisë	Lidhjeve
Konstante	4.27644*** (5.31) vlera t (0.000) vlera p	-0.0614173 (-0.08) vlera t (0.935) vlera p	3.162032*** (3.87) vlera t (0.000) vlera p
Ln Paga	0.1656319 (1.17) vlera t (0.245) vlera p	0.3893714*** (3.18) vlera t (0.002) vlera p	0.0796103 (0.55) vlera t (0.584) vlera p
Ln Vëllimi Ujit të Prodhuar	0.53318*** (9.22) vlera t (0.000) vlera p		
Ln Vëllimi Ujit që shkon për kanalizimet	0.1128604* (1.87) vlera t (0.063) vlera p		
Ln Popullsia që shërbehet me ujë		0.5749276*** (7.02) vlera t (0.000) vlera p	
Ln Popullsia që ka akses në kanalizime		0.2840244*** (3.62) vlera t (0.000) vlera p	
Ln Lidhjet me matësa të ujit			0.0475238 (1.41) vlera t (0.160) vlera p
Ln Lidhjet me matësa të kanalizimeve			0.7664642*** (15.51) vlera t (0.000) vlera p

Ln Vëllimi i ujit të matur	0.1500166*** (5.11) vlera t (0.000) vlera p	0.002597 (0.09) vlera t (0.930) vlera p	0.0768459 ** (2.23) vlera t (0.027) vlera p
----------------------------	---	---	---

Vëzhgimet	175	178	179
R ²	0.8507	0.8822	0.8413

Burimi: Autori

Tabela 6.4 paraqet variabellet e pavarura të përdorura (të gjitha në formë logaritmike), koeficientët e vlerësuar dhe në kllapa vlerat t dhe vlerat e probabilitetit p. Variabellet përdoren në formë logaritmike sepse njësitë matëse të tyre janë të ndryshme dhe në këtë drejtim të gjitha interpretimet e variableve jepen në përqindje.

Nga kjo tabelë mund të nxirren disa konkluzione.

Së pari, kostoja operative ndikohet nga përfshirja e variablës vëllimi i ujit të matur që konsiderohet variabël mjedisore dhe është një përbërës i rëndësishëm i kostos. Kjo pasi koeficienti i përcaktueshmërisë R² është i lartë. Si rrjedhim variabla vëllimi i ujit të matur ndikon në koston operative vjetore në kuptimin që një rritje në vëllimin e ujit të matur i rrit kostot, që mund të shpjegohet me rritjen e kostove që duhen për blerjen e matësive, instalimin, mirëmbajtjen e tyre.

Së dyti, koeficienti i variablës PAGA është gjithmonë pozitiv, por jo gjithmonë i rëndësishëm. Edhe në këtë rast paga është më e rëndësishme kur zgjedhim prodhimin duke patur si produkt popullsinë që i shërbehet. Në të treja rastet konfirmohet hipoteza teorike se kostoja operative e shoqërisë do të rritet nëse çmimi i punës rritet, por konfirmimi i kësaj hipoteze bëhet më specifik kur zgjedhim të prodhojmë mbi bazën e popullsisë së shërbyer pasi të gjithë treguesit janë pozitivë dhe sinjifikativë.

Një ndër arsytet përse paga është më e rëndësishme me ndikimin më të madh te kostoja operative vjetore kur zgjedhim modelin e popullsisë krahasuar me dy modelet e tjera atë të volumit dhe matësive mund të jetë si në vijim: disa shoqëri kanë sistemin me rrjedhje të lirë të ujit direkt nga burimi, ndërsa disa shoqëri të tjera e prodhojnë ujin me ngritje

mekanike. Në rastin e modelit të volumit efekti i forcës punëtore tek kostot është më i ulët se në rastin e modelit të popullsisë pasi numri i punonjësve është i shprehur në 1000 banorë dhe në këtë drejtim shoqëritë duke qenë se ju shërbejnë një numri popullsie të vogël (<50,000), numri i punonjësve për 1000 banorë është i lartë duke ndikuar që paga të ketë ndikimin më të madh. Në rastin e modelit të popullsisë forca punëtore përfshin edhe koston e shërbimit të klientit dhe faturimin.

Konkretisht në mënyrë matematikore lidhja mes variableve jepet si më poshtë:

1. Modeli i volumit

Kosto operative = $4.2 + 0.16 \times \text{Paga} + 0.53 \times \text{Vëllimi i ujit të prodhuar} + 0.11 \times \text{Vëllimi i ujit që shkon për kanalizimet} + 0.15 \times \text{Vëllimi i ujit të matur} + 0.51$

Kjo formulë tregon se duke mbajtur konstantë të gjithë koeficientët e tjerë:

- Konstantja ka një marrëdhënie pozitive me kostot operative.
- Një rritje me një përqind të pagave i rrit kostot operative me 0.16%.
- Një rritje me një përqind e vëllimit të ujit të prodhuar i rrit kostot operative me 0.53 %.
- Një rritje me një përqind të vëllimit të ujit që shkon për kanalizimet i rrit kostot operative me 0.11%.
- Një rritje me një përqind të vëllimit të ujit të matur i rrit kostot operative me 0.15%.

Rezultati është se variablet sipas modelit të volumit kanë një lidhje lineare pozitive me kostot operative.

2. Modeli i Popullsisë

Kosto operative = $-0.06 + 0.38 \times \text{Paga} + 0.57 \times \text{Popullsia që shërbehet me ujë} + 0.28 \times \text{Popullsia që ka akses ndaj shërbimeve të kanalizimeve} + 0.002 \times \text{Vëllimin e Ujit të Matur} + 0.45$

Kjo formulë tregon se duke mbajtur konstantë të gjithë koeficientët e tjerë:

- Konstantja ka një marrëdhënie negative me kostot operative vjetore, një rritje me një përqind do t'i ulë kostot operative me 0.06%.
- Një rritje me një përqind të pagave i rrit kostot operative vjetore me 0.38 %.
- Një rritje me një përqind të popullsisë së shërbyer me ujë i rrit kostot operative vjetore me 0.57 %.
- Një rritje me një përqind të popullsisë që ka akses ndaj shërbimeve të kanalizimeve i rrit kostot operative vjetore me 0.28%.
- Një rritje me një përqind të vëllimit të ujit të matur i rrit kostot operative vjetore me 0.002%.

Rezultati është se variablet sipas modelit të popullsisë kanë një lidhje lineare pozitive me kostot operative vjetore, përveç konstantes.

3. Modeli i Lidhjeve

Kosto operative = $3.16 + 0.08 \times \text{Paga} + 0.04 \times \text{Lidhjet me matësa për faturimin e shërbimeve të ujit} + 0.76 \times \text{Lidhje me matësa për faturimin e shërbimeve të kanalizimeve} + 0.07 \times \text{Vëllimi i ujit të matur} + 0.52$

Kjo formulë tregon se duke mbajtur konstantë të gjithë koeficientët e tjerë:

- Konstantja ka një marrëdhënie pozitive me kostot operative vjetore.
- Një rritje me një përqind të pagave i rrit kostot operative vjetore me 0.08%.
- Një rritje me një përqind të lidhjeve me matësa për faturimin e shërbimeve të ujit i rrit kostot operative vjetore me 0.04%.
- Një rritje me një përqind të lidhjeve me matësa për faturimin e shërbimeve të kanalizimeve i rrit kostot operative vjetore me 0.76%.
- Një rritje me një përqind të vëllimit të ujit të matur i rrit kostot operative vjetore me 0.07%.

Rezultati është se variablet sipas modelit të lidhjeve kanë një lidhje lineare pozitive me kostot operative.

Në të treja modelet koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 është i lartë që tregon se 85% e ndryshueshmërisë së kostos operative shpjegohet me variablet e modelit të volumit, 88% me variablet e modelit të popullsisë dhe 84 % me variablet e modelit të lidhjeve. Të treja modelet kanë R^2 të lartë për të shpjeguar ndryshueshmërinë e kostos operative vjetore dhe asnjëra prej tyre nuk përjashtohet, por ndër tre modelet, modeli që shpjegon më tepër ndryshueshmërinë e kostove operative vjetore është modeli i popullsisë me koeficientin e përcaktueshmërisë prej 88%.

Sikurse është përmendur në këtë punim niveli i humbjeve në sektorin UK është i lartë. ERRU në raportin e performancës së sektorit për vitin 2012 raporton se niveli i humbjeve në nivel sektori është 67%. Po kështu në Sektorin e UK 2011-2017 raportohet se niveli i humbjeve duhet të reduktohet në 40%, pra ndryshimi është me 27%.

Atëherë duke përdorur konkluzionin e formulës së regresionit arrijmë në këto konkluzione:

1. Pakësimi i humbjeve teknike nga 67% në 40% do të ulë vëllimin e ujit të prodhuar me 45% dhe kostoja operative vjetore ulet me 24%. **(Hipoteza 1 vërtetohet)**
2. Duke i shërbyer një popullsie më të madhe nga 1%-5% kosto operative vjetore rritet më pak se rritja e popullsisë (nga 0.57% në 2.8%). **(Hipoteza 2 vërtetohet)**
3. Duke rritur numrin e matësive (10%-20%) kosto operative vjetore rritet shumë më pak (<0.5-<1%). **(Hipoteza 3 hidhet poshtë)**

Pasi kemi analizuar modelet bazë sipas modelit OLS për të parë efektin që variablet e pavarura kanë te variabla e varur kosto operative vjetore dhe nisur nga konkluzioni që këto variabla ndikojnë pozitivisht dhe në mënyrë sinjifikative te variabla e varur, analiza do të vazhdojë me testimin e efijencës së shoqërive UK. Në vijim paraqiten rezultatet e modelit ekonometrik stokastik të funksionit të kostos (stochastic cost frontier) që teston efijencën e shoqërive dhe i rendit shoqëritë nga më performantja tek më pak performante.

6.2 Renditja e shoqërive sipas efijencës

Për të vlerësuar nivelin e efijencës së shoqërive kam ndërmarrë tre modele stokastike të funksionit të kostos. Regresionet OLS ishin të vlefshme për të identifikuar variablet sinjifikative që shpjegojnë ndryshueshmërinë e kostos operative vjetore, por ndërtimi i renditjes sipas efijencës duhet të marrë parasysh inefijencën dhe po ashtu termin e gabimit. Termi i gabimit shpjegon faktorët e rastit që vijnë nga katastrofa natyrore apo kushte të tjera që janë të jashtme nga kompania dhe nuk varen prej saj si psh, pozita gjeografike me vendndodhje në një zonë që i shërben një numri të kufizuar popullsie, ose largësia nga aksesit në basene lumorë. Inefijencia është konstantja në funksionet stokastike që realizon ndarjen nga termi i gabimit duke shpjeguar efijencën e shoqërisë, pavarësisht kushteve të jashtme jo të favorshme të shoqërisë, të cilat mund ta kishin penalizuar.

Tabela 6.5 Modelet Stokastike të funksionit të kostos për periudhën 2006-2012

Variabla e Varur: Kosto Operative

Variabla	MODELI		
	Volumit	Popullsisë	Lidhjeve
Konstante	4.145568 *** (5.64) vlera z (0.000) vlera p	0.1443024 (0.22) vlera z (0.826) vlera p	2.979438 *** (3.38) vlera z (0.001) vlera p
Paga	0.2889724 (2.17) vlera z (0.030) vlera p	0.4446555 *** (3.98) vlera z (0.000) vlera p	0.0913152 (0.66) vlera z (0.512) vlera p
Vëllimi Ujit të Prodhuar	0.732743 *** (14.48) vlera z (0.000) vlera p		
Vëllimi Ujit që shkon për kanalizimet	0.0035915 * (0.07) vlera z (0.948) vlera p		
Popullsia që shërbehet me ujë		0.6538994*** (9.29) vlera z (0.000) vlera p	
Popullsia që ka akses në kanalizime		0.1841228*** (2.77) vlera z	

		(0.006) vlera p	
Lidhjet me matësa të ujit			0.0770308*** (2.70) vlera z (0.007) vlera p
Lidhjet me matësa të kanalizimeve			0.8050483 *** (20.78) vlera z (0.000) vlera p
Vëzhgimet	186	195	192
Wald chi2(3)	1096.15	1715.45	1106.47

Burimi: Autori

Nga tabela 6.5 rezulton se të dhënat janë të përafërta me ato të modeleve të regresionit dhe interpretimi i saj është i njëjtë me tabelat që kanë shpjeguar modelet bazë OLS për periudhën 2006-2012 për variablën e varur të kostos operative vjetore.

Tabela 6.6 Renditja finale e Shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2012

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Berat & Kuçovë</i>	<i>Berat & Kuçovë</i>	<i>Berat & Kuçovë</i>
<i>Elber</i>	<i>Elber</i>	<i>Elber</i>
<i>Shkodër</i>	<i>Shkodër</i>	<i>Shkodër</i>
Fier	Fier	Fier
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Korçë	Korçë	Korçë
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Lushnje	Lushnje	Lushnje
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Burrel	Burrel	Burrel
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Krujë	Krujë	Krujë
Kukës	Kukës	Kukës
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Librazhd	Librazhd	Librazhd
Mallakastër	Mallakastër	Mallakastër
Ersekë	Ersekë	Ersekë

Fushë Krujë	Fushë Krujë	Fushë Krujë
Pukë	Pukë	Pukë
Fushë Arrëz	Fushë Arrëz	Fushë Arrëz
<i>Delvinë</i>	<i>Delvinë</i>	<i>Delvinë</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Libohovë</i>	<i>Libohovë</i>	<i>Libohovë</i>
<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>

Burimi: Autori

Ajo që konstatohet nga kjo renditje është se 5 shoqëritë më të mira për nga eficientia përgjatë vitit 2012 (të dhënat mbi renditjen e eficientisë për periudhën 2006-2011 gjenden të bashkëngjitura në shtojcat 15-21) janë të njëjtat shoqëri sipas të treja modeleve të volumit, popullsisë dhe lidhjeve të cilat janë: Tirana, Durrësi, Berat & Kuçova, Fier dhe Elber Shpk. Termi i konstantes në modelin stokastik merr parasysh të tjerë faktorë përveç tre të përmendurve më sipër. Këto faktorë që ndikojnë në eficienti mund të jenë menaxhimi i mirë, staf i kualifikuar, ekspertiza e akumuluar etj. Ndërsa 5 shoqëritë me eficienti më të keqe janë të njëjtat shoqëri sipas të treja modeleve të volumit, popullsisë dhe lidhjeve të cilat janë: Delvinë, Rrogozhinë, Libohovë, Krastë dhe Rubik. Termi i konstantes në modelin stokastik edhe në këtë rast merr parasysh të tjerë faktorë përveç atyre të mësipërme. Faktorët që ndikojnë në inefficiency mund të jenë menaxhimi i keq, staf i pakualifikuar, mungesë ekspertize etj.

Rezultatet e testimit stokastik shkojnë në linjë me teorinë e eficientisë mbi ekonominë e shkallës dhe konkluzionet e studimeve empirike të kryera nga autorë të njohur se sa më shumë të rritet numri i konsumatorëve të shërbyer aq më e ulët do të jetë kostoja për njësi. Në të njëjtën kohë ky konstatim mbështet analizën e kryer për Shqipërinë në kapitullin 3 se një rritje në numrin e popullsisë që i shërbehet lidhet me rritjen e dendësisë së popullsisë, e cila ndikon direkt në arritjen e ekonomive të shkallës.

Nga rezultati i testimit vërtetohet hipoteza 4 se metodat e deritanishme për renditjen e shoqërive sipas eficientisë duhet të ndryshojnë duke marrë parasysh renditjen sipas kushteve të operimit. Këtë e tregoi termi i konstantes që shpjegon faktorë të tjerë që nuk kapen nga modeli i volumit, popullsisë dhe lidhjeve.

6.3 Krahasoni i renditjes së performancës së shoqërive me renditjen e ERRU

Në Shqipëri me fillimin e monitorimit të performancës së sektorit në vitin 2006 filluan të kryhen analiza mbi performancën ku shoqëritë krahasoheshin me një benchmark, ose standart të vendosur nga njësia e monitorimit të benchmarkut dhe me vonë nga ERRU. Është e rëndësishme që të krahasohet renditja e performancës së shoqërive sipas këtij studimi shkencor dhe asaj që ERRU kryen.

Konkretisht ERRU i kategorizon shoqëritë sipas tre grupimeve duke përdorur si kriter numrin e lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm. Sipas ERRU grupimi sipas lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm kundrejt madhësisë së zonës së shërbimit ndihmon për të bërë dallimin ndërmjet shoqërive të mëdha apo të vogla. Për secilin grup më pas llogaritet benchmarku për treguesit kryesorë të sektorit dhe performanca e secilës shoqëri llogaritet duke u krahasuar me benchmarkun/standartin e secilit indikator.

Renditja e shoqërive bëhet duke marrë në konsideratë renditjen e shoqërive sipas lidhjeve të furnizimit me ujë. Duke qënë se në këtë punim u arrit renditja e performancës së shoqërive rezultatet krahasimore paraqiten si në vijim:

Shoqëritë që performojnë më mirë janë:

PUNIMI SHKENCOR

1. Tirana
2. Durrës
3. Elber
4. Berat & Kuçovë
5. Shkodër

ERRU

1. Tirana
2. Korçë
3. Elber
4. Vlorë
5. Shkodër

Duhet theksuar se në këtë punim doktoral renditja u realizua sipas të treja modeleve dhe rezultatet si për shoqëritë që performojnë më mirë ashtu dhe ato që performojnë më dobët janë të njëjta, pra renditja e shoqërive nuk ndryshon.

Shoqëritë që performojnë më dobët janë:

PUNIMI SHKENCOR

1. Delvinë
2. Rrogozhinë
3. Libohovë
4. Krastë
5. Rubik

ERRU

1. Pukë Fshat
2. Orikum
3. Gjirokastër Fshat
4. Libohovë
5. Has

Arsyet e ndryshimeve në renditjen që konstatohen nga ky krahasim janë si në vijim:

- Të dyja llojet e renditjeve përdorin metodologji të ndryshme.
- Renditja e punimit shkencor merr në konsideratë të dyja llojet e shërbimeve dhe si rezultat shoqëritë që ofrojnë vetëm shërbimin e ujit nuk janë të përfshira, e cila është një vlerë e shtuar. Ndërkohë që ERRU e bën këtë renditje për të gjitha shoqëritë pa dallim në shërbimet që ofrojnë.
- Kriteri për ndarjen e kategorive të madhësisë i përdorur nga ERRU është sipas lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm, ndërkohë që punimi shkencor sjell ndarjen sipas modelit të volumit, të popullsisë dhe lidhjeve me matësa. Kjo mund të jetë një pikë e fortë e punimit shkencor në renditjen që përdoret.
- Një pikë e fortë e renditjes që ERRU bën është se renditja e shoqërive kryhet sipas disa indikatorëve të performancës duke dhënë një vlerësim të performancës së shoqërive nga disa aspekte.

Testimi i efijencës duke përdorur modelin ekonometrik është një kontribut shkencor që rekomandohet të merret parasysh nga ERRU. Si konkluzion, efijenca është vetëm një aspekt që lidhet me ekonominë e shkallës. Përveç këtij faktori ekzistojnë dhe faktorë të tjerë, institucionalë, politikë, administrativë dhe ligjorë që bashkimi i shoqërive dhe krijimi i rajoneve të zbatohet plotësisht. Në këtë kuadër modeli i rajonalizimit që propozohet do të përmbledhë të gjithë këta faktorë të përmendur. Modeli së bashku me rekomandimet përkatëse janë objekt i kapitullit në vijim.

6.4 Mësimet e nxjerra në drejtim të modelit të propozuar për rastin e Shqipërisë

Në fillim të këtij punimi është ngritur hipoteza cilësore se rajonalizimi i shoqërive UK rrit efikasitetin, nxit interesin e sektorit privat dhe lehtëson aplikimin e skemave të PPP sepse arrihen ekonomitë e shkallës.

Në kapitullin e 3-të u analizuan disa raste studimore lidhur me modelet e rajonalizimit që vende të ndryshme kanë zbatuar, ndërsa në kapitullin 4-ët u trajtua problematika e sektorit UK dhe nga analiza sasiore u konkludua se për cilin numër popullsie ekzistonin premisa për ekonomi të shkallës. Konkluzioni i përgjithshëm është që nuk ka një model universal të rajonalizimit dhe Shqipëria duhet të gjejë modelin që i përshtatet kushteve social ekonomike, historike, politike, gjeografike ashtu siç dhe Banka Botërore ka rekomanduar në studimin e saj të fizibilitetit për këtë qëllim. Në këtë seksion do të përmbliken rezultatet e eksperiencës ndërkombëtare, rezultatet e dhëna nga përfaqësuesit e institucioneve të niveleve të ndryshme me ndikim në sektor gjatë intervistave të zhvilluara mbi modelin e rajonalizimit që mund të jetë i përshtatshëm në rastin e Shqipërisë dhe analiza mbi premisat e ekonomisë së shkallës.

Ndër mësimet më kryesore të nxjerra për Shqipërinë dhe që duhet të merren parasysh në këtë punim janë: faktori kohë është esencial për tu marrë në konsideratë pasi mund të kërkojë vite, se rajonalizimi bëhet një domosdoshmëri kur qytetarët nuk janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve dhe bëjnë presion në drejtim të përmirësimit të shërbimeve dhe ky proces nxitet në kushtet kur kërkohet për të siguruar fonde më të mëdha nga financuesit privatë.

Të gjitha institucionet e intervistuar për qëllime të këtij punimi e shohin rajonalizmin si mënyrën më të duhur për rritjen e efijencës së sektorit dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Rajonalizimi sipas këndvështrimit të tyre do të sjellë efijencë në kosto sepse peshën më të madhe e kanë shpenzimet për personelin dhe bashkimi i shoqërive do të sjellë ulje të stafit dhe efijencë në kosto. Të gjithë të intervistuarit arrijnë në

konkluzionin se rajonalizimi shihet si mundësi për thithjen e fondeve më të mëdha dhe kryerjen e investimeve veçanërisht në zonat rurale.

Skema e rajonalizimit

Skema e rajonalizimit mund të jetë që njësitë e pushtetit vendor të krijojnë një shoqatë, e cila të hyjë në kontratë me kompanitë rajonale për ofrimin e shërbimeve, ose që njësitë e pushtetit vendor të vazhdojnë të mbeten aksionerë të shoqërive. Kompania rajonale mund të marrë përsipër vetëm funksionet e menaxhimit dhe operimit, por jo të financimit dhe investimit. Një tjetër skemë mund të jetë që kompania rajonale të lidhë një kontratë konçensionit me një operator privat, ose një kontratë menaxhimi për t'i besuar vetëm funksionet e operimit dhe menaxhimit. Mundësi për fonde më të mëdha financiare ose ekzistenca e operatorëve privatë të fuqishëm, të cilët janë të gatshëm të financojnë kompani të mëdha rajonale mund të jetë faktor për të përshpejtuar procesin e bashkimit të kompanive më të vogla dhe krijimin e rajoneve.

Kufijtë e bashkimit

Eksperienca ndërkombëtare tregoi se bashkimi i kompanive mund të kryhet mbi bazën e aksesit ndaj baseneve lumorë ose kufijve administrativë, të cilët jo domosdoshmërisht përkrijnë me kufijtë e aksesit në basene. Nga analiza e problematikës së sektorit u arrit në konkluzionin se shoqëritë fillojnë të arrijnë eficiencën si rezultat i ekonomive të shkallës kur numri i popullsisë së shërbyer është mbi 100,000 banorë. Ndërkohë Direktiva e Bashkimit Europian Kuadër për Ujin (2000/60/KE) e vitit 2000 për menaxhimin e burimeve ujore përcakton kuadrin e përgjithshëm të përdorimit dhe menaxhimit me eficiencë të burimeve ujore dhe ofron një sistem të vetëm menaxhimi të ujit nëpërmjet baseneve të lumenjve si njësi natyrore gjeografike dhe hidrike, në kontrast me kufijtë administrativë dhe politikë.

Eksperienca ndërkombëtare e rajonalizimit tregon se shumica e shoqërive të bashkuara janë kryer mbi bazën e kufijve administrativë. Kjo për shkak se kufijtë administrativë të një rajoni janë të ndryshëm nga kufijtë e baseneve lumorë dhe një njësi administrative

mund t'i përkasë më shumë se një baseni lumor. Kjo do të kërkonte shumë dialog dhe konsultime ndërmjet strukturave të bashkuara dhe institucioneve të baseneve lumorë. Në Shqipëri aktualisht janë 12 qarqe apo rajone administrative: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Për të qënë në përputhje me kërkesat e BE-së për të përfituar fonde të mëdha rajonale, Qeveria Shqiptare duhet të konsiderojë uljen e numrit të rajoneve administrative nga 12 në 6 apo në 4.

Nga intervista e zhvilluar me kryetarin ERRU, Z. Avni Dervishi dhe komisionerin pranë ERRU, Z. Altin Uka në përputhje me Direktivën Europiane rajonalizimi duhet të kryhet mbi bazën e baseneve sepse ndarja administrative mund të ndryshojë. Shqipëria ka 6 basene dhe rajonalizimi nuk konceptohet me 1 vit dhe është një proces. Procesi fillon me integrimin e njësive, grumbullohet informacioni dhe analizohet i gjithë ky informacion. Si rrjedhim, mund të zgjasë në kohë.

Nga intervista e zhvilluar me komisionierin pranë ERRU, Z. Arjan Jovani kufijtë e bashkimit në kuadër të rajonalizimit mund të jenë një kombinim i ndarjes administrative dhe të aksesit në basenët lumorë sipas rastit specifik që analizohet. Konkretisht në muajin Dhjetor 2013 është kryer bashkimi i shoqërisë Malësi e Madhe me shoqërinë Shkodër fshat. Ndonëse të dyja këto shoqëri i përkasin ndarjeve administrative të ndryshme ato janë bashkur mbi bazën e kriterit të aksesit ndaj të njëjtit basen lumor.

Qëllimi i Bashkimit

Ekzistojnë mjaft shembuj si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në zhvillim ku sigurimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe pasjes së aksesit të kanalizimet janë të përqëndruara në një kompani të vetme. Sipas VKM nr.678 datë 3.10.2007 veprimtaria ligjore e ndërmarrjeve aksionere të UK përcaktohet si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe mirëmbajtja e të dy shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Në Shqipëri nga 58 SHUK aktuale vetëm 26 prej tyre i ofrojnë të dyja shërbimet. Për shoqëritë që ofrojnë vetëm shërbimin e ujit, shërbimet e kanalizimeve ofrohen nga Bashkia apo komuna në përputhje me zonën e juridiksionit.

Nga intervista me Z. Jovani, komisioner pranë ERRU, qëllimit i bashkimit duhet të jenë të dyja shërbimet dhe të gjitha funksionet që nga operimi deri te investimi. Po kështu mënyra më e mirë për të bërë të mundur zbatimin e modelit të rajonalizimit është me anë të partneritetit publik privat sepse ky sektor është monopol dhe pjesëmarrja dhe pronësia e qeverisë duhet të jetë evidente dhe një element i rëndësishëm. Ajo që do të mbetet sfida në kuadër të rajonalizimit është se deri në çfarë shkalle do të kryhet bashkimi: duke agreguar fillimisht disa funksione horizontalisht, apo duke agreguar vertikalisht të gjitha funksionet.

Mënyrat e Rajonalizimit

Është e njohur se pushteti qendror ka detyrën kushtetuese për të menaxhuar burimet ujore, të monitorojë dhe të sigurohet se qytetarët marrin shërbimet bazë siç është furnizimi me ujë dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve. Në këtë kuadër mund të jetë e llogjikshme që iniciativa për rajonalizimin e shoqërive duhet të jetë më direktivë nga pushteti qendror.

Megjithatë eksperiencia ndërkombëtare tregoi se ekzistojnë 3 mënyra sesi mund të kryhet ky process:

- Rajonalizim mbi baza plotësisht vullnetare të SHUK;
- Rajonalizim mbi baza vullnetare, por me rregullime nga pushteti qendror;
- Rajonalizim plotësisht i udhëhequr dhe kontrolluar nga pushteti qendror.

Në kapitullin e 3-të u analizuan të treja opsionet dhe rezultoi se opsioni i parë mund të jetë më i përshtatshëm në një vend të konsoliduar përse i përket decentralizimit që do të thotë se vetë NJQV janë të ndërgjegjësuar për përfitimet dhe kostot që vijnë nga ky proces dhe marrin vetë një iniciativë të tillë. Opsioni i tretë mund të jetë një mënyrë me një kosto më të ulët, por zbatimi i tij do të sillte kontradita me pushtetin vendor në kushtet kur në bazë të ligjit për decentralizimin ky i fundit ka marrë përsipër role dhe përgjegjësi të veta. Në këtë rast mund të përdoret ky opsion kur shoqërohet me incentivë apo kushtëzime për t'i mbështetur me skema apo burime financimi.

Sipas ERRU lidhur me rajonalizimin në Shqipëri është i nevojshëm vullneti politik. Në këtë kuptim mënyra më e mirë është akti ligjor me incentivë për pushtetin vendor dhe ERRU beson se ky është modeli më i mirë pasi uji është një e mirë publike dhe burimet ujore janë pronë shtetërore. Sipas ERRU edhe në Kosovë rajonalizimi është bërë nga lart poshtë me ligj me këshillimin e vendeve më të zhvilluara, siç ishte Mbretëria e Bashkuar. Në kuadër të reformës së re territoriale rajonalizimi duket se ka një fillim të mbarë dhe ekziston vullneti politik i shprehur në miratimin me shumicë votash të ligjit nr. 115/2014 datë Korrik, 2014.

Sipas Njesisë për Monitorimin dhe Benchmarkun pranë DPUK rajonalizim me kushtin e vullnetit të lirë mbetet një opsion mjaft i vështirë në rastin e Shqipërisë për shkak të aktorëve të shumtë, interesat e të cilëve duhet të konsolidohen. Një tjetër problem i evidentuar lidhet me procesin e decentralizimit sipas të cilit fillimisht cdo komunë duhej të kishte sistemin e vet dhe ta menaxhonte dhe shoqëria më pas kaloi te pushteti vendor. Ndërkohë sipas VKM 660 vendimi i transferimit të pronësisë së shoqërive te pushteti vendor përcaktonte kushtin që për 2 vjet aksionet e shoqërisë nuk mund të ndaheshin apo të shiteshin. Ky afat ka përfunduar dhe konflikti qëndron në faktin se në një anë kemi rajonalizim dhe nga ana tjetër ç'rajonalizim sepse afati ka mbaruar dhe pushteti vendor është i lirë të ndahet. Në këtë kuadër duhet vendimarrje politike sesi do të jetë rajonalizimi. Kjo çështje është e zgjidhur në kuadër të reformës së re territoriale.

Kriteret e Bashkimit

Eksperienca ndërkombëtare tregoi se ekonomia e shkallës është kriteri kryesor kur kompanitë konsiderojnë bashkimin, por ky nuk është i vetmi kriter. Disa vende për shkak të kriterit historik në drejtim të konsolidimit të procesit të decentralizimit aplikuan formën e bashkimit mbi bazën e vullnetit të lirë nga ana e kompanive.

Kryetari i ERRU ndau eksperiencën e rajonalizimit në Kosovë ku ka 7 kompani rajonale dhe Hollanda ku ka 6 kompani rajonale. Sipas kryetarit të ERRU, Z. Dervishi rajonalizimi duhet të marrë parasysh 3 aspekte bazë për t'u bashkuar:

- Institucional
- Ekonomik
- Teknik

Sipas komisionerit pranë ERRU Z. Jovani, kriteret që duhet të mbahen parasysh janë: (i) performanca e shoqërisë në kuptimin që fillimisht të fillojë ky proces me shoqëritë që performojnë më mirë siç është rasti i shoqërisë Korça qytet me Korçën fshat; (ii) kriteri i investimeve që do të thotë se ato shoqëri që e kanë rritur performancën e tyre si rezultat i investimeve, mund të bashkohen me shoqëri të tjera, për të përfituar nga investimet e kryera dhe (iii) kriteri i zonës turistike në të cilën ofrojnë shërbimet shoqëritë UK siç mund të jenë shoqëritë: Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë Qytet, Gjirokastrë fshat dhe Delvinë.

Në rastin e Shqipërisë ashtu siç e tregoi dhe eksperiencia ndërkombëtare kriteret që duhet të mbahen parasysh gjatë rajonalizimit janë teknike, gjeografike, ekonomike, sociale dhe përmbushja e këtyre kriterëve është plotësisht e realizueshme. ERRU duke qënë një ndër aktorët kryesorë të sektorit mund të vendosë kushtet që i detyrojnë shoqëritë që bashkohen të rajonalizohen.

Sipas MPPTT qëllimi i rajonalizimit shihet në këndvështrimin e ndarjes së kostove për të rregulluar ekuilibrat buxhetorë ndërmjet shoqërive me rënie të lirë dhe atyre që përdorin pompa për prodhimin e ujit. Një ujësjellës që nuk ka shpenzime teknike mund të bashkohet me një tjetër që ka shpenzime të konsiderueshme. Konkretisht ekziston një studim nga Ministria e Brendshme (përgjegjëse për politikën ndaj pushtetit vendor) për të parë se cili është ndryshimi i kapitaleve psh linjat e transmetimit, pikat e pompimit, niveli i pastërtisë për klorifikim.

Kuadri Ligjor

Në kapitullin 4 u analizua kuadri ligjor për nga perspektiva e rajonalizimit nga ku u arrit në konkluzionin se ekziston një bazë e mirë ligjore për rajonalizimin në drejtim të menaxhimit të burimeve ujore, administrimit të shoqërive dhe rregullimit të sektorit. Megjithë bazën e mirë ligjore që ekziston në Shqipëri përsëri do të jetë e nevojshme hartimi i një ligji specifik për shërbimet e UK, siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare për sektorin 2011-2017.

Ky ligj do të rregullojë veçanërisht çështjet që lidhen me kompanitë rajonale dhe do të përcaktojë:

- statutet dhe pronësinë e ndërmarrjeve rajonale;
- parimet dhe inventarin dhe vlerësimin e aseteve;
- hyrjen dhe daljen nga tregu;
- strukturat e shërbimeve të bashkuara të shitjes me pakicë.

Ndonëse në Strategji parashikohej që ligji të jetë funksional në fund të muajit Qershor 2013, ky ligj ende nuk ka filluar të hartohet, apo dhe diskutohet me palët e interesuara. Sipas Kryetarit të ERRU shumë vende të botës kanë hartuar një ligj të posaçëm për shërbimet UK, Banka Botërore ka rekomanduar Aktin e Ujit dhe në rastin e Shqipërisë është i nevojshëm unifikimi ligjor, i cili do të rregullonte problemin e mbivendosjes së institucioneve. Në kushtet kur rajonalizimi po zbatohet nga një projekt i financuar nga Bashkimi Europian, hartimi i ligjit bëhet një domosdoshmëri që duhet të konsiderohet sa më shpejt. Sipas ERRU nga eksperiencia ndërkombëtare hartimi i ligjit kërkon më shumë se 3 vjet kohë (eksperiencia në Lindjen e Mesme). Sipas komisionerit pranë ERRU, Z. Jovani, hartimi i një ligji të posaçëm për korporatat publike është i nevojshëm në kuadër të rajonalizimit.

Sipas shefes së sektorit ekonomik dhe monitorimit pranë ERRU, ligji i ri që propozohet për korporatat publike do rishqyrtojë të gjitha ligjet që përplasen. Konkretisht, shoqëritë u konsideruan format e para të privatizimit prandaj i nënshtrohen ligjit të kompanive tregëtare, por nga ana tjetër e marrin financimin nga Qeveria dhe në këtë kuadër

ekzistojnë përplasje mes ligjeve. Ligji i pushtetit vendor po kështu me ligjin e ERRU ka përplasje sepse pushteti vendor ka kompetencën për të krijuar një shoqëri ndërkohë që ligji i ERRU i jep të drejtën të heqë liçencën.

Tarifat

Eksperienca nderkombëtare e trajtuar në kapitullin 3-të tregoi se disa vende aplikojnë tarifa të diferencuara, ndërsa disa të tjera tarifa uniforme. Sipas intervistës me shefen e sektorit ekonomik dhe monitorimit pranë ERRU, është e paqartë ende nëse Enti do të përcaktojë tarifën për kompaninë rajonale dhe ajo më pas e përcakton për shoqëritë që janë bashkuar. Duke ju referuar ligjit aktual mendohet që ERRU të vendosi çmimin deri në bazë për ç' do bashkues, por këto janë ide nga eksperienca të ndryshme. Ekzistojnë 3 lloj kategorish për të ardhur te çmimi mesatar ku fillimisht ulet çmimi për konsumatorin familjar dhe rritet çmimi për kategoritë institucione buxhetore dhe private, të cilët në njëfarë mënyre do të kompensojnë tarifën e ulët për familjarët. Por në kushtet kur shoqëritë e bashkuara konsolidohen atëherë mund të aplikohet skema drejt unifikimit, që do të thotë rritje e tarifës për familjarët në një masë më të madhe krahasuar me kategoritë e tjera dhe rritja për kategoritë e tjera në një masë më të ulët (psh. 15% për familjarët dhe 6% për publike dhe private për të arritur në të njëjtin nivel). Tarifat mendohen të jenë të larta si fillim.

Metodologjia e llogaritjes së tarifave mund të ndryshojë kur të bëhet rajonalizimi, por baza do të mbetet. Një metodologji është që të kesh fitimin si bazë, por ka metodologji specifike për marzhin e fitimit. Edhe shoqëritë më të mira nuk arrijnë të mbulojnë kostot totale. Mendohet që në vitin 2017 të mbulohet kostoja totale. Kostot e operimit kanë arritur të mbulohen nga ana e disa shoqërive. Kostot e investimit dhe amortizimit janë të larta prandaj dhe tarifa do të jetë e lartë. Nga intervista me komisionerin pranë ERRU, Z. Jovani, modeli i propozuar për rajonalizimin përveç karakteristikave të trajtuara në këtë punim, mund të përfshijë rregullime që për shërbime specifike si psh. që faturimi mund t'i nënkontraktohet një kompanie tjetër private.

Konkluzioni i përgjithshëm është se modeli i propozuar i rajonalizimit duhet të jetë një model që nuk merr parasysh vetëm çështjen e ekonomive të shkallës, por kriteret gjeografike, historike, social ekonomike. Kuadri ligjor, kushtet institucionale dhe administrative janë të përshtatshme që ky proces të fillojë të zbatohet në Shqipëri. Sipas ERRU një mundësi për rajonalizimin mund të jenë shoqëritë që i përkasin Berat - Kuçova, Poliçanin dhe Ura Vajgurore meqenëse ekziston eksperiencë e mirë në drejtim të bashkimit të shoqërive Berat me Kuçovën. Në studimin tonë Poliçani dhe Ura Vajgurore nuk ishin pjesë e kampionit për shkak se të dhënat për këto dy kompani ishin vetëm përsa i përket furnizimit me ujë.

Sipas njësisë së monitorimit dhe benchmarkut pranë DPUK modeli pilot me 3 kompani rajonale që po zbatohet aktualisht në Shqipëri nga (Consulting Group GmbH në bashkëpunim me VA dhe SETEC Engineering), mund të jetë një përpjekje mjaft e mirë në rast se më parë miratohej ligji specifik për rajonalizimin dhe më pas vendimmarrja do të ishte një hap më i lehtë.

Modeli për rajonalizimin i propozuar nga Consulting Group GmbH në bashkëpunimin me VA dhe SETEC Engineering ka mjaft elementë të ngjashëm me ato që trajton ky punim. Konkretisht konkluzionet mbi rajonalizimin sipas këtij grupi përmbledhen si më poshtë:

1. Modeli i rajonalizimit në rastin e Shqipërisë duhet të jetë një model unik që t'i përshtatet kushteve ekonomike, sociale, gjeografike, historike.
2. Përsa i përket kufijve të bashkimit analizohen të dyja rastet: ndarjes administrative dhe të aksesit ndaj baseneve lumorë, por në rastin e Shqipërisë rekomandohet bashkimi mbi bazën e ndarjes administrative me argumentin se sistemi i baseneve është më kompleks dhe nuk ka një databazë të konsoliduar me të dhëna për basenet.
3. Lidhur me kuadrin ligjor rekomandohet që të hartohet një ligj i veçantë për "Korporatat Publike" që të rregullojë aspektet e rajonalizimit.
4. Përsa i përket mënyrave të rajonalizimit analizohen të treja llojet: (i) vullnetar; (ii) vullnetar me incentiva nga pushteti qendror dhe (iii) i drejtuar nga pushteti qendror. Nga të treja keto llojet rekomandohet rajonalizimi mbi baza vullnetare.

5. Studimi parashikon reduktimin e rajoneve nga 12 në 6 dhe së fundmi në 4.
6. Qëllimi i bashkimit parashikohet të jetë për të dyja llojet e shërbimit dhe rekomandohet që të përfshijë të gjitha funksionet duke filluar nga operimi, deri te investimi dhe financimi.
7. Studimi parashikon që në një periudhë 10-vjeçare tarifat të mund të harmonizohen, por studimi parashikon që kur bashkohen shoqëritë që performojnë mirë me ato që performojnë dobët, rregullimi i tarifave të bëhet me anë të skemës së subvencionit të kryqëzuar.
8. Lidhur me formën e financimit ky studim analizon formën e partneritetit publik privat si një mënyrë që do të mund t'a bënte të zbatueshme rajonalizimin.

Nga rezultatet e eksperiencës ndërkombëtare dhe intervistave gjysmë të strukturuar arrihet në mbështetjen e hipotezës cilësore se rajonalizimi i shoqërive të UK rrit efikasitetin, nxit interesin e sektorit privat dhe lehtëson aplikimin e skemave të PPP sepse arrihen ekonomitë e shkallës.

Studimi akademik i këtij punimi dhe studimi i konsulencës i kryer nga partnerët e sipërpërmendur kanë mjaft ngjashmëri në shumë elementë, por dhe ndryshime. Në vijim do të paraqesim **ndryshimet mes këtyre 2 studimeve:**

1. Studimi i doktoraturës rekomandon se kufijtë e bashkimit mund të jenë një kombinim mbi bazën e kufijve administrativë me atë mbi bazën e aksesit në basenet lumorë sipas rasteve që analizohen. Kjo pasi kur shqyrtohet bashkimi nuk është vetëm kriteri i kufijve që analizohet, por edhe kriteri ekonomik për të parë sesa është numri i popullsisë që shërbehet me qëllimin e arritjes së ekonomive të shkallës.
2. Mënyra e rajonalizimit që rekomandoj në këtë punim është vullnetar me incentivë nga pushteti qendror, ndërkohë që studimi i konsulencës rekomandon bashkim mbi baza tërësisht vullnetare.
3. Modeli i rajonalizimit në këtë punim ka një vlerë të shtuar sepse identifikon në mënyrë shkencore modelin më të mirë të eficiencës së sektorit UK. Konkluzioni është se modeli më i mirë për të marrë në konsideratë eficiencën e kostos është

modeli i popullsisë që do të thotë se kur rritet dendësia e popullsisë së shërbyer ka efijencë në kosto. Pra ky punim sjell një vlerë të shtuar për modelin e rajonalizimit kur të marrë në konsideratë çështjen e ekonomisë së shkallës.

KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONET

Në nivel botëror uji konsiderohet një burim që sa vjen dhe po rrallohet dhe janë disa faktorë që shkaktojnë këtë fenomen të tilla si ngrohja globale, rritja e popullsisë që ushtron presion për më shumë ujë dhe ndryshimet demografike nga zhvendosja e popullsisë nga zonat rurale drejt atyre urbane. Uji nga një mall i lirë apo social është kthyer në një mall konsumi. Zhvillimet globale në drejtim të ambjentit (që kanë ndodhur dhe po ndodhin) kanë dëmtuar burimet potenciale. Ndaj gjithnjë e më shumë menaxhimi me efektivitet dhe efikasitet të ujit përfaqëson një nga sfidat më të vështira të shekullit të XXI.

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të analizohej rritja e efikasitetit të sektorit të UK duke trajtuar faktorët që ndikojnë në rritjen e saj nëpërmjet 3 modeleve të rritjes së efikasitetit të shoqërive të UK, si dhe të sugjerojë një model rajonalizimi të përshtatshëm për Shqipërinë duke identifikuar tiparet e modelit dhe partneritetin publik-privat si instrument zbatimi.

Në Shqipëri janë të pakta studimet e thelluara mbi rolin e PPP-ve në zhvillimin ekonomik të vendit dhe po kështu nuk ekzistojnë studime të thelluara mbi rritjen e efikasitetit të sektorit të UK. KfW dhe Banka Botërore janë institucione që kanë kryer disa studime mbi decentralizimin dhe rritjen e efikasitetit të sektorit. Partneriteti Publik-Privat (PPP) është mjaft i përhapur dhe ka rezultuar të jetë një nga instrumentat më përfituese si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim nisur nga kontributi që sjellin në zhvillimin ekonomik. Shumë qeveri në vende të ndryshme i kanë parë PPP-të si mënyra alternative për menaxhimin e shërbimeve publike dhe financimin e tyre nëpërmjet projekteve komplekse infrastrukturore (Pollit & Bouckaert, 2011:6).

Një element i rëndësishëm i efikasitetit, që është edhe një ndër përfitimet që vijnë nga PPP-të është arritja e ekonomive të shkallës. Një ndër mënyrat e realizimit të ekonomive të shkallës është bashkimi i disa njësive, të cilat do t'i shërbejnë një numri më të gjerë konsumatorësh. Ky koncept po aplikohet sot gjerësisht në sektorin e UK si në vendet e

zhvilluara ashtu dhe në vendet në zhvillim. Termi që përdoret sot në këtë sektor është rajonalizimi i shoqërive UK. Rajonalizimi shihet si një mundësi për të patur akses ndaj menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE) e datës 23 Tetor 2000 për menaxhimin e burimeve ujore përcakton kuadrin e përgjithshëm të përdorimit dhe menaxhimit me efikasitet të burimeve ujore dhe ofron një sistem të vetëm menaxhimi të ujit nëpërmjet baseneve të lumenjve si njësi natyrore gjeografike dhe hidrike, në kontrast me kufijtë administrativë dhe politikë.

Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore dhe me kapacitetin aktual që disponon është në gjendje të plotësojë nevojat e popullsisë. Sfida mbetet përdorimi me efektivitet i burimeve ujore. Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve që përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm është 654 milionë m³, ndërsa volumi mesatar i ujit të prodhuar rezulton 278 milionë (m³)⁵⁸. Kjo tregon se vetëm 43% e burimeve ujore shfrytëzohet. Prodhimi i ujit është 31% më i lartë sesa kërkesat për ujë të pijshëm duke supozuar se e gjithë popullsia që jeton në zonën e juridiksionit do të furnizohej me ujë të pijshëm, ndërsa volumi i ujit të faturuar përmbush vetëm 54% të kërkesave në nivel sektori.

Në Shqipëri operojnë 58 shoqëri të UK dhe indikatorët e performancës tregojnë një situatë jo të shëndetshme financiare: shkallë relativisht e ulët e furnizimit me ujë: 80% mbulimi në përgjithësi nga e cila 90% në zonat urbane dhe 62 % në zonat rurale, shkalla e humbjes (pjesa e ujit që prodhohet e futet në sistem, por që nuk gjeneron asnjë të ardhur) është përafërsisht 67%, ndërsa standarti sipas ERRU është 30%, mbulimi me shërbime të ujërave të zeza është 50% në përgjithësi, vazhdueshmëria e furnizimit me ujë është 11.6 orë, ndërkohë që kjo shifër në vendet Europës Perëndimore është në nivelin 24 orë në ditë. Performanca e dobët e shoqërive UK ushtron presione për Qeverinë, e cila është e detyruar të ofrojë subvencione, të cilat ndonëse kanë ardhur duke u zvogëluar mbeten përsëri të larta në nivelin e 8% të Kostove Totale Operative për vitin 2012. Për më tepër që këto subvencione jepen për të mbuluar humbjet financiare të shoqërive U/K, ndërkohë që debati i sotëm është që subvencioni duhet të jepet për të ndihmuar shtresat në nevojë. Eksperienca në Shqipëri tregon se disa shoqëri

⁵⁸ Raporti “5 vjet Benchmarking”, 2011

të tilla si Korça, Pogradeci, Librazhdi, Elbasani, Lushnje realizojnë arkëtime totale që mbulojnë koston direkte të shërbimit të U/K. Prandaj është e nevojshme të nxirren mësim nga eksperiencia e këtyre shoqërive dhe të zbatohen nga shoqëritë e tjera. E rëndësishme është që shoqëritë të ndërgjegjësohen të operojnë si shoqëri tregëtare duke përmirësuar menaxhimin e tyre.

Nga rishikimi i literaturës rezultati i përgjithshëm është se në të gjitha rastet e analizuara nëpër studime të ndryshme procesi i bashkimit, ose rajonalizimit ka si faktor kryesor përmirësimin e efijencës nëpërmjet teorisë së ekonomive të shkallës. Kjo është arsyeja ku unë mbështes studimin shkencor dhe modelin që studjon efijencën e sektorit.

Studimet empirike ekonometrike arritën të tregojnë se ekonomitë e shkallës janë më të fuqishme për kompanitë e vogla në ofrimin e shërbimeve të UK dhe se ato janë më të qëndrueshme kur madhësia e kompanisë përcaktohet nga vëllimi i ujit të prodhuar. Po këto studime tregojnë se ekonomi më të fuqishme të shkallës ekzistojnë kur numri i lidhjeve apo popullsia që i shërbehet përdoret si tregues për madhësinë e kompanisë. Gjithashtu, kushtet në të cilat operojnë kompanitë e ujit janë të ndryshme të tilla si: kushtet institucionale, politike, ekonomike, prandaj bëhet e rëndësishme që përveç faktorit ekonomik që rezultoi më i rëndësishmi të merren në konsideratë dhe faktorët e tjerë. Për përzgjedhjen e variableve të modelit jam bazuar pikërisht në këto studime.

Nga eksperiencia ndërkombëtare modelet e rajonalizimit të analizuara janë të ndryshme nga një vend në tjetrin. Kjo reflektohet nga shumëllojshmëria e modeleve që lidhet me kushtet historike, gjeografike, kulturore dhe social ekonomike. Një mësim i përgjithshëm është që nuk ekziston një model unik apo universal dhe se rajonalizimi bëhet një domosdoshmëri kur qytetarët nuk janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve dhe bëjnë presion në drejtim të përmirësimit të shërbimeve dhe ky proces nxitet në kushtet kur kërkohet për të siguruar fonde më të mëdha nga financuesit privatë. Numri i parametrave për t'u marrë në konsideratë në rastin e Shqipërisë mund të jetë i ndryshëm nga ato të rasteve studimore.

Njësitë bazë të analizës së këtij studimi janë të gjitha shoqëritë e UK në total 58 që operojnë në Shqipëri. Sipas të dhënave për vitin 2012, 42 prej tyre i shërbejnë një popullsie më pak se 50,000 banorë dhe nga këto shoqëri 30 i shërbejnë një popullsie më pak se 22,000 banorë, çka tregon se ka një mungesë të theksuar të “ekonomive të shkallës”.

Gjatë periudhës së analizës konstatohet se disa prej këtyre shoqërive nuk kanë ekzistuar. Si rezultat i kësaj për periudhën tonë të analizës 54 shoqëri ishin operative për të 7 vitet dhe kjo është arsyeja që nga 58 shoqëri aktuale u mbledhën të dhënat për 54 prej tyre. Analiza merr në konsideratë të dyja llojet e shërbimeve që ofrohen përkatësisht furnizimin me ujë dhe të paturit akses ndaj kanalizimeve. Analiza fillon me vlerësimin e performancës së sektorit UK për periudhën 2006-2012 dhe vazhdon me gjetjen e mënyrave për të rritur eficiencën e shoqërive duke përdorur një model ekonometrik për eficiencën, i cili analizon të dhënat për 29 shoqëri UK, që përbëjnë kampionin e analizës. Të dhënat u përpunuan në formatin e serive kohore dhe u testuan me ndihmën e programit STATA 2011.

Fillimisht, u ndërtuan tre modelet bazë OLS dhe modeli përfundimtar OLS që përfshiu variablën e jashtme mjedisore për të parë rëndësinë e variableve të pavarura në koston operative vjetore, që është variabla e varur. Në të treja modelet koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 është i lartë që tregon se 85% e ndryshueshmërisë së koston operative vjetore shpjegohet me variablet e modelit të volumit, 88% me variablet e modelit të popullsisë dhe 84 % me variablet e modelit të lidhjeve. Të treja modelet kanë R^2 të lartë për të shpjeguar ndryshueshmërinë e koston operative vjetore dhe asnjëra prej tyre nuk përjashtohet, por ndër tre modelet, modeli që shpjegon më tepër ndryshueshmërinë e koston operative është modeli i popullsisë me koeficientin e përcaktueshmërisë prej 88%.

Duke përdorur konkluzionin e formulës së regresionit u arritën këto konkluzione:

1. Pakësimi i humbjeve teknike nga 67% në 40% do të ulë vëllimin e ujit të prodhuar me 45% dhe kostoja operative vjetore ulet me 24%. (Hipoteza 1 vërtetohet)

2. Duke i shërbyer një popullsisë më të madhe nga 1%-5% kostoja operative vjetore rritet më pak se rritja e popullsisë (nga 0.57% në 2.8%). (Hipoteza 2 vërtetohet)
3. Duke rritur numrin e matësive (10%-20%) kostoja operative vjetore rritet shumë më pak ($<0.5\%$ - $<1\%$). (Hipoteza 3 hidhet poshtë)

Më pas u ndërtuan 3 modele Stokastike të Funksionit të Kostos (Stochastic Cost Frontier) për të renditur shoqëritë sipas efijencës së tyre nga më performante në më pak performante dhe u krahasua kjo renditje me renditjen e kryer nga ERRU. Ajo që konstatohet nga kjo renditje është se 5 shoqëritë më të mira për nga efijencia përgjatë vitit 2012 janë të njëjtat shoqëri sipas të treja modeleve të volumit, popullsisë dhe lidhjeve të cilat janë: Tirana, Durrësi, Berat & Kuçova, Fier dhe Elber Shpk. Termi i konstantes në modelin stokastik merr parasysh të tjerë faktorë përveç tre të përmendurve më sipër. Këto faktorë që ndikojnë në efijencë mund të jenë menaxhimi i mirë, staf i kualifikuar, ekspertiza e akumuluar etj.

Ndërkohe 5 shoqëritë me efijencë më të keqe janë të njëjtat shoqëri sipas të treja modeleve të volumit, popullsisë dhe lidhjeve të cilat janë: Delvinë, Rrogozhinë, Libohovë, Krastë dhe Rubik. Termi i konstantes në modelin stokastik edhe në këtë rast merr parasysh të tjerë faktorë përveç atyre të mësipërme. Faktorët që ndikojnë në inefijencë mund të jenë menaxhimi i keq, staf i pakualifikuar, mungesë ekspertize etj. Nga rezultati i testimit vërtetohet hipoteza 4 se metodat e deritanishme për renditjen e shoqërive sipas efijencës duhet të ndryshojnë duke marrë parasysh renditjen sipas kushteve të operimit. Këtë e tregoi termi i konstantes që shpjegon faktorë të tjerë që nuk kapen nga modeli i volumit, popullsisë dhe lidhjeve.

Arsyet e ndryshimeve në renditjen që konstatohen duke i krahasuar me renditjen e ERRU janë si në vijim:

- Të dyja llojet e renditjeve përdorin metodologji të ndryshme.
- Renditja e punimit shkencor merr në konsideratë të dyja llojet e shërbimeve dhe si rezultat shoqëritë që ofrojnë vetëm shërbimin e ujit nuk janë të përfshira, e cila është një vlerë e shtuar. Ndërkohë që ERRU e bën këtë renditje për të gjitha shoqëritë pa dallim në shërbimet që ofrojnë.

- Kriteri për ndarjen e kategorive të madhësisë i përdorur nga ERRU është sipas lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm, ndërkohë që punimi shkencor sjell ndarjen sipas modelit të volumit, të popullsisë dhe lidhjeve me matësa. Kjo mund të jetë një pikë e fortë e punimit shkencor në renditjen që përdoret.
- Një pikë e fortë e renditjes që ERRU bën është se renditja e shoqërive kryhet sipas disa indikatorëve të performancës duke dhënë një vlerësim të performancës së shoqërive nga disa aspekte.

Rezultatet e testimit stokastik shkojnë në linjë me teorinë e efijencës mbi ekonominë e shkallës dhe konkluzionet e studimeve empirike të kryera nga autorë të njohur se sa më shumë të rritet numri i konsumatorëve të shërbyer aq më e ulët do të jetë kostoja për njësi. Në të njëjtën kohë ky konstatim mbështet analizën e kryer për Shqipërinë se një rritje në numrin e popullsisë që i shërbehet lidhet me rritjen e dendësisë së popullsisë, e cila ndikon direkt në arritjen e ekonomive të shkallës.

Njësi të tjera që analizohen janë institucionet pjesëmarrëse në sektor në drejtim të politikbërjes, financimit, administrimit dhe mbikqyrjes rregullatore. Për t'i analizuar këto njësi përdoren 14 pyetësorë gjysmë të strukturuar me qëllim që të kuptohej roli i tyre në sektor, kuadri ligjor që rregullon marrëdhëniet e institucioneve të ndryshme, këndvështrimi i institucionit lidhur me iniciativën e re të Qeverisë në drejtim të rajonalizimit (bashkimit të shoqërive) dhe barrierat që ekzistojnë për të realizuar këtë proces sipas këndvështrimit të tyre.

Të gjitha institucionet e intervistuar për qëllime të këtij punimi e shohin rajonalizmin si mënyrën më të duhur për rritjen e efijencës së sektorit dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Rajonalizimi sipas këndvështrimit të tyre do të sjellë efijencë në kosto sepse peshën më të madhe e kanë shpenzimet për personelin dhe bashkimi i shoqërive do të sjellë ulje të stafit dhe efijencë në kosto. Të gjithë të intervistuarit arrijnë në konkluzionin se rajonalizimi shihet si mundësi për thithjen e fondeve më të mëdha dhe kryerjen e investimeve veçanërisht në zonat rurale. Studimi arriti të nxjerrë konkluzione mbi tiparet e modelit të rajonalizimit, të cilat jepen si rekomandime në pjesën e fundit të këtij punimi. Nga rezultatet e eksperiencës ndërkombëtare dhe intervistave gjysmë të

strukturara arrihet në mbështetjen e hipotezës cilësore se rajonalizimi i shoqërive të UK rrit efikasitetin, nxit interesin e sektorit privat dhe lehtëson aplikimin e skemave të PPP sepse arrihen ekonomitë e shkallës.

Shënim: Ky studim është konceptuar dhe shkruar për periudhën e analizës 2006-2012. Për të dhënat e dy viteve 2013 dhe 2014 nuk konstatohet ndonjë ndryshim i rëndësishëm sepse nuk ka patur ndryshime thelbësore institucionale. Reforma e re territoriale e miratuar në vitin 2013 ende pritet të zbatohet. Në këtë kontekst situata aktuale nuk ja pakëson vlerën studimit. Kjo reformë do të jetë objekt studimi në të ardhmen për të krahasuar efektet e bashkimit të shoqërive me periudhën paraardhëse të punimit tim doktoral.

REKOMANDIME

Mbështetur në rishikimin e literaturës, analizën sasiore dhe analizën cilësore me qëllim rritjen e efijencës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri rekomandohet :

I. Qeveria Shqiptare ka tre alternativa për të marrë në konsideratë si indikator për madhësinë e shoqërive që bashkohen. Të tre alternativat janë të rëndësishme, por ndërmjet tyre rekomandohet indikator i numrit të popullsisë së shërbyer duke filluar nga minimumi 100,000 banorë.

II. Qeveria Shqiptare duhet të konsiderojë një kombinim të kufijve administrativë me aksesin në basenet lumorë kur konsideron bashkimin e shoqërive UK sipas rasteve përkatëse. Kushtet bazë që Qeveria duhet të konsiderojë janë:

- Arritja e ekonomisë së shkallës duhet të konsiderohet si në rastin e kriterit të kufijve administrativë, ashtu edhe në rastin e kufijve të baseneve lumorë.
- Në rastin e përdorimit të kriterit të bashkimit sipas kufijve të baseneve lumorë, duhet të analizohet nëse shoqëritë i përkasin një baseni të vetëm ose jo. Në rastin kur i përkasin më shumë se një baseni, Qeveria Shqiptare përveç kriterit të ekonomisë së shkallës duhet të marrë parasysh kohën e nevojshme shtesë që kërkohet për të negociuar me palët e përfshira dhe arritur konsensusin e nevojshëm.

III. Qeveria Shqiptare duhet të synojë të bashkojë si fillim ato shoqëri që i ofrojnë të dyja shërbimet: furnizimin me ujë dhe kanalizimet. Shoqëritë UK që bashkohen të shohin mundësinë e bashkimit të të gjitha funksioneve, sepse jo vetëm që arrihen më mirë ekonomitë e shkallës, por shoqëria e re e bashkuar mund të përfitojë fonde më të mëdha nga investitorët privatë, të cilët janë të nxitur të ndërhyjnë në formën e partneritetit publik privat. Kriteret që duhet të mbahen parasysh rekomandohen të jenë: (i) performanca e shoqërisë në kuptimin që fillimisht të fillojë ky proces me shoqëritë që performojnë më mirë siç është rasti i shoqërisë Korça qytet me Korçën fshat; (ii) kriteri i investimeve që do të thotë se ato shoqëri që e kanë rritur performancën e tyre si rezultat i investimeve, mund të bashkohen me shoqëri të tjera, për të përfituar nga

investimet e kryera dhe (iii) kriteri i zonës turistike në të cilën ofrojnë shërbimet shoqëritë UK siç mund të jenë shoqëritë: Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë Qytet, Gjirokastrë fshat dhe Delvinë.

Lidhur me politikën e subvencioneve rekomandohet që Qeveria Shqiptare me qëllim uljen e subvencionit duhet ta kushtëzojë me kriteret e performancës menaxheriale të shoqërive UK. Pavarësisht nga humbjet e mëdha që shoqëritë UK përballen dhe subvencionet e larta nga pushteti qendror, tendenca e përgjithshme është që subvencioni në një periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë të shkojë drejt rënies më drastike.

IV. Qeveria Shqiptare duhet të synojë përfshirjen e kontratave të PPP-ve të sipas llojit të funksioneve të bashkuara. Një kontratë menaxhimi do të ishte e përshtatshme kur shoqëritë zgjedhin të bashkojnë funksionin e operimit dhe administrimit, ndërsa një kontratë konçensionit do të ishte e përshtatshme kur shoqëritë vendosin ti bashkojnë të gjitha funksionet.

V. Qeveria Shqiptare duhet të institucionalizojë marrëdhëniet mes pushtetit vendor dhe shoqërive rajonale që do të krijohen për ofrimin e shërbimeve të UK dhe pronësinë e aseteve. Në kuadër të Reformës së re Territoriale rekomandohet hartimi i një ligji të posaçëm që do të rregullojë veçanërisht çështjet që lidhen me shoqëritë rajonale. Përveç sa më sipër rekomandohet që ligji i ri për shërbimet publike të përcaktojë në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë për shoqëritë rajonale.

VI. Në kushtet kur Shqipëria është në hapat e para të decentralizimit dhe pushteti vendor po konsolidohet në drejtim të ushtrimit të roleve dhe përgjegjësisë është e rekomandueshme rajonalizim mbi baza vullnetare me rregullime nga pushteti qendror. Qeveria Shqiptare duhet të shoqërojë rajonalizimin me një strategji komunikimi dhe edukimi për njësitë e pushtetit vendor, shoqëritë e UK, përfituesit përfundimtarë për të sqaruar se rajonalizimi i shoqërive nuk ka si qëllim të kundërshtojë parimet e procesit të decentralizimit, por që përveç rritjes së efikasitetit ky proces ka si qëllim në të njëjtën kohë të mos çënojë vendimarrjen e pushtetit vendor. Qëllimi final është të ofrohen shërbime më cilësore për konsumatorët, ti bëjë shoqëritë të afta financiarisht dhe t'ju mundësojë financime më të mëdha nga institucionet ndërkombëtare.

VII. ERRU duhet të bashkëpunojë me botën akademike për renditjen e shoqërive sipas performancës. Rekomandohet që renditja të kryhet duke marrë në konsideratë të dyja llojet e shërbimeve ujin dhe kanalizimet. Në kriteret për renditjen ERRU përveç indikatorëve të performancës që lidhen me menaxhimin e shoqërisë duhet të marrë në konsideratë edhe faktorët jashtë mjedisit të shoqërisë për të parë sesi reagon shoqëria në kushtet e një shoku të jashtëm.

RËNDËSIA DHE RISITË

Studimi është i pari që trajton eficiencën për sektorin UK në mënyrë shkencore. Për këtë qëllim shërben si nxitës për studiues të tjerë që të vazhdojnë kërkime të thelluara veçanërisht për çështjen e rajonalizimit dhe rritjen e eficiencës së sektorit.

Modeli i popullsisë rezultoi më i miri ndërmjet modelit të volumit dhe lidhjeve për të analizuar uljen e kostos operative. Si rezultat këto gjetje duhet të mbahen parasysh nga politikbërësit dhe menaxherët e përfshirë në sektorin UK.

Renditja e shoqërive sipas eficiencës rezultoi i ndryshëm me renditjen që ERRU kryen, si rrjedhim përbën një kontribut shkencor për ERRU.

Modeli i rajonalizimit në Shqipëri është një skemë që aplikohet nga shumë vende dhe ka rezultuar të jetë i sukseshëm. Në këtë kuadër trajtimi në rastin e Shqipërisë paraqet interes për të gjitha palët e interesuara në kushtet kur mbështetet në iniciativën e qeverisë dhe në kushtet kur tashmë po zbatohet reforma e re territoriale.

BIBLIOGRAFIA

- Agere, S. (2000). "Promoting Good Governance: principles, practices and perspectives". Commonwealth Secretariat, London, UK, f.68.
- Ahoroni, Y. (1986). "The Evaluation and Management of State-Owned Enterprises". Cambridge, MA, Ballinger Publishing Company, fq. 6-12
- Angjeli, A. (2011). "Transition and Economic Freedom in Albania". UMSH Press, fq. 29-39.
- Anderson, G. and Arsenault, N. (1998). "Fundamental of Educational Research". London: Routledge Falmer, f. 119.
- Andrews, M. (2008). The Good Governance Agenda: Beyond Indicators without Theory. *Oxford Development Studies*, 36:4, fq. 379–407.
- Awwa Research Foundation. (2008). "Regional Solution to Water Supply Provision". Second Edition, f. 2.
- Bach, T. dhe Jann, W. (2010). Animals in the Administrative Zoo: Organizational Change and Administrative Autonomy in Germany, *International Review of Administrative Sciences* 76:3, fq.443-468.
- Banka Botërore (2011), Decentralizimi dhe Realizimi i Shërbimeve në Shqipëri: Qeverisja në Sektorin e Ujit, *Raport nr. 64412-AL*, fq.12- 23.
- Banka Botërore (2007), *Water Sector Policy Note and Action Plan*, fq.19-20
- Bartoli, A. (2008). 'The Study of Public Management in France: La specificite du modele francais d'administration', in W. Kickert (ed.) *The Study of Public Management in Europe and the US: A Comparative Analysis of National Distinctiveness*, Abingdon, Routledge, fq. 14–41.
- Barro, J.B. (1974). Are the Government Bonds Net Wealth?. *Journal of Political Economy*, vol 82, fq. 1095-1117.
- Bakllamaja, A. (2011). Politika e Subvencionit në Sektorin e Furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve dhe alternativat në kuadrin e decentralizimit. *Revista Shqiptare Social Ekonomike* nr. 4(68), fq. 137-146.
- Beecher, J. (1996). The Regionalization of Water Utilities: Perspectives, Literature Review and Annotated Bibliography", fq. 5, 10.

- Baumol, W.J. (1977). On the Proper Cost Tests for Natural Monopoly in a Multiproduct Industry 809. *American Economic Review*, fq.809-822.
- Baumann, D. (1998). "Forecasting Urban Water Use:Theory and Principles" in D.Baumann, J.Boland and W.M Hanemann eds.Urban Water Demand Management and Planning, New York: Mc Graw Hill, fq. 77-94.
- Bellamy, R. and Palumbo, R. (2010). "From Government to Governance". London, Ashgate, f.10.
- Berg, S. and Lin, C. (2005). Consistency in performance rankings: the Peruvian water sector. *PURC Working Paper*, fq.1-20.
- Berg, S, and Lin, C. (2008). Consistency in performance rankings: the Peru water sector. *Applied Economics*, Vol 40, no. 6, fq. 793-805.
- Berg, S. Marques, S. and Yane, S. (2010). Performance Benchmarking Analysis of Japanese Water Utilities. *Proceedings, Pi2011 Conference*, pp.1-10.
- Biswas, AK., Uitto, JI. (2001). "Sustainable Development of the Ganges-Brahmaputra-Meghna Basin". United Nations University Press, Tokyo, Japan, fq. 1-16.
- Bless, C. and Higson-Smith, C. (2000). "Fundamentals of Social Research Methods: an African perspective". Cape Town: Juta, fq. 28, 98.
- Boyatzis, R.E.(1998). "Transforming Qualitative Information: thematic analysis and code development". Sage, fq.1-14.
- Boston, J., Martin, J., Pallot, J. and Walsh, P. (1996). "Public Management: The New Zealand Model". Oxford University Press, Auckland, New Zeland, f.5
- Bourgon, J. (1998). *Fifth Annual Report to the Prime Minister on the Public Service of Kanada*, Ottawa, Privy Council Office, f.20.
- Brans, M. and Hondeghem, A.(2005).Competency Framework in Belgian Governments:Causes, Construction and Content. *Public Administration*, 83: 4, fq. 823-37.
- Brawn , V. and Clarke, V. (2006). Using Thematic Analysis in Psychology. *Qualitative Research in Psychology*, 3, fq. 77-101.
- Broucker, B., Depre, R., and Hondeghem, A. (2010). Les propositions de reforme. *La Revue Nouvelle* 65:1, fq. 31-9.
- Brook-Cowen, P.J. (1997). The private sector in water and sanitation-how to get started. Private Sector, *World Bank Note no.126*, Washington D.C: World Bank, fq. 1-7.

- Buchholz, T.G. (2007). "Ide të gjalla nga economistë të vdekur". Instituti i Studimeve Politike & Dita, fq. 135, 295, 355, 367-368, 379-380.
- Bulmer, M. (1984). "Sociological Research Methods: An introduction". London: Macmillan Publishers, f.4.
- Campbell, G. (2001). "Public Private Partnership – A developing Market?". Melbourne, Unpublished.
- Chang, C. and Griffin, R.(1992). Water Marketing as a Reallocation Institution in Texas. *Water Resources Research*, 28, fq. 879-890.
- Civici, A. (2007). "Dilemat e Zhvillimit", Geer, 2007, fq. 69, 71.
- Clark, Robert M. and Richard G. S. (1981). A Regional Water Supply Cost Model. *Growth and Change* 12, no. 3, fq 9-16.
- Clemens, E.I. (1959). "Economics and Public Utilities". New York: Appleton-Century-Crofts, f. 765.
- Colby, B.G. (1992). Transaction costs and efficiency in western water allocation. *American Journal Agricultural Economics*, 72(5), fq. 1184-1192.
- Commision on UK Public Private Partnership (2001), Building Better Partnership: The final report from the Commission on Public Private Partnership, Summary, IPPR: London.
- Cook, A-L. (2004). Managing for Outcomes in the New Zealand Public Management System. *Working Paper 04/15*, New Zealand Treasury.
- Collin, S.O and Hansson, L. (2000) "The propensity, persistance and performance of public private partnerships in Sweden", in Public Private Partnerships:Theory and Practice in International Perspectives by Osborne, S, Routlege Taylor & Francis Group, London, UK, fq.200-216.
- Committee of Public Accountants (2000), Improving the Delivery of Government IT projects, 1st report Session 1999-2000, London, House of Commons.
- Crane, R. (1994). Water Markets, Market Reform and the Urban Poor:Results from Jacarta, Indonesia. *World Development* 22, no.1, fq. 71-83.
- Creswell, J. W. (1994). "Research design: Qualitative & quantitative approaches". Thousand Oaks, CA: Sage, f.50.

- Cubbin, J. and Tzanidakis, G. (1998). Regression versus data envelopment analysis for efficiency measurement: an application to the England and Wales regulated water industry. *Utilities Policy* 7, fq 75-85.
- Cuttaree, V. and Perrot C.M. (2011). 'Public Private Partnership in Europe and Central Asia'. Banka Botërore, f. 5.
- Departamenti i bashkërendimit të strategjive dhe koordinimit të ndihmës së huaj, Këshilli i Ministrave
- http://www.dsdc.gov.al/dsdc/Prezantohet_Master_Plani_per_Sektorin_e_Ujesjelles_Kanalizimeve_ne_Shqiperi_527_1.php
- Depoorter, Ben, W. (1999). "Regulation of Natural Monopoly". Center for Advanced Studies in Law and Economics, University of Ghent, Faculty of Law, fq.498-515.
- Depre, R. and Parys, M. (2005) "De virtuele matrix als nieuw organisatieconcept". In Hondeghem, A. Depre, R., Decopernicushervorving in perspectief. Veranderingsmanagement in de federale overheid, Brugge, Vanden Broele, Reeks Burger, bestuur en beleid, fq. 123-152.
- Direktiva Kuadër e Ujit (2006/60/KE), datë 23 Tetor 2000.
- Direktiva e Ujit të Pijshëm (98/83/KE), datë 3 Nëntor 1998.
- Direktiva e Trajtimit të Ujit të Ndotur Urban (91/27/KE), datë 21 Maj 1991.
- Drechsler, W., and Kattel, R., and Lynn, L. Jnr (2008). Towards the Neo-Weberian State? Perhaps, but Certainly, Adieu, NPM!. *NISPACE Journal of Public Administration and Policy*, Special issue: 'A Distinctive European Model? The Neo-Weberian State, 1:2, fq. 75-90, 95-99.
- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve (2011), *Raporti:5 vjet Benchmarking: monitorimi i performancës për sektorin e ujësjiellës kanalizimeve në Shqipëri*, Tiranë, Shqipëri.
- Dunleavy, P., Margetts, H., Bastow, S. et al. (2006a). "Digital Era Governance: IT Corporations, the State and E-government". Oxford, Oxford University Press, fq. 5-20.
- et al. (2006b). New Public Management is Dead—Long Live Digital-Era Governance. *Journal of Public Administration Research and Theory*, 16:3, fq. 467-494.

- Easter, K. W. and Hearne, R.R.(1995). Water Markets and Decentralized Water Resources Management: International Problems and Opportunities. *Water Resources Bulletin*. 31, fq. 9-20.
- Economic Commission for Europe (1990), *Economic Survey of Europe*, New York, USA, fq. 87-116.
- Eco, U. (1981). “Si Shkruhet nje Punim Diplome: Shkencat Shoqerore”. Dituria, 2006, fq. 67-73
- <http://www.amazon.com/Come-SI-UNA-Tesi-Laurea/dp/8845246310>
- Enti Rregullator i Ujit (2011), Metodologjia për Vendosjen e Tarifave, Tiranë, Shqipëri.
- Enti Rregullator i Ujit (2014), *Raporti i Performancës për Shoqëritë UK*, Tiranë, Shqipëri, fq.8.
- http://www.erru.al/doc/UK-Albanian_B_lowres_opt.pdf
- Estache, A. and Rossi, M. (1999). Comparing the performance of public and private water companies in Asia and Pacific region: what a stochastic costs frontier shows. *World Bank Policy Research Working Paper*, fq.1-23.
- European Environment Agency (2000), Sustainable Use of Europe’s Water? State, Prospects and Issues”, in Environment Assessment Series, 7, Copenhagen.
- Feigenbaum, S. and Teeple, R. (1983). Public vs. private water delivery: a hedonic cost approach. *The Review of Economics and Statistics* 65(4), fq. 672-678.
- Ferlie, E. and Geraghty, J. (2005). ‘Professionals in Public Service Organizations: Implications for Public Sector Reforming’., in E. Ferlie, L. Lynn Jnr, and C. Pollitt (eds.) *The Oxford Handbook of Public Management*, Oxford, Oxford University Press, fq. 422–425.
- Friedman, M. and Rose D. (1982). ”Capitalism and Freedom”. University of Chicago Press, f.29.
- Friedman, M. and Rose D. (1990). ”Free to Choose”. First Harvest Edition, Harcourt Inc, fq. 3-10.
- Frone, S. (2008). Factors And Challenges Of Regionalization In The Water And Wastewater Sector. *Romanian Journal of Economics*, Institute of National Economy, vol. 27(2(36)), fq 185-200.

- Garcia, S. and Thomas, A. (2001). The Structure of Municipal Water Supply Costs: Application to a Panel of French Local Communities. *Journal of Productivity Analysis* 16 (1), fq. 5–29.
- Gray, P. (2001). "Private Participation in Infrastructure: a review of the evidence" (mimeo), Washington D.C: World Bank, f.10.
- HDR Engineering (2009), Regionalization Strategies to Assist Small Water Systems in Meeting new SDWA Requirements, fq. 2-3
- Held, D. (1984). "Power and Legitimacy in Contemporary Britain", in G. McLennan, D.Held and S. Hall (eds) 1984, fq. 15-30.
- Hodge, G. and Carsten, G. (2005). "The challenge of public private partnerships: learning from international experience". Cheltenham, UK, f. 2.
- Howlett, M. and Ramesh, M. (2003). "Studying Public Policy: policy cycles and policy subsystems". Ontario:Oxford University Press, f. 24.
- Holloway, I. and Todres, L. (2003). The Status of Method: flexibility, consistency and coherence. *Qualitative Research*, 3, fq. 345-357.
- IDA Program Document for a First Development Policy Operation (2007), Report no. 38441-AL, World Bank, fq.21-22.
- Jann, W., Rober, M., and Wollman, H. (2006). "Public Management:grundlagen, wirkungen und kritik". Berlin, Edition Sigma, fq.1-25.
- Jeffares, S., Hullivan, H., and Bovaird, T. (2009). "Beyond the contract-the challenge of evaluating the performance of public private partnerships", paper presented at the International Research Society for Public Management (IRSPM) 6-8 April, Copenhagen, Denmark.
- Jessop, K. (1998). The rise of governance and the risks of failure: the case of economic development. *International Social Science Journal*, 155, fq.29-46.
- Joris, G., De Visscher, C., and Montuelle, C. (2009). "Federal public administration reform in Belgium: new public management under deconstruction", fq.1-14.
- Kappeler A. and Nemoz M. (2010). Public Private Partnerships in Europe- before and during the recent financial crisis. *Economic and Financial Report 2010/04*, fq.3-5
- http://www.bei.europa.eu/attachments/efs/efr_2010_v04_en.pdf

- Khanom, N. A. (2010). Conceptual Issues in Defining Public Private Partnership. *International Review of Business Research Papers*, Vol 6, Number 2, fq. 5-12, 150-163.
[http://www.wbiconpro.com/14\[1\].-Nilufa.pdf](http://www.wbiconpro.com/14[1].-Nilufa.pdf)
- Klijn, E-H. (2008). Governance and Governance Networks in Europe: an Assessment of Ten Years of Research on the Theme. *Public Management Review*, 10:4, fq. 505-525.
- Kingdom, W. (2005). Models of Aggregation for Water and Sanitation Provision. *Water Supply and Sanitation Notes*, Note No. 1, fq. 5,15, 21.
- Kim, H. Y and Clark, R.M. (1988). Economies of Scale and Scope in Water Supply. *Regional Science and Urban Economics* 18, no. 4, fq. 479-502.
- Kim, E. and Lee, H. (1998). Spatial Integration of Urban Water Services and Economies of Scale. *Review of Urban and Regional Development Studies*, 10(1), fq. 3-18.
- King, A. (1976). "The problem of overload." In A. King (ed) *Why is Britain Becoming Harder to Govern ?* London:BBC, fq.8-30.
- Leibenstein, H. (1966). Allocative Efficiency vs. 'X-Efficiency. *American Economic Review*, Vol.56, No. 3, fq. 392-415.
<http://www.nvcc.edu/home/jmin/readingstuff/allocative%20efficiency%20vs%20x%20efficiency%20leibenstein.pdf>
- Ligji nr. 8652 datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".
- Ligji nr. 8744 datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".
- Ligji nr. 8783 datë 7.5.2001 "Për miratimin e marrëveshjes së konçensionit të formës BOT ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe Berlinwasser International GmbH për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimeve Elbasan si dhe dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për konçensionarin e kësaj marrëveshjeje".
- Ligji nr. 8093 datë 21.03.2006 "Për rezervat ujore".
- Ligji 7512 datë 10.8.1991 "Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, iniciativave të lira dhe privatizimit".
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".

- Lynn, L. Jnr. (2006). "Public Management: Old and New". New York and London, Routledge/Taylor and Francis, fq. 5-23.
- Ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar me ligjin nr. 9352 datë 3.03.2005 dhe ligjin nr. 9915 datë 12.05.2008.
- Manning, S.P., Barefield, A., and Mays, J. (2005). "Consolidation Issues: Pros, Cons, Options and Perceptions". Department of Agricultural Economics, Mississippi State University Extension, f.6.
- Marshall, A. (1907). The Social Possibilities of Economic Chivalry 17. *Economic Journal*, fq. 7-21.
- McFarlane S. (2003). Regional Water Works: sharing urban water services. *Western Cities Project Report #28*, f.7.
- Mergos, G. (2005). Private participation in the water sector: recent trends and issues. *European Water* 9/10, fq. 59-75.
- Mergos, G. (1991). Sustainability Issues and Technology Choice in Irrigation Investment. *Water Resources Management*, Vol.5, fq.243-250.
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (2011), Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, fq. 20-25, 39.
http://www.erru.al/doc/Strategjia_Kombetare_sektoriale_e_sherbimeve_te_furnizimit_me_uje_dhe_kanalizime_2011_-_2017.pdf
- Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication and KfW (2011), Water Supply and Sewerage Master Plan: Population Projection, f. 8.
- Mizutani, F. and Urakami, T. (2001). Identifying network density and scale economies for Japanese Water Supply Organizations. *Pap. Reg. Sci* 80:2, 4:2001, fq. 211-230.
- Mouton E.B.J. and Prozesky, P.V.B. (2001). "The Practice of Social Research". Cape Town: Oxford University Press, f.4.
- Moulton, L. and Anheier, H.(2001). "Public Private Partnerships in the United States: Historical Patterns and Current Trends". The Centre for Civil Society, LSE, London, fq.3-19.

- NAO (2003), *Managing Resources to Deliver Better Public Services*, HC 61-1, Session 2003-04, National Audit Office, London, fq.1-24.
- Nauges, N. and Van der Berg, C. (2008). Economies of Density, Scale and Scope in the Water Supply and Sewerage Sector: A Study of Four Developing and Transition Economies. *Journal of Regulatory Economics* 34, fq. 144-163.
- O'Connor, J. (1973). "The Fiscal Crisis of the State". New York: Harper and Row, f. 40
- OECD (2005a), *Modernising Government, the way forward*, Paris, OECD, fq.90-93.
- OECD (2006), *Private Sector Participation: Policy Framework for Investment*.
- OECD (1998). *Water Consumption and Sustainable Water Resource Management*, Proceedings, Paris.
- OECD (2012), *OECD Work on Water*, f. 11.
- Ongaro, E. (2004). "Public Management Reform and Modernization: Trajectories of Administrative Change in Italy, France, Greece, Portugal and Spain, Cheltenham and Northampton Mass". Edward Elgar, fq. 252-263.
- Osborne, D. and Gaebler, T. (1992). "Reinventing Government : How the Enterprenerial spirit is transforming the public sector". Reading Mass, Adison Wesley, f.9.
- Osborne, S. (2010). "The New Public Governance Emerging Perspectives on the Theory and Practice of Public Governance". London and New York, Routledge/Taylor and Francis, f.9.
- Palys, T. (1997). "Research Decision: Quantitative and Qualitative Perspectives". Harcourt Brace and Company: Canada, fq. 3, 47.
- Padeco CO, LTD. (2009). *Feasibility Study of Regional Utilities in the Water and Wastewater Sector of Albania*, f. 13.
- Pearce, D. (1988). Economics, Equity and Sustainable Development. *Futures (UK)*, Vol. 20, no.6, f. 600.
- Pollit, C. (1990). "Managerialism and the Public Services: the Anglo-American experience". Oxford: Basil Blackwell, fq.19-21.
- Pollit C, Bouckaert G. (2011). "Public Management Reform: a comparative analysis, governance and the neo-weberian state". Oxford University Press, fq. 5-8,10,11, 20-24.
- Pollitt, C. and Bouckaert, G. (2004). "Public Management Reform. A Comparative Analysis". Oxford University Press, Oxford.

- Pollit, C. and Bouckaert, G. (2009). "Continuity and Change in Public Policy and Management". Cheltenham, Edward Elgar, fq. 213-230.
- Pollock, A., Price, D. and Dunningan, M. (2000). Decifit before Patients: A report on the Worcestershire Royal Infirmary PFI and Worcestershire Hospital Configuration, University College, London, f.8.
- Programi Buxhetor Afatmesëm i Rishikuar, 2013-2015, fq. 22-23.
- http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Buxheti/Programi_Buxhetor_Afatmesem_ne_Vite/Programi_Buxhetor_Afatmesem_2013-2015_Faza_II-2.pdf
- Public Services International Research Unit (2013), Energy Liberalization, privatization and public Ownership David Hall, Sandra van Niekerk, Jenny Nguyen, Steve Thomas.
- http://www.world-psi.org/sites/default/files/en_psiro_ppp_final_lux.pdf
- Punch, K.F. (2005). "Introduction to Social Research: Quantitative and qualitative approaches". Thousand Oaks, CA: SAGE Publications, f.2.
- Quiggin, J. (1995). Does privatization pay?. *Austrialian Economic Review*, No. 110 (2nd quarter), fq. 23-42.
- Quiggin, J. (2010). To sell or not" *FINANCE & DEVELOPMENT*. December 2011, Vol. 48, No. 4, fq.1-5.
- Ramanathan, R. (2002). "Introductory Econometrics with Application". Harcourt College Publishers, London, fq 9, 144, 50-51, 82.
- Rezoluta e KDNJ 18/1, e miratuar në 28.9.2011 "E Drejta e Njeriut për Ujë të Pijshëm të Sigurt dhe Higjienë".
- Rice, I. M. (1979). Regionalization of Water Utilities: Disadvantages. *Journal American Water Works Association*, no. 5, f. 11.
- Sabbioni, G. (2006). Econometric Measures of the Relative Efficiency of Water and Sewerage Utilities in Brazil. *PURC Research on Benchmarking*, fq. 3, 4, 6
- Saal, D. and Parker, D. (2001). Productivity and price performance in the privatized water and sewerage companies of England and Wales. *Journal of Regulatory Economics* 20(1), fq. 61-90.
- Savenije H. and P. van der Zang (2002). Water as an Economic Good and Demand Management Pardigms with Pitfalls IWRA. *Water International*, Volume 27, Number 1, fq.98-104.

- Seckler, D.W., Amarasinghe, U., Molden, D., de Silva, R. and Barker, R. (1998a). World Water Demand and Supply, 1990–2025: Scenarios and Issues. *Research Report 19*, International Water Management Institute, Colombo, Sri Lanka, fq.37-53.
- Shleifer, A. (1998). State versus Private Ownership. *Journal of Economic Perspectives* 12(4), fq. 133-150.
- SMC Martin, Inc. (1983). Regionalization Options for Small Water Systems. Washington, DC: U.S. Environmental Protection Agency, fq. 19, 111.
- Solanes, M. and Villarreal, G.F.(1999). “The Dublin Principles for Water as Reflected in a Comparative Assessment of Institutional and Legal Arrangements for Integrated Water Resources Management”. Global Water Partnership Technical Advisory Committee (TAC), Swedish International Development Cooperation Agency, Sweden, fq. 6-37.
- Strategjia Kombëtare e Decentralizimit dhe Autonomisë Vendore, 2000
<http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/L2-Strategjia-Kombetare-Ndersektorale-per-Decentralizimin-Qeverisjen-Vendore-2014-2020-draft.doc>
- Sherman, R. (1989). The Regulation of Monopoly, Cambridge, Cambridge University Press, fq. 265-268.
- Shoqëria Ujësjetellës Kanalizime Durrës (2011), Raporti Vjetor, fq. 1-20, 8, 23, 25, 26
- Tahir M. Nisar. (2007). Value for money drivers in public private partnership schemes. *International Journals of Public Sector Management*, Vol.20 Iss: 2, fq.147-156.
- Tood, M. and Ware, P.(2000). Social Care, contracts and voluntary sector providers : a view from the UK. *International Journal of Public Private Partnership*, Vol.2 no.2, fq.233-50.
- Terreblance, M. and Durrheim, K. (2002). “Research in Practice: applied methods for social sciences”. Cape Town: University of Cape Town Press, f. 274.
- Turok, I. (1993). Inward Investments and Local Linkages: How Deeply Embedded is Silicon Glen?. *Regional Studies*, 27, fq. 401-417.
- Tynan, N.(2003). Returns to Scale in Water Systems in Developing Countries: Some Econometric Evidence processed, World Bank paper, fq. 1-14.

- Tynan, N. and Kingdom, B. (2005). Optimal Size of Utilities?: Return to Scale in Water. Evidence from Benchmarking. Public Policy for the Private Sector, Note no.283, Washington D.C, World Bank, fq.1-4.
- Tortajada, C., Varis, O., Biswas, A.K., and Lundqvist, J. (2001). Water Management in Megacities, Routledge, Water Resources Development, fq. 3–14.
- Urio, P. (2010). “Public Private Partnerships: Success and Failure Factors For In-Transition Countries”. University Press of America, Maryland, fq. 26, 30, 104.
- United Nations Conference on Environment and Development (1992), Foreign Affairs, House of Representatives, One Hundred Second Congress, first session, April 17, July 24, and October 3, 1991, Volume 4, f. 14.
- UNDP and UNCTAD (2011), Raporti mbi Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri, fq. 19-22
http://www.mete.gov.al/doc/web_fdi_report_albanian.pdf
- Udhëzimi nr. 6569 date 27.06.2006 “Për kriteret e procedurat për përdorimin e subvencioneve shtetërore për sh.a dhe ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve.
- Value Add Management Services dhe Sachsen Wasser GmbH (2011), Studimi kombëtar mbi shërbimet e klientit në shoqëritë e UK.
http://www.erru.al/doc/Studim_mbi_perceptimin_e_Konsumatorit_mbi_sherbimet.pdf
- Van Ham, and Koppenjan, J. (2001). Building Public Private Partnerships: Assessing and Managing Risks in Port Development’ Public Management Review, Vol.4, No.1, fq. 593-616.
- Veggeland, N. (2007). “Paths of Public Innovation in the Global Age: Lessons from Scandinavia”. Cheltenham and Northampton, Mass., Edward Elgar, fq.1-15.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 314 datë 15.5.2003 “Për miratimin e kontratës ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Shoqërisë AqquaMundo, GmbH për administrimin e ndërmarrjes së ujësjellës kanalizimeve-sh.a, Kavajë”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.550, datë 1.8.2003, "Për tarifat e shërbimeve, që kryhen nga shërbimi i gjendjes civile”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 660 datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të UK te njësitë e qeverisjes vendore”.
- Vendimi i KKRR nr. 8, datë 04.02.2011, " Për miratimin e modelit të kontratës tip".

VKM nr. 1304 datë 11.12.2009 për Modelin e Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujës-jellës kanalizimeve”.

http://www.erru.al/doc/Kodi_i_Furnizimit_me_Uje_dhe_Kanalizimeve.pdf , 14

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.678, datë 3.10.2007, “ Për një shtesë në vendimin nr.271, datë 9.5.1998 “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore”.

World Bank (1989), Sub-Saharan Africa From Crisis to Sustainable Growth, A Long Term Perspective Study, Washington: The World Bank.

Wiersma, W. (1995). “Research methods in education: An introduction” (Sixth edition). Boston:Allyn and Bacon, f. 404.

Williamson, J. (1993). Latin American Adjustment: How much has Happened, Washington DC; Institute for international Economics, 1990, and John Williamson Democracy and the Washington Consensus, World Development, Vol. 21, No 8, 1993, f. 1331.

http://www.visionaryvalues.com/wiki/images/Williamson_DemocracyandWashingtonConsensus.pdf

Winfield, M. S., Kaufman, Sh., and Whorely, D. (2000). New Public Management comes to Ontario. Instituti Kanadez per Politikat dhe Mjedisin. fq. 1-2.

Winston, C. (1998). U.S. Industry Adjustment to Economic Deregulation. Journal of Economic Policy12 (2), fq. 175-196.

Whitlatch E. and Charles S. ReVelle. (1990). Regionalization in Water Resource Projects. Water International 15, no.2, fq. 70-80.

Wollmann, H. (2001). Germany’s Trajectory of Public Sector Modernization: Continuities and Discountinuties. Policy and Politics, 29:2, fq.151-169.

Wollmann, H. (2012).”Administrative reforms and New Public Management modernization of (local level) public administration in Germany”. Handbook of Public Administration, Edward Elgar: Cheltenham, fq. 6.

_____ 2010 Zombie Economics: How dead ideas still walk among Us (Princeton, New Jersey: Princeton University Press).

_____ 2011 Zombie Economics: To Sell or Not, (Princeton, Neë Jersey: Princeton University Press).

World Bank (2004), Project performance assessment report, Report no. 29638

World Bank (2007), Water Sector Policy Note and Action Plan, fq. 19-20

Yescombe, E.R. (2011). "Public Private Partnership: principles of policy and finance".

Published by Elsevier Ltd, London, fq. 1-5, 12, 13, 15-28, 246.

Zyra e KfW-së, Tiranë (2011), *Ex Post-Evaluation Brief Albania: Kavaja – Water Supply and Sewage Disposal*.

https://www.kfw-entwicklungsbank.de/migration/Entwicklungsbank-Startseite/Development-Finance/Evaluation/Results-and-Publications/PDF-Dokumente-A-D/Albanien_Kavaja_2011.pdf

Zyra e KfW-së, Tiranë (2011), *Ex Post-Evaluation Brief Albania: Water Supply Elbasan*

https://www.kfw-entwicklungsbank.de/migration/Entwicklungsbank-Startseite/Development-Finance/Evaluation/Results-and-Publications/PDF-Dokumente-A-D/Albanien_Elbasan_2011.pdf

Zyra e KfW-së, Tiranë (2011), *Albania: Water Supply and Sanitation Kruja I*, Water Supply and Sanitation Kruja II.

https://www.kfw-entwicklungsbank.de/migration/Entwicklungsbank-Startseite/Development-Finance/Evaluation/Results-and-Publications/PDF-Dokumente-A-D/Albania_Water_Supply_2009.pdf

Burime interneti

www.dpuk.gov.al

Treguesit për periudhën 2008-2012 për shoqërinë UK Durrës

http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info_txt.php?id=966&idn=14

Treguesit e performancës për shoqërinë UK Tiranë 2008-2012

http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info_txt.php?id=1010&idn=15

http://www.visionaryvalues.com/wiki/images/Williamson_DemocracyandWashingtonConsensus.pdf

Millennium Development Goals Report 2011, f.54

http://www.undp.org/content/dam/undp/library/MDG/english/MDG_Report_2011_EN.pdf

http://www.wds.worldbank.org/external/default/WDSPContentServer/WDSP/IB/2004/08/05/0001606_040805112514/Rendered/PDF/29638.pdf

Fjalor Ekonomik

<http://www.economist.com/economics-a-to-z/i#node-21529948>

SHTOJCAT

Shtojca 1 Lista e 29 shoqërive dhe numrit të popullsisë me akses te uji/kanalizimet

Nr.	Emri Shoqërisë	Numri popullsisë që shërbehet me ujë	Numri popullsisë me akses te kanalizimet
1	Berat & Kuçovë	103743	87512
2	Burrel	23025	16475
3	Delvinë	6300	2092
4	Durrës	267612	181240
5	Elber (sh.p.k)	116000	112250
6	Ersekë	5900	5900
7	Fier	126250	76042
8	Fushë Arrëz	1986	1700
9	Fushë Krujë	9616	8360
10	Gjirokastër (Q)	33156	14025
11	Kamëz	40768	20104
12	Kavajë	61071	23751
13	Korçë (Q)	87500	77400
14	Krastë	2213	2013
15	Krujë	16837	16000
16	Kukës	40000	25000
17	Lezhë	31378	31706
18	Libohovë	3082	567
19	Librazhd	18812	16100
20	Lushnjë (Q)	47500	40000
21	Mallakastër	17975	10720
22	Mirditë	6074	5261
23	Pogradec	58142	43885
24	Pukë	2892	2112
25	Rrogozhinë	9007	3504
26	Rubik	2322	2207
27	Sarandë	43220	32346
28	Shkodër (Q)	82649	73465
29	Tiranë (Q)	828200	655000
	TOTALI për kampionin 29 shoqëri	2093226	1586735
	Totali i popullsisë 58 shoqëri	2573023	1586735
Pesha e Kampionit/Total i popullsisë		81%	100%

Shtojca 2

Intervista me Z.Avni Dervishi, Kryetar i Entit Rregullator të Ujit

Data e Intervistës: 24 Korrik, 2013- Tiranë

Pyetja 1: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK. Madje në Strategjinë Kombëtare në objektivat e politikës parashikohet që nga 57 shoqëri në vitin 2010 (periudhë kur po punohej për strategjinë) ky numër duhet të shkojë deri në 26 në vitin 2017.

1.1 A jeni të familjarizuar me këtë proces dhe a ka qënë ERRU pjesë e bisedimeve me Qeverinë për këtë vendim?

1.2 Cilat mendoni se do të jenë sfidat kryesore të ERRU, ligjore, instucionale dhe kapaciteteve profesionale (pengesat për ERRU) në kuadër të rajonizimit ?

Pyetja 2: Një ndër funksionet e ERRU është liçensimi i kompanive. Sipas raportimeve në website zyrtar të ERRU, kanë mbetur vetëm 2 kompani të paliçencuara. Kjo është një ecuri e mirë duke marre në konsideratë që nga 24 kompani të liçencuara në vitin 2008 ky numër ka shkuar në 56 shoqëri nga 58 shoqëri që operojnë aktualisht.

2.1 Cilat kanë qënë problemet kryesore të liçensimit.

2.2 Cilat kanë qënë pengesat kryesore për liçensimin e tyre

Pyetja 3: Ndër funksionet më kryesore të ERRU është politika tarifore. Sipas një studimi të Bankës Botërore për decentralimin i gushtit 2011 ERRU mbledh vetë të dhënat për kompanitë me qëllim miratimin e tarifave. Ndërkohë si strukturë e DPUK është Njësia për monitorimin e të dhënave të sektorit që ka filluar të grumbullojë të dhënat që nga viti 2006. Në faqen zyrtare të ERRU raportohet se Enti siguron të dhënat nga vetë operatorët si dhe nga Njësia e monitorimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizimeve.

3.1 Cila është marrëdhënia e ERRU me këtë njësi dhe a ka përputhje mes verifikimeve që ERRU siguron nga vetë kompanitë dhe Njësia për monitorimin e të dhënave?

Pyetja 4: Në Strategjinë Kombëtare përcaktohet hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e UK (Public Corporate Laë), që do të rregullojë veçanërisht çështjet që lidhen me kompanitë rajonale. Në Strategji parashikohet që ligji të jetë funksional në fund të muajit Qershor 2013.

4.1 A është miratuar një ligj i tillë dhe e ka qënë ERRU pjesë e bisedimeve?

Pyetja 5: Në kuadër të rajonalizimit ashtu si dhe në të gjitha vendet e tjera ku është aplikuar, është e pranueshme që tarifat të mos jenë të njëjta për të gjithë ofruesit e shërbimeve në varësi të kostos. Në *Strategjinë Kombëtare për Sektorin e UK për vitet 2011-2017* parashikohet vendosja e tarifave sezonale për zonat bregdetare. Gjithashtu përcaktohet se do të ishte e preferueshme një strukturë tarifash që bazohet në vlera fikse dhe volum.

ERRU me anë të një të metodologjie kërkon nga operatorët e ujit të aplikojnë tarifa më të larta për konsumatorët, që konsumojnë përtej kufirit minimal dhe tarifa të ulta për ata që konsumojnë më pak metër kub ujë.

5.1 A ka parashikuar ERRU ndonjë skenar lidhur me politikën e ardhshme tarifore duke patur parasysh që rritja e tarifave në kuadër të rajonizimit mund të shkaktojë përplasje me njësitë e pushtetit vendor të cilët përpiqen t'i ruajnë tarifat në nivele të ulta për të kënaqur elektoratin?

Pyetja 6: Në dokumentin e BB për decentralizimin i hartuar në 2011, parashikohet që duke filluar nga viti 2012, ERRU do të aplikojë një sistem tarifar 3 vjeçar dhe aprovimi do të bazohet në biznes planet e përgatitura nga shoqëria.

6.1 A është aplikuar deri tani sistemi tarifar 3 vjeçar? Sa shoqëri kanë filluar të përgatisin biznes planet 5 vjeçare?

Pyetja 7: Një ndër funksionet e mandatuara të ERRU është përcaktimi i standarteve kombëtare për shërbimet si dhe standartet për programin e investimeve dhe shitjen e aseteve, standarte që ndihmojnë për të matur performancën dhe subvencionet që pushteti qendror parashikon.

7.1 Ç'mund të na thoni për këto standarte ?

Pyetje 8: Disa shoqëri ofrojnë vetëm shërbimin e ujësjellësit dhe bashkia/komuna ofron shërbimin e kanalizimit. A ka ndonjë hap për t'i kaluar këto shërbime te një kompani e vetme?

Pyetje 9: Ç'mund të thoni për dy shoqëritë Tirana dhe Durrësi ?

Pyetje 10 : Lidhur me modelin e rekomanduar nga BB për rajonalizimin – Kush mund të jetë më i përshtatshëm ?

Pyetje 11: Kriteret e bashkimit mund të jenë sipas ndarjes administrative apo mbi bazën e aksesit te basenet?

Shtojca 3

Intervista me Z. Altin Uka, Komisioner pranë ERRU

Intervistuar më 19 Korrik, 2013-Tiranë

Pyetja 1: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK. Madje në Strategjinë Kombëtare në objektivat e politikës parashikohet që nga 57 kompani në vitin 2010 (periudhë kur po punohej për strategjinë) ky numër duhet të shkojë deri në 26 në vitin 2017.

1.1 A jeni të familjarizuar me këtë proces dhe a ka qënë ERRU pjesë e bisedimeve me Qeverinë për këtë vendim?

1.2 Mbi çfarë baze duhet të bëhet bashkimi, atë administrative apo të bazeneve?

Pyetja 2: Një ndër funksionet e ERRU është liçensimi i kompanive. Sipas raportimeve në website zyrtar të ERRU, kanë mbetur vetëm 2 kompani të paliçencuara. Kjo është një ecuri e mirë duke marrë në konsideratë që nga 24 kompani të liçencuara në vitin 2008 ky numër ka shkuar në 56 kompani nga 58 kompani që operojnë aktualisht.

2.1 Në kuadër të rajonalizimit çfarë mendoni për liçencimin e kompanive rajonale që do të krijohen?

Pyetja 3: Në kuadër të rajonalizimit ashtu si dhe në të gjitha vendet e tjera ku është zbatuar, është e pranueshme që tarifat të mos jenë të njëjta për të gjithë ofruesit e shërbimeve në varësi të kostos. Megjithatë duhet të synohet drejt kalimit gradual në tarifa uniforme.

3.1 Çfarë mund të thoni lidhur me tarifat uniforme?

Pyetja 4: Në dokumentin e BB për decentralizimin i hartuar në 2011, parashikohet që duke filluar nga viti 2012 ERRU do të aplikojë një sistem tarifar 3 vjeçar dhe aprovimi do të bazohet në biznes planet e përgatitura nga shoqëria.

4.1 A është aplikuar deri tani sistemi tarifar 3 vjeçar ? Sa shoqëri kanë filluar të përgatisin biznes planet 5 vjeçare?

Shtojca 4

Intervista me Z. Arjan Jovani, Komisioner pranë Entit Rregullator të Ujit

Data e Intervistës: 28 Shkurt, 2014- Tiranë

Pyetja 1: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK. Madje në Strategjinë Kombëtare në objektivat e politikës parashikohet që nga 57 shoqëri në vitin 2010 (periudhë kur po punohej për strategjinë) ky numër duhet të shkojë deri në 26 në vitin 2017.

1.1 *Cili është mendimi juaj si përfaqësues i ERRU në lidhje me këtë vendim dhe a keni qënë ju pjesë e bisedimeve?*

1.2 *Cilat mendoni se do të jenë sfidat kryesore të ERRU, ligjore, institucionale dhe kapaciteteve profesionale (pengesat për ERRU) në kuadër të rajonalizimit?*

Pyetja 2: Në kuadër të rajonalizimit ajo që diskutohet është gjetja e një modeli që mund të përshtatet në rastin e Shqipërisë. Nga eksperiencia ndërkombëtare ka rezultuar se nuk ka një model unik universal që do të mund të aplikohet në rastin e Shqipërisë. Nga një studim i BB është rekomanduar që në rastin e Shqipërisë modeli duhet të marrë parasysh jo vetëm kriterin ekonomik, por dhe atë social, gjeografik, historik.

Gjithashtu në Strategjinë Kombëtare përcaktohet hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e UK (Public Corporate Law), që do të rregullojë veçanërisht çështjet që lidhen me shoqëritë rajonale. Në Strategji parashikohet që ligji të jetë funksional në fund të muajit Qershor 2013.

Kur flasim për modelin që të jetë i zbatueshëm ka këto karakteristika:

- Kufijtë e bashkimit: mbi ndarje administrative apo të aksesit në basenet lumore
- Qëllimi i bashkimit: të dyja shërbimet, dhe funksionet që nga operimi deri te investimi
- Mënyrat e bashkimit: vullnetar, por me incentiva nga pushteti qendror apo komplet nga pushteti vendor
- Kuadri ligjor: me ligj të veçantë apo jo
- Financimi: Partneritet Publik Privat apo tërësisht kompani private rajonale.

2.1 Cili është mendimi juaj për modelin e rajonalizimit sipas secilës karakteristikë?
Ç'mund të na thoni për kriteret teknike, gjeografike, ekonomike, sociale a janë të realizueshme?

2.2 A mendoni se mund të konsiderohet çështja e rajonalizimit pa një ligj të tillë?

2.3 Cilat rajone mendoni ju se mund të bashkohen si fillim?

2.4 Cila mund të jetë vështirësia nga këndvështrimi i pushtetit vendor për të realizuar rajonalizimin?

2.5 Duke qenë se stafi do të pakësohet kur të kemi rajonalizimin a ka përllogaritje të impaktit të uljes së kostos së personelit duke e targetuar si pjesë të strategjisë afatmesme dhe afat gjatë?

Pyetja 3: Ndër funksionet më kryesore të ERRU është politika tarifore. Në metodologjinë e hartuar në vitin 2011, neni 4 te objektivi i përballueshmërisë përcaktohet se në përputhje me standartet ndërkombëtare, shtresat me të ardhura të ulta të popullsisë nuk duhet të paguajnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Po kështu sipas objektivit të efikasitetit mjedisor struktura e tarifave duhet të përcaktojë tarifa më të larta, për konsumatorët me nivel të lartë konsumi me qëllim inkurajimin e ruajtjes së burimeve dhe një nivel konsumi të qëndrueshëm, duke patur parasysh edhe çështjet mjedisore.

3.1 Së pari, a mund të na thoni cila është referenca ndërkombëtare dhe së dyti, a ka ERRU një përllogaritje nqs tarifat aktuale e zbatojnë këtë kriter orientues, dhe çfarë ndodh kur faturimi është më i madh se ky kufi, ka element subvencionues apo amortizues të kësaj ngarkese, që prek shpenzime të tjera domethënë të shtresave të varfëra ?

3.2 Në dokumentet e saj në website ERRU raporton se për të siguruar barazi në drejtim të politikës tarifore, kërkon nga operatorët e ujit të aplikojnë tarifa më të larta për konsumatorët, që konsumojnë përtej kufirit minimal.

- A ka studime referuese për konsumin minimal?

- Ka ndonjë metodologji?

- A ka debate lidhur me këtë kufi në Shqipëri, shumë i ulët apo i lartë dhe abuzues? dhe tarifa të ulta për ata që konsumojë më pak metër kub ujë?

Pyetja 4: Shoqëritë Tirana dhe Durrës janë shoqëri rajonale. Ndonëse të dhënat tregojnë për rezultate pozitive të dyja këto shoqëri kanë tregues problematikë si psh. uji pa të ardhura që është në nivele të mëdha.

4.1 A mund të merren si shembull pozitiv për të menduar për rajonalizimin?

Pyetja 5: Në Shqipëri pjesëmarrja e sektorit privat në formën e Partneritetit Publik Privat ka dështuar (Rasti i Elbasanit- kontrata e konçensionit me Elber dhe rasti i Kavajës, kontrata e menaxhimit). KfW ka bërë vlerësime dhe ka nxjerrë arsyet përse ka dështuar.

5.1 Nga këndvështrimi i ERRU përse kanë dështuar këto raste të pjesëmarrjes private?

A mendoni se zgjidhja e vështirësive të sektorit është nëpërmjet PPP? Në rast se jo cili është mendimi juaj për daljen e sektorit nga vështirësitë?

Shtojca 5

Intervista me Zj. Ana METOHU

Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe të Monitorimit pranë Entit Rregullator të Ujit

Data e Intervistës: 13 Korrik, 2013- Tiranë

Pyetja 1: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK. Madje në Strategjinë Kombëtare në objektivat e politikës parashikohet që nga 57 shoqëri në vitin 2010 (periudhë kur po punohej për strategjinë) ky numër duhet të shkojë deri në 26 në vitin 2017.

1.1 A jeni të familjarizuar me këtë proces dhe a ka qënë ERRU pjesë e bisedimeve me Qeverinë për këtë vendim?

1.2 Cilat mendoni se do të jenë sfidat kryesore të ERRU, ligjore, institucionale dhe kapaciteteve profesionale (pengesat për ERRU) në kuadër të rajonalizimit?

Pyetja 2: Një ndër funksionet e ERRU është liçensimi i shoqërive. Sipas raportimeve në website zyrtar të ERRU, kanë mbetur vetëm 2 shoqëri të paliçencuara. Kjo është një ecuri e mirë duke marrë në konsideratë që nga 24 shoqëri të liçencuara në vitin 2008 ky numër ka shkuar në 56 shoqëri nga 58 shoqëri që operojnë aktualisht.

2.1 Në kuadër të rajonalizimit çfarë mendoni për liçencimin e shoqërive rajonale që do të krijohen?

Pyetja 3: Ndër funksionet më kryesore të ERRU është politika tarifore. Sipas një studimi të Bankës Botërore për decentralizimin i gusht 2011 ERRU mbledh vetë të dhënat për shoqëritë me qëllim miratimin e tarifave. Ndërkohë si strukturë e DPUK është Njësia për Monitorimin e të dhënave të sektorit që ka filluar të grumbullojë të dhënat që nga viti 2006.

3.1 Cila është marrëdhënia e ERRU me këtë njësi dhe a ka përputhje mes verifikimeve që ERRU siguron nga vetë shoqëritë dhe Njësia për Monitorimin e të dhënave?

Pyetja 4: Në Strategjinë Kombëtare përcaktohet hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve (Public Corporate Law), që do të rregullojë veçanërisht çështjet që lidhen me shoqëritë rajonale. Në Strategji parashikohet që ligji të jetë funksional në fund të muajit Qershor 2013.

4.1 A është miratuar një ligj i tillë dhe e ka qënë ERRU pjesë e bisedimeve?

Pyetja 5: Në kuadër të rajonalizimit ashtu si dhe në të gjitha vendet e tjera ku është zbatuar, është e pranueshme që tarifa të mos jenë të njëjta për të gjithë ofruesit e shërbimeve në varësi të kostos. Në *Strategjinë Kombëtare për Sektorin e UK për vitet 2011-2017* parashikohet vendosja e tarifave sezonale për zonat bregdetare. Gjithashtu përcaktohet se do të ishte e preferueshme një strukturë tarifash që bazohet në vlera fikse dhe volum. ERRU me anë të një të metodologjie kërkon nga operatorët e ujit të aplikojnë tarifa më të larta për konsumatorët, që konsumojnë përtej kufirit minimal dhe tarifa të ulta për ata që konsumojnë më pak metër kub ujë. Periudha kur është miratur metodologjia përkon me kohën kur u përgatit një studim fizibiliteti nga Banka Botërore për rajonalizimin e shoqërive të UK.

5.1 A është marrë parasysh në metodologjinë e vendosjes së tarifave koncepti i rajonalizimit? Nëse jo cili është mendimi juaj lidhur me politikën tarifore ?

5.2 A ka parashikuar ERRU ndonjë skenar lidhur me politikën e ardhshme tarifore duke patur parasysh që rritja e tarifave në kuadër të rajonalizimit mund të shkaktojë përplasje me njësitë e pushtetit vendor të cilët përpiqen t'i ruajnë tarifat në nivele të ulta për të kënaqur elektoratin?

Pyetja 6: Në dokumentin e BB për decentralizimin i hartuar në 2011, parashikohet që duke filluar nga viti 2012 ERRU do të aplikojë një sistem tarifar 3 vjeçar dhe aprovimi do të bazohet në biznes planet e përgatitur nga shoqëria.

6.1 A është aplikuar deri tani sistemi tarifar 3 vjeçar ? Sa shoqëri kanë filluar të përgatisin biznes planet 5 vjeçare ?

6.2 Cili/cilat rajone mund të jenë si pilot pra cilat shoqëri do të ishin të gatshme për të eksperimentuar këtë proces?

Pyetja 7: Një ndër funksionet e mandatuara të ERRU është përcaktimi i standarteve kombëtare për shërbimet si dhe standartet për programin e investimeve dhe shitjen e aseteve, standarte që ndihmojnë për të matur performancën dhe subvencionet që pushteti qendror parashikon.

7.1 Ç'mund të na thoni për këto standarte ?

Shtojca 6

Intervista me Zj.Vilma Bibolli/ Drejtor, Njësia e Monitorimit të të dhënave &
Benchmarking

Data e Intervistës: 31 Korrik 2013

Pyetja 1: Stafi i Njesisë grumbullon çdo tremujor rreth 203 të dhëna sasiore mbajtur me bazë mujore nga të gjitha shoqëritë e përfshira në programin e monitorimit. Regjistrohen të dhënat në program, bëhet verifikimi i tyre dhe nëse identifikohen gabime, bëhen korigjimet përkatëse.

1.1 Në ç'mënyrë bëni verifikimin e të dhënave?

1.2 ERRU ka gjithashtu përgjegjësinë që të verifikojë dhe hetojë të dhënat. Cili është bashkëpunimi juaj me ERRU për të konsoliduar dhe verifikuar të dhënat?

1.3 A bën Ministria e Financave verifikimin e të dhënave mbi bazën e të cilit bazohet dhënia e subvencionit? Po në lidhje me përdorimin e tij?

Pyetja 2: Në raportin e Benchmarkut të dhënat për investimet që shoqëritë raportojnë nëpërmjet pyetësorit, vazhdojnë të jenë të pabesueshme. Ka faktorë objektivë dhe subjektivë që ndikojnë në saktësinë e këtij lloji informacioni.

2.1 Ku bazoheni në arritjen e këtij konkluzioni dhe cilët janë këta faktorë objektivë dhe subjektivë?

Pyetja 3: Analiza e trendit historik 2006-2010 për sektorin e UK kanë shërbyer në përcaktimin e prognozës së sektorit deri në vitin 2017 siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare të Sektorit. Stafi i Njesisë së Monitorimit ka dhënë një kontribut të madh për hartimin e planit të veprimeve të Strategjisë, të cilët janë shumë konkretë pasi në çdo hap mbështeten në treguesit realë e të matshëm të performancës.

3.1 A janë përmbushur plan veprimet sipas përcaktimit në Strategji?

3.2 A bën Njësia ndonjë klasifikim të shoqërive që performojnë më mirë dhe më dobët mbi bazën e ndonjë benchmark?

Pyetja 4: Në raportin e Benchmarkut një ndër sfidat e ardhshme që përmendet është forcimi i rolit të Njesisë në aspektin e vlerësimit të nevojave për investimet në sektor, i cili do të mundësohet nëpërmjet hartimit të Masterplanit Kombëtar të Investimeve dhe monitorimit të tij. Vlerësimi i nevojave për investime në sektor duket se arrihet deri

diku nëpërmjet Programit Buxhetor Afat-mesëm ku përcaktohen objektiva që maten me indikatorë. Në PBA jepet në mënyrë të detajuar shpenzimet sipas projekteve në periudhë afat-mesme.

Deri në vitin 2020 raporti mesatar i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë popullsinë e vendit do të jetë 98% nga 80.8 % në vitin 2011. Raporti mesatar i mbulimit me shërbime KUZ nga 50.8 % në vitin 2011 në 77 %, si dhe mbulimi me shërbim të trajtimit të ujrave të ndotura në impjante trajtimi nga 4% në vitin 2011 në 50%. Orientimi i shoqërive të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove drejt mbulimit 100% të Kostos Direkte të Operimit (KDO) me të ardhurat deri në 2015 në të gjitha shoqëritë UK dhe më tej mbulimin e të gjitha kostove në vitin 2020. Rritja e kapaciteteve të stafit menaxhues dhe të operim mirëmbajtjes. Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit Shqiptar me direktivat e BE-së për sektorin. Inkurajimi i bashkimit të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve. Siç shohim në PBA jepet objektivi deri në vitin 2020. Ndërkohë në Strategjinë UK objektivat janë deri në 2017.

4.1 A ka përputhje mes treguesve të të dy dokumentave?

4.2 A keni qënë pjesë e Masterplanit Kombëtar që sapo është përfunduar?

4.3 A nuk do të ishte mirë që në të ardhmen Njësia të kishte database të investimeve që jepen per arritjen e disa objektivave te matshëm duke treguar nevojën dhe masën e plotësimit të objektivave nëpërmjet investimeve ?

4.4 Cili është bashkëpunimi juaj me pushtetin vendor si pronar të shoqërive? A keni informacion në përdorimin e të dhënave që ju monitoroni?

Pyetja 5: Në Strategjinë Sektoriale të ujit 2011-2017 thuhet se një ndër masat është hartimi dhe zbatimi i një programi subvencionesh për familjet e varfra. Po kështu në raportin e benchmarkut si sfidë e ardhshme përmendet forcimi i rolit të njësisë në aspektin e vlerësimit të nevojave për subvencione nëpërmjet hartimit të metodikave e skemave sa më efikase të subvencionimit me qëllim reduktimin e tyre nëpërmjet rritjes së performancës dhe aplikimi i subvencioneve për shtresat në nevojë.

5.1 A janë hartuar metodikat e skemave të subvencionimit?

5.2 Duke qënë se pushteti vendor është pronar i shoqërive të UK a mendoni se duhet kaluar përgjegjësia e subvencionit pushtetit vendor, i cili bën më pas shpërndarjen e tij në përputhje me listat e familjeve të varfra?

Çfarë mund të thoni lidhur me bashkëpunimin me institucionet e përfshira në çështjen e subvencionit si MoF, MPCs?

Pyetja 6: Në raportin e Benchmarkut përmendet zgjerimi i juridiksionit të zbatimit të programit të monitorimit nëpërmjet përfshirjes në të edhe të shërbimit të kanalizimeve në rastet kur nuk është, si dhe përfshirjen e të gjithë operatorëve të tjerë të licencuar (komuna) që ofrojnë shërbimin e UK. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që te jepet një panoramë më e plotë për sektorin, në nivel kombëtar; zgjerimi i programit të monitorimit nëpërmjet përfshirjes në të, të informacionit për impjantet e trajtimit të ujërave të përdorura urbane, si dhe disa të dhënave dhe treguesve shtesë, të cilët do të mundësojnë analiza edhe më cilësore e gjithëpërfshirëse, në vazhdim.

6.1 Cili është kontributi i Njesisë për monitorimin e të dhënave të kanalizimeve dhe të impjanteve të trajtimit të ujërave të përdorura urbane ?

Pyetja 7: Në Strategjinë Kombëtare 2011-2017 Qeveria Shqiptare përcakton rajonalizimin si një mënyrë për të zgjidhur çështjen e performancës së dobët të shoqërive dhe përfitimit të investimeve.

7.1 A keni qënë pjesë e procesit të diskutimit të rajonizimit? Po për ligjin e ri që propozohet?

Shtojca 7

Intervista me Zj. Ljutvilda Gugushka
Drejtor, Drejtoria e Rajonalizimit dhe Politikave, MPPT
Data e Intervistës: 29 Korrik 2013

Pyetja 1: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, pika 1.4.7 ka parashikuar se do të zbatojë vendimin për të shkuar drejt bashkimit të shoqërive me konceptin e vullnetit të lirë me stimuj ekonomikë nga pushteti Qendror.

Pyetje: Për çfarë vendimi bëhet fjalë dhe çfarë përmban ?

1.2 Cilat mendoni se do të jenë sfidat kryesore të ERRU, ligjore, institucionale dhe kapaciteteve profesionale (pengesat për ERRU) në kuadër të rajonalizimit ?

Pyetja 2: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK. Madje në Strategjinë Kombëtare në objektivat e politikës parashikohet që nga 57 shoqëri në vitin 2010 (periudhë kur po punohej për strategjinë) ky numër duhet të shkojë deri në 26 në vitin 2017.

Pyetje: A është bërë ndonjë studim për zvogëlimin e SHUK nga 57 në 26?

Pyetja 3: Në Strategji përmendet se është e nevojshme hartimi i legjislacionit për përafrim të tij me Direktivat BE duke futur konceptin “përdoruesi paguan”. Çfarë është bërë në këtë drejtim?

Pyetja 4: Në Strategji pika 1.5.1 thuhet se kuadri ligjor për pjesëmarrjen e sektorit privat është i mjaftueshem.

A ka ndonjë zhvillim tjetër duke patur parasysh se Strategjia është miratuar në vitin 2011?

Pyetja 5: Në Strategjinë Kombëtare përcaktohet hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e UK (Public Corporate Law), që do të rregullojë veçanërisht çështjet që lidhen me shoqëritë rajonale. Në Strategji parashikohet që ligji të jetë funksional në fund të muajit Qershor 2013. Ky ligj do të përcaktojë:

- statutet dhe pronësinë e shoqërive rajonale
- parimet dhe inventarin dhe vlerësimin e aseteve
- hyrjen dhe daljen nga tregu

- strukturat e shërbimeve të bashkuara të shitjes me pakicë.

A është miratuar një ligj i tillë dhe me kë po bashkëpunon MPPT për këtë ligj?

Pyetja 6: Në Strategji, pika 1.5.3 përmendet se Qeverisë do t'i kërkohen subvencione për kategoritë me të ardhura të ulta.

Çfarë është bërë në këtë drejtim?

Shtojca 8

Intervista me Afrida Saraci, Shefe e Sektorit të Monitorimit të Buxhetit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Buxhetit në Ministrinë e Brendshme

Data e Intervistës: 26 Korrik 2013, Tiranë

Pyetja 1: Sipas ligjit të decentralizimit njësitë e qeverisjes vendore kanë në pronësi ujësjellësat. Ndërkohë pronësia e shoqërisë UK Durrës ende nuk i ka kaluar pushtetit vendor më saktë Bashkisë Durrës. Cilat janë arsyet?

Pyetje 2: Te Strategjia 2011-2017 përmendet ideja e bashkimit të shoqërive dhe krijimit të rajoneve, sepse shoqëritë janë të vogla, të copëzuara. Te kjo strategji përmendet Ministria e Brendshme për hartimin e një ligji të ri specifik që do të rregullojë çështjen e bashkimit dhe ka mbivendosje institucionesh. Ç'mund të na thoni për këtë ligj?

Pyetje 3: Disa shoqëri i kanë shërbimet bashkë, disa të ndara? Pse ndodh kjo situatë dhe a ka ndonjë plan që shërbimet të bashkohen?

3.1 Po tarifa për kanalizimet a është aplikuar?

Pyetje 4: Politika e subvencionit a duhet të mbulojë shtresat në nevojë apo humbjet financiare të kompanive?

Shtojca 9

Intervista me Zj. Gelardina Prodani, Drejtor, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, MoF

Data e Intervistës: 31 Korrik 2013, Tiranë

Pyetja 1: Si sigurohet MoF për përputhjen e treguesve dhe nevojave për financim ndërmjet PBA-së dhe Strategjisë Sektoriale ?

Pyetja 2: A ka ndonjë akt tjetër ligjor që rregullon subvencionin?

Pyetja 3: A kushtëzohet dhënia e subvencionit me kushtin e përmirësimit të treguesve operacionalë dhe financiarë?

Pyetja 4: A bën Ministria e Financave verifikimin e të dhënave mbi bazën e të cilit bazohet dhënia e subvencionit? Po në lidhje me përdorimin e tij

Pyetja 5: Cilat janë parimet e dhënies së këtyre transfertave? A lidhen këto me përmirësimin e performancës së shërbimit të UK?

Pyetja 6: A është hartuar ndonjë program i tillë?

Pyetja 7: Me cilin Institucion bashkëpunoni, DPUK, MPCSB?

Pyetja 8: Në rast se jo çfarë politike ka Ministria për reduktimin e subvencionit?

Pyetja 9: A mund t'ja kaloni përgjegjësinë e subvencionit pushtetit vendor, i cili bën më pas shpërndarjen e tij në përputhje me listat e familjeve të varfra?

Pyetja 10: Përse nuk u realizua politika e Qeverisë për uljen çdo vit të subvencionit të ujit 10% deri sa të arrijë 0 për 4 vjet sipas DPO 1 ?

Shtojca 10

Intervista me Z. Dokllead Ademi, Drejtor i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Durrës dhe

Kryetari i Shoqatës së Bashkisë

Data e Intervistës: 25 Korrik 2013, Durrës

Pyetja 1: Sa komuna dhe shoqëri të vogla jashtë bashkisë Durrës ekzistojnë?

Pyetja 2: A janë transferuar asetet e shoqërisë Durrës te pushteti vendor dmth a është Bashkia pronare ?

Pyetja 3: A ndeshet shoqëria me problemin e zhvillimeve të pakontrolluara urbane? A ka ndonjë plan për kontrollin urban dhe peri-urban?

Pyetja 4: Shoqëria është rajonale në vetvete, por ka disa tregues të performancës teknikë dhe financiarë që janë ende larg standarteve. Përveç arsyeve të sipërpërmendura a ka arsye të tjera?

4.1 Pse donatorët nuk financojnë?

Pyetja 5: Përse uji që nuk sjell të ardhura është në nivele të larta? (për shkak të amortizimit të rrjeteve, për shkak të lidhjeve të paligjshme ?). A janë të pamjaftueshme financimet nga Qeveria për investimet? A janë të pamjaftueshme financimet nga Donatorët?

Pyetja 6: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK.

6.1 A jeni të familjarizuar me këtë proces?

6.2 A do të preferonit të lidhnit një kontratë me Bashkinë për ofrimin e shërbimeve?

Shtojca 11

Intervista me Z. Taulant Zeneli, Drejtor-Bashkia Tiranë

Data e Intervistës: Shtator, 2013

Shoqëria e Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë

Pyetja 1: Sa komuna dhe shoqëri të vogla jashtë bashkisë së Tiranës ekzistojnë? Sa përqind të aksioneve zotëron Bashkia Tiranë?

Pyetja 2: Përse është vonuar procesi i marrjes së pronësisë së shoqërisë nga Bashkia Tiranë? Në raportin e Fizibilitetit të BB Bashkia Tiranë ka deklaruar se nuk e merr pronësinë për shkak se me strukturën e një bordi mbikqyrës të shoqërisë të zgjedhur nga Këshilli Bashkiak (përfaqësues i shumë forcave politike) mund t'i rrezikojë kontrollin direkt të menaxhimit të shoqërisë. Kjo sepse Kryetari ka përgjegjësinë direkte përpara qytetareve.

Pyetja 3: A ndeshet Bashkia me problemin e zhvillimeve të pakontrolluara urbane? A ka ndonjë plan për kontrollin urban dhe peri-urban?

Pyetja 4: Cili është bashkëpunimi juaj me shoqërinë UK Tiranë? A keni ndonjë marrëveshje performance me shoqërinë?

Pyetja 5: Shoqëria është rajonale në vetvete, por ka disa tregues të performancës teknike dhe financiare që janë ende larg standarteve. Si shpjegohet?

Pyetja 6: A janë të pamjaftueshme financimet nga Qeveria për investimet? A janë të mjaftueshme financimet nga Donatorët?

Pyetja 7: Po në lidhje me komunat në zonat më të thella arrijnë ato të arkëtojnë ujin e faturuar? Në rast se jo a paguajnë qytetarët e Tiranës një tarifë më të lartë përmes skemës së subvencionit të kryqëzuar për të mbuluar mosarkëtimet nga komunat më të thella? Si i ndihmon Bashkia komunat për investime?

Pyetja 8: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK.

A jeni të familjarizuar me këtë proces ? A mendoni se do ishte e përshtatshme të ekzistojë një shoqëri e vetme që të përfshijë Tiranën, komunat dhe Kamzën?

Shtojca 12

Intervista me Z. Bledar Dollaku, Kordinator projektesh pranë KfW

Data e Intervistës: 25 Korrik 2013, Tiranë

Financimi nga donatorët dhe institucionet e huaja është burimi kryesor i investimeve në sektorin e UK në Shqipëri. Totali i fondeve të angazhuara nga të gjithë donatorët për sektorin për periudhën 2000-2012 është 662.98 milionë Euro nga ku niveli i disbursimeve për këtë periudhë është 354.16 milionë Euro ose 54%. Financimi nga KfW për sektorin në periudhën 2000-2012 është 277 708 387 Euro dhe niveli i disbursimeve është 153 895 746 Euro ose 55% (Departamenti për Koordinimin e Donatorëve, Këshilli i Ministrave).

Pyetja 1: Të dhënat e mësipërme tregojnë se niveli i disbursimeve krahasuar me nivelin e fondeve të angazhuara është i ulët për afërsisht 55%. Cilat mendoni se janë arsyet e këtij niveli të ulët disbursimi ?

Pyetja 2: Cilat ishin mësimet e nxjerra nga kjo përvojë që sipas KfW ishte një projekt që nuk i arriti rezultatet në rastin e konçensionit të Elbasanit ?

2.1 Përse KfW mendonte që kontrata e menaxhimit do të kishte qënë më e përshtatshme kur dihet se kontrata e menaxhimit do të duhej gjithsesi të arrinte disa tregues të performancës si mbulimi i kostos, rritja e tarifave dhe databazë e besueshme?

Pyetja 3: Cilat janë mësimet e nxjerra nga kontrata e menaxhimit në Kavajë?

Pyetja 4: Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 ka parashikuar rajonalizimin e shoqërive të UK.

4.1 A jeni të familjarizuar me këtë proces dhe a ka qënë KfW pjesë e bisedimeve me Qeverinë për të asistuar? Në rast se po në çfarë drejtimesh mendoni të mbështesni qeverinë?

4.2 Nga eksperiencia e përfshirjes suaj në projekte në Shqipëri në kuadër të krijimit të rajoneve cila formë e pjesëmarrjes PSP mund të ishte më e përshtatshme (Konçension, Leasing, Menaxhim, Privatizim etj) ?

Pyetja 5: Auditori vjen një herë në 6 muaj. Të dhënat i merrni nga shoqëritë apo nga DPUK?

Shtojca 13

Intervista me Z. Arben Bakllamaja-ekspert në sektorin e ujësjellës kanalizimeve

Data e Intervistës: 30 Korrik 2013-Tiranë

Në Strategjinë për Decentralizimin të Gusht 2011 të përgatitur nga Banka Botërore përmendet se ka lidhje të ngushtë mes shërbimit të dobët dhe mungesës së qeverisjes: Instrumentat ligjore, ekonomikë dhe administrative.

Pyetja 1: A mendoni se ka mangësi të kuadrit ligjor që rregullon sektorin e UK?

Pyetja 2: Shoqëritë që mendohet të bashkohen, a mendoni që do ishin të gatshme. Pasi do jenë shoqëritë me vullnet të lirë por kjo duket e vështirë. Psh. Korça qytet dhe Korça fshat.

Performancën ku e shikoni?

Pyetja 3: Çfarë mund të thoni për instrumentat ekonomikë të tilla si tarifat, investimet kapitale dhe subvencionet? Tarifat kanë një metodologji shumë të mirë me blloqe dhe është hartuar pas studimit të fizibilitetit të BB.

Pyetja 4: Sa të besueshme janë të dhënat për subvencionet. ERRU bën verifikime të të dhënave, por ka patur mosrakordim të të dhënave më Njësinë. A e kërkon subvencionin DPUK mbi bazën e të dhënave që ja dërgon MeF?

Shtojca 14

Intervista me Z. Philip D. Giantris, President i Valu Add Management

Data e Intervistës: Tetor 2013, Tiranë

Pyetja 1: Ka një studim Fizibiliteti të Bankës Botërore i hartuar në 2009 për Rajonalizimin. Çfarë mund të na thoni për këtë studim si pjesë e hartimit të tij ?

Pyetja 2: Cilat mendoni se janë kriteret e përzgjedhjes së rajoneve pilot të rajonalizimit?

Pyetja 3: Po në lidhje me Ligjin për Korporatat Publike ç'mund të na thoni?

Pyetja 4: A ka studime të tjera në fushën e ujit ?

Shtojca 14

Renditja finale e shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2006

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Elber</i>	<i>Elber</i>	<i>Elber</i>
<i>Berat & Kuçovë</i>	<i>Berat & Kuçovë</i>	<i>Berat & Kuçovë</i>
<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	<i>Fier</i>
Shkodër	Shkodër	Shkodër
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Korçë	Korçë	Korçë
Lushnje	Lushnje	Lushnje
Burrel	Burrel	Burrel
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Krujë	Krujë	Krujë
Ersekë	Ersekë	Ersekë
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Librazhd	Librazhd	Librazhd
<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>
<i>Fushë Krujë</i>	<i>Fushë Krujë</i>	<i>Fushë Krujë</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>

Shtojca 15

Renditja finale e shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2007

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Berat & Kuçovë</i>	<i>Berat & Kuçovë</i>	<i>Berat & Kuçovë</i>
<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	<i>Fier</i>
<i>Shkodër</i>	<i>Shkodër</i>	<i>Shkodër</i>
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Korçë	Korçë	Korçë
Lushnje	Lushnje	Lushnje
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Burrel	Burrel	Burrel
Krujë	Krujë	Krujë
Ersekë	Ersekë	Ersekë
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Librazhd	Librazhd	Librazhd
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Pukë	Pukë	Pukë
<i>Fushë Krujë</i>	<i>Fushë Krujë</i>	<i>Fushë Krujë</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>
<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>

Shtojca 16

Renditja finale e shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2008

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>
<i>Elber</i>	<i>Elber</i>	<i>Elber</i>
<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	<i>Fier</i>
Shkodër	Shkodër	Shkodër
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Korçë	Korçë	Korçë
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Lushnjë	Lushnjë	Lushnjë
Burrel	Burrel	Burrel
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Krujë	Krujë	Krujë
Ersekë	Ersekë	Ersekë
Kukës	Kukës	Kukës
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Mallakastër	Mallakastër	Mallakastër
Librazhd	Librazhd	Librazhd
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Pukë	Pukë	Pukë
<i>Fushë Krujë</i>	<i>Fushë Krujë</i>	<i>Fushë Krujë</i>
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Fushe Arrëz</i>	<i>Fushe Arrëz</i>	<i>Fushe Arrëz</i>
<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>

Shtojca 17

Renditja finale e shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2009

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>
<i>Elber</i>	<i>Elber</i>	<i>Elber</i>
<i>Shkodër</i>	<i>Shkodër</i>	<i>Shkodër</i>
Fier	Fier	Fier
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Korçë	Korçë	Korçë
Lushnje	Lushnje	Lushnje
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Burrel	Burrel	Burrel
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Krujë	Krujë	Krujë
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Ersekë	Ersekë	Ersekë
Kukës	Kukës	Kukës
Mallakastër	Mallakastër	Mallakastër
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Librazhd	Librazhd	Librazhd
Fushë Krujë	Fushë Krujë	Fushë Krujë
<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>
<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>

Shtojca 18

Renditja finale e shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2010

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>
<i>Elber</i>	<i>Elber</i>	<i>Elber</i>
<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	<i>Fier</i>
Shkodër	Shkodër	Shkodër
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Korçë	Korçë	Korçë
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Lushnje	Lushnje	Lushnje
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Burrel	Burrel	Burrel
Krujë	Krujë	Krujë
Kukës	Kukës	Kukës
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Ersekë	Ersekë	Ersekë
Librazhd	Librazhd	Librazhd
Mallakastër	Mallakastër	Mallakastër
Fushë Krujë	Fushe Krujë	Fushe Krujë
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>
<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>
<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>

Shtojca 19

Renditja finale e shoqërive UK sipas modeleve stokastike të funksionit të kostos për vitin 2011

Modeli Volumit	Modeli i Popullsisë	Modeli i Lidhjeve
<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>	<i>Tiranë</i>
<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>	<i>Durrës</i>
<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>	<i>Berat Kuçovë</i>
<i>Elber</i>	<i>Elber</i>	<i>Elber</i>
<i>Fier</i>	<i>Fier</i>	<i>Fier</i>
Shkodër	Shkodër	Shkodër
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë
Sarandë	Sarandë	Sarandë
Korçë	Korçë	Korçë
Lushnje	Lushnje	Lushnje
Lezhë	Lezhë	Lezhë
Kavajë	Kavajë	Kavajë
Pogradec	Pogradec	Pogradec
Burrel	Burrel	Burrel
Kukës	Kukës	Kukës
Krujë	Krujë	Krujë
Kamëz	Kamëz	Kamëz
Mirditë	Mirditë	Mirditë
Librazhd	Librazhd	Librazhd
Ersekë	Ersekë	Ersekë
Mallakastër	Mallakastër	Mallakastër
Fushë Krujë	Fushë Krujë	Fushë Krujë
Delvinë	Delvinë	Delvinë
<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>	<i>Rubik</i>
<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>	<i>Rrogozhinë</i>
<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>	<i>Pukë</i>
<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>	<i>Fushë Arrëz</i>
<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>	<i>Krastë</i>